

**MBINGARKESA KURRIKULARE NË ARSIMIN
FILLOR DHE TË MESËM TË ULËT NË KOSOVË**
(Realitet apo perceptim?)

**MBINGARKESA KURRIKULARE NË ARSIMIN
FILLOR DHE TË MESËM TË ULËT NË KOSOVË**
(Realitet apo perceptim?)

MBINGARKESA KURRIKULARE NË ARSIMIN FILLOR DHE TË MESËM TË ULËT NË KOSOVË - (Realitet apo perceptim?)

Realizuar nga:

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Koordinuar nga:

Selim Mehmeti

Ekipi hulumtues dhe autorët e raportit:

Selim Mehmeti, Haxhere Zylfiu, Skender Mekolli, Mevlude Aliu-Gashi, Luljeta Shala dhe Ismet Potera

Botues:

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Për botuesin:

Nezir Çoçaj, drejtor

Këshilli Shkencor i IPK-së:

Prof. dr. Hajrullah Koliqi

Prof. asoc. dr. Naser Zabeli

Prof. asoc. dr. Hatixhe Ismajli

Prof. asoc. dr. Linda Grapci

Korrektues gjuhësor:

Bekim Morina

Përgatitja teknike:

Skender Mekolli

Shtypi:

Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë

Përmbajtja

Lista e tabelave	7
Lista e figurave	10
Lista e shkurtesave	12
Parathënie	13
Përmbledhje.....	17
Abstract.....	19
KAPITULLI I - Hyrje	21
1.1. Konteksti i studimit	21
1.2. Nevoja për këtë studim.....	22
1.3. Shtrimi i problemit të studimit	24
1.4. Objekti dhe qëllimi i studimit.....	25
1.5. Pyetjet kërkimore	27
1.6. Rëndësia e studimit	28
1.7. Konceptet kryesore.....	28
KAPITULLI II - Shqyrtimi i literaturës.....	35
2.1. Zhvillimi - rishikimi i kurrikulave	35
2.2. Mbingarkesa kurrikulare - faktorët ndikues	39
2.3. Ndikimi i mbingarkesës së kurrikulës në mirëqenien e nxënësve	52
2.4. Ndikimi i mbingarkesës së kurrikulës në punën dhe mirëqenien e mësimeve.....	55
2.5. Strategjitë për trajtimin dhe zvogëlimin e mbingarkesës kurrikulare	57
KAPITULLI III - Metodologjia e hulumtimit	65
3.1. Dizajni i hulumtimit.....	65
3.2. Popullata dhe mostra	67
3.3. Instrumentet për mbledhjen e të dhënave	69
3.4. Mbledhja dhe analiza e të dhënave	73
3.5. Kufizimet e studimit	74
3.6. Aspekti etik i studimit	75

KAPITULLI IV - Rezultatet e hulumtimit.....77

4.1. Gjetjet nga analiza e kurrikulave77

4.1.1. Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar në Kosovë..... 78

4.1.2. Kurrikulat Bërthamë 79

4.1.3. Gjetjet nga analiza e kurrikulave lëndore/ programeve
mësimore 92

4.1.4. Disa gjetje specifike nga analiza e kurrikulave lëndore/
programeve mësimore në arsimin fillor95

4.1.5. Disa gjetje specifike nga analiza e kurrikulave lëndore/
programeve mësimore në arsimin e mesëm të ulët 103

4.2. Gjetjet nga analiza e disa faktorëve të ndërlidhur me kurrikulën dhe krahasimi i tyre me disa shtete të rajonit dhe oeOECD-së..... 110

4.2.1. Koha e mësimin të detyrueshëm në arsimin fillor dhe
të mesëm të ulët 110

4.2.2. Shpërndarja e kohës së mësimin për fusha
kurrikulare/lëndë mësimore 114

4.2.3. Kohëzgjatja e vitit shkollor dhe e pushimeve brenda
një viti shkollor 118

4.2.4. Koha e mësimin dhe arritjet e nxënësve në vlerësime
ndërkombëtare dhe kombëtare..... 120

4.2.5. Mesatarja e nxënësve në klasë dhe raporti mësimdhënës-
nxënës 124

4.2.6. Koha e punës së mësimdhënësve 125

4.3. Rezultatet nga perceptimet e komunitetit të shkollës për mbingarkesën kurrikulare 128

4.3.1. Perceptimi i mësimdhënësve për mbingarkesën
kurrikulare128

4.3.2. Perceptimet e nxënësve për mbingarkesën e tyre në
mësim..... 156

4.3.3. Perspektiva nga prindërit për mbingarkesën e nxënësve
në mësim..... 177

4.3.4. Mbingarkesa kurrikulare nga perspektiva e drejtorëve të
shkollave dhe koordinatorëve të cilësisë në shkolla 202

4.3.5. Mbingarkesa kurrikulare nga perspektiva e njohësve dhe koordinatorëve për zhvillimin e kurrikulës	224
KAPITULLI V - Diskutimi i rezultateve	251
KAPITULLI VI - Përfundime dhe rekomandime	281
6.1. Përfundime	281
6.2. Rekomandime.....	287
Literatura.....	292
Shtojcat	297

Falënderim

Studimi për mbingarkesën kurrikulare në arsimin fillor dhe në arsimin e mesëm të ulët në Kosovë është produkt dhe kontribut i veçantë i Institutit Pedagogjik të Kosovës dhe stafit të tij, i realizuar gjatë vitit 2022.

Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK) falënderon të gjithë ata që e përkrahën dhe mbështetën realizimin dhe përfundimin me sukses të këtij studimi. IPK-ja falënderon në mënyrë të veçantë nxënësit e klasave të teta dhe të nënta, nga shkollat pjesëmarrëse në këtë studim, prindërit, mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave, njohësit dhe koordinatorët e zhvillimit të kurrikulave, të cilët iu përgjigjën pa asnjë hezitim kërkesës për të qenë pjesë e këtij studimi dhe me kontributin e tyre i dhanë kuptim përmbajtjesor studimit.

Studimi nuk do të mund të realizohej pa bashkëpunimin, angazhimin dhe përkrahjen e Këshillit Shkencor të IPK-së, të cilët udhëzuan për projektin e studimit, shtrirjen e këtij studimi dhe e miratuan atë për të ndjekur rrugëtimin profesional e shkencor drejt një studimi të veçantë, me një tematikë të veçantë studimi.

Gjithashtu, IPK-ja falënderon të gjithë kolegët e Institutit, miqtë dhe bashkëpunëtorët profesionalë të Institutit, të cilët me sugjerimet, vërejtjet dhe kritikën e tyre konstruktive ndikuan në avancimin e cilësisë së këtij studimi.

Lista e tabelave

Tabela 1.	<i>Faktorët e mbingarkesës kurrikulare dhe dimensionet e mbingarkesës (NCCA, 2010)</i>	40
Tabela 2.	<i>Dimensionet e mbingarkesës dhe përshkrimi i elementeve të tyre (OECD, 2020)</i>	41
Tabela 3.	<i>Pozita/roli i respondentëve të përfshirë në studim (në numër)</i>	69
Tabela 4.	<i>Plani mësimor për klasën përgatitore dhe arsimin fillor</i>	84
Tabela 5.	<i>Plani mësimor për klasat 1-5, i zbatuar në vitet 2003-2016</i>	85
Tabela 6.	<i>Plani mësimor për arsimin e mesëm të ulët</i>	89
Tabela 7.	<i>Plani mësimor për klasat 6-9, i zbatuar në vitet 2003-2016</i>	91
Tabela 8.	<i>Numri i orëve për javë mësimi, numri i temave vjetore dhe numri i RNL – vjetore në kurrikulat lëndore/programet mësimore – klasat 1, 3 dhe 5</i>	97
Tabela 9.	<i>Dallimet në paraqitjen e çështjeve ndërkurrikulare në kurrikulat lëndore të arsimin fillor.</i>	102
Tabela 10.	<i>Numri i orëve për javë mësimi, numri i temave vjetore dhe numri i RNL–ve vjetore në kurrikulat lëndore/programet mësimore – klasat 6, 8 dhe 9</i>	105
Tabela 11.	<i>Dallimet në paraqitjen e çështjeve ndërkurrikulare në kurrikulat lëndore të arsimin e mesëm të ulët.</i>	109
Tabela 12.	<i>Vitet e shkollimit dhe orët e mësimi në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në disa vende të rajonit dhe të OECD-së</i>	112
Tabela 13.	<i>Tabela 13. Ditët e mësimi dhe javët e pushimit gjatë një viti shkollor në disa vende të rajonit dhe të OECD-së</i>	119
Tabela 14.	<i>PISA 2018 - Përqindja e nxënësve që nuk kanë arritur nivelin minimal të aftësive</i>	123
Tabela 15.	<i>Raporti mësimdhënës – nxënës</i>	125
Tabela 16.	<i>Detyrat dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve për 39 sisteme arsimore, shteteve të OECD-së</i>	127

<i>Tabela 17.</i>	<i>Ndryshimet, risitë në kurrikulat e reja, dhe vështirësitë në zbatimin e kurrikulës nga perspektiva e mësimitdhënësve</i>	<i>138</i>
<i>Tabela 18.</i>	<i>Mbingarkesa kurrikulare dhe faktorët e saj nga perspektiva e mësimitdhënësve</i>	<i>145</i>
<i>Tabela 19.</i>	<i>Reflektimi i mësimitdhënësve ndaj ndikimit të mbingarkesës kurrikulare te nxënësit dhe ndikimit në punën e tyre</i>	<i>151</i>
<i>Tabela 20.</i>	<i>Angazhimi i nxënësve në mësim - koha e angazhimit</i>	<i>159</i>
<i>Tabela 21.</i>	<i>Faktorët e mbingarkesës së nxënësve në mësim - përshkrime të elementeve të mbingarkesës nga perspektiva e nxënësve</i>	<i>167</i>
<i>Tabela 22.</i>	<i>Ndryshimet dhe shqetësimet e nxënësve nga ndikimi i mbingarkesës me mësim</i>	<i>174</i>
<i>Tabela 23.</i>	<i>Problemet dhe shqetësimet e mësimitdhënësve dhe nxënësve në zbatimin e kurrikulës, nga perspektiva e prindërve</i>	<i>183</i>
<i>Tabela 24.</i>	<i>Tabela 24. Ndikimi i mbingarkesës së nxënësve në mësim – efektet negative dhe pozitive</i>	<i>187</i>
<i>Tabela 25.</i>	<i>Ndikimi i mbingarkesës në mësim në ndryshimet emocionale dhe në sjellje të fëmijët, ndryshimet dhe shqetësimet që ndodhin në familje</i>	<i>196</i>
<i>Tabela 26.</i>	<i>Pikëpamjet e drejtorëve të shkollave dhe KC për aspekte të lidhura me zbatimin e kurrikulës dhe rolin e tyre</i>	<i>208</i>
<i>Tabela 27.</i>	<i>Pikëpamjet e drejtorëve të shkollave dhe KC për mbingarkesën kurrikulare dhe faktorët e mbingarkesës</i>	<i>214</i>
<i>Tabela 28.</i>	<i>Pikëpamjet e drejtorëve të shkollave dhe KC për ndikimin e mbingarkesës kurrikulare në arritjet, mirëqenien e nxënësve dhe në punën e mësimitdhënësve</i>	<i>219</i>
<i>Tabela 29.</i>	<i>Mundësitë e pashfrytëzuara në zhvillimet rreth reformës kurrikulare</i>	<i>229</i>
<i>Tabela 30.</i>	<i>Përshkrimi i mbingarkesës kurrikulare dhe faktorët ndikues nga perspektiva e njohësve dhe koordinatorëve për zhvillimin e kurrikulës</i>	<i>236</i>
<i>Tabela 31.</i>	<i>Ndikimet e mbingarkesës kurrikulare nga perspektiva e njohësve dhe koordinatorëve për zhvillimin e kurrikulës</i>	<i>242</i>

<i>Tabela 32.</i>	<i>Veprimet e nevojshme për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare nga perspektiva e njohësve dhe koordinatorëve për zhvillimin e kurrikulës</i>	<i>247</i>
<i>Tabela 33.</i>	<i>Faktorët e mbingarkesës sipas perceptimit të pjesëmarrësve në studim</i>	<i>267</i>
<i>Tabela 34</i>	<i>Përmbledhje e karakteristikave të manifestimit të ndikimit të mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e nxënësve</i>	<i>272</i>

Lista e figurave

<i>Figura 1.</i>	<i>Numri i RNL për lëndët mësimore me 2 orë mësimore në javë (klasa 8)</i>	<i>106</i>
<i>Figura 2.</i>	<i>Mesatarja e orëve të mësimit për klasë, në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët, në disa vende të rajonit dhe të OECD-së</i>	<i>113</i>
<i>Figura 3.</i>	<i>Shpërndarja e kohës së mësimit për fushat kurrikulare/lëndë mësimore në arsimin fillor në disa vende të rajonit dhe të OECD-së</i>	<i>115</i>
<i>Figura 4.</i>	<i>Shpërndarja e kohës së mësimit për fushat kurrikulare/lëndët mësimore, në arsimin e mesëm të ulët, në disa vende të rajonit dhe të OECD-së</i>	<i>116</i>
<i>Figura 5.</i>	<i>Marrëdhënia midis rezultateve të PISA (2015) dhe kohës së mësimit (Burimi: OECD, 2020)</i>	<i>121</i>
<i>Figura 6.</i>	<i>Dallimet në numrin e temave vjetore dhe numrin e RNL-ve në klasat 1,3 dhe 5</i>	<i>255</i>
<i>Figura 7</i>	<i>Dallimet në numrin e temave vjetore dhe numrin e RNL-vë në klasat 6, 8 dhe 9</i>	<i>256</i>
<i>Figura 8</i>	<i>Integrimi i çështjeve ndërkurrikulare në numër të kurrikulave lëndore /kl. 5/</i>	<i>258</i>
<i>Figura 9</i>	<i>Integrimi i çështjeve ndërkurrikulare në numër të kurrikulave lëndore /kl. 9/</i>	<i>259</i>
<i>Figura 10</i>	<i>Marrëdhënia midis rezultateve të Testit të Arritshmërisë (2022) dhe kohës së obligueshme të mësimit (klasat 6-9)</i>	<i>261</i>

Lista e shkurtesave

AF	Arsimi Fillor
AMU	Arsimi i Mesëm i Ulët
AP	Aktivitet/Departamentet Profesionale
AShSh	Akademia e Shkencave e Shqipërisë
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
DASh	Departamenti i Arsimit dhe Shkencës
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
FNV	Fëmijë me Nevoja të Veçanta
IEAA	Institucioni Edukativo – Arsimor dhe Aftësues
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
IZhA	Instituti për Zhvillimin e Arsimit
KB/1	Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe Arsimin Fillor
KB/2	Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Ulët
KDSH	Këshilli Drejtues i Shkollës
KKAP	Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar
KL	Kurrikula Lëndore
KP	Këshilli i Prindërve
KSC	Koordinator për Sigurim të Cilësisë
MAShTI	Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit
NCCA	Këshillit Kombëtar për Kurrikulën dhe Vlerësimin
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PISA	Programi Ndërkombëtar për Vlerësimin e Nxënësve
RNK	Rezultatet e të nxënit për kompetenca
RNL/T	Rezultatet e të nxënit të lëndës/temës mësimore

RNSh	Rezultatet e të nxënit të shkallës për fusha kurrikulare
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
ShFMU	Shkolla Filllore dhe e Mesme e Ulët
TIK	Teknologji e Informimit dhe Komunikimit
UNICEF	Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
VBSH	Vlerësimi i Brendshëm i Shkollës

Parathënie

Studimi *Mbingarkesa kurrikulare në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë – (realitet apo perceptim?)*, është tematik, i realizuar nga hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës, gjatë periudhës prill–gusht 2022. Ky studim është një dëshmi e përpjekjeve të Institutit për të mbështetur zhvillimet e reja në arsim, me qëllime të informimit dhe orientimit të politikave e praktikave arsimore.

Raporti i OECD-së (2020), *Mbingarkesa e kurrikulës - një rrugë përpara*, ishte pikë referimi për këtë studim. Ky raport është përdorur për të vendosur aspektet që do të eksploroohen për mbingarkesën kurrikulare në kontekstin e arsimit parauniversitar në Kosovë, qasjen në metodologjinë e hulumtimit dhe realizimin e tij, bazuar në projektin kërkimor të shqyrtuar dhe të miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit Pedagogjik të Kosovës.

Raporti i këtij studimi, i organizuar me një strukturë të përafërt të studimeve të veçanta që publikohen nga IPK-ja, është ndërtuar në gjashtë kapituj. Përtej organizimit të përmbajtjes së raportit në kapituj të veçantë, këtij botimi i paraprin abstrakti për këtë studim, i cili përshkruan qasjen hulumtuese dhe sjell gjetjet kryesore të studimit, të cilat konfirmojnë elemente të mbingarkesës kurrikulare në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, si dhe ofron orientimet për vendosje të një politike arsimore që në thelb duhet të ketë një strategji funksionale për trajtimin dhe preventivën e mbingarkesës së kurrikulës.

Kapitulli i parë – Hyrje, përshkruan kontekstin e studimit dhe të situatës në raport me zbatimin e reformës kurrikulare. Tutje, në këtë kapitull, zërthehet nevoja për këtë studim, përkatësisht nevojat për të përkrahur sistemin arsimor në Kosovë përmes një studimi të tillë. Vijohet me shtrimin e problemit të studimit, i cili merr për bazë studime të ndryshme profesionale dhe shkencore në vendosjen e objektit, qëllimit të studimit dhe pyetjeve kërkimore. Pjesë e këtij kapitulli janë edhe referimet për konceptet kryesore, për të cilat vlerësojmë se i kontribuojnë të kuptuarit e përbashkët të aspekteve që trajtohen në këtë studim.

Kapitulli i dytë – Shqyrtimi i literaturës, trajton problematikën e mbingarkesës kurrikulare nga autorë dhe studime që lidhen me mbingarkesën kurrikulare. Në ndërlidhje me objektin e studimit, ky kapitull ofron një përmbledhje të gjetjeve të pasqyruara në studime të ndryshme lidhur me mbingarkesën kurrikulare - faktorët ndikues, ndikimin e mbingarkesës së kurrikulës në mirëqenien e nxënësve, në punën dhe mirëqenien e mësimit në mësimdhënësve, si dhe strategjitë për trajtimin dhe zvogëlimin e mbingarkesës kurrikulare.

Kapitulli i tretë - Metodologjia e hulumtimit, paraqet aspektet kryesore nga metodologjia hulumtuese e zbatuar në këtë studim, përshkruan dizajnin e hulumtimit, qasjen cilësore të zbatuar në këtë studim rasti zbulues. Aspekte të tjera, që referohen në këtë kapitull, lidhen me popullatën dhe mostrën e studimit, metodat dhe instrumentet e hulumtimit, procedurën e mbledhjes dhe analizës së të dhënave, aspektin etik të studimit dhe kufizimet e studimit nga rrethanat e kontekstit.

Kapitulli katër – Rezultatet e studimit, është kapitulli më e veçantë e këtij studimi. Ky kapitull sjell rezultate dhe argumente të rëndësishme të lidhura me studimin. Rezultatet e studimit, gjetjet kryesore, në këtë kapitull janë të organizuara në tri pjesë. Pjesa e parë shqyrton gjetjet nga analiza e kurrikulave, me specifikime të veçanta për gjetjet nga analiza e dokumentit të Kornizës kurrikulare, kurrikulave bërthamë dhe kurrikulave lëndore, për klasat 1,3, 5, 6, 8 dhe 9. Pjesa e dytë prezanton gjetjet nga analiza e disa faktorëve të ndërlidhur me kurrikulën dhe krahasimin e tyre me disa shtete të rajonit dhe të OECD-së, me kontekstin e Kosovës, që lidhen me: (i) kohën e mësimit të detyrueshëm në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, (ii) shpërndarjen e kohës së mësimit për fushat kurrikulare/lëndë mësimore, (iii) kohëzgjatjen e vitit shkollor dhe të pushimeve brenda një viti shkollor, (iv) kohën e mësimit dhe arritjet e nxënësve në vlerësime ndërkombëtare dhe kombëtare, (v) mesataren e nxënësve në klasë dhe raporti mësimitdhënës – nxënës, si dhe (vi) kohën e punës së mësimitdhënësve.

Pjesa e tretë e kapitullit të katërt pasqyron rezultatet nga perspektivat e nxënësve, mësimitdhënësve, prindërve, drejtuesve të shkollave, njohësve dhe koordinatorëve në zhvillimin e kurrikulave. Rezultatet në këtë pjesë

raportohen të ndara sipas grupeve të respondentëve pjesëmarrës në këtë studim. Gjetjet kryesore dhe përshkrimi narrativ i tyre, sipas fushave tematike të eksploruara, shoqërohen me citime të shkëputura nga të dhënat e mbledhura me intervista, me pyetësorë dhe me fokus-grupe.

Kapitulli i pestë - Diskutimi i rezultateve, sjell diskutimin e rezultateve në ndërlidhje me objektin e studimit dhe pyetjet kërkimore që e udhëheqin studimin. Pjesa e parë e diskutimit të rezultateve përfshin gjetjet kryesore dhe diskutimet për raportin midis zgjerimit të kurrikulës, përmbajtjeve mësimore dhe rezultateve të të nxëniet me kohën mësimore të obligueshme. Pastaj, vazhdohet me gjetjet kryesore dhe diskutimet për atë që ishte dilema kryesore në këtë studim, e ngritur në shumë studime të tjera si pyetje kryesore: *Mbingarkesa kurrikulare është realitet apo perceptim?* Në këtë pjesë diskutohen perceptimet për mbingarkesën kurrikulare të raportuar nga respondentët e këtij studimi, që përfaqësonin shtresat kryesore të komunitetit të shkollës dhe, të aktorëve të tjerë që në parim i kanë parë apo përjetuar mbingarkesën kurrikulare dhe ndikimet e saj.

Në kapitullin e gjashtë janë prezantuar *përfundimet dhe rekomandimet* e dala nga ky studim. Ato janë mbështetur në gjetjet kryesore të studimit dhe rekomandime për institucionet arsimore, duke vënë theksin në elemente që mund të sjellin një strategji funksionale për trajtimin dhe preventiven e mbingarkesës së kurrikulës, si dhe kahet zhvillimore për efektivitetin e mësimdhënies, si një nga veprimet kryesore për të garantuar mirëqenien e të gjithë nxënësve dhe eliminimin e pabarazive në mësim.

Shpresojmë që raporti i këtij studimi, rezultatet e tij, do të merren si pikë referimi në zhvillimet e reja të lidhura me vazhdimin e reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar. Ky studim vjen në kohë dhe rrethana të veçanta, të cilat i konsiderojmë të duhura dhe koherente me shtrirjen e zbatimit të kurrikulës në të gjitha klasat e arsimit parauniversitar në Kosovë dhe me pritjen e raportit të radhës nga studimi PISA (2022). Këto zhvillime shihen si mundësi të reja për të bërë rishikimet e nevojshme në aspektet të konsideruara mbingarkesë kurrikulare dhe për veprime e ndërhyrje të tjera që sigurojnë cilësi në arsimin parauniversitar.

Botimi i këtij raporti të studimit do ju shërbejë komunitetit arsimor, lexuesve dhe politikëbërësve e studiuesve tjerë të kësaj fushe. Prandaj, çdo sugjerim, kritikë dhe ndihmë tjetër në këtë tematikë të studimit, IPK-ja e mirëpret me kënaqësi, si formë të bashkëpunimit për përmirësimin dhe avancimin e arsimit kosovar. Ne vlerësojmë se me këtë qasje rrisim nivelin e shqyrtimit dhe diskutimit shkencor, me përgjegjësi dhe profesionalizëm të çështjeve të rëndësishme arsimore.

Nezir Çoçaj, drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës

Përmbledhje

Sisteme të ndryshme arsimore, në përgjigje të kërkesave të shoqërisë për të përshtatur kurrikulën që zbatohet në shkolla me zhvillimet e shpejta shoqërore, teknologjike dhe ekonomike, zgjedhin qasje të ndryshme të rishikimit të kurrikulës. Këto qasje mund të rezultojnë në mbingarkesë kurrikulare, ndikimet e se cilës reflektohen në mirëqenien e nxënësve, mësimdhënësve, dhe në efektivitetin e mësimdhënies.

Për të gjetur strategji veprimi dhe masa të duhura për të minimizuar ndikimin e mbingarkesës kurrikulare, studimet e literaturës profesionale, që kanë trajtuar këtë problematikë, tregojnë nevojën për eksplorimin e mbingarkesës kurrikulare si një temë të veçantë kërkimi, nga dimensionet dhe perspektiva të ndryshme, si dhe nga qasje të ndryshme kërkimi, në varësi të konteksteve të sistemeve arsimore.

Ky studim rasti cilësor shqyrton mbingarkesën kurrikulare në kontekstin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë. Studimi ka për qëllim të eksplorojë nëse përmbajtjet e kurrikulave në raport me pritshmëritë dhe kohën mësimore paraqesin ndonjë aspekt të mbingarkesës për nxënës dhe për mësimdhënës, si dhe të përvijojë orientime për adresimin e mbingarkesës kurrikulare, për të siguruar mirëqenien e nxënësve dhe mësimdhënësve dhe për të mbështetur mësimdhënien efektive.

Për këtë studim u përdorën analiza e përmbajtjes së dokumenteve të kurrikulës në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, me një thellim më të veçantë në kurrikulat lëndore. Për të shqyrtuar mendimin për mbingarkesën kurrikulare, ndikimin dhe faktorët e saj, janë përdorur intervista gjysmë të strukturuar, pyetësorë e diskutime me fokus-grup me mësimdhënës, nxënës, prindër, drejtues të shkollës, koordinatorë të cilësisë, njohës dhe koordinatorë për zhvillimin e kurrikulave.

Gjetjet tregojnë sa i rëndësishëm ishte një studim rasti i tillë, për kontekstin e arsimit parauniversitar në Kosovë. Rezultatet e studimit konfirmojnë elemente të mbingarkesës kurrikulare në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, me dallime ndërmjet niveleve të arsimit dhe klasave, të cilat vijnë nga faktorë të shumtë të mbingarkesës. Disa faktorë të pranishëm janë: zgjerimi i kurrikulës, mbingarkesa me përmbajtje dhe pritshmëri të larta për nxënës në raport me kohën mësimore në dispozicion, mbingarkesa e perceptuar nga dokumentet kurrikulare, përdorimi i teksteve shkollore, detyrat e shtëpisë dhe vlerësimi i nxënësve. Gjithashtu, rezultatet e studimit konfirmojnë ndikimin e mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e nxënësve dhe mësimdhënësve dhe në efektivitetin e mësimdhënies.

Rëndësia e studimit është praktike dhe teorike. Rekomandimet e studimet ndihmojnë në vendosje të një politike arsimore që në thelb ka një strategji funksionale për trajtimin dhe preventivën e mbingarkesës së kurrikulës. Kjo qasje mund të gjejë zbatim gjatë rishikimit të kurrikulës, por edhe gjatë udhëheqjes së zbatimit të saj dhe të proceseve të mësimi që ndikojnë dhe kanë nxitur më shumë mbingarkesën e perceptuar. Mirëqenia e nxënësve dhe e mësimit duhet të jetë referencë parësore në këto procese.

Fjalët çelës: *mbingarkesë kurrikulare, faktorët e mbingarkesës, zgjerimi i kurrikulës, koha e mësimi, perceptim, mirëqenie e nxënësve dhe mësimit.*

Abstract

Different educational systems, in response to society's demands to adapt the curriculum applied in schools to the rapid social, technological and economic developments, choose different approaches to curriculum revision. These approaches can result in curricular overload, the impacts of which are reflected in the well-being of students, teachers, and teaching effectiveness.

In order to find action strategies and appropriate measures to minimize the impact of curricular overload, professional literature studies that have dealt with this problem, show the need for exploring curricular overload as a special research topic, from different dimensions and perspectives, as well as from various research approaches, depending on the contexts of the educational systems.

This qualitative case study examines curriculum overload in the context of elementary and lower secondary education in Kosovo. The study aims to explore if the contents of the curricula in relation to the expectations and teaching time, present any aspect of overload for students and for teachers, as well as to outline orientations for addressing curriculum overload, to ensure the well-being of students, teachers and to support effective instruction.

For this study, the analysis of the content of the curriculum documents in primary and lower secondary education is used, with a special depth in the subject curricula. In addition, semi-structured interviews, questionnaires and focus group discussions were used to examine the opinion of curricular overload, of those who have seen and experienced curricular overload and its impacts (teachers, students, parents, school leaders, coordinators of quality, experts and coordinators for curriculum development)

Findings from this study show how important such a case study was, for the context of pre-university education in Kosovo. The results of the study confirm elements of curricular overload in primary and lower secondary education, with differences between education levels and classes, which come from multiple overload factors. Some factors present are: curriculum expansion, content overload and high expectations for students in relation to the available teaching time, perceived overload of curriculum documents, use of textbooks, homework and student assessment. Also, the results of the study confirm the impact of curricular overload on the well-being of students, teachers and on teaching effectiveness.

The significance of the study is practical and theoretical. The recommendations of the studies help to establish an educational policy that basically has a functional strategy for the treatment and prevention of curriculum overload. This approach can be applied when revising the curriculum, but also when guiding its implementation and the learning processes that influence and have further encouraged the perceived overload. The well-being of students and teachers should be the primary reference in these processes.

Keywords: *curriculum overload, factors of overload, curriculum expansion, lesson time, perception, student and teacher well-being.*

KAPITULLI I

Hyrje

Zhvillimi dhe rishikimi i kurrikulave është proces që lidhet me ndryshimet në arsim dhe ka për qëllim t'u përgjigjet kërkesave dhe kaheve të zhvillimeve në shoqëri, në edukim, në shkencë, në teknologji, etj. Zhvillimi dhe rishikimi i kurrikulave përcillen me ndryshime në qasje, në pritshmëri për nxënës, mësimdhënës dhe sistemin arsimor, në ndryshim të përmbajtjeve mësimore, por edhe në përgatitjet për zbatim në harmoni me kahet e zhvillimit të kurrikulave.

Lidhur me ndryshimet në kurrikula, përgatitjet për zbatim dhe udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës, zhvillohen debate dhe diskutime të shumta në mesin e komunitetit arsimor, por edhe në shtresa të ndryshme të shoqërisë. Ato lidhen me kontekstin, mundësitë reale të zbatimit të kurrikulës, pritshmëritë e saj, mbingarkesën, mirëqenien për nxënës dhe mësimdhënës.

Mbingarkesa kurrikulare është një problem pedagogjik që gjithnjë e më shumë ka nxitur sistemet arsimore të vendeve të ndryshme në trajtimin e saj, nga perspektiva të ndryshme, përfshirë trajtimin e faktorëve ndikues në mbingarkesë dhe të ndikimeve të mbingarkesës.

Ky studim, për mbingarkesën kurrikulare, është pjesë e planit të studimeve të Institutit Pedagogjik të Kosovës për vitin 2022, më gjithëpërfshirësi i bërë për aspektet e mbingarkesës në kurrikulën e arsimit parauniversitar në zbatim. Me anë të këtij studim rasti, analitik dhe përshkrues, synohet të sheshohen çështjet më të rëndësishme që lidhen me mbingarkesën kurrikulare, faktorët ndikues dhe efekti i tyre në mësim, të cilët e përcjellin zbatimin e kurrikulës, me theks të veçantë në arsimin fillor dhe në arsimin e mesëm të ulët.

1.1. Konteksti i studimit

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MASHTI), në vitin 2016, pas fazës së pilotimit, miratoi dokumentin konceptual të reformës kurrikulare, Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar në Kosovë (KKAP), i cili ka për bazë zhvillimin e kompetencave (MASHT, /KKAP/, 2016). Ky dokument rregullon tërë

sistemin e arsimit parauniversitar dhe shërben si ombrellë për angazhimet në ngritjen e cilësisë dhe barazisë në shërbimet arsimore për të gjithë (Boshtrakaj, 2018).

Gjithashtu, MASHTI, pas fazës së pilotimit të kurrikulës, në vitin 2016, miratoi edhe dokumentet operative të kurrikulës, Kurrikulat Bërthamë për tri nivele të arsimit parauniversitar: arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë – gjimnazet.

Kompletimi i pakos së dokumenteve kurrikulare, të vitit 2016, vazhdoi me zhvillimin e kurrikulave lëndore/programeve mësimore për secilën klasë të arsimit parauniversitar, nën udhëheqjen e Divizionit për kurrikula, dhe mbështetje të mësuesve në MASHTI, proces i cili vazhdoi deri në vitin 2021.

Pra, në arsimin parauniversitar në Kosovë, nga viti shkollor 2016/2017, filloi një fazë e re e reformës kurrikulare, faza e zbatimit të kurrikulave lëndore/programeve të reja mësimore, të hartuara në bazë të konceptit të kurrikulës së bazuar në arritjen e kompetencave (Mehmeti et al, 2019). Në vitin shkollor 2021/2022, klasa e pestë (5) ishte klasa e fundit e shtrirjes së zbatimit të kurrikulës në të gjitha klasat e arsimit parauniversitar.

Tani, dokumentet kurrikulare në zbatim, KKAP, KB për nivele të arsimit, si dhe Kurrikulat Lëndore (KL) për secilën klasë, janë pikë referimi për zbatimin e kurrikulave nga të gjitha institucionet arsimore (shkollat) dhe bartësit e tjerë që kanë rol në zbatimin e kurrikulës në shkallë vendi.

1.2. Nevoja për këtë studim

Viti shkollor 2021/2022, për reformën kurrikulare të arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës, konsiderohet vit i përmbylljes së një faze të reformës kurrikulare, pasi që në këtë vit shkollor, në të gjitha klasat e arsimit parauniversitar, punohet me kurrikulat e reja lëndore, të konceptuara në frymën e dokumenteve kurrikulare (KKAP dhe KB) të bazuara në kompetenca.

Shtrirja e zbatimit të kurrikulës së bazuar në kompetenca në shkallë vendi, në të gjitha klasat, ka arritur një nivel të ndjeshëm institucionalizimi,

nëpërmjet zhvillimit të kurrikulave lëndore për klasë, trajnimit të mësimeve për zbatimin e kurrikulës, organizimit të procesit mësimor në bazë të planit mësimor për secilën klasë, zbatimit të sistemit të ri të vlerësimit të nxënësve, si dhe dokumentimit të punës së shkollave në zbatimin e kurrikulës (Mehmeti et al., 2019).

Zbatimi i kurrikulës është një proces i vazhdueshëm, për të cilin gjithmonë nevojiten evidenca, informata kthyes shtesë për të bërë përmirësimet e nevojshme për zbatim të suksesshëm të kërkesave të kurrikulës, në mënyrë të veçantë kur përfundohet një cikël apo fazë e zbatimit të reformës kurrikulare.

Nga fillimi i zbatimit të kurrikulës së bazuar në kompetenca, specifikisht nga shtrirja e zbatimit të kurrikulës në të gjitha shkollat e Kosovës, janë ngritur dilema të shumta nga shkollat (drejtorët, mësimeve, prindërit dhe nxënësit) për mundësinë e zbatimit të saj, kërkesat e larta, përgatitjen e sistemit për të zbatuar të gjitha elementet e kurrikulës, etj. Sipas Buleshkaj & Koren (2022), reformat e mëdha kurrikulare, të cilat synojnë të ndryshojnë nivelin konceptual të shkollimit, siç është kurrikula e Kosovës, komunitetit të shkollës i duhet më shumë kohë dhe mbështetje për të përvetësuar informacionin dhe për të bërë interpretimet e tyre se si të udhëheqin dhe zbatojnë sa më mirë kurrikulën e re.

Paqartësi, sfida dhe dilema për aspekte të veçanta të përmbajtjes, qasjes dhe zbatimit të reformës kurrikulare në Kosovë, janë evidentuar dhe raportuar në studime të publikuara në 6-7 vitet e fundit, si Manninen (2014), Mehmeti & Buleshkaj (2017), Potera & Shala (2018), Boshtrakaj, et al. (2018), Mehmeti et al. (2019), Buleshkaj & Koren (2022), etj.). Mirëpo, në asnjërin prej këtyre studimeve nuk është trajtuar çështja e mbingarkesës kurrikulare dhe ndikimet e saj në mësim, në punën e nxënësve dhe të mësimeve.

Kjo shtron nevojën për studime të aspekteve të ndryshme, të lidhura me mbingarkesën kurrikulare. Këtë e ka referencë edhe ky studim, rezultatet e të cilit pritet t'u shërbejnë të gjitha institucioneve që lidhen me procesin e zbatimit të kurrikulës, në mënyrë të veçantë MASHT-it, komunave/DKA-ve dhe institucioneve edukativo-arsimore/ shkollave, për të përcaktuar strategji dhe veprime të duhura për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare.

1.3. Shtrimi i problemit të studimit

Të kuptuarit për mbingarkesën kurrikulare është bërë një fushë e rëndësishme kërkimore në shkallë globale, për shkak të ndryshimeve të shpeshta në reformën kurrikulare, për shkak të tendencës për zgjerimin e kurrikulës, rritjes së kërkesave për ndërrimin e qasjes së punës nga shkollat dhe mësimdhënësit, por edhe për shkak të kërkesave gjithnjë e më të shtuara të nxënësve/të rinjve për lirim nga informacionet e tepërta.

Studime të ndryshme, si profesionale ashtu dhe shkencore, nga autorë dhe institucione të ndryshme, si p.sh. Bekteshi (2009), Këshillit Kombëtar për Kurrikulën dhe Vlerësimin (NCCA) (2010), Majoni, (2017), OECD (2020), etj., flasin për mbingarkesë kurrikulare të manifestuar me shtim të përmbajtjeve mësimore në përgjigje të kërkesave të shoqërisë, shtim të përmbajtjeve mësimore në raport me kohën mësimore vjetore në dispozicion - planin mësimor, mosbalancim të kurrikulës, sfida në pranueshmërinë e kurrikulës nga ana e mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave, strese të nxënësve dhe mësimdhënësve nga mbingarkesa kurrikulare dhe mbingarkesa kohore për mësim, por edhe për nevoja që të përcaktohen strategji të mundshme për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare.

Në Kosovë, pavarësisht se janë bërë pesë vjet të shtrirjes së zbatimit të reformës kurrikulare në shkallë vendi, akoma nuk është bërë ndonjë studim gjithëpërfshirës apo vlerësim për mbingarkesën kurrikulare. Ashtu sikur nuk ka ndonjë evidencë të përmbledhur për masat preventive të ndërmarra nga sistemi arsimor, për parandalimin apo minimizimin e mbingarkesës kurrikulare.

Vite më parë, në vitin 2009, është publikuar studimi i prof. Bektesh Bekteshit për Mbingarkimin e nxënësve me mësim në shkollë, mirëpo hulumtimi empirik për këtë studim është realizuar në vitin shkollor 1981/1982 (Bekteshi, 2009).

Studimet e viteve të fundit, që lidhen me reformën kurrikulare në Kosovë, kryesisht kanë një përqendrim të trajtimit tematik, disa prej tyre kanë përshkrim të zbatimit dhe disa bëjnë përpjekje për të matur shkallën e

zbatimit, sfidat dhe vështirësitë në zbatim (Manninen, 2014; Boshtrakaj, 2018; Mehmeti et al., 2019; Buleshkaj & Koren, 2022) pa një fokusim të veçantë në aspektet e konsideruara mbingarkesë kurrikulare. Mbi këtë bazë, IPK-ja, në kuadër të planit të studimeve profesionale dhe shkencore për vitin 2022, projektoi këtë studim të veçantë, çështjen e mbingarkesës kurrikulare, përmes të cilit synon të sheshojë çështjet me të rëndësishme që lidhen me ngarkesën kurrikulare në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët dhe të ofrojë një informacion tërësor dhe analitik për këtë tematikë, i cili do të jetë në shërbim të komunitetit arsimor.

1.4. Objekti dhe qëllimi i studimit

Objekti i studimit. Në këtë hulumtim, objekt i studimit është mbingarkesa kurrikulare në arsimin e detyrueshëm në Kosovë, aspektet e konsideruara mbingarkesë kurrikulare dhe ndikimet e saj në mësim, në arritjet/rezultatet e nxënësve, në mirëqenien e nxënësve dhe të mësimdhënësve.

Meqë mbingarkesa kurrikulare është një problem i ndërlikuar dhe mjaft kompleks (Bekteshi, 2009; NCCA, 2010; OECD, 2020;), i cili për t'u hulumtuar në tërësi dhe në mënyrë të gjithanshme kërkon kohë të gjatë, u përcaktuam që këtë problem ta hulumtojmë dhe ta studiojmë në arsimin e detyrueshëm në Kosovë, arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, me një fokus më të veçantë në klasat 1, 3 dhe 5 të arsimit fillor dhe në klasat 6, 8 dhe 9 të arsimit të mesëm të ulët.

Çështjen e mbingarkesës kurrikulare e trajtuam nga shumë aspekte, nga analiza e dokumenteve kurrikulare (KKAP dhe KB), me një trajtim më të thellë të kurrikulave lëndore, në raport me kohën mësimore për fusha kurrikulare/lëndë mësimore, përmbajtjet mësimore, rezultatet e të nxënësve, qasjet ndaj çështjeve ndërkurrikulare etj.

Në linjë me objektin e studimit, i analizuam raportet e fundit të OECD-së, disa nga indikatorët që mundësojnë të nxirren elementet e mbingarkesës kurrikulare, përtej përmbajtjeve mësimore dhe rezultateve të të nxënësve, si: koha e mësimit të detyrueshëm në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, apo plani i mësimit në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, shpërndarja e kohës

së mësimimit për fushat kurrikulare/lëndë mësimore; kohëzgjatja e vitit shkollor dhe e pushimeve brenda një viti shkollor, mesataret e nxënësve në klasë dhe raporti mësimdhënës – nxënës, si dhe koha e punës së mësimdhënësve.

Për të trajtuar më mirë problematiken e këtij studimi, i morëm në konsideratë mendimet e subjekteve të komunitetit arsimor që lidhen me zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës, në mënyrë të veçantë mendimet e nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve, të cilët ballafaqohen drejtpërdrejt me mbingarkesën kurrikulare. Trajtimi i mendimeve të komunitetit arsimor ishte më se i nevojshëm për të marrë përgjigje në atë që shpesh diskutohet se a është mbingarkesa kurrikulare perceptim apo realitet.

Diskutimi i rezultateve, gjetjeve kryesore të studimit, ndërlidhet me qëllimin dhe pyetjet kërkimore të studimit, si dhe me shqyrtimin e literaturës për problematiken e mbingarkesës kurrikulare.

Qëllimi i studimit. Studime të shumta kanë trajtuar mbingarkesën kurrikulare në dimensione të ndryshme, duke vërë theksin më shumë në faktorët e mbingarkesës, në zgjerimin e kurrikulës, mbingarkesën me përmbajtje mësimore në raport me kohën mësimore në dispozicion, mbingarkesën e raportuar sipas perceptimeve të nxënësve dhe mësimdhënësve, si dhe ndikimin e mbingarkesës kurrikulare në arritjet dhe mirëqenien e nxënësve, si dhe në efikasitetin dhe mirëqenien e mësimdhënësve (Bekteshi, 2009; Alexander & Flutter, 2009; NCCA, 2010; Majoni, 2017) OECD, 2020; etj.).

Në këtë pikëpamje, qëllimi kryesor i këtij studimi ishte të eksplorojë dhe të trajtojë problematikën e mbingarkesës kurrikulare në arsimin e obligueshëm në Kosovë, të hetojë nëse përmbajtjet e kurrikulave në raport me pritshmëritë dhe kohën mësimore - planin mësimor paraqesin ndonjë aspekt të mbingarkesës për nxënës dhe për mësimdhënës, dhe të përcaktojë një përmasë të përafërt të aspekteve të mbingarkesës kurrikulare në raport me kërkesat zyrtare që lidhen me zbatimin e kurrikulës.

Po ashtu, qëllimi i studimit ishte të pasqyrojë aspekte të mbingarkesës kurrikulare, të raportuara nga pikëpamjet e përfaqësuesve nga komuniteti i shkollës (nxënës, prindër, mësimdhënës dhe drejtues të shkollave) dhe të

atyre të lidhur me zhvillimin e kurrikulës (hartues dhe koordinator për zhvillimin e kurrikulave), në përpjekje për të dhënë përgjigje në pyetjen që diskutohet shumë në komunitetin arsimor: *A është mbingarkesa kurrikulare “reale” apo “e perceptuar”?*

Gjithashtu, ky studim ka për qëllim të kontribuojë me orientime dhe rekomandime për një politikë të re arsimore në lidhje me përcaktimin e strategjive për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare dhe mbështetjen për nxënës dhe mësimsdhënës në funksion të ngritjes së performancës së nxënësve dhe përmirësimit të mirëqenies së tyre dhe të mësimsdhënësve.

1.5. Pyetjet kërkimore

Për të përmbushur qëllimin e këtij studimi, janë përcaktuar pyetjet dhe nënpyetjet kërkimore në vijim:

1. Sa janë të dukshme aspektet e mbingarkesës kurrikulare në setin e dokumenteve kurrikulare në zbatimin, në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët në Kosovë?
 - 1.1. *A ka mbingarkesë nga zgjerimi i kurrikulave, shtimi i përmbajtjeve mësimore, pritshmërive për nxënës dhe cili është raporti i mbingarkesës me kohën mësimore të obligueshme?*
 - 1.2. *A ka mbingarkesë kurrikulare të shkaktuar nga mënyra e përfshirjes së çështjeve ndërkurrikulare në kuadër të kurrikulave?*
 - 1.3. *Çfarë është marrëdhënia midis rezultateve të nxënësve në arsimin e detyrueshëm dhe kohës së mësimin?*
2. Si perceptohet mbingarkesa kurrikulare nga subjektet e komunitetit të shkollës, subjektet e lidhur me zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës?
 - 2.1. *Nga cilët faktorë është i nxitur perceptimi për mbingarkesën kurrikulare?*

- 2.2. *Si perceptohet ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në rezultatet dhe mirëqenien e nxënësve dhe të mësimeve?*
- 2.3. *Si i parashikojnë zgjidhjet e mundshme, strategjitë për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare?*

1.6. Rëndësia e studimit

Në Kosovë, ndër vite janë bërë studime dhe analiza për procesin e zbatimit të kurrikulës së vitit 2001 dhe të kurrikulës së vitit 2016, të kryera nga institucione dhe studiues të ndryshëm në Kosovë (Peppers et al., 2005; Manninen, 2014; Boshtrakaj et al.; 2018; Mehmeti et al., 2019; Buleshkaj & Koren, 2022), të cilat pasqyrojnë rezultate dhe evidenca të ndryshme për udhëheqjen e procesit të reformës kurrikulare, zbatimin e kurrikulës, sfidat në zbatim, nevojat për mbështetjen e mësimeve dhe përgjithësisht të institucioneve arsimore etj. Këto studime prekin tërthorazi elemente të mbingarkesës kurrikulare, por nuk i trajtojnë ato në mënyrë specifike.

Prandaj, rëndësia e këtij studimi është e veçantë, është praktike dhe teorike. Studimi, në radhe të parë do të ndihmojë të kuptuarit më të thelluar të njohjes së problematikës së mbingarkesës kurrikulare, të faktorëve ndikues në mbingarkesë dhe të efektit të mbingarkesës në arritjet dhe mirëqenien e nxënësve dhe në efikasitetin e mirëqenien e mësimeve.

Kontribut tjetër me rëndësi i studimit është ofrimi i orientimeve dhe rekomandimeve për institucionet arsimore në lidhje me përcaktimin e strategjive për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare dhe mbështetjen për nxënës dhe mësime në funksion të mirëqenies së tyre dhe të efektivitetit në mësim.

1.7. Konceptet kryesore

Studimi për mbingarkesën kurrikulare është kompleks dhe shumëdimensional, prandaj konceptet kryesore që lidhen me këtë hulumtim trajtohen nga pikëpamjet shkencore të fushës së pedagogjisë, të didaktikës dhe të psikologjisë. Ndërsa konceptet e ndërlidhura në këtë hulumtim kryesisht referohen nga përkufizimet në dokumentet kurrikulare në Kosovë,

për të kontekstualizuar me gjuhën profesionale që përdoret në dokumente zyrtare për arsimin parauniversitar në Kosovë.

Përkufizimi i koncepteve kryesore të hulumtimit

Konceptet kryesore lidhen me konceptin mbingarkesë dhe kurrikulë, si ombrellë e studimit, pastaj me konceptet specifike, si: mbingarkesa kurrikulare, përmbajtje kurrikulare, kohë mësimore, mirëqenie e nxënësve dhe mësimdhënësve.

Mbingarkesa – mbingarkesa kurrikulare. Sipas Fjalorit pedagogjik të prof. Shefik Osmanit (1983), me mbingarkesë kuptohet vënia e barrës mbi nxënësin, vënia e detyrave të shumta për të mësuar, të cilat ai nuk mund t'i bartë, t'i përballojë. Ajo paraqitet si angazhim i tepruar me vlera që nuk përkojnë me moshën dhe aftësitë intelektuale të nxënësit, reflektohet negativisht në qëndrimin e nxënësit ndaj të mësuarit dhe shkollës (Osmani, 1983).

Në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe mbingarkesë përkufizohet ngarkesa që e tejkalon masën e lejuar ose që i shtohet një ngarkese të zakonshme. Mbingarkesa përshkruhet edhe nga aspekti i shtimit të gjerave të tepërta apo të panevojshme, ose të vështira për t'u përvetësuar apo përballuar në një shkrim apo në një vepër. Në raport me mbingarkesën e programeve mësimore dhe teksteve shkollore, i referohet ngarkesës me punë ose me detyra më të rënda se sa mund të kryejë rregullisht ose se sa mund të përballojë zakonisht nxënësi apo mësimdhënësi – mbingarkimi i nxënësve, mbingarkimi i programeve (ASHSH, 1980).

Mbingarkesa është një mospërputhje ndërmjet kapacitetit dhe ngarkesës. Mbingarkesa e kurrikulës njihet edhe si mbipopullim i kurrikulës ose zgjerim i kurrikulës (NCCA, 2010). Zgjerimi i kurrikulës u referohet tendencës për të përfshirë lëndë të reja mësimore, kërkesave dhe përmbajtje mësimore të re në kurrikulë, si përgjigje ndaj kërkesave të reja shoqërore, pa hequr përmbajtjet mësimore paraprake apo pa rritur kohën mësimore. Kështu, kurrikulat bëhen të mbipopulluara me kalimin e kohës (Alexandër & Flutter, 2009).

Mbingarkesa e përmbajtjes. Në literaturën pedagogjike, sasia e përmbajtjes mësimore që zhvillon mësimdhënësi nga një fushë kurrikulare/lëndë mësimore paraqitet si faktor për mbingarkesë të nxënësit. I referohet sasisë së tepërt të përmbajtjes për t'u mësuar brenda një kohe mësimore të caktuar në kuadër të një fushë kurrikulare/lënde mësimore, apo për një temë mësimore. Për të shmangur mbingarkimin e përmbajtjes, sisteme të ndryshme arsimore kanë marrë në konsideratë që gjatë ridizajnit të kurrikulës të kenë kujdes të shtuar në vendosjen e strukturës së përgjithshme të kurrikulës, numrin lëndëve, numrin e temave mësimore, sasinë dhe cilësinë e kohës së mësimin, por edhe madhësinë dhe gjuhën e dokumenteve të kurrikulës (OECD, 2020).

Koha mësimore - është koncept gjithëpërfshirës, që lidhet me kurrikulën, planin mësimor, i cili referon kohën për mësimdhënie dhe nxënien e një lënde të veçantë apo fushe mësimore gjatë një niveli të arsimit, një shkalle kurrikulare, një viti dhe jave të mësimin. Përfshin kohën mësimore të detyrueshme dhe jo të detyrueshme, kohën për realizimin e aktiviteteve kurrikulare dhe jashtëkurrikulare. Koha e mësimin të detyrueshëm u referohet sasisë dhe shpërndarjes së orëve të mësimin të detyrueshëm, sipas planit të mësimin, i cili mbulon secilën klasë dhe fushë kurrikulare/ lëndë mësimore që duhet të sigurohet nga çdo shkollë publike dhe duhet të ndiqet apo të frekuentohet në mjediset formale të klasës, nga pothuajse të gjithë nxënësit e shkollave publike (OECD, 2020), sipas kalendarit të vitit për shkollat publike në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, i cili përcaktohet nga sistemet arsimore të vendeve përkatëse.

Mirëqenia e nxënësve - është një term kompleks, holistik, që në vete përfshin aspekte të dimensioneve të mirëqenies psikologjike, sociale, kognitive dhe fizike. Mirëqenia e nxënësve është rezultat i ndërveprimeve ndërmjet këtyre katër dimensioneve, të dallueshme, por edhe të lidhura ngushtë njëra me tjetrën. Secili dimension mund të konsiderohet edhe si rezultat dhe si një kusht mundësues në lidhje me dimensionet e tjera dhe, së bashku, tregojnë cilësinë e përgjithshme të mirëqenies së nxënësve (OECD, 2017). Në këtë drejtim, angazhimi i shkollës në sigurimin e një mjedisi të të nxënët mundësues për të gjithë nxënësit është parakusht themelor për nxënie efektive dhe të qëndrueshme të nxënësve (IPK, 2016), krahas me kurrikulën

si bazë e orientimeve për zhvillimin e procesit mësimor – edukativ dhe konsolidimin e aftësive dhe kompetencave të nxënësve, dhe me aspektin e organizativ e lehtësues të mësimdhënies dhe të nxënies. Studimi ynë, ndër të tjera, pasqyron edhe ndikimin e mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e nxënësve, të raportuar nga vetë nxënësit dhe përfaqësuesit e tjerë të komunitetit arsimor.

Mirëqenia e mësimdhënësve. Sipas Acton dhe Glasgow (2015), mirëqenia e mësimdhënësve përkufizohet si "një ndjenjë individuale e përbushjes profesionale personale, kënaqësisë, qëllimit dhe lumturisë, e ndërtuar në një proces bashkëpunues me kolegët dhe nxënësit" (cituar nga Mc Callum et al, 2017). Mirëqenia e mësimdhënësve i referohet më shumë aftësisë së mësimdhënësve për të zhvilluar një ekuilibër pozitiv, por dinamik, midis burimeve të mësimdhënësve dhe sfidave/kërkesave të tyre mjedisore, sociale, individuale, fizike, mendore, psikologjike (Benevene et al, 2020). Studimi ynë pasqyron edhe ndikimin e mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e mësimdhënësve, të raportuar nga vetë mësimdhënësit.

Përkufizimi i koncepteve të ndërlidhura me fushën e studimit. Meqë studimi mbulon arsimin e detyrueshëm dhe çështjet e mbingarkesës kurrikulare në këtë nivel të arsimit, në pjesën në vijim pasqyrohen disa nga konceptet e dokumenteve kurrikulare që ndërlidhen me mbulimin e aspekteve të trajtuara në këtë studim.

Korniza kurrikulare - është dokumenti themelor në të cilin përshkruhen orientimet dhe udhëzimet kryesore për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës së arsimit parauniversitar (qëllimet e arsimit, kompetencat kyçe, rezultatet e të nxënies sipas niveleve etj. Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar në Kosovë është e bazuar në kompetenca. KKAP, së bashku me Kurrikulat Bërthamë për nivele të arsimit, kanë kaluar në një fazë të pilotimit në periudhën 2013-2015 dhe janë rishikuar dhe miratuar në vitin 2016 (MASHTI, 2016).

Kurrikula Bërthamë - është dokumenti themelor për një nivel formal të arsimit, ka kërkesa të përbashkëta për të gjithë nxënësit në aspektin e kompetencave kryesore të zbërthyera për shkallë kurrikulare, fushat kurrikulare/lëndët e përbashkëta dhe orientimet e përgjithshme. Aktualisht,

arsimi parauniversitar në Kosovë ka tri dokumente të kurrikulave bërthamë: Kurrikula Bërthamë për arsimin fillor; Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët; dhe Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë – gjimnazet. Kurrikulat Bërthamë për një nivel të arsimit janë të ndara apo të organizuara në dy shkallë kurrikulare (MASHTI, 2016).

Shkallët kryesore të kurrikulës - janë nënivele formale të arsimit, që ndërlidhen me fazat e zhvillimit të fëmijëve dhe organizimin e procesit të mësimdhënies, nxënies dhe vlerësimit. Kurrikula e arsimit parauniversitar në Kosovë është e ndarë në 6 shkallë kryesore kurrikulare. Në arsimin fillor, shkalla e parë e kurrikulës përfshin klasën përgatitore, klasat 1 dhe 2, ndërsa shkalla e dytë përfshin klasat 3, 4 dhe 5. Në arsimin e mesëm të ulët janë të integruara shkallët e kurrikulës 3 dhe 4, në shkallën 3 janë përfshirë klasat 6 dhe 7, ndërsa në shkallën 4 janë të përfshira klasat 8 dhe 9. Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët, përkatësisht klasat 1-9, është i pjesë e arsimit detyrueshëm.

Kompetencat kryesore – koncepte holistike që përfshijnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat. Gjashtë kompetencat e parapara me Kornizën Kurrikulare të arsimit parauniversitar në Kosovë¹ rrjedhin nga qëllimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar dhe përcaktojnë rezultatet kryesore të të nxënit, të cilat duhet t'i arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme gjatë sistemit të arsimit parauniversitar (MASHT, 2016). Kompetencat në kurrikulë reflektohen si një nga parimet e organizative të kurrikulës. Parimi organizativ për një kurrikulë përcakton drejtimet kryesore që duhet mbajtur parasysht si në fushën e hartimit të programit, ashtu dhe në zhvillimin e veprimtarive mësimore në klasë (Karameta, 2014).

¹ **Kompetencat kryesore të arsimit të Kosovës janë të bazuara dhe të ndërlidhura me tetë Kompetencat kryesore Evropiane për Nxënie Tërëjetësore (Kornizën Referuese Evropiane).** Kompetencat e arsimit të Kosovës janë:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- Kompetenca e të menduarit
- Kompetenca e të mësuarit
- Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
- Kompetenca personale
- Kompetenca qytetare

Rezultatet e të nxënit - në dokumentet kurrikulare përkufizohen si “Deklarata që përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë të bëjë një nxënës/se në fund të një shkalle apo niveli”. Ato shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat (MASHT, 2016). Në kontekstin e kurrikulës së arsimit parauniversitar në Kosovë, ka disa lloje të rezultateve mësimore:

- Rezultatet kryesore të të nxënit për kompetenca (duhet të arrihen në fund të arsimit parauniversitar – në fund të klasës së 12-të);
- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (RNSH) - duhet të arrihen nëpërmjet të gjitha lëndëve mësimore, deri në fund të çdo shkalle kurrikulare, gjithsej 6 shkallë kurrikulare);
- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare për shkallë kurrikulare (RNF) - duhet të arrihen nëpërmjet të gjitha lëndëve mësimore të fushës përkatëse, deri në fund të çdo shkalle kurrikulare, (gjithsej 7 fusha kurrikulare);
- Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNLT) - duhet të arrihen nëpërmjet përmbajtjeve mësimore dhe veprimtarive të ndryshme mësimore, gjatë një viti shkollor;
- Rezultatet e të nxënit të njësisë mësimore – përcaktohen nga mësimdhënësit e lëndëve mësimore përkatëse (mund të jenë për 1-2 orë mësimore.

Kurrikula lëndore/Programi mësimor - është dokument që përshkruan rezultatet dhe përmbajtjet mësimore, metodologjinë përkatëse për mësimdhënie dhe vlerësim, për një lëndë të veçantë. Për çdo klasë të arsimit parauniversitar në Kosovë janë hartuar kurrikulat lëndore të secilës fushë/lëndë mësimore, ato janë të integruara në një dokument të përbashkët të kurrikulës lëndore për klasë, si Kurrikulat lëndore/programet mësimore - klasa e parë, Kurrikulat lëndore/programet mësimore - klasa e dytë, e kështu me radhë.

Përmbajtja mësimore – në dokumentet kurrikulare përkufizohen si tërësia e dijeve, informacionit, fakteve, situatave, veprimtarive etj., të grupuara në një lëndë ose fushë të të nxënës, që shërbejnë si bazë për formimin dhe zhvillimin e njohurive të reja dhe kompetencave.

Kurrikula me zgjedhje - përfaqëson lëndët mësimore dhe aktivitetet kurrikulare të vendosura në nivelin e shkollës, të cilat nxënësit mund t'i zgjedhin në pajtueshmëri me interesat, talentet dhe nevojat e tyre. Koha mësimore e kurrikulës me zgjedhje, në kontekstin e arsimit në Kosovë, dallon nga klasa në klasë dhe përfshin rreth 4 % të kohës mësimore në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët.

Çështjet ndërkurrikulare - përmbajtje të rëndësishme kurrikulare që nuk i përkasin krejtësisht vetëm një lënde apo një fushe të kurrikulës, por që mësohen në disa lëndë. Shembuj të zakonshëm të çështjeve ndërkurrikulare në kurrikulat e arsimit parauniversitar të Kosovës janë: edukimi për paqe, të drejtat e njeriut dhe edukata qytetare, çështjet gjinore, shkathtësitë e komunikimit, edukimi për zhvillim të qëndrueshëm, edukimi ndërkulturor etj.

KAPITULLI II

Shqyrtimi i literaturës

Çështja e mbingarkesës në mësim, si koncept dhe si problem, ka qenë dhe mbetet në fokusin e teorisë dhe praktikës pedagogjike. Në zhvillimet aktuale në arsim, çështja e mbingarkesës në mësim trajtohet në dimensione të shumta, është bërë një nga temat kryesore që duhet trajtuar para çdo reforme kurrikulare.

Trajtimi dhe adresimi me kohë dhe në mënyrë të duhur i problematikes së mbingarkesës kurrikulare dhe faktorëve ndikues është një orientim i rëndësishëm së veçantë në përpjekjet e sistemeve arsimore dhe të zhvilluesve të kurrikulave, që të zhvillojnë dhe zbatojnë sistem kurrikular që në fokus ka në radhë të parë mirëqenien e nxënësve, por edhe të mësimdhënësve.

Në literaturën pedagogjike dhe didaktike, në studimet në fushën e edukimit, mbingarkesa kurrikulare është trajtuar nga aspekti i mbingarkesës sasiore, me numër të lëndëve mësimore, fondit të orëve mësimore për klasë, por edhe nga aspekti i mbingarkesës së përmbajtjes mësimore dhe ndikimit të saj në punën e nxënësve dhe të mësimdhënësve.

Për këtë studim, shqyrtimi i literaturës, por edhe i fokusit të hulumtimit, është orientuar në trajtimin e mbingarkesës kurrikulare nga perspektiva e zhvillimit të kurrikulave, e analizës së kurrikulave në raport me kohën mësimore dhe elementet e ndërlidhura me të, për realizimin e kërkesave kurrikulare, si dhe nga perspektiva e analizës së ndikimit të mbingarkesës kurrikulare në arritjet dhe mirëqenien e nxënësve dhe të mësimdhënësve.

2.1. Zhvillimi - rishikimi i kurrikulave

Procesi i zhvillimit apo rishikimit të Kurrikulës/Programeve mësimore kalon nëpër faza të ndryshme, të cilat e kompletojnë ciklin e procesit të ndryshimeve dhe e plotësojnë atë në të gjitha hallkat e zhvillimit të tij. Autoritetet e vendeve të ndryshme ndjekin përvoja të ndryshme. Vlejnë të veçohen përvojat e vendeve të ndryshme që janë të përafërta, si: Angli, Finlandë, Skoci, SHBA, Australi, etj. Për shembull, në Australi procesi i zhvillimit të kurrikulës përfshin katër faza: (i) Forma e Kurrikulumit; (ii) Të

shkruarit e Kurrikulumit; (iii) Implementimi/zbatimi; dhe (iv) Vlerësimi dhe rishikimi i Kurrikulumit (cituar sipas Devetaku-Gojani, 2011).

Sipas Tyler (1949), zhvillimi i kurrikulës duhet të shikohet si një cikël: cilësia dhe ndikimi i funksioneve të kurrikulës duhet të monitorohen duke vëzhguar me kujdes rezultatet dhe të dhënat nga këto vëzhgime, të cilat duhet të përdoren për të bërë rishikimet e nevojshme. Kurrikula është koncept, gjithnjë në zhvillim (cituar sipas Karameta, 2014).

Zhvillimi/rishikimi i kurrikulave është pjesë e reformave në arsim, pjesë themelore e reformës kurrikulare, e cila nga politikëbërësit kryesisht arsyetohet se bëhet me qëllim që t'u përgjigjet sfidave, me të cilat ballafaqohet shoqëria, apo t'u përshtatet zhvillimeve në shoqëri, arritjeve në shkencë dhe në teknologji, si dhe arritjes së vizionit që e përcakton shoqëria për të ardhmen.

Këtë orientim të arsyeshmërive për reformën kurrikulare e gjejmë edhe në hyrje të dokumentit KKAP, në të cilin theksohet se zhvillimi i kurrikulës së re është bërë me qëllim të ballafaqimit me sfidat, si: nevoja për ndërtimin e një shoqërie të dijes, integrimi në epokën digjitale, rritja e ndërvarësisë dhe e lëvizshmërisë, të mësuarit për të jetuar së bashku, zhvillimi i qëndrueshëm, diaspora dhe mërgata (MASHT /KK, 2016). Vizioni dhe arsyetimi për reformimin e kurrikulës së re bazoheshin në vendimin për përmirësimin e sistemit arsimor të Kosovës dhe përafrimin e tij me kërkesat e shkollave të shekullit të 21-të (Buleshkaj & Koren, 2022).

Sipas Mehmeti, Buleshkaj & Lynn (2013), ndryshimet e nevojshme në kurrikulë mund të adresohen në tri mënyra të ndryshme: (i) Nga fokusi me lëndët në qendër te fokusi në rezultate mësimore dhe i bazuar në kompetenca; (ii) Nga fokusi me mësimdhënësin në qendër te fokusi me nxënësin në qendër dhe (iii) Nga metodologjia didaktike/ligjëruese në një metodologji me ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.

Kurrikulat e reja, në vende të ndryshme apo sisteme të ndryshme arsimore, kanë të përbashkët një seri aspektesh të karakterit të përgjithshëm dhe një bashkësi orientimesh për çdo fushë të nxënies (Karameta, 2014). Sipas Mehmeti et al. (2019), trendët e zhvillimit të kurrikulave të reja tregojnë se

dokumentet kurrikulare dallojnë nga shteti në shtet. Dallime vërehen si në strukturë të dokumenteve kurrikulare, ashtu edhe në qëllime, në parime, në organizimin e përmbajtjes mësimore, vendosjen e rezultateve të të nxënit, numrin e fushave të kurrikulës/lëndëve mësimore etj.

Sipas Raportit të Progresit të Këshillit të Bashkimit Evropian (2010), për zbatimin e programit të punës për arsimin dhe trajnimin, vendet evropiane po i reformojnë kurrikulat e tyre, mbi kornizën e kompetencave kyçe për të mësuarit gjatë gjithë jetës, publikuar në fund të vitit 2006. Korniza në fjalë thekson se reforma kurrikulare për përmirësimin e kompetencave ka nevojë për një qasje tërësore, gjithëpërfshirëse, duke organizuar nxënien në të gjitha lëndët mësimore, mësimdhënien e qartë të kompetencave, trajnimin e mësuesve të rinj, qasjet didaktike, si dhe duke përfshirë aktivisht mësimdhënësit, nxënësit dhe të tjerët (European Communities, 2007).

Këtë e thotë edhe raporti i OECD-së (2020), i cili sjell edhe disa ndryshime të sistemeve arsimore të vendeve të OECD-së në raport me reformën e kurrikulave në arsimin parauniversitar. Sipas raportit të OECD-së, kurrikulat në sisteme të ndryshme arsimore dallojnë edhe në qasjen e bazuar në kompetenca dhe numrin e kompetencave kryesore, qasjen e integritit të lëndëve në fusha kurrikulare dhe numrin e lëndëve të përfshira brenda një fushe kurrikulare, çështjet ndërkurrikulare etj. (OECD, 2020).

Reformimi i kurrikulës së fundit në arsimin parauniversitar në Kosovë, e draftuar në vitin 2011 dhe e rishikuar dhe miratuar në vitin 2016, është bërë mbi kornizën e kompetencave kyçe, me dallime në numrin e kompetencave kryesore dhe në qasjen e mbarështrimit dhe integritit të tyre në dokumentet kurrikulare, deri te kurrikulat lëndore. Pra, edhe KKAP në Kosovë është e ndërtuar në bazë kompetencash, përmes së cilës synohet të zhvendoset fokusi nga presioni për realizimin e përmbajtjes së përcaktuar me programe mësimore dhe tekste shkollore, në zhvillimin e kompetencave kryesore të zbërthyer nëpërmjet rezultateve të nxënit.

Zhvillimi i kompetencave të përcaktuara në kuadër të kurrikulës synohet të bëhet nëpërmjet fushave të kurrikulës, lëndëve/moduleve me zgjedhje,

projekteve, çështjeve kurrikulare dhe formave të tjera inovative të punës me nxënës, të udhëhequra nga shkollat (Mehmeti & Buleshkaj, 2017).

Në anën tjetër, zbatimi në praktikë i kurrikulës është objektivi përfundimtar i procesit të reformimit të kurrikulës, i cili në masë të madhe varet nga përkushtimi dhe gatishmëria e mësimeve, por edhe nga përkrahja e drejtorëve të shkollave dhe mekanizmave mbështetës që kanë rol dhe përgjegjësi në mbikëqyrje dhe përkrahje të shkollave për zbatimin e kurrikulës.

Sipas Marash (2009), termi zbatim ka të bëjë me përdorimin në praktikë të një kurrikulumi ose programi mësimor, gjegjësisht vënien në praktikë të programeve dhe lëndëve mësimore. Është e rëndësishme të theksohet se zbatimi i kurrikulës nuk mund të bëhet pa nxënës (Marash (2009). Gjithashtu, është e rëndësishme të thuhet se zbatimi i kurrikulës varet në masë të madhe nga funksionaliteti dhe serioziteti i mekanizmave institucionalë dhe në nivel shkolle, që janë të lidhur me zbatimin e kurrikulës.

Zbatimi i kurrikulës bëhet i suksesshëm atëherë kur mësimeve fitojnë përvojat e duhura, njohuritë, shkathtësitë, idetë dhe qëndrimet e drejta për kurrikulën apo programin mësimor që do ta vënë në praktikë. Vetëm kur pranohet plotësisht nga mësuesit e një shkolle dhe kur veprimtaritë e lidhura me të kthehen në rutinë, mund të thuhet se kurrikulumi ka arritur fazën e “institucionalizimit” (Marash, 2009). “Institucionalizimi” i zbatimit të kurrikulës në shkollë lidhet edhe me informimin e prindërve për kurrikulën dhe rolin e tyre në këtë proces.

Suksesi i zbatimit të kurrikulës, përveç që është i ndikuar nga udhëheqja e zbatimit të kurrikulës dhe niveli i kompetencave të mësimeve në fushën e kurrikulës dhe në praktikën e zbatimit të saj, në masë të madhe është i varur nga strategjitë e ndërmarra nga sistemet arsimore për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare qysh gjatë procesit të dizajnit të kurrikulës.

Zhvillimi/rishikimi i kurrikulave, në përpjekje për t’iu përgjigjur sfidave, me të cilat ballafaqohet shoqëria, arritjeve në shkencë dhe në teknologji, sipas

studimit të OECD-së (2020), mund të rezultojë me mbingarkesë të kurrikulës, e cila mund të përfshijë mbingarkesë në përmbajtje mësimore apo sasi të tepërt të përmbajtjeve mësimore në raport me kohën e disponueshme për mësim, mosbalancim të kurrikulës ku disa fusha kurrikulare mund të favorizohen në kurriz të fushave të tjera etj (OECD, 2020).

Referuar raporteve të studimeve lidhur me kurrikulën, të studimeve krahasuese që lidhen me kurrikulën (IZhA, 2011; Karameta, 2014; OECD, 2020), sisteme të ndryshme arsimore, në përpjekje për të normalizuar mbingarkesën kurrikulare, kanë bërë kalim nga kurrikula me bazë në përmbajtje në kurrikula të bazuara në kompetenca, nga kurrikula në bazë lënde në atë me bazë fushat e të nxënës, do të mundësojë që të mësuarit të evidentojë dhe të unifikojë të përbashkëtat, duke evituar copëzimin dhe mungesën e lidhjes ndërmjet përmbajtjeve të lëndëve.

2.2. Mbingarkesa kurrikulare - faktorët ndikues

Çështja e mbingarkesës kurrikulare dhe e faktorëve që ndikojnë në mbingarkesë kurrikulare është trajtuar dhe hulumtuar kryesisht në mbështetje të literaturës ndërkombëtare që e trajtojnë këtë problematikë, në kuadër të sistemeve të ndryshme, e cila pothuajse është e pranishme në shumicën e sistemeve arsimore, por që reflektohet dhe trajtohet në mënyra dhe qasje të ndryshme.

Në raporte të studimeve të ndryshme, mbingarkesa kurrikulare dhe faktorët që ndikojnë në mbingarkesë kurrikulare trajtohen në mënyra të ndryshme (Bekteshi, 2009; Alexandër & Flutter, 2009; NCCA, 2010; Majoni, 2017; OECD, 2020 etj.), varësisht nga fokusi dhe qëllimi i studimeve. Pavarësisht qasjeve të ndryshme në trajtimin e mbingarkesës kurrikulare dhe faktorëve të saj, pothuajse të gjitha studimet përshkruajnë disa faktorë që kanë kontribuar në mbingarkesën e kurrikulës në arsimin fillor apo të mesëm të ulët, të cilët kryesisht përfshijnë zgjerimin e kurrikulës, me elemente përbërëse të saj, si shtimin e numrit të lëndëve mësimore, shtimin e përmbajtjeve mësimore në raport me kohën mësimore, apo mungesën e kohës mësimore, madhësinë dhe vëllimin e kurrikulës.

Në raportin e Këshillit Kombëtar për Kurrikulën dhe Vlerësimin (NCCA, 2010) për mbingarkesën kurrikulare në arsimin fillor, raportohen tre faktorë kryesorë, të cilët mund të identifikohen si kontribuues në mbingarkesën e kurrikulës në shkollat fillore, përfshirë madhësinë e kurrikulës së shkollës fillore, të rishikuar në vitin 1999, zgjerimin e kurrikulës në vitet e fundit dhe shkollat dhe klasat e nxituara në zbatim të kurrikulës. Për secilin nga këta tre faktorë, raporti identifikon disa dimensione të mbingarkesës së kurrikulës të ndërlidhur me faktorët përkatës, të cilët pasqyrohen si në vijim (NCCA, 2010):

Tabela 1: Faktorët e mbingarkesës kurrikulare dhe dimensionet e mbingarkesës (NCCA, 2010)

Faktorët e mbingarkesës kurrikulare	Dimensionet e mbingarkesës
Madhësia e kurrikulës së shkollës fillore	Zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulës në shkollën fillore Organizimi i kurrikulës Hierarkia e lëndëve mësimore dhe koha mësimore Tekstet shkollore
Zgjerimi i kurrikulës	Vlerësimi Udhëzime për mësuesit/shkollat dhe materialet shtesë mbështetëse Iniciativa dhe programe për shkollat
Shkolla të nxituara dhe klasa të nxituara	Hapësira e shkollës, objektet dhe burimet Mungesa e kohës/mundësisë së mësimdhënësve për planifikimin e kurrikulës Mungesa e kohës për të komunikuar me prindërit Politika dhe legjislacioni

Autori i studimit “Mbingarkimi i nxënësve me mësim në shkollë”, Bektesh S, Bekteshi (2009), faktorët e mbingarkimit të nxënësve me mësim në shkollë i grupon në katër faktorë: (i) faktorët shoqërorë; (ii) faktorët e familjes, (iii) faktorët shkollorë; dhe (iv) faktorët që dalin nga vetë nxënësit. Në raport me faktorët shkollorë, ku trajtohen elementet e kurrikulës, specifikohen ngarkesa që vijnë nga plani dhe programi mësimor, mësimdhënësi, tekstet shkollorë, detyrat e shtëpisë, njohuritë paraprake të nxënësve dhe kushtet e punës në shkollë.

Në anën tjetër, sipas raportit të OECD-së (2020), mbingarkesa e kurrikulës ka bazë në katër dimensione. Secili dimension adreson aspekte të veçanta të mbingarkesës, siç është përshkruar në vijim.

Tabela 2: Dimensionet e mbingarkesës dhe përshkrimi i elementeve të tyre (OECD, 2020)

Dimensionet e mbingarkesës së kurrikulës	Përshkrimi
1. Zgjerimi i kurrikulës	I referohet tendencës për të përfshirë lëndë mësimore, tema të përmbajtjes së re në kurrikulë, në përgjigje të kërkesave të reja shoqërore, pa marrë në konsideratë, në mënyrë të përshtatshme, tema mësimore, të cilat duhet të hiqen.
2. Mbingarkesa e përmbajtjes	I referohet dimensionit aktual të mbingarkesës së kurrikulës, d.m.th. sasisë së tepërt e përmbajtjes që duhet të zhvillohet dhe të mësohet në raport me kohën mësimore në dispozicion.
3. Mbingarkesa e perceptuar	I referohet dimensionit të perceptuar ose të përjetuar të mbingarkesës, siç raportohet nga nxënësit dhe mësimdhënësit.
4. Mosbalancimi i kurrikulës	I referohet vëmendjes joproporcionale që u kushtohet fushave të caktuara të kurrikulës në kurriz të fushave të tjera, pa rregullime të duhura në fushat me prioritet të ulët.

Studimet e cituara më sipër, për faktorët, dimensionet e mbingarkesës dhe specifikat e tyre, tregojnë qartazi kompleksitetin e mbingarkesës kurrikulare, tregojnë qartazi se mbingarkesa kurrikulare është komplekse dhe e ndikuar nga faktorë të shumtë, duke theksuar në mënyrë të veçantë zgjerimin e kurrikulës dhe me shtimin e përmbajtjeve mësimore në raport me gjerësinë, vëllimin e tyre me kohën mësimore në dispozicion, por edhe aspektet e organizimit dhe zbatimit të kurrikulës dhe të perceptimeve të subjekteve të komunitetit të shkollës që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e kurrikulës.

Kjo nënkupton se mbingarkesa kurrikulare shkon përtej këtyre komponentëve themelore përmbajtjesore të kurrikulës, është e lidhur edhe me mënyrën se si janë të organizuara kurrikulat për nivelet e arsimit dhe klasat gjegjëse, formatin dhe madhësinë e kurrikulës, tekstet shkollore, udhëzimet për mësuesit/shkollat dhe materialet mësimore mbështetëse, iniciativat dhe programet mbështetëse për zbatimin e kurrikulës, vlerësimin e nxënësve, organizimin e brendshëm të shkollave, kapacitetet dhe qasjet në praktikën e mësimdhënies, punës me nxënës, mësimdhënës dhe me prindër, hapësirën e shkollës dhe burimet për të zbatuar qasje kreative në organizimin e proceseve të mësimin.

Pjesë e mbingarkesës kurrikulare shihen edhe politika dhe legjislacioni, që lidhen me rregullimin e sistemit arsimor, përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit, punësimin dhe zhvillimin e mësimdhënësve, ndarjen e kohës mësimore për mësim të detyrueshëm dhe për mësim jo të detyrueshëm etj. Zgjerimi i kurrikulës, shtimi i përmbajtjeve mësimore apo mbingarkesa me përmbajtje mësimore në raport me kohën mësimore në dispozicion, do të plotësohen me disa elemente të trajtimit në vijim.

2.2.1. Zgjerimi i kurrikulës

Zgjerimi i kurrikulës zakonisht shkaktohet nga procesi i rishikimit të kurrikulave nga sistemet arsimore, më qëllim të ballafaqimit të sfidave që përballen sot shoqëritë, si integrimi në epokën digjitale, rritja e ndërvarësisë dhe e lëvizshmërisë, të mësuarit për të jetuar së bashku, edukimi mjedisor, edukimin mediatic, zhvillimi i qëndrueshëm etj., por edhe për shkak të presionit nga grupet e interesit dhe nevojave të mjedisit në ndryshim.

Zgjerimi i kurrikulës mund të rezultojë me shtim të lëndëve mësimore, siç raportohet nga shumë sisteme arsimore, të cilat kanë listë të gjatë të lëndëve mësimore, si në arsimin fillor ashtu edhe në arsimin e mesëm të ulët, "lista e lëndëve thjesht është bërë më e gjatë dhe asgjë nuk është hequr për të akomoduar lëndët e reja" (Alexandër & Flutter, 2009).

Referuar raporteve të studimeve të përshkrua më sipër për mbingarkesën kurrikulare, veçanërisht raportit të studimit të OECD-së (2020), zgjerimi i kurrikulës nuk lidhet vetëm me futjen e lëndëve të reja në sistemin e kurrikulës, por edhe me shtimin e përmbajtjeve dhe kohës së mësimimit në lëndë të caktuara për të pasqyruar ndryshimet në shoqëri, për përgjigje të kërkesave në rritje, p.sh. për globalizim, kompetenca digjitale, si dhe me shtimin e temave të reja mësimore, brenda lëndëve ekzistuese.

Zakonisht zgjerimi i kurrikulës, si shtimi i lëndëve mësimore, shtimi apo zvogëlimi i kohës mësimore, temave mësimore pa ndryshuar kohën mësimore, janë të lidhura me vendimmarrje politike nga sistemet arsimore, të cilat shpesh kanë agjenda të caktuara politike. Përfshirja e temave të reja mësimore në lëndët ekzistuese dhe në kohën e njëjtë mësimore, konsiderohet si një opsion që është më pak i ngarkuar politikisht, por që paraqet sfida për mësimdhënës (OECD, 2020).

Sisteme arsimore të ndryshme arsimore, si përgjigje ndaj kërkesave në rritje të shoqërisë, në kurrikulat shtetërore kanë vendosur një grup kompetencash të rekomanduara nga Komisioni Evropian, të gjitha tetë kompetencat, apo të modifikuara nga sistemet arsimore, që konsiderohen kritike për të mësuarit gjatë gjithë jetës, si (Komisioni Evropian, 2018): shkrim-leximi; shumëgjuhësia; aftësitë numerike, shkencore dhe inxhinierike; kompetenca digjitale dhe të bazuara në teknologji; aftësitë ndërpersonale dhe aftësia për të adoptuar kompetenca të reja; qytetari aktive; ndërmarrësia; ndërgjegjësimi dhe shprehja kulturore.

Sipas raportit të OECD-së (2020), sisteme të ndryshme arsimore, në përgjigje të zgjerimit të kurrikulës nga kërkesat e shoqërisë dhe nga zhvillimet e tjera shoqërore, kanë vendosur krijimin e një lënde mësimore të veçantë për të akomoduar kërkesa të ndryshme shoqërore në ndryshim, duke

i ikur kështu përsëritjes së temave të njëjta në lëndë të ndryshme, si dhe kanë bërë përkthimin e nevojave shoqërore në kompetenca dhe tema ndërkurrikulare dhe futjen e tyre në lëndët/fushat ekzistuese mësimore.

Në sisteme të ndryshme arsimore, edhe në Kosovë, zhvillimi i kurrikulave në arsimin parauniversitar merr për bazë qasjen e bazuar në kompetenca, si një mundësi për të orientuar pritshmëritë për nxënës në zhvillimin e kompetencave kryesore, dhe si një mundësi për të menaxhuar me kujdes zgjerimin e kurrikulave.

2.2.2. Mbingarkesa e përmbajtjes mësimore

Nga trajtimi i bërë te pjesa për konceptet kryesore të hulumtimit, shohim se mbingarkesa e përmbajtjes i referohet sasisë së tepërt të përmbajtjes për t'u mësuar brenda një kohe mësimore të caktuar, në kuadër të një fushë kurrikulare/lënde mësimore apo për një temë mësimore. Sipas Bekteshit (2009), përmbajtjet mësimore janë burimi themelor i mbingarkimit. Përmbajtja e vështirë, e pakuptueshme dhe tepër e gjerë, e detyron nxënësin të mësojë shpejt, t'i përvetësojë dhe t'i mbajë mend shumë informacione të llojllojshme marginale, të tërthorta, pa vlerë dhe të panevojshme, të cilat nuk shërbejnë për asgjë dhe nuk kanë kurrfarë vlere njohëse në jetën e njeriut. Zakonisht, përmbajtjet e tilla nuk janë të lidhura me situata nga jeta dhe nuk e përgatisin një individ për përballje me problematikat reale në jetë.

Mbingarkesa e përmbajtjes është e lidhur me vendosjen e qëllimeve dhe rezultateve të nxënës që vendosen në kurrikula, të cilat shpesh nuk përkojnë me kohën mësimore të përcaktuar për arritjen e tyre. Sipas studimit të OECD-së (2020), mbingarkesa me përmbajtje mësimore shpesh nxitet nga pritshmëri jorealiste për të ruajtur gjerësinë (numrin e lëndëve dhe temave mësimore që duhet të mësohen brenda një lënde mësimore) dhe thellësinë.

Gjithashtu, sipas raportit të njëjtë, burime shtesë të mbingarkesës së përmbajtjes mund të lindin bazuar në mënyrën se si ato përkthehen në programe mësimore, tekste shkollore, materiale vlerësimi dhe detyra shtëpie. Mbingarkesa e përmbajtjes është kështu një koncept relativ, pasi

varet nga kush e përdor kurrikulën, mirëpo mbingarkesa e përmbytjes është forma më e shpeshtë e raportuar e mbingarkesës së kurrikulës (OECD, 2020).

Mbingarkesa me përmbytje mësimore shpie në mësimdhënie sipërfaqësore, manifestohet në rezultatet e testimeve/provimeve (Peffer, et al. 2005). Arritja e ekuilibrit të nevojshëm midis gjerësisë dhe thellësisë në përmbytjen e kurrikulës mbetet një çështje e pazgjidhur e vazhdueshme në reformat arsimore të shumë sistemeve arsimore (Alexandër & Flutter, 2009).

Në anën tjetër, sipas UNESCO-s (2002), të kesh më pak tema për t'u mbuluar më thellë një kurrikulë shpesh ngre shqetësime për uljen e standardeve të arritjeve të nxënësve (UNESCO, 2002). Megjithatë, mësimi i më pak temave mësimore në thellësi më të madhe për temat përkatëse i ndihmon nxënësit të zhvillojnë nivel më të lartë të të kuptuarit dhe të menduarit që mundësojnë që mësimet e fituara të transferohen përtej lëndëve specifike në fusha të reja mësimore dhe situata me probleme të reja (Coker et al., 2016). Schwartz et al. (2009), ndër të tjera, argumentojnë se mësimi i më pak temave mësimore në thellësi më të madhe mund të përmirësojë jo vetëm arritjet akademike të nxënësve, por edhe nivelin e kënaqësisë së tyre për mësim.

Sipas Peffer, et al. (2005), një mënyrë për t'u përballur me kurrikulat e mbingarkuara me përmbytje mësimore është që mësimdhënësve (dhe nxënësve) t'u lejojë mundësia e zgjedhjes së temave që duan të japin nga një sërë temash të ofruara në kurrikula dhe të mos detyrohen të mbulojnë të gjitha temat e renditura në kurrikula. Paralelisht me ndërtimin e autonomisë së mësimdhënësve në përzgjedhjen e temave mësimore bëhet e qartë se vëllimi i temave duhet të përcaktohet në raport me pedagogjinë e mësimdhënies dhe rezultatet e të nxënësve, të cilat bëhen pjesë e vlerësimit (Peffer, et al., 2005).

Sipas Bektishi (2009), dukurinë e mbingarkimit e shkakton edhe fragmentarizmi, përkatësisht mungesa e lidhshmërisë së përmbytjeve mësimore brenda vetë lëndës mësimore, ndërmjet lëndëve të ndryshme mësimore të së njëjtës fushë, klasë ose të klasave të ndryshme (Bektishi, 2009). Prandaj, është e rëndësishme të trajtohet mbingarkesa kurrikulare

edhe nga perspektiva e qasjes në shtrimin e përmbajtjeve mësimore të lëndëve nga një fushë kurrikulare, si dhe ndërmjet çështjeve ndërkurrikulare.

Kurrikulat që aktualisht zbatohen në arsimin parauniversitar në Kosovë (nga viti 2016 e këndej) janë të bazuara në kompetenca, organizimi i përmbajtjeve mësimore fillon nga konceptet e fushave kurrikulare, thellësia e të cilave përcaktohet me rezultate të të nxënësve për fusha kurrikulare në kuadër të një shkalle kurrikulare, pastaj organizimi i përmbajtjeve mësimore të kurrikulave lëndore bëhet me tema mësimore, thellësia e të cilave përcaktohet me rezultate të nxënësve për një vit shkollor (MASHT, 2016).

Nga shkolla pritet që t'i përgatisë nxënësit për mësim gjatë gjithë jetës, duke kultivuar kureshtjen e natyrshme të të rinjve për informata të reja, duke zhvilluar interesimin për të nxënë dhe duke i përgatitur nxënësit për mësim të pavarur (Boshtrakaj, 2018).

Në diskutime të ndryshme me mësimdhënës nga Kosova, që janë duke zbatuar kurrikulën e bazuar në kompetenca, janë ngritur shqetësime për mbingarkesën e kurrikulave me përmbajtje mësimore (lëndë dhe tema mësimore për lëndë), rezultate të nxënësve vështirë të arritshme, mirëpo ato nuk janë përmbledhur dhe raportuar në mënyrë formale dhe nuk janë bërë studime profesionale dhe shkencore për nivelin dhe aspektet e mbingarkesës kurrikulare me përmbajtje mësimore, gjë të cilën synon ta bëjë ky studim.

2.2.3. Mbingarkesa e përmbajtjeve mësimore në raport me kohën mësimore

Problemi i mbingarkesës së kurrikulës me përmbajtje mësimore, në radhë të parë, trajtohet në raport me kohën mësimore, sa i përket numrit të orëve mësimore për klasë dhe lëndë mësimore, kohën të cilën nxënësi e kalon në mësim, në shkollë, në përvetësimin e detyrave dhe përmbajtjeve mësimore, duke përfshirë ngarkesën me ditë pune gjatë vitit shkollor, me orë mësimi gjatë ditës, javës dhe vitit shkollor, me kohëzgjatje të orës mësimore, me cilësinë e kohës së mësimi për të mësuar në shkollë, pas shkollës aktivitetet jashtëshkollore.

Në raporte të analizave krahasuese (IZHA, 2011; OECD, 2020) për kohën mësimore në sisteme të ndryshme arsimore, sa u përket javëve të mësimit, numrit të orëve mësimore për një ditë mësimi në klasa dhe nivele të ndryshme të arsimit parauniversitar, kohëzgjatjes së orës mësimore etj., ka përafrime dhe dallime në sisteme të ndryshme arsimore, me diferenca të konsiderueshme në mes të lëndëve mësimore brenda një sistemi arsimor. Në përgjithësi, raportohet se koha mësimore javore apo numri i orëve mësimore për një ditë mësimi nuk ka ndryshuar në dekadën e fundit. Bazuar në këtë, nënkuptohet se edhe koha e mësimdhënies vazhdon të jetë e pandryshuar, përkundrajt faktit se në kurrikula janë shtuar apo integruar tema të reja mësimore dhe rezultate të të nxënësve që duhet të arrihen, si dhe janë shtuar kërkesa të reja për mësimdhënës.

Në literaturë ka dallime sa i përket lidhjes apo marrëdhënies së kohës së mësimit në shkollë dhe performancës së nxënësve. Sipas Rivkin dhe Schiman (2015), koha e shtuar e mësimit është gjetur se ofron më shumë mundësi mësimi dhe lidhet me arritje më të larta akademike, ndihmon nxënësit me performancë më të ulët që të arrijnë nxënësit me performancë më të lartë (cituar sipas OECD, 2020). Megjithatë, sipas Alexander dhe Flutter, (2009), Fitz Patrick dhe O'Shea (2013), OECD (2014) etj., më shumë orë mësimi nuk përkthehen automatikisht në rezultate më të mira dhe mësim cilësor (cituar sipas OECD, 2020).

Studimet lidhur me marrëdhënien midis kohës së mësimit dhe performancës së nxënësve kryesisht marrin për bazë rezultatet apo performancën e nxënësve në programin e vlerësimit ndërkombëtar të nxënësve (PISA), marrëdhënie kjo e cila reflektohet edhe në performancën e nxënësve kosovarë në PISA 2015 dhe PISA 2018. Cilësia e shfrytëzimit të kohës së mësimit vlerësohet të jetë një nga faktorët determinues në performancën e nxënësve.

2.2.4. Mbingarkesa kurrikulare dhe tekstet shkollore

Teksti shkollor është libër themelor për secilën fushë/lëndë mësimore, i shkruar në bazë të kurrikulës dhe i formësuar në pikëpamje didaktike, duke marrë parasysh aftësitë psikofizike të nxënësve dhe veçoritë e lëndës

mësimore (Kuvendi i Kosovës, 2006). Teksti shkollor është vlerë pedagogjike, tradicionalisht e verifikuar mjaft nga pikëpamja e funksionit dhe e vlerës së tij didaktike” (Ramaj, 2001).

Në parim, tekstet shkollore, por edhe materialet e tjera mësimore, derivojnë nga kurrikula, apo ato zhvillohen për nxënës dhe, si një nga burimet e punës për mësimdhënës në funksion të zbatimit të kurrikulës, proces i cili shpesh përcillet me sfida të shumta, të cilat reflektohen gjatë zbatimit të kurrikulës, reflektohen në punën e nxënësve, por edhe të mësimdhënësve, për shkak të mospërputhjes me kurrikulën dhe për shkak të mbingarkesës së teksteve në dimensione të ndryshme, si nga përmbajtja, aparatura didaktike, vështirësitë e kërkesave për nxënës, vëllimi etj.

Mbingarkesa kurrikulare në tekstet shkollore vjen për shkak të sasisë së madhe të përmbajtjeve mësimore, temave/njësive mësimore me përmbajtje të stërngarkuara, me përmbajtje të vështira dhe të ndërlikuara për moshën dhe mundësitë e nxënësve, me gjuhën e papërshtatshme, gabimet shkencore dhe gjuhësore. Nxënësit në mënyrë të veçantë mund t’i mbingarkojë aparatura didaktike e tekstit shkollor, e cila në disa tekste shkollore është e tepërt, e gjerë, e vështirë, përgjithësuese, e pacaktuar (Bekteshi, 2009).

Studime të ndryshme për kurrikulën dhe për tekstet shkollore në kontekstin e arsimit parauniversitar në Kosovë (Peffer, et al., 2005, Thaçi, 2012; Azemi, & Morina, 2013; Boshtrakaj, et al., 2019) flasin për mangësi në kuadrin rregullativ për hartimin dhe vlerësimin e teksteve shkollore, për mangësi të konsiderueshme me aparaturë didaktike, si dhe për probleme dhe të meta sa u përket saktësisë shkencore, ngarkesës me përmbajtje, aparaturës didaktike, trajtimit të aspekteve gjinore, por edhe për probleme me përmbajtje dhe me metodologji.

Në raportin e Institutit të Edukimit, Universiteti i Londrës, Planet dhe programet kombëtare në Kosovë – Vlerësim i hapave të parë (Peffer, et al., 2005) ishin theksuar problemet lidhur me mbingarkesën e teksteve shkollore, duke u specifikuar tekstet në fushën e shkencës, të cilat sipas raportit duken të stërngarkuara dhe promovojnë më shumë nxënie të dijes sesa shkathtësi të të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemeve. Po ashtu, sipas raportit të njëjtë, si kurrikulat, ashtu edhe tekstet në fushën e shkencës, nuk ka përqendrim të qartë rreth ideve dhe teorive të mëdha, ndërkaq zbatimi i ideve

në praktikë kryesisht bëhet në mënyrë abstrakte dhe jo në mënyrë të kontekstualizuar.

Ngarkesa e teksteve shkollore, si një element specifik i mbingarkesës kurrikulare, trajtohet në mënyrë më specifike në studimin *Problemet dhe të metat e teksteve shkollore - Analizë e teksteve shkollore të Kosovës, të ciklit të Shkollës së Mesme të Ulët* (Thaçi, 2012). Studimi ka një fokus të analizës së teksteve në lëndët Biologji, Gjeografi, Histori, Edukatë qytetare. Studimi ofron të dhëna për ngarkesa të teksteve shkollore me: (i) informacione, fakte e shifra; (ii) shprehje, terma, abstraksione dhe koncepte; (iii) përmbajtje të larmishme dhe gjithëpërfshirëse; (iv) një numër të madh faqesh – e vëllimshme; (v) aparaturë didaktike dhe fletore pune; dhe (vi) shpërputhje me moshën e nxënësve.

Secili prej këtyre aspekteve është dimension i veçantë që kërkon veprime profesionale dhe praktike gjatë hartimit dhe rishikimit të teksteve shkollore. Është e rëndësishme të sigurohet që madhësia, vëllimi dhe cilësia e teksteve shkollore të mos i pengojnë përpjekjet për të reduktuar përmbajtjen. Niveli i detajeve të përfshira në tekste shkollore mund të çojë, gjithashtu, në konfuzion mbi atë që është e detyrueshme dhe çfarë jo (OECD, 2020).

Shqetësimet e ngritura nga mësimdhënësit për tekstet shkollore shpërfaqen në *Aparatura didaktike e teksteve shkollore* (Azemi, & Morina, 2013) dhe në studimin *Cilësia e teksteve shkollore në Kosovë* (Boshtrakaj, et al. 2019). Ato lidhen me mungesë të aktualitetit, relevancës dhe përputhshmërisë me kurrikulën e re, mbingarkesë me tema, tekst, fakte, formula, mungesë të referencës në burime të tjera për informata shitesë, mospërshtatje me nivelin kognitiv të nxënësve, mungesë të ndërlidhjes/mundësisë me informatat dhe përvojat paraprake të nxënësve, mungesë të korrelacionit ndërkurrikular; fokus në informata/fakte dhe reproduktim, ilustrime joadekuate, jofunksionale dhe joatraktive për nxënësin etj. (IPK, 2019).

Shqetësime të përafërta janë në fokus të diskutimit në komunitetin e mësimdhënësve dhe të komunitetit të gjerë të arsimit, për tekstet aktuale të hartuara disa vjet pas fillimit të zbatimit të kurrikulës së bazuar në kompetenca.

2.2.5. Mbingarkesa kurrikulare dhe detyrat e shtëpisë

Detyrat e shtëpisë përkufizohen si detyra që u jepen nxënësve nga mësuesit, të cilat duhet të bëhen jo gjatë orëve të mësimit (Cooper, 1989). Rezultatet e studimeve lidhur me detyrat e shtëpisë ndryshojnë duke u bazuar në shumë faktorë, të tillë si mosha e grupit të studiuar, matja e performancës akademike, ndikimi në mirëqenien e nxënësve etj.

Studimet flasin edhe për ndryshime në raport me synimet se për çfarë jepen detyrat e shtëpisë për nxënës. Disa nga synimet më të shpeshta të detyrave të shtëpisë janë praktika, përgatitja për mësim, pjesëmarrja në mësim, marrëdhëniet prind-fëmijë, zhvillimi personal komunikimi prind-mësues, vlerësimi, marrëdhëniet me publikun, politika, dënimi etj. (Epstein & Voorhis, 2001).

Studimet tregojnë së kur detyrat vlerësohen dhe luajnë rol në notën përfundimtare, priten të përmirësojnë performancën në provim. Sipas Andereson, kjo ndodh ngaqë nxënësit do të jenë më të motivuar për detyrat që vlerësohen dhe mësojnë më shumë prej tyre dhe, si pasojë, rezultatet e provimeve përmirësohen. Megjithatë, detyrat që vlerësohen kanë kosto shtesë për mësuesit dhe nxënësit. Mësimdhënësit kalojnë shumë kohë duke vlerësuar detyrat dhe duke dhënë informata kthyesë të përshtatshme. Sa u përket nxënësve, ata duhet të kalojnë nëpër një proces më produktiv të të mësuarit për të gjetur kohë të punojnë për detyrat që vlerësohen (cituar nga Habili, 2018).

Ka diskutime edhe lidhur me kohën se sa duhet të jetë ajo për t'i kryer nxënësit detyrat e shtëpisë, që të mos cenohet mirëqenia e nxënësve. Bekteshi (2009) e trajton kohën për detyrat e shtëpisë, të cilat nuk duhet të marrin më shumë se gjysmën e kohës së mësimit të rregullt në shkollë, koha për detyra të shtëpisë do të duhej të sillej prej 0.5 – 1 orë për nxënësit e klasave të të arsimit fillor dhe 1-2 orë për nxënësit e klasave të arsimit të mesëm të ulët.

Ka diskutime edhe për rolin e përfshirjes së prindërve në detyrat e shtëpisë të fëmijëve të tyre, si në raport me përkrahjen e fëmijëve drejtpërdrejt në

mësime dhe detyra, ashtu edhe në raport me krijimin e kushteve dhe klimës për të mësuar në shtëpi dhe për angazhim në bërjen e detyrave të shtëpisë.

Përtej trajtimeve më sipër, studime të ndryshme i trajtojnë detyrat e shtëpisë edhe si një aspekt i veçantë i mbingarkesës kurrikulare, nivelin e vështirësisë së detyrave të shtëpisë në raport me moshën e nxënësve, por edhe me kohën për kryerjen e detyrave të shtëpisë, ku kërkohet angazhim shumë i madh i nxënësve në shtëpi. Niveli i vështirësisë së detyrave të shtëpisë është një aspekt shumë delikat, që duhet trajtuar me kujdes (Habili, 2018).

Detyrat e shtëpisë reflektohen si faktor i mbingarkesës, në varësi të kushteve që gjinden sistemet arsimore, dhe një pjesë e madhe e tyre kanë bërë që detyrat e shtëpisë për nxënësit të jenë të pashmangshme, për shkak të shumë përmbajtjeve në kurrikula dhe kohës mësimore të pamjaftueshme për zhvillimin e tyre në klasë, apo për shkak se në shkolla nuk punohet përtej kohës mësimore të detyrueshme. Apo heqjen e detyrave të shtëpisë, me zgjatjen e kohës së angazhimit në shkollë lidhur me detyrat dhe mësimet që paraprakisht janë dhënë si detyra dhe mësime në shtëpi. Detyrat e shtëpisë, gjithashtu, mund të jenë shkaktarë të stresit të nxënësit dhe prindërit e tyre, duke zvogëluar kohën e lirë të nxënësve ose kohën e dedikuar për aktivitete të tjera, si p.sh. ushtrime, lojë, punë, pushim etj. (Cooper, et al., 2006).

Studimet që lidhen me detyrat e shtëpisë për nxënësit, një pjesë e tyre të cituara edhe në studimin e OECD-së (2020) për mbingarkesën kurrikulare, flasin për anë negative dhe pozitive të detyrave të shtëpisë. Si anë pozitive, mbështetësit e detyrave të shtëpisë theksojnë se bërja e detyrave të shtëpisë referohet si një mundësi për mbajtjen e kontinuitetit të mësimeve, si një mundësi që mund të përmirësojë kujtesën dhe aftësitë e të menduarit të nxënësit, të zhvillojë kulturën e punës së pavarur dhe ndjenjën e përgjegjësisë etj.

Ndërsa, si anë negative të detyrave të shtëpisë kundërshtarët e tyre theksojnë sasinë e tepërt të detyrave të shtëpisë në ditë, ndikimin në jetën dhe mirëqenien e nxënësve, si dhe argumentimin se sasia e madhe e detyrave të shtëpisë nuk e përmirëson performancën akademike të nxënësve. Sipas raportit, Polonia dhe Kazakistani janë ndër vendet/sistemet arsimore që

raportojnë se përballen me një sfidë të mbingarkesës me detyra të shtëpisë për nxënës.

Koha për detyra të shtëpisë është e lidhur me sasinë e detyrave të shtëpisë dhe vështirësitë e kërkesave të tyre. Koha për detyra të shtëpisë trajtohet edhe në sondazhin kombëtar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Kazakistanit (2016). Sipas raportit, nxënësve u kërkohet të kalojnë kohë të konsiderueshme duke bërë detyrat e shtëpisë të caktuara nga mësimdhënësit, në fusha lëndore të ndryshme (veçanërisht në lëndët e detyrueshme), dhe kjo ka një ndikim si në jetën personale (gjumë dhe në kohën e lirë), ashtu edhe në jetën familjare (fundjavë, pushime).

Kjo tregon atë që konsiderohet çekuilibër në rutinën e përditshme të nxënësve, pasi nxënësit nuk janë në gjendje të balancojnë kohën e tyre midis detyrave e mësimëve dhe pushimit për shkak të ngarkesës së detyrave të shtëpisë. Në përgjithësi, ngarkesa e tepërt e kohës me detyra të shtëpisë çon në probleme me gjumin dhe në lodhje. Lidhur me përvojën e nxënësve me detyrat e shtëpisë, raporti nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Kazakistanit (2016) thekson se pothuajse gjysma e nxënësve (48%) raportuan se nuk i mbaruan të gjitha detyrat e tyre në kohë për shkak të ngarkesës së madhe.

2.3. Ndikimi i mbingarkesës së kurrikulës në mirëqenien e nxënësve

Praktikat e organizimit të shkollës, mësimdhënies, mësimnxënies dhe e proceseve të tjera, që lidhen me organizimin e proceseve edukativo-arsimore në shkolla, janë të lidhura me nxënësit, bëhen për nxënësit. Pra, edhe kurrikulat, në radhë të parë, hartohen për nxënësit dhe e gjithë puna rreth tyre bëhet për të siguruar një sistem kurrikular, i cili u mundëson nxënësve të zhvillojnë një set të kompetencave të tyre, në përputhje me mundësitë dhe potencialet për zhvillim të tyre, për përgatitje për jetë, punë, aftësim për mësim gjatë gjithë jetës dhe për përballje me sfidat, me të cilat shoqëritë ballafaqohen.

Mirëqenia e nxënësve trajtohet në studime dhe perspektiva të ndryshme, nga perspektiva e adresimit dhe promovimit të mirëqenies nga kurrikulat (O’Neill, (Ed.), 2017), si dhe nga aspekti i ndikimit të kurrikulës në mirëqenien e nxënësve (OECD, 2017), aspekt i ndërlidhur me studimin tonë.

Studim i OECD-së (2017) “Mirëqenia e nxënësve në PISA 2015” trajton aspekte të shumta të mirëqenies së nxënësve, nga dimensionin psikologjik, social, kognitiv dhe fizik të mirëqenies. Në secilin dimension reflektohet roli i shkollës, organizimit të jetës shkollore, por edhe ndikimi i kurrikulës në mirëqenien e nxënësve.

Studimi i OECD-së (2017), kur trajton dimensionin psikologjik në mirëqenien e nxënësve, specifikon aspektet e ndikimit në mirëqenie, si ndjenjën e qëllimit të jetës së nxënësve, vetëdijen, gjendjet afektive dhe forcën emocionale. Pastaj, specifikon aspektet e mbështetjes që ndikojnë pozitivisht në mirëqenien psikologjike të nxënësve, si motivimi, vetëfikasiteti, shpresa etj., si dhe ndikimin negativ, që vjen nga ankthi, stresi, depresioni etj. Për dimensionin social të mirëqenies së nxënësve, studimi u referohet aspekteve që lidhen me cilësinë e jetës sociale të nxënësve brenda dhe jashtë shkollës, në raport me marrëdhëniet e nxënësve me familjen, bashkëmoshatarët dhe mësuesit e tyre, të vetëraportuar nga nxënësit pjesëmarrës në studimin PISA 2015.

Lidhur me dimensionin kognitiv të mirëqenies së nxënësve, studimi i OECD-së (2017) u referohet nivelit të njohurive që kanë nxënësit dhe nevojave të tyre për të marrë pjesë aktivisht në shoqërinë e sotme, si nxënës gjatë gjithë jetës, punëtorë efektivë dhe qytetarë të angazhuar. Për këtë dimension, studimi merr për bazë aftësitë e nxënësve për përdorimin e njohurive akademike për të zgjidhur problemet vetëm ose në bashkëpunim me të tjerët dhe aftësitë e nivelit të lartë të arsimit, si të menduarit kritik, aftësinë për të përballuar ide nga këndvështrime të ndryshme. Ndërsa, lidhur me dimensionin fizik të mirëqenies së nxënësve, studimi i OECD-së (2017) i referohet shëndetit të nxënësve të vetëraportuar nga nxënësit, në raport me aktivitetet fizike dhe të bërit jetë të shëndetshme.

Pra, mirëqenia e nxënësve, reflektohet në dimensione të ndryshme dhe merr ndikime nga faktorë të ndryshëm. Ndikimet mund të jenë pozitive kur nxënësit nuk janë të mbingarkuar në mësim, marrin mbështetjen e duhur për t'u zhvilluar maksimalisht, por mund të jenë edhe negative kur ka prezencë të mbingarkesës kurrikulare, mungesë të mjaftueshme të kohës mësimore dhe mungesë të mbështetjes së duhur në përputhje me nevojat dhe mundësitë e nxënësve. Prandaj, mirëqenia e nxënësve duhet të jetë parësore që në hartimin apo rishikimin e kurrikulës, veçanërisht kur bëhet fjalë për mbingarkesën kurrikulare, sepse mirëqenia rrit të nxënësve dhe anasjelltas ndikon si faktor frenues në procesin e të nxënësve.

Një kurrikulë e mbingarkuar mund të ushtrojë presion në mirëqenien e nxënësve, në mënyrë të veçantë mund të ndikojë në rritjen e ndjenjës së stresit dhe presionit për nxënës, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në performancën e nxënësve (OECD, 2020).

Në raport me kohën mësimore, si faktor i mbingarkesës kurrikulare, studime të ndërlydhura me mësimdhënien, arrijtjet e nxënësve, studimin PISA, të reflektuara edhe në raportin e OECD-së (2020), tregojnë se koha mësimore e shtuar ofron mundësi më të madhe për mësim dhe ndikon në arrijtjet me të larta akademike të nxënësve, ndihmon nxënësit me performancë më të ulët që të arrijnë nxënësit me performancë më të lartë. Mirëpo, sipas studimeve të njëjta, shumë orë mësimi nuk përkthehen automatikisht në rezultate më të mira dhe mësim cilësor dhe se marrëdhënia midis orëve të mësuarit dhe performancës së nxënësve nuk është lineare. Sipas raportit të OECD-së (2016), koha e shpenzuar për të mësuar gjatë një dite, si në shkollë, ashtu edhe jashtë kohës së mësimi në shkollë, gjegjësisht mësimi në shtëpi, nuk lidhet me performancën akademike të nxënësve. Rrjedhimisht kjo tregon se mirëqenia e nxënësve në dimensionin kognitiv, në raport me kohën e mësimi, lidhet me të drejtë me cilësinë e shfrytëzimit të kohës së mësimi, në radhë të parë në shkollë, por edhe në shtëpi (OECD, 2020).

Përtej përmbajtjeve mësimore dhe kohës së mësimi, siç është përshkruar më sipër, mbingarkimi i nxënësve në mësim vjen si rezultat edhe i faktorëve të tjerë, të ndryshëm, si: mësimdhënësi, tekstet shkollore, detyrat e shtëpisë,

niveli i njohurive paraprake të nxënësve, kushtet e punës në shkollë, rrethanat familjare, si dhe nga faktorë të tjerë që lidhen me vetë nxënësin (Bekteshi, 2009).

Pavarësisht faktit se mbingarkesa e kurrikulës gjithnjë e më shumë njihet si një temë që duhet studiuar më thellësisht, ka shumë pak studime që dëshmojnë mbingarkesën kurrikulare të perceptuar apo përjetuar nga nxënësit dhe mësimitdhënësit dhe ndikimin e saj në mirëqenien e nxënësve dhe mësimitdhënësve.

OECD-ja (2020), në studimin e saj *Mbingarkesa e kurrikulës: Një rrugë përpara*, fokusohet në analizën e faktorëve të ndryshëm që nxisin mbingarkesë kurrikulare të perceptuar ose të përjetuar, përfshirë: numrin e lëndëve mësimore për klasë, numrin e temave mësimore dhe rezultateve të të nxënit që duhet të trajtohen brenda një kohe të caktuar, koha e nxënësve për mësim në shkollë dhe në shtëpi, shpeshtësia dhe llojet e vlerësimeve, tekstet shkollore, materialet mësimore dhe detyrat e shtëpisë, gatishmëria e mësimitdhënësve për zbatimin e reformës kurrikulare etj.

Disa nga faktorët e përshkruar më sipër, ishin referencë orientuese për të përcaktuar fokusin e problemit të studimit dhe qasjen hulumtuese që kemi ndjekur në këtë studim rasti për mbingarkesën kurrikulare në arsimin e detyrueshëm në Kosovë.

2.4. Ndikimi i mbingarkesës së kurrikulës në punën dhe mirëqenien e mësimitdhënësve

Mësimitdhënia është një profesion dinamik, kërkues, sfidues nga kërkesa të shumta dhe ndryshimet e shpeshta në legjislacion dhe kurrikula, i ekspozuar ndaj stresit, djegies profesionale, dhe rrezikut nga një shkallë e konsumimit, që ka nxitur shumë studiues të merren me studime për mirëqenien e mësimitdhënësve, veçanërisht në dekadën e fundit.

Zgjerimi i kurrikulës, përmbajtjeve të reja mësimore, temave mësimore për çështje të ndryshme ndërkurrikulare, përfshirja e kërkesave të reja për mësimitdhënës në kuadër të kurrikulave, siç është për shembull kompetenca

digjitale, ndikon pashmangshëm në punën dhe efikasitetin e mësimdhënësve.

Sipas studimit të bërë nga NCCA (2005), shtimi i përmbajtjeve të reja mësimore në arsimin fillor, me kohë të njëjtë mësimore ndër vite, ka bërë që mësimdhënësit të ankohen se nuk mund t'i mbulojnë lëndët dhe përmbajtjet e reja të kurrikulës në kohën në dispozicion. Jo vetëm mungesa e kohës mësimore të mjaftueshme për zhvillimin e përmbajtjeve mësimore shfaq pakënaqësitë dhe shqetësimet e mësimdhënësve. Pakënaqësi dhe shqetësime nga mësimdhënësit shfaqen edhe kur kanë kompetencë të pamjaftueshme për lëndën që e mbajnë dhe kompetencat e veçanta në mësimdhënie. Kur mësimdhënësit nuk kanë kompetencë të mjaftueshme, apo kur nuk marrin trajnime të duhura për një kompetencë të kërkuar nga sistemi apo për ndryshimet kurrikulare, ata ka të ngjarë të ndihen të mbingarkuar dhe të pafuqishëm (Rutherford, Long & Farkas, 2017).

Shtimi i lëndëve dhe përmbajtjeve mësimore, sidomos në arsimin fillor, ndikon që shpesh mësimdhënësit të kenë një fokus më të veçantë në lëndët kryesore, siç janë Gjuha, Matematika, Shkencat dhe të lënë anash lëndët e shkathësive që ndikojnë pozitivisht në mirëqenien e nxënësve. Në anën tjetër, kur mësimdhënësit atakohen nga mbingarkesa kurrikulare, mungesa e trajnimeve të duhura dhe mungesa e kompetencave të veçanta në një fushë të caktuar, puna e tyre reflektohet te nxënësit, të cilët nuk marrin mbështetjen e nevojshme prej mësimdhënësve të tyre.

Pra, mirëqenia e mësimdhënësve në raport me kurrikulën, në mënyrë të veçantë, atakohet nga zgjerimi i kurrikulës dhe shtimi i përmbajtjeve mësimore, mungesa e kohës mësimore për trajtimin efektiv të tyre me nxënësit, si dhe nga mungesa e kompetencës së mjaftueshme për ligjërimin dhe praktikimin në klasë dhe për të qenë të suksesshëm në punën me nxënësit. Një kurrikulë e mbingarkuar mund të ushtrojë presion në mirëqenien e nxënësve, në rritjen e presionit nxënësve për mësim, i cili pastaj në mënyrë të drejtpërdrejtë në performancën e nxënësve (OECD, 2020). Performanca e nxënësve pastaj ndikon në mënyra të ndryshme në mirëqenien e mësimdhënësve, ka ndikim pozitiv kur shihen rezultatet e punës me nxënësit, shihet një ndjenjë individuale e përmbushjes profesionale personale,

kënaqësisë, por ka edhe ndikim negativ, që ndikon në humbjen e besimit në nxënë, prindër dhe në zvogëlimin e kënaqësisë për punën që bën.

Detyrat dhe përgjegjësitë e mësimitdhënësve, përtej mësimitdhënies si detyrë dhe përgjegjësi kryesore, në sistemin organizativ të punës së shkollave dhe të sistemeve arsimore, janë të shumta, përfshirë ato që lidhen me planifikimin, punën me kolegë, prindër, punën me dokumentacionin pedagogjik dhe administrativ në shkollë, angazhimin në aktivitete jashtëkurrikulare etj. Angazhimet shtesë, përtej mësimitdhënies dhe përgatitjes për mësimitdhënie, ka të ngjarë të paraqesin mbingarkesë për mësimitdhënës, e cila pastaj reflektohet në rënien e efikasitetit - performancën e mësimitdhënësve në punë, në paraqitjen e stresit, shqetësimeve, lodhjes dhe konsumimit në punë të mësimitdhënësve, të cilat drejtpërdrejt ndikojnë në mirëqenien e tyre.

Është e rëndësishme të ritheksohet se mbingarkesa e kurrikulës ka ndikim në punën e mësimitdhënësve, por nuk është e njëjtë me ngarkesën e tepërt të punës për mësimitdhënësit dhe drejtuesit e shkollës. Shumë faktorë të tjerë, përveç kurrikulës, kanë ndikim në ngarkesën e mësimitdhënësve, të tillë si ndryshimet në strukturën administrative ose në numrin e madh të nxënësve (Easthope & Easthope, 2000).

2.5. Strategjitë për trajtimin dhe zvogëlimin e mbingarkesës kurrikulare

Siç u përshkrua më lart, mbingarkesa e kurrikulës ka implikime të shumta në procesin edukativo-arsimor. Mund të jetë një faktor stresues për nxënë dhe mësimitdhënës, mund të jetë pengesë në procesin e të nxënimit dhe mund të ndikojë shumë në rezultatet e të nxënimit. Meqë gati është e pamundur për të eliminuar plotësisht mbingarkesën kurrikulare, si gjatë reformës kurrikulare, ashtu edhe gjatë zbatimit të saj, sistemet arsimore sugjerohen nga studiues dhe mekanizma institucionalë, siç është OECD-ja, që trajtojnë këtë problematikë, të ndërmarrin masa të ndryshme, strategji për të minimizuar dhe shmangur mbingarkesën kurrikulare.

Sipas raportit të OECD-së (2020), krijimi i një lënde mësimore të veçantë është një strategji e ndërmarrë nga vende/sisteme të ndryshme arsimore, për të adresuar sfidën e zgjerimit të përmbajtjes mësimore për shkak të kërkesave shoqërore, si: Edukimi në karrierë, studimet e punës dhe edukimi sipërmarrës; Edukimi shëndetësor, mirëqenia, mënyra e jetës; Edukimi mediatik; Aftësi dhe të aplikuara të projektimit dhe teknologjisë, informatikë etj. Kjo strategji është ndërmarrë me qëllim që çështje të veçanta të dallohen, të mos "humben" midis përmbajtjeve brenda lëndëve ekzistuese dhe të mos ngarkohen lëndët ekzistuese. Për të mos e keqinterpretuar këtë strategji, është e rëndësishme të bëhet një dallim i qartë midis dyfishimit të panevojshëm dhe reflektimit të qëllimshëm mbi të njëjtën përmbajtje në lëndë të ndryshme, për të çuar më tej dhe thelluar të kuptuarit e koncepteve kryesore nga nxënësit.

Një strategji tjetër, e ndërmarrë nga vende të ndryshme të OECD-së, apo një qasje alternative për të adresuar sfidën e zgjerimit të përmbajtjes mësimore, për shkak të kërkesave shoqërore, si një element bazë i mbingarkesës kurrikulare, është përkthimi i nevojave shoqërore në kompetenca dhe tema ndërkurrikulare dhe futja e tyre në lëndët/fushat ekzistuese mësimore. Disa vende/sisteme arsimore kanë përzgjedhur përfshirjen e kompetencave kryesore në kurrikula, në futjen e tyre në fushat/lëndët mësimore ekzistuese. Disa të tjera kanë vendosur për temat ndërkurrikulare. Mirëpo, një pjesë e madhe e vendeve/sistemeve arsimore të OECD-së kanë vendosur për qasjen e dyfishtë të përfshirjes së kompetencave dhe temave ndërkurrikulare në kurrikulë. Lidhur me këto qasje, raporti sjell disa detaje për disa vende, se si i kanë integruar kompetencat dhe temat ndërkurrikulare në kurrikulat e tyre. Në linjë me këtë, disa thekse nga qasjet e vendeve si Estonia, Onatario (Kanada), Finlandë, Japoni, nga raporti i OECD-së (2020), tregojnë se:

Estonia përfshin kompetencat ndërkurrikulare në fushat lëndore. Për shembull, studimi i matematikës përshkruhet si zhvillim jo vetëm i kompetencave matematikore, por i të gjitha kompetencave të tjera të përgjithshme. Programi mësimor i Estonisë për matematikën shpjegon se si mësohen kompetencat e përgjithshme përmes matematikës, (p.sh. vlerat kulturore: matematika është një shkencë

që bashkon kultura të ndryshme dhe studentët mund të mësojnë për veprat e matematikanëve nga vende dhe periudha të ndryshme).

Në Ontario (Kanada) çdo lëndë e kurrikulës përfshin një seksion të quajtur "të mësuarit ndërkurrikular dhe të integruar", i cili përshkruan se si përmbajtja e lëndës dhe kompetencat e pritshme lidhen me lëndët e tjera. Seksioni ofron, gjithashtu, shembuj specifikë se si mund të organizohet mësimi ndërkurrikular. Qeveria ka marrë vendim që fusha të reja lëndore të mos shtohen, por kërkesat e shoqërisë të përfshihen në kurrikulën ekzistuese, duke lejuar përfshirjen në kurrikula të kompetencave ndërkurrikulare të tilla si p.sh. edukimi financiar.

Kurrikula australiane paraqitet si një model tredimensional, i përbërë nga: 1) fusha mësimore; 2) temat ndërkurrikulare; dhe 3) kompetencat ndërkurrikulare (d.m.th. aftësitë e përgjithshme). Modeli sugjeron që nxënësit t'i mësojnë të tri këto dimensione në mënyrë të ndërvarur dhe t'i organizojë ato nëpërmjet një qasjeje të integruar, në vend që të jenë lëndë të pavarura.

Në Finlandë mësimi i bazuar në fenomene ka fituar vëmendje në hartimin e kurrikulës. Në këtë qasje, zhvillimi i kompetencave artikullohet përmes mësimëve të bazuara në fenomene ose tema. Në këtë mënyrë, lëndët nuk ndahen, por, përkundrazi, ndahen në mësim të bazuara në fenomene që trajtojnë një temë të caktuar me një perspektivë holistike, duke kaluar përtej kufijve të lëndëve. Kjo qasje nxit kompetencat e nxënësve duke i inkurajuar ata të kuptojnë, të përdorin dhe të ndërtojnë modele të ndryshme për të interpretuar dhe shpjeguar sjelljen njerëzore, mjedisin dhe fenomenet e lidhura me to, duke përdorur pedagogji të të mësuarit aktiv, si projekte kërkimore, aktivitete jashtëshkollore etj.

Japonia e organizon kurrikulën rreth tri kompetencave: 1) njohuritë dhe aftësitë; 2) aftësi për të menduar, për të gjykuar dhe për t'u shprehur; dhe 3) motivimi për të mësuar dhe humanizmi. Kurrikula

synon t'i zhvillojë këto kompetenca jo duke shtuar lëndë të reja, por duke i futur ato në lëndët ekzistuese.

Para se sistemet arsimore të vendosin për qasjet apo strategjitë që do t'i ndërmarrin në adresimin e aspekteve të konsideruara mbingarkesë kurrikulare, si zgjerimi i kurrikulës, shtimi i përmbajtjeve etj., hapi i parë i sugjeruar është identifikimi i sfidave kryesore, me të cilat përballen sistemet arsimore në raport me mbingarkesën kurrikulare, pastaj vendosja e strategjive për adresimin e tyre. Kështu, në raportin e OECD-së (2020) janë raportuar disa nga sfidat kryesore për këtë temë, të raportuara nga vendet/sistemet e ndryshme arsimore, si:

- Numri i madh i lëndëve ose sasia e tepërt e përmbajtjeve mësimore;
- Dyfishimi i përmbajtjes nëpër lëndë mësimore;
- Shkëputje në përparimin e të mësuarit nëpër nivelet të ndryshme të arsimit;
- Madhësia dhe vëllimi i dokumenteve të kurrikulës;
- Vështirësitë në vendosjen e prioriteteve ose hartimin e përmbajtjes së kurrikulës në nivel lokal dhe shkollor.

Në raportin e njëjtë, janë raportuar edhe strategjitë, të cilat i kanë ndërmarrë sistemet e ndryshme arsimore për adresimin e këtyre dhe mbingarkesës kurrikulare, si:

- Përcaktimi i numrit të duhur të lëndëve dhe temave;
- Përzgjedhja e temave si koncepte kyçe në një kurrikulë të mbingarkuar;
- Përfshirja e kompetencave dhe temave ndërkurrikulare në kurrikulë;
- Heqja e dyfishimit të përmbajtjes nëpër klasa dhe nëpër lëndë të ndryshme;
- Përsëritja e qëllimshme e temave nëpër klasa, cikle mësimore dhe nivele arsimore;
- Pilotimi i përpjekjeve për të adresuar mbingarkesën e përmbajtjes dhe vlerësimi i ndikimit të tyre në mësimdhënie, të nxënit dhe mirëqenien;

- Bërja e dokumenteve të kurrikulës më të qasshme, duke i përfshirë mësimdhënësit në procesin e zhvillimit;
- Përcaktimi i përmbytjes bazë në nivel kombëtar dhe dhënia e autonomisë shkollave dhe pushtetit lokal për përshtatjen e përmbytjeve mësimore;
- Zhvillimi i kapaciteteve të shkollave për të hartuar përmbytjen mësimore.

Orientimet për veprime institucionale lidhur me adresimin e mbingarkesës kurrikulare në masë të madhe lidhen me fuqizimi i autonomisë së shkollës dhe mësimdhënësve, si një mënyrë më efikase për t'u përballuar me mbingarkesën kurrikulare. Përmes autonomisë së shkollës në aspektet përmbytjesore të kurrikulës, mësimdhënësve, në radhë të parë, u lejohet mundësia dhe inkurajohen që të zgjedhin temat mësimore që duan të japin nga një sërë temash e orientimesh të ofruara në kurrikula. Po ashtu, të gjitha veprimet që e tërheqin vëmendjen kah autonomia e zgjeruar e profesionit të mësimdhënies mund të ndihmojnë edhe në përballje me kurrikulat e stërngarkuara (Peffer, et al.,2005).

Në anën tjetër, në raport me ngarkesën e punës dhe angazhimit, si për nxënës ashtu edhe për mësimdhënës, raporti i OECD-së (2020) vë theksin edhe në disa sfida, si:

- Mungesa e kompromiseve ndërmjet synimit më të lartë dhe fokusimit në gjërat thelbësore të kurrikulës dhe të pritshmërive për nxënës;
- Mospërputhja midis kohës së mësimi të caktuar për një lëndë të caktuar dhe sasisë së përmbytjes së kurrikulës që do të mbulohet;
- Mbingarkesa me detyra të shtëpisë;
- Mbingarkesa e mësimdhënësve dhe kërcënimi për mirëqenien e tyre.

Lidhur me këto sfida, sipas raportit përkatës, sistemet arsimore kanë ndërmarrë veprime për të rregulluar kohën e të mësuarit në shkollë dhe në shtëpi, por edhe në rregullimin e mënyrës se si përmbytja duhet t'u transmetohet nxënësve për të përmbushur nevojat e tyre të të mësuarit dhe mirëqenies, rrjedhimisht për të siguruar ekuilibrin midis aktiviteteve

mësimore dhe aktiviteteve të tjera, që janë po aq thelbësore për zhvillimin kognitiv, social dhe emocional të nxënësve.

Ndërsa, për mësimdhënës, sipas raportit përkatës, sisteme të ndryshme arsimore po e përdorin digjitalizimin e kurrikulës si një mundësi shtesë dhe mësimdhënësit mund ta përdorin atë nga kompjuterët dhe pajisjet e tjera të TIK-ut dhe si një mundësi më të lehtë për përshtatje të saj me nevojat e nxënësve dhe me përqendrim në orientimet e shkollës. Në këtë drejtim, Australia praktikon kurrikulën e digjitalizuar për t'iu dhënë mundësi mësimdhënësve dhe shkollave që përqendrohen në orientimet e vendosura nga shkolla, p.sh. në zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik dhe krijues të nxënësve të saj, rrjedhimisht në ndarjen e kurrikulës sipas prioriteteve, fushave dhe klasave.

Në raportin e Këshillit Kombëtar për Kurrikulën dhe Vlerësimin (NCCA, 2010) për mbingarkesën e kurrikulës në arsimin fillor, raportohen disa iniciativa kurrikulare nga sisteme të ndryshme arsimore, si Zelanda e Re, Skocia, Singapori etj., për t'iu përgjigjur mbingarkesës së kurrikulës. Iniciativat kurrikulare përfshijnë:

- Krijimin e faqeve të internetit për të publikuar zhvillimet rreth kurrikulave, përvojat, mësimet, rasteve studimore etj.
- Udhëzues skematikë për zhvillimin e kurrikulës;
- Projektet e veçanta për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të kurrikulës;
- Programe të veçanta për udhëheqës të institucioneve arsimore që lidhen me zbatimin e kurrikulës;
- Projekte dhe programe të veçanta për përdorimin e teknologjisë informative në proceset e kurrikulës;
- Projekte dhe programe të veçanta për trajnimin e mësimdhënësve,
- Programe për krijimin e komuniteteve të mësuarit, krijimin e rrjetit të drejtorëve të shkollave, që t'u mundësojnë shkollave të punojnë së bashku drejt zbatimit të kurrikulës;

- Programe dhe projekte të vlerësimit dhe vetëvlerësimit në ndërlidhje me parimet dhe vlerat e përgjithshme që qëndrojnë në themel të kurrikulës dhe qasjet si transmetohen ato në mësimdhënie dhe punën e gjithmbarshme të shkollës;
- Seminare për Fakultetet e Edukimit që përgatisin mësimdhënës.

Në raport me kontekstin e zhvillimeve të kurrikulës në Kosovë, iniciativat kurrikulare të përafërta janë vendosur në dokumentin Udhërrëfyesi për zbatimin e kurrikulës së re, 2016-2021, si një risi në reformën e fundit kurrikulare (MASHT, 2016), që nuk është vlerësuar dhe konsideruar si duhet në procesin e udhëheqjes së zbatimit të kurrikulës (IPK, 2019), rrjedhimisht edhe në ndërmarrjen e veprimeve institucionale për adresimin e aspekteve të konsideruara mbingarkesë kurrikulare.

KAPITULLI III -

Metodologjia e hulumtimit

Kapitulli i tretë prezanton metodologjinë hulumtuese të përdorur në këtë studim. Shfrytëzimi i qasjes hulumtuese për këtë studim, zhvillimi i metodologjisë dhe përgatitja për këtë hulumtim, janë bërë duke u bazuar në qëllimin e studimit dhe pyetjet kërkimore. Çështjet e tjera, që janë marrë në konsideratë për këtë studim, janë shqyrtimi i burimeve, studimeve që lidhen me çështjen e mbingarkesës së kurrikulës, qasjet në trajtimin e mbingarkesës për nxënës dhe mësimdhënës.

Shqyrtimi i dokumenteve kurrikulare dhe raporteve të hulumtimit që adresonin aspektet që ishin objekt trajtimi në këtë studim, si dhe konteksti i reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar në Kosovë, me theks të veçantë në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët. Në pjesën në vijim do të pasqyrohen: modeli i studimit, popullata dhe mostra e studimit, instrumentet e studimit, procedura e mbledhjes së të dhënave dhe analiza e të dhënave.

3.1. Dizajni i hulumtimit

Qasja hulumtuese cilësore është zbatuar për realizimin e studimit. Hulumtimi cilësor në kuptim më të gjerë ka të bëjë me atë se si individët apo grupet e caktuara kuptojnë botën e tyre, si dhe botën që i rrethon ato dhe ndërtojnë kuptimin në pikëpamje të përvojave të tyre. Ideja themelore e kryerjes së një hulumtimi cilësor është se kuptimi është ndërtuar në mënyrë shoqërore (Saqipi, 2013), duke u nisur nga premisa se realiteti është një konstrukt shoqëror (Matthews & Ross, 2010).

Qasja hulumtuese cilësore është një mjet për të eksploruar dhe kuptuar kuptimin që individët ose grupet e përshkruajnë një problem shoqëror ose njerëzor (Creswell, 2009). Ndër të tjera, kjo qasje hulumtuese përfshin përcaktimin e pyetjeve dhe procedurave e hapave për realizimin e studimit, mbledhjen e të dhënave, zakonisht në mjedisin e pjesëmarrësve, analizën e të dhënave nga temat specifike në ato të përgjithshme, dhe pastaj interpretimin e dhënave nga studiuesit dhe përgatitjen e raportit.

Creswell (2009), në zbërthimin e qasjes hulumtuese cilësore, përdori termin botëkuptim, i cili formëson praktikën e hulumtimit, për të përshkruar një

grup besimesh të aplikuara nga studiuesit në drejtimin e veprimeve të tyre dhe kryerjen e projekteve hulumtuese. Gjithashtu, sipas Creswell (2009), katër botëkuptimet, nga të cilat veprojnë studiuesit, janë: postpozitivizmi, konstruktivizmi, avokatia dhe pragmatizmi. Këto aspekte ishin pika referimi në kryerjen e këtij studimi.

Ky studim ndjek botëkuptimin social konstruktivist, i cili mban supozimin se "individët kërkojnë të kuptojnë botën në të cilën jetojnë dhe punojnë". Ata zhvillojnë kuptime subjektive të përvojave të tyre dhe "kuptimet janë të ndryshme dhe të shumëfishta". Në vend që të fillojnë me teorinë, si në postpozitivizëm, studiuesit zhvillojnë në mënyrë induktive një teori ose model kuptimi (Creswell, 2009).

Modeli i hulumtimit është i bazuar në studim rasti. Zakonisht studimi i rastit në hulumtim përfshin një rast ose një numër të vogël rastesh, por secili prej tyre eksplorohehet në hollësi (Matthews & Ross, 2010). Ky hulumtim i rastit studimor është rast studimor zbulues dhe kishte për qëllim të hedhë dritë mbi temën e hulumtimit për mbingarkesën kurrikulare në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë, të hedhë dritë nëse ka mbingarkesë kurrikulare në dokumentet kurrikulare në zbatim, apo ajo është më shumë perceptim nga aktorët e lidhur me zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës. Këtë do ta tregojnë të dhënat dhe gjetjet nga analiza e kurrikulave në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, si dhe të dhënat dhe gjetjet nga eksplorimi dhe shqyrtimi i perceptimeve të pjesëmarrësve nga komuniteti i shkollës, njohësit e kurrikulës dhe zyrtarët e arsimit të përfshirë në zhvillimin dhe koordinimin e aktiviteteve për zhvillimin dhe rishikimin e kurrikulave.

Studimi nuk kishte për qëllim të eksplorohte dhe të kërkonte një marrëdhënie shkak-pasojë në procesin e reformës kurrikulare dhe nuk pritej të bëjë shpjegime për shkaqet. Qëllimi ishte një përshkrim i thellë se si ishin gjërat në raport me kurrikulat në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë, aspektet që konsiderohen mbingarkesë kurrikulare, si shihen dhe si u përjetuan ato edhe nga pjesëmarrësit në këtë studim. Pra, synimi ishte të hedhim dritë mbi veçantinë e mbingarkesës kurrikulare në kontekstin e kurrikulës së Kosovës.

Studimi ka përdorur të dhëna cilësore të mbledhura përmes analizës së përmbajtjes së dokumenteve kurrikulare dhe raporteve hulumtuese të

ndërlidhura me objektin e studimit, intervistave gjysmë të strukturuar, pyetësorëve dhe diskutimit në grupe të fokusuara.

Metodologjia për studim rasti cilësor, e zbatuar në këtë studim, ofroi mundësi kërkimi për objektin e studimit dhe aspektet e ndërlidhura me objektin e studimit, si dhe mundësi për të përshkruar, nga burime të shumta informacioni, shkallën e mbingarkesës kurrikulare, faktorët ndikues në kontekstin e kurrikulës së Kosovës, si dhe mundësitë për trajtimin dhe zvogëlimin e mbingarkesës kurrikulare, me pikë referimi përvojat e jetuara të pjesëmarrësve në këtë studim.

3.2. Popullata dhe mostra

Popullatën e këtij studimi e përbëjnë mësime ndërhënësit në arsimin e detyrueshëm në Kosovë, përkatësisht në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët (1-9), nxënësit e klasave 8 dhe 9, prindërit që i kanë fëmijët në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, drejtues të shkollave në arsimin e detyrueshëm, si dhe zyrtarë arsimor dhe zhvillues të kurrikulave. Për shkak të natyrës së studimit, për të eksploruar më në thellësi objektin e studimit dhe pyetjet kërkimore, mostrat pjesëmarrëse në këtë studim u përzgjedhën përmes metodës së qëllimshme dhe të përshtatshme, bazuar në rolet që lidhen me zhvillimin e kurrikulës dhe zbatimin e saj në klasat 1,3, 5, 6, 8 dhe 9.

Përzgjedhja e mostrës është e lidhur me qasjen hulumtuuese në këtë studim, me qasjen cilësore. Procedura e përzgjedhjes së mostrës cilësore është e qëllimshme, e përzgjedhur nga njëmbëdhjetë (11) shkolla që u zgjedhën për të qenë pjesë e këtij studimi, të cilat ishin shkolla prijëse në procesin e shtrirjes së zbatimit të kurrikulës në të gjitha shkollat në Kosovë. Ato përfaqësonin shkollat publike për arsim fillor dhe të mesëm të ulët.

Kriteret për përzgjedhjen e shkollave, nga të cilat është përfshirë mostra e komunitetit të shkollës, ishin numri i shkollave që ishin shkolla prijëse në fillimin e zbatimit të kurrikulave të reja lëndore të hartuara sipas kurrikulës së bazuar në kompetenca, pastaj numri i nxënësve në shkolla dhe vendndodhja e shkollës (fshat-qytet). Numri i shkollave të përfshira në këtë studim, sipas kriterëve më sipër, është njëmbëdhjetë (11) shkolla publike,

shkolla fillore dhe të mesme të ulëta (SHFMU), në njëmbëdhjetë (11) komuna të Kosovës.

Siç u përshkrua më sipër, ashtu si përzgjedhja e shkollave, edhe procedura e përzgjedhjes së mostrës cilësore ishte e qëllimshme, edhe për nga përfaqësimi i komunitetit të shkollës. Qëllimi ishte të sigurohej një përfaqësim gjithëpërfshirës nga komuniteti i shkollës, me përvojë të ndryshme në organizimin e udhëheqjen e shkollës, në procesin e mësimin, në punën me nxënës/fëmijë, në mënyrë që ata të ishin në gjendje të reflektonin përvojën e tyre lidhur me procesin e zbatimit të kurrikulës.

Kështu, **mostra e drejtorëve të shkollave dhe KSC** përfaqësohet me 20 pjesëmarrës, prej tyre 11 drejtorë dhe zv.drejtorë të shkollave dhe 9 koordinatorë të cilësisë. Nga kjo mostër, 13 prej tyre apo 65 % punojnë në shkolla urbane, ndërsa 7 ose 35% punojnë në shkollat me lokacion në fshat. Po ashtu, nga kjo mostër, sa i përket kualifikimit, 12 prej tyre ose 60% janë me kualifikim katërvjeçar universitar, fakultetin në programet për përgatitjen e mësimitdhënësve, ndërsa 8 prej tyre ose 40%, përveç fakultetit në programet për përgatitjen e mësimitdhënësve, kanë edhe kualifikim master, kryesisht në programet Udhëheqje në Arsim dhe Mësimdhënia dhe kurrikulat.

Mostra e mësimitdhënësve përbëhet prej 65 mësimitdhënësve. Nga mostra e mësimitdhënësve, 40 mësimitdhënës, ose rreth 62% e mësimitdhënësve, punojnë në shkollat me lokacion në zonat urbane, ndërsa 25 mësimitdhënës ose 28 % e tyre punojnë në shkollat me lokacion në fshat. Mostra e mësimitdhënësve që japin mësim në arsimin fillor, klasat 3-5, përbëhet prej 25 mësimitdhënësve ose rreth 38%, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët prej 40 mësimitdhënësve ose rreth 62% e mostrës së mësimitdhënësve. Mbi 70 % e mostrës së mësimitdhënësve janë udhëheqës të aktiveve profesionale për klasat 3, 4 dhe 5 në arsimin fillor dhe për fushat kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi, Matematika dhe Shkencat e natyrës. Gjithashtu, sa i përket mostrës së mësimitdhënësve, rreth 21 % e tyre kanë marrë pjesë në hartimin e kurrikulave apo janë trajner/e për kurrikula.

Mostra e nxënësve përbëhet nga 30 nxënës të klasave 8 dhe 9, që kanë rol në udhëheqje të klasës dhe të Këshillit të nxënësve të shkollës. Mostra e nxënësve të klasës së 8-të përbëhet prej 13 nxënësve ose rreth 43%, ndërsa

mostra e nxënësve të klasës së 9-të përbëhet prej 17 nxënësve, ose rreth 57 %. Referuar vendbanimit të nxënësve, me vendbanim në fshat janë 10 nxënës apo rreth 33 % e nxënësve, ndërsa me vendbanim në zona urbane janë 20 nxënës apo rreth 67 % e nxënësve.

Mostra e prindërve në këtë studim përbëhet nga 36 prindër, prej tyre 13 prindër i kanë fëmijët e tyre në shkollat rurale, ndërsa 23 në shkollat urbane. Në raport me nivelin e arsimit, ku fëmijët e tyre i vijnë në mësim, 16 prindër i kanë fëmijët në shkollë fillore, 9 prindër i kanë fëmijët në shkollë fillore dhe në shkollë të mesme të ulët dhe 11 prindër i kanë fëmijët vetëm në shkollë të mesme të ulët. Prej mostrës së përgjithshme të prindërve, 7 prindër janë të fëmijëve me nevoja të veçanta. Mbi 70 % e prindërve kanë role në organet e shkollës, janë prindër në Këshillin e Prindërve të Klasës, Këshillin e Prindërve të Shkollës, apo janë pjesë e Këshillit Drejtues të Shkollës.

Përbërja e mostrës së respondentëve të studimit, sipas karakteristikave nga pozitat e përshkruara më lart, ishte:

Tabela 3. Pozita/roli i respondentëve të përfshirë në studim (në numër)

Nr	Pozita/roli i respondentëve	Numri
1	Drejtorë/zëvendësdrejtorë të shkollës	11
2	Koordinatorë për sigurim të cilësisë në shkollë	9
4	Mësimdhënës të arsimit fillor	25
5	Mësimdhënës të arsimit të mesëm të ulët	40
6	Nxënës nga klasat 8 dhe 9	30
7	Prindër	36
8	Zyrtarë arsimorë dhe njohës të kurrikulës - që kanë rol në zhvillimin e kurrikulave	4
Gjithsej respondentë të përfshirë në studim		155

3.3. Instrumentet për mbledhjen e të dhënave

Të dhënat cilësore zakonisht mbledhen kur përdoret qasja epistemologjike interpretuese dhe kur të dhënat e mbledhura janë fjalët dhe shprehjet e vetë pjesëmarrësve në hulumtim (Matthews & Ross, 2010). Për përmbushjen e qëllimit të studimit, lidhur me eksplorimin dhe trajtimin e problematikes së

mbingarkesës kurrikulare në arsimin e obligueshëm në Kosovë, është përdorur një listë e pyetjeve udhëzuese të hulumtimit, të cilat janë përpunuar dhe përdorur në protokollin për intervista gjysmë të strukturuar, pyetësor të tipit të hapur për shprehje të mendimit të pavarur, protokollin për diskutim në fokus-grup, si dhe listë-kontrolli për analizë të përmbajtjeve të dokumenteve kurrikulare.

3.3.1. Përshkrimi i instrumenteve të mbledhjes së të dhënave

Intervistat. Protokollin e intervistës gjysmë të strukturuar, përgatitur në mbështetje të pyetjeve udhëzuese të hulumtimit, për marrjen e mendimit të përgjithshëm nga përfaqësues të komunitetit arsimor, për mbingarkesën kurrikulare, faktorët ndikues dhe efektin e saj te nxënësit dhe mësimdhënësit. Pyetjet e intervistës u krijuan për të qenë sa më të hapura që të jetë e mundur. Ato u zhvilluan bazuar në pyetjet kryesore të studimit dhe u organizuan në katër tema kryesore: (i) Reforma kurrikulare dhe procesi i zbatimit të kurrikulës; (ii) Mbingarkesa kurrikulare – aspektet/faktorët e mbingarkesës; (iii) Ndikimi i mbingarkesës tek nxënësit dhe mësimdhënësit; dhe (iv) Idetë për strategjitë lidhur me evitimin dhe zvogëlimin e mbingarkesës kurrikulare - trajtimin e mbingarkesës së nxënësve në mësim.

Përdorimi i qasjes së intervistës gjysmë të strukturuar u zgjodh pasi lehtësoi një mbledhje të thelluar të të dhënave gjatë gjithë procesit të intervistës. Intervistat u realizuan me shtatë mësimdhënës (7), prej tyre katër (4) mësues klase dhe tre (3) mësimdhënës lëndor nga fushat kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi, Matematika dhe Shkencat natyrore; tre (3) drejtorë shkollash; dy (2) zyrtarë të Ministrisë së Arsimit dhe dy (dy) njohës të kurrikulës që kanë qenë pjesë e zhvillimit të kurrikulës.

Pyetësori me pyetje të hapura. Përdorimi i pyetësorit të tipit të hapur në këtë studim, i përgatitur në mbështetje të pyetjeve udhëzuese të hulumtimit, lejoi që të mblidhen të dhëna nga një pjesëmarrje më e madhe e respondentëve të studimit, që kanë njohuri për një temë me interes dhe që përjetuan zbatimin e kurrikulës në dy-tri vitet e fundit, dhe të përdoren ato gjatë analizës tematike të aspekteve të trajtuara në këtë studim.

Pyetjet e pyetësorit janë ndërlidhur kryesisht me katër tema kryesore të trajtuara nga perspektiva të ndryshme, nga nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit, dhe të lidhura me njohuritë apo rolin e tyre për temat gjegjëse dhe atë që konsiderohet praktikë e përjetuar në kuadër të temave kryesore të hulumtuara. Pra, pyetjet në pyetësorë, pas të dhënave demografike, janë organizuar në katër tema: (i) Reforma kurrikulare dhe procesi i zbatimit të kurrikulës; (ii) Mbingarkesa kurrikulare – aspektet/faktorët e mbingarkesës; (iii) Ndikimi i mbingarkesës te nxënësit dhe mësimdhënësit; dhe (iv) Idetë për strategjitë lidhur me evitimin dhe zvogëlimin e mbingarkesës kurrikulare - trajtimin e mbingarkesës së nxënësve në mësim.

Pyetësorët me pyetje të hapura u realizuan me 58 mësimdhënës, 36 prindër, 30 nxënës, 8 drejtorë dhe zv.drejtorë të shkollave, si dhe 9 koordinatorë të cilësisë në shkolla. Arsyeja kryesore për të planifikuar dhe përfshirë një numër të madh të respondentëve në hulumtimin me pyetësorë me pyetje të hapura lidhet me qasjen hulumtuese cilësore nga pikëpamjet e pjesëmarrësve të studimeve të realizuara nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, për të folur, dëgjuar, dhe lexuar përvojat e përshkruara nga shkollat për çështjet që lidhen me zbatimin e kurrikulës.

Diskutimi në fokus-grup. Në kuadër të këtij studimi, diskutimi në fokus-grup u realizua bazuar në pyetjet udhëzuese të hulumtimit, të cilat u përdorën në protokollin e diskutimit në grup, i cili mundësoi që gjatë diktimit me një fokus-grup të mësimdhënësve të mblidhen të dhëna shtesë mësimdhënësit, të cilët përfaqësonin kolegët e tyre për të përshkruar praktikën e zbatimit të kurrikulës dhe aspektet që u përjetuan në procesin e zbatimit të kurrikulës, qoftë si mundësi, përparësi, por edhe sfidë dhe mbingarkesë në punën e tyre dhe për nxënësit në mësim.

Diskutimi në fokus-grup me shtatë (7) mësimdhënës të përzgjedhur rastësisht, nga 11 shkollat e përfshira në studim, ofroi një mundësi për të vërtetuar të dhënat paraprake të mbledhura nga intervistat gjysmë të strukturuar, pyetësorët me pyetje të hapura dhe temat kryesore të identifikuara. Përveç kësaj, diskutimi në fokus-grup me mësimdhënës ofroi një mundësi për të kuptuar më mirë qëndrimet e mësimdhënësve për shumë

çështje të konsideruara mbingarkesë kurrikulare, si dhe mbështeti disa nga përfundimet në këtë studim, që lidhen me rolin e shkollës në trajtimin e mbingarkesës kurrikulare.

Analiza e dokumenteve

Për të siguruar evidencë të aspekteve të konsideruara mbingarkesë kurrikulare në setin e dokumenteve kurrikulare në zbatim, me theks më të veçantë të kurrikulave lëndore, për klasa të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, u përdor listë kontrolli. Listë kontrolli ka përfshirë tema kryesore për analizën e përmbajtjes së kurrikulave, të organizuar në tri kategori, sipas hierarkisë së dokumenteve kurrikulare (KKAP, KB dhe KL) dhe nënkategori sipas fushave kurrikulare, me një thellim më të veçantë në fushat kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi, Matematika dhe Shkencat e natyrës. Elementet e listë kontrollit ishin: koha mësimore, qëllimet e kurrikulës, rezultatet e të nxënësve, përmbajtjet/temat mësimore, çështjet ndërkurrikulare, si dhe udhëzimet metodologjike.

Analiza e përmbajtjes së setit të dokumenteve kurrikulare ishte e rëndësishme, pasi ofronte një kontekst, nga i cili mund të shiheshin elementet e mbingarkesës së kurrikulës.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënave nga analiza e përmbajtjes së dokumenteve kurrikulare ishte të qartësonte të kuptuarit e organizimit të kurrikulave dhe të gjente evidencë për përgjigje në pyetjen kërkimore:

Sa janë të dukshme aspektet e mbingarkesës kurrikulare në setin e dokumenteve kurrikulare në zbatimin, në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët në Kosovë?

Dhe, nënpyetjeve: (i) A ka mbingarkesë nga zgjerimi i kurrikulave, shtimi i përmbajtjeve mësimore, pritshmërive për nxënës dhe cili është raporti i mbingarkesës me kohën mësimore të obligueshme? (ii) A ka mbingarkesë kurrikulare të shkaktuar nga mënyra e përfshirjes së çështjeve ndërkurrikulare në kuadër të kurrikulave? dhe (iii) Çfarë është marrëdhënia midis rezultateve të nxënësve në arsimin e detyrueshëm dhe kohës së mësimin?

Kurrikulat lëndore në zbatim, të analizuara për këtë studim, përfshijnë klasat 1, 3, 5, 6, 8 dhe 9. Klasat më sipër, në të cilat është fokusuar analiza e kurrikulave lëndore, shihen më specifike për shkak se në mesin e tyre kemi klasa fillestare në nivele të arsimit (klasa e parë – fillimi i arsimit fillor, klasa e gjashtë – fillimi i arsimit të mesëm të ulët), klasa fillestare në shkallë kurrikulare të ndryshme (klasa e tretë – shkalla II dhe klasa e tetë - shkalla IV) dhe dy klasë të tjera, si dhe dy klasë të tjera, të cilat janë klasa përfundimtare të niveleve të arsimit, përkatësisht niveli 1 (klasa e pestë) dhe nivelit 2 (klasa e nëntë).

Mostra e dokumenteve kurrikulare të analizuara nënkupton se kishte një kufizim për analizë të dokumenteve kurrikulare dhe të fushave të kurrikulës. Gjetjet u përdorën për të ndërlidhur disa aspekte të kurrikulës me disa shtete të rajonit dhe të OECD-së, si dhe u përdorën për trekëndëzim me të dhënat e siguruara përmes intervistave, pyetësorëve dhe diskutimit në fokus-grup.

3.4. Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Të dhënat për këtë studim janë mbledhur në bazë të udhëzuesit të përgatitur për hulumtuesit e terrenit. Udhëzuesi përmbante një përshkrim të shkurtër të qëllimit të studimit, formën e prezantimit para respondentëve të studimit, instrumentet dhe mënyrën e mbledhjes së të dhënave, si dhe planin dinamik për mbledhjen e të dhënave. Të dhënat për këtë studim u mbledhën nga hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës, gjatë periudhës prill–gusht 2022.

Intervistat, pyetësorët me pyetje të hapura, janë zhvilluar në secilën shkollë të përfshirë në këtë studim, në hapësira të përshtatshme të siguruara paraprakisht nga drejtorët e shkollës. Në një shkollë kanë marrë pjesë 3-4 hulumtues, të cilët në hapësira të ndryshme kanë mbajtur takime me respondentët e mostrës nga shkolla dhe i kanë siguruar të dhënat me ndihmën e instrumenteve të përgatitura paraprakisht. Bisedat janë regjistruar me lejen e respondentëve që janë intervistuar, në kohëzgjatje 35-45 minuta. Pyetësorët me pyetje të hapura janë plotësuar në prezencë të hulumtuesve, në kohëzgjatje rreth 40 minuta.

Ndërsa, procesi i të dhënave, përpunimi dhe analiza e tyre, u realizuan sipas planit dinamik për analizën e të dhënave, duke përdorur metodën e analizës së përmbajtjes për të dhënat cilësore. Ishte një proces i ndërlikuar, në disa hapa, duke filluar me analizën e dokumenteve kurrikulare, mbledhjen e të dhënave nga respondentët e studimit, pastaj përpunimin dhe interpretimin e tyre për faza të mëtejme.

Analizën e të dhënave cilësore e bazuam në metodën e analizës së përmbajtjes (Gläser & Laudel, 2013), përmes analizës klasike të përmbajtjes, proces gjatë të cilit janë analizuar koncepte dhe shpeshësia e tyre në një tekst sipas qëllimit dhe fushave tematike të hulumtuara dhe ndërveprimi i koncepteve në kuadër të të dhënave të shqyrtuara. Çështjet për shqyrtim dhe diskutim, si dhe problemet që u ngritën gjatë intervistave dhe pyetësorëve me pyetje të hapura, si dhe gjatë diskutimit në fokus-grup, u klasifikuan, u interpretuan dhe u përshkruan gjatë analizës së të dhënave. Fillimisht nga hulumtuesit e përcaktuar përgjegjës për një kategori të subjekteve të përfshira në studim, pastaj nga ekipi hulumtues, autorë të këtij studimi, është bërë diferencimi përmbajtjesor midis kodeve, si dhe është evidentuar shpeshësia e secilit kod për të siguruar informacion sasior për temat e ngritura nga respondentët e këtij studimi.

Kjo qasje mundësoi që të dhënat e mbledhura të grupohen në kategori tematike, të lidhen me pyetjet kërkimore, për të cilat pastaj u bënë interpretime dhe përshkrime brenda një strukture të temave e nëntemave që e karakterizojnë këtë studim. Kështu, për këtë studim, metoda e analizës së përmbajtjes shqyrton termat dhe konceptet më të shpeshta (Vogrinc, & Saqipi, (2020).

3.5. Kufizimet e studimit

Mbingarkesa kurrikulare është një problem i ndërlikuar dhe mjaft kompleks. Në pamundësi për të thelluar shqyrtimin në tërësi të përmbajtjeve kurrikulare, në aspektin vertikal dhe horizontal, në studim kemi analizuar elementet bazike të përmbajtjeve të kurrikulave që japin indicie të mbingarkesës kurrikulare në raport me kohën mësimore dhe mundësitë reale të realizimit të kurrikulës në shkollë.

Studimi është realizuar në një periudhë kur komuniteti arsimor, në veçanti nxënësit, mësime dhënësit dhe prindërit, janë ballafaquar, në këto 2-3 vitet e fundit, me rrethanat dhe ndikimet nga periudha e pandemisë Covid-19, të cilat kanë ndikuar deri diku në perceptimet e tyre në disa aspekte të trajtuara në kuadër të objektit të studimit - mbingarkesës kurrikulare.

Një element tjetër i kufizimeve të këtij studimi lidhet me faktin se në këtë studim nuk janë marrë për shqyrtim kurrikulat lëndore të të gjitha klasave, si dhe në mostër të studimit nga komuniteti shkollor janë përfshirë vetëm shkollat publike dhe nuk janë përfshirë as shkollat me mësim në gjuhën e komuniteteve. Prandaj, përgjithësimi i rezultateve të studimit për mbingarkesën kurrikulare në arsimin e detyrueshëm në Kosovë paraqet vështirësi, kur marrim për bazë faktorët ndikues përtej dokumenteve kurrikulare, si mësime dhënia, tekstet shkollore, mjedisi shkollor etj.

Pavarësisht kufizimeve, ky studim mbetet një burim i mirë informacioni për të gjitha institucionet arsimore që lidhen me procesin e zhvillimit dhe zbatimit të kurrikulës, i bazuar në analizë të dokumenteve kurrikulare, në përvoja të sistemeve arsimore për trajtimin e mbingarkesës kurrikulare, si dhe në perceptimet e subjekteve nga komuniteti arsimor, të cilët i referohen përvojës autentike të tyre me kurrikulën në zbatim. Gjithashtu, studimi ofron një bazë të mirë të orientimeve dhe rekomandimeve për institucionet arsimore në lidhje me trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare.

3.6. Aspekti etik i studimit

Studimi është kryer duke iu përmbajtur etikës hulumtuese për studime në fushën e edukimit, për të marrë të dhëna relevante për objektin e studimit. Për studim janë përdorur orientimet e raportit të OECD-së (2020) për sistemet arsimore lidhur me dimensionet e hulumtimit të problematikës së mbingarkesës kurrikulare, gjithnjë me përshtatjeje për kontekstin e këtij studimi.

Pasi që për studim janë përdorur intervista gjysmë të strukturuar, pyetësorë të hapur me plotësim në prezencën e hulumtuesve, paraprakisht hulumtuesit e angazhuar në këtë studim janë pajtuar me respondentët e studimit për

formën e intervistës, për kohën dhe për mënyrën e regjistrimit të intervistës, apo plotësimin të të dhënave të kërkuara me pyetësor të hapur.

Gjatë realizimit të intervistave, vizitave hulumtuese në shkollat e përfshira në studim, janë dhënë informacionet e nevojshme për studimin dhe qëllimin e tij, si dhe janë siguruar për besueshmëri të plotë të përdorimit të dhënave nga intervistat dhe pyetësorët e hapur, vetëm për qëllime të studimit.

KAPITULLI IV

Rezultatet e hulumtimit

Rezultatet e hulumtimit paraqesin përpjekjet e punës ekipore për t'u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore të këtij studimi. Rezultatet janë organizuar në tri pjesë. Pjesa e parë përfshin gjetjet kryesore nga analiza e dokumenteve kurrikulare, analiza e kurrikulave lëndore/programet mësimore. Pjesa e dytë përfshin rezultatet nga analiza e disa aspekteve kurrikulare dhe krahasimet me disa shtete të rajonit dhe të OECD-së, që lidhen më shumë me kohën mësimore të obligueshme në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët. Ndërsa, në pjesën e tretë janë përfshirë gjetjet kryesore nga përpunimi dhe interpretimi i të dhënave të siguruara me intervista gjysmë të strukturuar dhe pyetësorë të realizuar me respondentë nga komuniteti i shkollës (mësimdhënës, nxënës, prindër, drejtorë të shkollave dhe koordinatorë të cilësisë), si dhe me njohës e koordinatorë të zhvillimit të reformës kurrikulare dhe në arsimin parauniversitar.

4.1. Gjetjet nga analiza e kurrikulave

Sistemi i kurrikulës së arsimit parauniversitar në Kosovë përbëhet nga shtylla konceptuale, e përcaktuar në dokumentin Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar (KKAP) në Kosovë dhe nga shtylla operative, e shprehur përmes Kurrikulave Bërthamë për nivelet formale të arsimit (nivelet I, II dhe III) dhe nga kurrikulat lëndore për secilën klasë.

Dimensione të mbingarkesës së kurrikulës, si zgjerimi i kurrikulës dhe mbingarkesa e përmbajtjes kurrikulare, lidhen drejtpërdrejt me setin e dokumenteve të kurrikulës, që lidhen me një klasë, shkallë kurrikulare apo nivel të arsimit. Mbi këtë bazë është bërë një analizë e dokumenteve kurrikulare, duke filluar nga KKAP, për të vazhduar me fokus Kurrikulat Bërthamë për arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët dhe një analizë më specifike kurrikulave lëndore në zbatim në klasat 1, 3, 5, 6, 8 dhe 9.

Analiza e dokumenteve të kurrikulës, sipas hierarkisë së tyre, nxori në pah disa çështje të rëndësishme të konsideruara mbingarkesë kurrikulare dhe të raportit midis zgjerimit të kurrikulës, përmbajtjeve mësimore dhe rezultateve të të nxënësve, me kohën mësimore të obligueshme. Gjetjet nga

analiza e përmbajtjes së setit të dokumenteve kurrikulare në zbatim, prezantohen sipas hierarkisë së dokumenteve kurrikulare të analizuara.

4.1.1. Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar në Kosovë

Dokumenti i Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Kosovë (KKAP) është dokument konceptual i kurrikulës dhe përgjithësisht i organizimit të sistemit të arsimit parauniversitar. KKAP është e ndërtuar në bazë të kompetencave, duke iu referuar kompetencave evropiane, përmes së cilave synohet të zhvendoset fokusi nga presioni për realizimin e përmbajtjes së përcaktuar me programe mësimore dhe tekste shkollore në zhvillimin e kompetencave kryesore, të zbërthyera nëpërmjet rezultateve të të nxënit.

Qasja e integruar e lëndëve mësimore në fusha kurrikulare, gjithsej shtatë (7) fusha kurrikulare, është një risi, që ka rezultuar me disa shmangie gjatë zhvillimit të kurrikulave bërthamë dhe kurrikulave lëndore, fillimisht në raport me lëndët mësimore. Vendosja për mësimin e të gjitha fushave kurrikulare, nga klasa përgatitore (klasa 0) deri në klasën e dymbëdhjetë (12), ka bërë që në zbërthimin e mëtejshëm të kurrikulës, nga klasa e parë e arsimit fillor, të fillohet me minimum 10 lëndë mësimore. Kjo përben një zgjerim të kurrikulës, sidomos për arsimin fillor, i cili reflektohet si dimension i mbingarkesës kurrikulare në këtë nivel të arsimit.

Dokumenti i KKAP ka përcaktuar gjithsej 62 rezultate të të nxënit të kompetencave kryesore, të cilat duhet t'i arrijnë nxënësit gjatë sistemit të arsimit parauniversitar. Gjuha e formulimit të rezultateve të të nxënit siguron ndërlidhjen në mes të rezultateve dhe kompetencave, siguron mundësi që në mënyrë progresive rezultatet të arrihen nëpërmjet të gjitha fushave të kurrikulës. Në mesin e rezultateve të të nxënit, shtatë (7) prej tyre fillojnë me folje pasive, të cilat mund të konsiderohen si pikënisje në rezultatet e të nxënit në Kurrikulat Bërthamë dhe në Kurrikulat lëndore që fillojnë me folje pasive.

Përshkrimet e bëra në dokumentin e KKAP, për veçoritë e niveleve formale të arsimit parauniversitar dhe relacionet me kurrikulën, si dhe përshkrimet për shkallët kryesore të kurrikulës – rolin e tyre në organizimin dhe

vlerësimin e punës edukativo-arsimore në shkollë, janë një referencë e mirë për të evituar mbingarkesën e mundshme kurrikulare. Mirëpo, ato nuk ofrojnë orientime dhe udhëzime se si të trajtohet dhe zvogëlohet mbingarkesa kurrikulare në faza të tjera të zhvillimit dhe zbatimit të kurrikulave.

Mbingarkesa kurrikulare nuk është koncept i trajtuar në të gjitha orientimet e dhëna për zhvillimin e dokumenteve kurrikulare që dalin nga dokumenti i KKAP, dhe as në fjalorthin e vendosur në kuadër të këtij dokumentit të KKAP.

4.1.2. Kurrikulat Bërthamë

Kurrikulat Bërthamë janë hierarkia e parë e tri dokumenteve kurrikulare, që burojnë nga dokumenti i KKAP. Arsimi parauniversitar në Kosovë, në secilin nivel të tij, ka një dokument të Kurrikulës Bërthamë, në të cilin kompetencat kryesore të përcaktuara me Kornizën Kurrikulare zberthehen tutje përmes rezultateve të nxënit, që janë specifike për çdo shkallë dhe fushë kurrikulare të nivelit përkatës të arsimit.

Në kuadër të secilit dokument të Kurrikulës Bërthamë gjejmë përshkrimin e veçorive të shkallëve kurrikulare, përshkrimin e kompetencave kryesore dhe rezultatet e kompetencave për shkallë kurrikulare, përshkrimin e fushave kurrikulare dhe rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare, planin mësimor, përshkrimet për metodologjinë e përgjithshme, si dhe aspektet që lidhen me sistemin e vlerësimit të nxënësve. Këto elemente ishin pika referimi në analizën e kurrikulave bërthamë për arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët (KB/1 dhe KB/2).

Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës (klasat 0, 1, 2, 3, 4 dhe 5). Dokumenti i KB/1 përmban gjithsej 122 faqe, pjesë e të cilit janë edhe fjalorthi dhe lista e kontakteve të koordinatorëve e zv.koordinatorëve të kurrikulave për nivele të arsimit dhe për fusha kurrikulare. Dokumenti është i organizuar në dy shkallë kryesore kurrikulare, shkallën e parë kurrikulare, e cila përfshin klasat 0, 1 dhe 2, dhe shkallën e dytë kurrikulare, e cila përfshin klasat 3,4 dhe 5.

Përshkrimi i veçorive të shkallëve kurrikulare (shkallët kurrikulare 1 dhe 2) është bërë në rreth dy (2) faqe të dokumentit të KB. Aspektet e mbuluara në përshkrim janë trajtuar në mënyrë shumë të përgjithshme, duke vërë theksin në elementet e përgjithshme të shkallëve kurrikulare, pa orientime se si të përdoren elementet përshkuese të shkallëve kurrikulare në vendosjen e rezultateve të kompetencave, përshkrimin e fushave kurrikulare dhe vendosjen e rezultateve të të nxënit për fusha kurrikulare.

Ashtu si përshkrimi i veçorive të shkallëve kurrikulare, edhe përshkrimi i gjashtë kompetencave kryesore për këto shkallë kurrikulare është bërë në mënyrë shumë të përgjithshme, por që ka shërbyer si një bazë e mirë për përcaktimin e rezultateve të të nxënit për kompetenca për të dy shkallët kryesore kurrikulare të këtij niveli të arsimit.

Rezultatet e të nxënit për kompetenca (RNK), për të dy shkallët kryesore kurrikulare të këtij niveli të arsimit, janë shkruar me një gjuhë të qartë, me elemente që kërkojnë forma të ndryshme të matjeve dhe vëzhgimeve për të verifikuar arritjen e tyre. Në disa raste, RNK-të kanë shumë tekst (3-4 rreshta) dhe nivel të lartë të kërkesave, i cili vështirëson arritjen e rezultateve nga të gjithë nxënësit e klasave për të cilat janë përcaktuar. Për secilën kompetencë, për një shkallë kurrikulare janë përcaktuar nga 6-9 rezultate të të nxënit.

Numri i rezultateve të të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës së parë (1) arrin në 44 rezultate të të nxënit, ndërsa në shkallën e dytë (2) arrin në 50 rezultate të të nxënit. Pra, me gjithsej 94 rezultate të të nxënit për kompetencat kryesore që duhet të arrihen deri në fund të klasës së pestë.

Përshkrimi në KB i fushave kurrikulare është bërë me një strukturë të njëjtë për secilën fushë kurrikulare, strukturë e cila përmban elementet në vijim: Hyrja, qëllimi, temat dhe rezultatet e të nxënit për tema, udhëzime metodologjike, udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare, udhëzime për vlerësim dhe udhëzime për materialet dhe burimet mësimore.

Elementet e përshkruara në kuadër të fushave kurrikulare janë trajtuar në mënyrë shumë të përgjithshme, duke mos i theksuar mjaftueshëm veçoritë e fushave kurrikulare në secilën shkallë kurrikulare dhe ndërlihdjen me përshkrimin e përgjithshëm të veçorive të shkallëve kurrikulare. Ka raste kur

gjuha e përgjithshme e përshkrimit të ndonjë koncepti të fushës kurrikulare përsëritet si në nivelin e parë të arsimit (klasat 1-5), ashtu edhe në nivelin e dytë të arsimit (klasat 6-9), me nuanca shumë të vogla përshkruese. Si të tilla përshkrimet për fusha kurrikulare nuk i orientojnë mjaftueshëm zhvilluesit e kurrikulave lëndore për vendosjen e elementeve kurrikulare që nuk ndikojnë në mbingarkesën e nxënësve, në mënyrë të veçantë formati i përshkimeve nuk i orienton mjaftueshëm mësimmshënësit dhe shkollat në planifikimin dhe realizimin e proceseve edukativo-arsimore në fushat kurrikulare gjegjëse.

Mënyra se si janë vendosur rezultatet e të nxënësve për fusha kurrikulare tregon specifikat e fushave gjegjëse dhe mundësitë që ofrojnë ato për një gamë më të gjerë të veprimtarive mësimore për zhvillimin e fushave gjegjëse dhe arritjen e rezultateve të të nxënësve. Mirëpo, ato dallojnë shumë për nga gjerësia dhe thellësia e kërkesave në kuadër të rezultateve të të nxënësve. Ato nuk dallojnë shumë në numër të rezultateve, pavarësisht përqindjes së kohës mësimore për një fushë kurrikulare. P.sh. fusha kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi ka mbi 38 % të kohës mësimore për shkallën kurrikulare 1, rezultate të të nxënësve për këtë fushë kurrikulare janë përcaktuar të jenë 24, ndërsa një fushë tjetër kurrikulare, siç është për shembull fusha kurrikulare Shkencat e natyrës, ka 14 rezultate të të nxënësve, me rreth 5% të kohës mësimore në shkallën e njëjtë kurrikulare.

Ajo çka i dallon shumë rezultatet e të nxënësve për fusha kurrikulare janë numri i kërkesave brenda një rezultati të të nxënësve, pavarësisht shkallës kurrikulare. Një pjesë e madhe e tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë, tregojnë për një ngarkesë kurrikulare në raport me veçoritë e shkallëve kurrikulare dhe me kohën mësimore të përcaktuar për fusha kurrikulare. Dy-tre shembuj të rezultateve në vijim tregojnë për këtë tendencë të mbingarkesës me kërkesa brenda rezultateve të të nxënësve për fusha kurrikulare.

Fusha kurrikulare Shkencat e natyrës, Shkalla kurrikulare 1, rezultati nr. 1.6. Identifikon mënyrat e orientimit dhe lëvizjet në hapësirë dhe tregon forma të thjeshta të bashkëveprimit në relacionin njeri-naturë, dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit që shkaktohen nga faktorë të ndryshëm në rrethin ku jeton e më gjerë, tregon për rolin që ka në ruajtjen e mjedisit dhe ndërmerr veprime të dobishme që promovojnë mjedisin e pastër (MASHTI (KB/1), 2016).

Fusha kurrikulare Shkencat e natyrës, Shkalla kurrikulare 2, rezultati nr. 1.6. Përshkruan pozitën e Tokës në Sistemin diellor, lëvizjet e Tokës, diellit, Hënës, dhe trupave të tjerë të këtij sistemi, elementet e hartës, përmbajtjen e hartës, legjendën e hartës, shenjat hartografike, skicën, planin, globin, veçoritë e elementeve natyrore të mjedisit natyror (relievin, klimën, ujërat, botën bimore dhe shtazore), bashkëveprimin njeri/natyrë, rreziqet natyrore, resurset natyrore e objektet e trashëgimisë natyrore, në veçanti ato të Republikës së Kosovës (MASHTI (KB/1), 2016).

Fusha kurrikulare Jeta dhe puna, Shkalla kurrikulare 2, rezultati nr. 8.1. Është i vetëdijshëm për ekzistimin e diversitetit individual në klasë, në shkollë dhe në jetë, për të përmirësuar të kuptuarit, dëshirat dhe aspiratat e të tjerëve, duke menaxhuar situatat dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë konstruktive dhe paqësore (MASHTI (KB/1), 2016).

Një dallim tjetër në rezultatet e të nxënit që nuk orientojnë mjaftueshëm zhvilluesit e kurrikulave lëndore ka të bëjë me mënyrën e vendosjes së koncepteve për (i) qëndrimet, vlerat dhe besimet; (ii) Aftësitë dhe shkathësitë; dhe (iii) Konceptet specifike dhe njohuritë që lidhen me fushën kurrikulare. Në shumicën e fushave kurrikulare ato janë të përbashkëta, gjë që le të kuptohen se të gjitha këto elemente bazike të kurrikulës zhvillohen në të dy shkallët kurrikulare. Zhvillimi i një numri sosh nga klasa e parë, apo edhe më herët, nga klasa përgatitore, përbën elemente për zgjerim të kurrikulës dhe të përmbajtjeve kurrikulare.

Në anën tjetër, në raport me orientimet dhe udhëzimet metodologjike, në të gjitha përshkrimet në kuadër të fushave kurrikulare, ka pak orientime dhe udhëzime se si mësimdhënësit t'i qasen zbërthimit të rezultateve të fushave në rezultatet e të nxënit për tema dhe si t'i qasen emërtimit të temave, apo si të bëjnë planifikimin për zbatim të kurrikulës, cilin model duhet të ndjekin me shtrirjen apo shpërndarjen e temave mësimore brenda një klase, në raport me specifikat e nivelit/ klasës përkatëse dhe thellësinë e gjerësinë e përmbajtjes së temave përkatëse.

Edhe orientimet dhe udhëzimet për vlerësim, si dhe për materialet e burimet mësimore, janë të përgjithshme, gati të njëjta, si në KB1 ashtu edhe në KB2, me dallime ndërmjet fushave, me disa specifika për fushat kurrikulare gjegjëse, brenda formatit të strukturës së KB për këtë nivel të arsimit.

Plani mësimor për klasën përgatitore dhe arsimin fillor në KB1 ndahet për fusha kurrikulare në përqindje dhe në numër të orëve mësimore për fusha/lëndë mësimore. Tabela në vijim pasqyron planin mësimor për klasën përgatitore dhe arsimin fillor, klasat 1-5, sipas KB1.

Tabela 4. Plani mësimor për klasën përgatitore dhe arsimin fillor

Fushat kurrikulare	Lëndët mësimore	Shkalla I - klasat	Shkalla II-- klasat			Gjith. Kl. 1-5				
			Kl. 1	Kl. 2	Gjith. Kl.1-2		Kl. 3	Kl.4	Kl.5	Gjith. Kl. 3-4
1. Gjuhët dhe komunikimi	1. Gjuhë amtare	Kl. Përgatitore: Nxënësit gjatë një javë i zhvillojnë përmbajtjet nga të gjitha fushat	8	8	16	8	8	8	24	40
	2. Gjuhë angleze									
2. Artet	3. Ed.figurative		2	2	4	2	2	2	6	10
	4. Ed.muzikore									
3. Matematikë	5. Matematikë		5	5	10	5	5	5	15	25
4. Shkencat natyrore	6. Njeriu dhe natyra		1	1	2	2	2	2	6	8
5. Shoqëria dhe mjedisi	7. Shoqëria dhe mjedisi		1	1	2	2	2	2	6	8
6. Ed.fizike, sportet dhe shëndeti	8. Ed.fizike, sportet dhe shëndeti		2	2	4	2	2	2	6	10
7. Jeta dhe puna	9. Shkathësi për jetë		1	1	2	1	1	1	3	5
	10. Pjesa zgjedhore		1	1	2	1	2	2	5	7
Totali – Orë javore		18 ²	21	21	42	23	24	24	71	113

Burimi/MAShT (2018 /2021): Kurrikulat lëndore/programet mësimore për klasat 1-5

² Për klasën përgatitore, organizimi i planit mësimor mbetet kompetencë e mësuesit/es (edukator/es). E rëndësishme është që nxënësit duhet të kalojnë nëpër të gjitha fushat e kurrikulës- lëndët mësimore brenda javës, përkatësisht brenda 18 orëve.

Krahasuar me planin mësimor nga Korniza kurrikulare – Libri i Bardhë (DASH, 2001), i realizuar deri në vitin 2016, plani mësimor në zbatim ka numrin e njëjtë të orëve të mësimit për arsimin fillor, gjithsej 113 orë javore, në të gjitha klasat e arsimit fillor, klasat 1-5. Mirëpo, ka një ndryshim të theksuar në numrin e lëndëve mësimore në klasat 1 dhe 2, ngase tani mësohen në minimum 10 lëndë mësimore, ndërsa me planin paraprak klasat 1 dhe 2 kishin nga 7 lëndë mësimore. Tabela në vijim prezanton planin mësimor sipas lëndëve dhe numrit javor të orëve të mësimit për lëndë mësimore në arsimin fillor, të zbatuar në vitet 2003-2016.

Tabela 5. Plani mësimor për klasat 1-5, i zbatuar në vitet 2003-2016

Fushat kurrikulare	Lëndët mësimore	Klasat					Gjithsej orë javore kl. 1-5
		1	2	3	4	5	
1. Gjuhët dhe komunikimi	1. Gjuhë amtare	7	7	7	6	5	32
	2. Gjuhë angleze	/	/	2	2	2	6
2. Artet	3. Edukatë figurative	2	2	1	1	1	7
	4. Edukatë muzikore	2	2	1	1	1	7
3. Matematikë	5. Matematikë	5	5	5	5	5	25
4. Shkencat e natyrës	6. Njeriu dhe natyra	/	/	1	2	2	5
5. Studimet shoqërore dhe edukata qytetare	7. Edukatë qytetare	/	/	1	2	2	5
	8. Histori	/	/	/	/	2	2
6. Edukata fizike dhe sportet	9. Edukata fizike dhe sportet	2	2	2	2	2	10
7. Teknologjia	10. Punëdore	1	1	1	1	1	5
11. Pjesa zgjedhore/ - Kurrikula me zgjedhje		1	2	2	2	2	9
Totali – Orë mësimore javore		20	21	23	24	25	113

Burimi/MAShT (2003, 2004, 2005,2006): Planet dhe programet mësimore për klasat 1 - 5.

Sipas këtyre të dhënave, krahasuar me tabelën paraprake, shihet se me kurrikulën e re në zbatim, në klasa 1-2 janë shtuar tri lëndë mësimore, si Gjuha angleze, Njeriu dhe natyra dhe Shoqëria dhe mjedisi.

Sa u përket orientimeve dhe udhëzimeve për veprime dhe iniciativa për adresimin eventual të mbingarkesës kurrikulare, ashtu si në dokumentin e KKAP, edhe në KB1 ato mungojnë. Mbingarkesa kurrikulare nuk është pjesë e orientimeve të përgjithshme për arsimin fillor, orientimeve dhe përcaktimeve për fushat kurrikulare në këtë nivel të arsimit dhe as në fjalorthin e vendosur në kuadër të këtij dokumentit të KB1.

Kurrikulave Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët (klasa 6, 7, 8 dhe 9).

Arsimi i mesëm i ulët është i organizuar në dy shkallë kryesore kurrikulare, të cilat janë vazhdimësi e shkallëve të arsimit fillor, përkatësisht në shkallën e tretë (klasat 6 dhe 7) dhe shkallën e katërt (klasat 8 dhe 9). Struktura e përmbajtjes së kapitujve të KB (II) për arsimin e mesëm të ulët është e njëjtë me KB të niveleve të tjera të arsimit parauniversitar. Dokumenti i KB përmban gjithsej 126 faqe, përfshirë fjalorthin dhe listën e kontakteve të koordinatorëve e zv.koordinatorëve të kurrikulave për nivele të arsimit dhe për fusha kurrikulare.

Gjetjet nga analiza e Kurrikulës Bërthamë për këtë nivel të arsimit tregojnë, të njëjtën gjë me KB1, lidhur me veçoritë e shkallëve kurrikulare. Kështu, edhe veçoritë e shkallëve kurrikulare 3 dhe 4 janë trajtuar në mënyrë shumë të përgjithshme, duke vënë theksin në përshkrimin e shkallëve me elementet e përgjithshme të Shkalla 3 – Zhvillim i mëtejshëm dhe orientim dhe elementet e përgjithshme të Shkalla 4 – Përforcim dhe orientim, pa orientime se si të përdoren elementet përshkruese të shkallëve kurrikulare në zhvillimin e mëtejshëm të kurrikulave për këto dy shkallë kurrikulare.

Gjuha përshkruese e përgjithshme përdoret edhe në elementet e përshkuara për gjashtë kompetencave kryesore për këto shkallë kurrikulare, por me një dallim kundrejt KB1, duke vënë theksin në kompetencën e komunikimit dhe të shprehurit, kompetencën e të menduarit dhe kompetencën e të mësuarit, si kompetenca bazë për kompetencat e tjera (MASHT, 2016 (KB/2).

Rezultatet e të nxënit për kompetenca, për të dy shkallët kryesore kurrikulare të këtij niveli të arsimit, janë shkruar me një gjuhë të qartë, me elemente që

kërkojnë forma të ndryshme të matjeve dhe vëzhgimeve për të verifikuar arritjen e tyre. Për secilën kompetencë kryesore, për një shkallë kurrikulare janë përcaktuar nga 8 deri në 10 rezultate të të nxënit. Numri i rezultateve të të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës së tretë (3) = 50 rezultate të të nxënit, ndërsa në shkallën e katërt (4) arrin në 48 rezultate të të nxënit. Pra, me gjithsej 98 rezultate të të nxënit për kompetencat kryesore që duhet të arrihen deri në fund të klasës së nëntë.

Përshkrimi në KB i fushave kurrikulare, ashtu si në KB1, është bërë me një strukturë të njëjtë për secilën fushë kurrikulare, si në KB1, me strukturë e cila përmban elementet në vijim: Hyrja, qëllimi, temat dhe rezultatet e të nxënit për tema, udhëzime metodologjike, udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare, udhëzime për vlerësim dhe udhëzime për materialet dhe burimet mësimore.

Edhe në KB2 elementet e përshkruara në kuadër të koncepteve të fushave kurrikulare janë trajtuar në mënyrë shumë të përgjithshme, duke mos i theksuar mjaftueshëm veçoritë e fushave kurrikulare në secilën shkallë kurrikulare. Ka raste kur gjuha e përgjithshme e përshkrimit të ndonjë koncepti të fushës kurrikulare përsëritet nga niveli paraprak i arsimit, nga KB1, me dallime të vogla përshkruese. Si të tilla përshkrimet për fusha kurrikulare nuk duket se ofrojnë mjaftueshëm orientime për zhvilluesit dhe zbatuesit e kurrikulave lëndore.

Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare në KB2 pasqyrojnë specifikat e fushave gjegjëse të kurrikulës dhe mundësitë që ato ofrojnë për një gamë më të gjerë të veprimtarive mësimore për arritjen e tyre. Njëjtë, si në KB1, edhe në KB2, rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF) nuk dallojnë shumë në numër të rezultateve për një shkallë kurrikulare, pavarësisht përqindjes së kohës mësimore për një fushë kurrikulare. Nuk ka një kriter apo standard të vendosjes së numrit të rezultateve të të nxënit për fusha, për të qenë një orientim shtesë për zhvilluesit dhe përdoruesit e kurrikulave për klasë, si dhe për qëllime të tjera, siç mund të jenë për hartimin e teksteve shkollore.

RNF në KB/2 dallojnë për nga numri i kërkesave brenda një rezultati të të nxënit dhe nga pikënisja e referimit për ndarjen e rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare për një shkallë kurrikulare. Në fushën kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi, RNF janë të organizuara sipas shkathtësive bazë, në fushat e tjera kurrikulare RNF janë të organizuara sipas koncepteve të fushës kurrikulare përkatëse dhe rezultateve të të nxënit që duhet të arrihen deri në fund të klasës 9, pastaj në bazë të tyre janë zbërthyer rezultate të të nxënit për një shkallë kurrikulare.

Edhe në KB2 një dallim tjetër në rezultatet e të nxënit ka të bëjë me mënyrën e vendosjes së koncepteve për: (i) qëndrimet, vlerat dhe besimet; (ii) aftësitë dhe shkathtësitë; dhe (iii) konceptet specifike dhe njohuritë që lidhen me fushën kurrikulare. Në shumicën e fushave kurrikulare ato janë të përbashkëta për të dyja shkallët kurrikulare, nuk pasqyrohen ndryshimi nga shkalla në shkallë kurrikulare, shtrirja, thellimi, dhe orientimi për matje dhe verifikim në arritjen apo zotërimin e tyre.

Sa u përket udhëzimeve metodologjike, referuar përshkrimeve në kuadër të fushave kurrikulare, shihen se ato kanë gjuhë të përgjithshme, të përafërta me KB1, pa orientime të mjaftueshme me specifikat dhe veçoritë e shkallëve kurrikulare në këtë nivel të arsimit, por edhe të vetë fushave kurrikulare, në raport me konceptet e fushës dhe rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare, shtrirjen apo shpërndarjen e temave mësimore, thellësinë dhe gjerësinë e përmbajtjes së temave përkatëse, brenda një klase apo shkalle kurrikulare.

Edhe orientimet dhe udhëzimet për vlerësim, si dhe për materialet e burimet mësimore, janë të përgjithshme, me KB1, me dallime të vogla ndërmjet fushave, me disa specifika për fushat kurrikulare gjegjëse, brenda formatit të strukturës së KB për këtë nivel të arsimit.

Plani mësimor në KB2 për arsimin e mesëm të ulët, klasat 6-9, ndahet për fusha kurrikulare, në përqindje dhe në numër të orëve mësimore për fusha/lëndë mësimore. Tabela në vijim pasqyron planin mësimor për klasat 6-9 të arsimit të mesëm të ulët.

Tabela 6. Plani mësimor për arsimin e mesëm të ulët

Fushat kurrikulare	Lëndët mësimore	Shkalla III			Shkalla IV			Gjith. Kl. 6-9
		Kl.6	Kl. 7	Gjith. Kl. 6-7	Kl. 8	Kl. 9	Gjith. Kl. 8-9	
1. Gjuhët dhe komunikimi	1. Gjuhë amtare	5	5	10	5	4	9	19
	2. Gjuhë e huaj	2	2	4	2	2	4	8
	3. Gjuhë e dytë e huaj	1	1	2	1	1	2	4
	4. Art muzikor	1	1	2	1	1	2	4
2. Artet	5. Art figurativ	1	1	2	1	1	2	4
3. Matematikë	6. Matematikë	4	4	8	4	4	8	16
4. Shkencat natyrore	7. Fizikë	2	2	4	2	2	4	8
	8. Kimi	/	2	2	2	2	4	6
	9. Biologji	2	2	4	2	2	4	8
5. Shoqëria dhe mjedisi	10.Histori	2	2	4	2	2	4	8
	11.Gjeografi	2	2	4	2	1	3	7
	12.Edukatë qytetare	1	1	2	1	2	3	5
6. Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	13.Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	2	2	4	2	2	4	8
	7. Jeta dhe puna	14.Teknologji me TIK	2	2	4	2	2	4
Pjesa zgjedhore	15.Pjesa zgjedhore	2	1	3	1	2	3	6
Totali – Orë javore		29	30	59	30	30	60	119

Burimi/MAShT (2018 /2020): Kurrikulat lëndore/ programet mësimore për klasat 6 - 9.

Krahasuar me planin mësimor nga Korniza kurrikulare – Libri i Bardhë (DASH, 2001) dhe planet e programet mësimore për klasë dhe lëndë mësimore, që ishin në zbatim deri në vitin 2016, plani mësimor për kurrikulat aktuale në zbatim ka një ndryshim të vogël në numrin e orëve të mësimimit për arsimin e mesëm të ulët, gjithsej 119 orë javore tani, ndërsa në kurrikulat paraprake kishte 117 orë javore, pra nga një orë javore më shumë në klasat 6 dhe 7. Ka hyrë lënda gjuhë e dytë e huaj me një orë mësimi në javë në kuadër të kohës mësimore për lëndën e Gjuhës angleze, si dhe është zvogëluar koha mësimore e kurrikulës me zgjedhje për 3 orë në javë, apo rreth 33 % më pak kohë mësimore për kurrikulën me zgjedhje. Ndërsa, koha mësimore është shtuar për lëndën e Matematikës, në klasën e 9-të dhe në lëndën Teknologji me TIK për klasat 6, 7 dhe 8. Tabela në vijim prezanton planin mësimor sipas lëndëve dhe numrit javor të orëve të mësimimit për lëndë mësimore në arsimin e mesëm të ulët, të zbatuar në vitet 2003-2016.

Tabela 7. Plani mësimor për klasat 6-9, i zbatuar në vitet 2003-2016

Fushat kurrikulare	Lëndët mësimore	Klasat				Gjithsej orë javore (4 vite)
		6	7	8	9	
1. Gjuhët dhe komunikimi	1. Gjuhë amtare	5	5	5	4	19
	2. Gjuhë angleze	3	3	3	3	12
2. Artet	3. Edukatë muzikore	1	1	1	1	4
	4. Edukatë figurative	1	1	1	1	4
3. Matematikë	5. Matematikë	4	4	4	3	15
4. Shkencat e natyrës	6. Fizikë	2	2	2	2	8
	7. Kimi	/	2	2	2	6
	8. Biologji	2	2	2	2	8
	9. Histori	2	2	2	2	8
5. Studimet shoqërore dhe edukata qytetare	10. Gjeografi	2	2	2	1	7
	11. Edukatë qytetare	1	1	1	1	4
	12. Edukata fizike dhe sportet	2	2	2	2	8
6. Edukata fizike dhe sportet	13. Teknologji me TIK	1	1	1	2	5
	14. Mësimi zgjedhor – Kurrikula e përcaktuar nga shkolla	2	1	2	4	9
Totali – Orë mësimore javore		28	29	30	30	117

Burimi/MAShT (2003, 2004, 2005): Planet dhe programet mësimore për klasat 6 - 9.

Nga të dhënat e tabelës, shihet se ka një rritje minimale prej 2 orë mësimore në javë në këtë nivel të arsimit dhe ka zgjerim të kurrikulës me një lëndë të re mësimore, shtimin e lëndës mësimore Gjuha e dytë e huaj.

Edhe në KB2, sa u përket orientimeve dhe udhëzimeve për veprime dhe iniciativa për adresimin eventual të mbingarkesës kurrikulare, ashtu si në dokumentin e KKAP, në KB1, ato mungojnë. Mbingarkesa kurrikulare nuk është pjesë e orientimeve të përgjithshme për arsimin e mesëm të ulët, nuk është pjesë e orientimeve dhe u përcaktimeve për fushat kurrikulare në këtë nivel të arsimit dhe as në fjalorthin e vendosur në kuadër të këtij dokumentit të KB2.

4.1.3. Gjetjet nga analiza e kurrikulave lëndore/ programeve mësimore

Struktura e kurrikulave lëndore është e njëjtë për secilën klasë, në bazë të udhëzimeve në Kurrikulat Bërthamë. Pas hyrjes në secilin dokument të kurrikulave lëndore, është përfshirë plani mësimor, i nivelit përkatës të arsimit, i cili siguron një koherencë në orientime për të pasur në vëmendje kohën mësimore për çdo fushë/lëndë mësimore dhe për çdo klasë. Secili dokument i kurrikulave lëndore të një klasë përcillet me një vendim për zbatimin e planit dhe programit lëndor, i nxjerrë dhe i protokolluar nga kabineti i ministrit.

Programet e secilës lëndë mësimore janë të ndërtuara në bazë të rezultateve të kompetencave, koncepteve dhe rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare përkatëse. Përmbajtja e kurrikulës lëndore/programit mësimor të një lënde mësimore përfshin aspektet në vijim:

- Hyrje;
- Qëllimi i mësimin të lëndës në klasën përkatëse;
- Konceptet e fushës, temat mësimore dhe rezultatet e të nxënit;
- Udhëzime metodologjike;
- Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare;

- Udhëzimet për vlerësim;
- Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore.

Sasia dhe thellësia e udhëzimeve dhe orientimeve që ofrohen për kurrikulat lëndore/programet mësimorë dallon ndërmjet lëndëve mësimore, përfshirë edhe brenda një fushe kurrikulare, me nuanca të ruajtjes së specifikave të lëndës mësimore, por edhe në varësi të qasjes që kanë punuar grupet hartuese të kurrikulave lëndore.

Dallimet në udhëzimet dhe orientimet e kurrikulave lëndore vërehen në gjuhën e përshkrimit të qëllimit të mësimi të kurrikulës lëndore në klasën përkatëse, në numrin e rezultateve të të nxëniti, sidomos të lëndët mësimore që kanë fond të njëjtë të orëve mësimore javore, në udhëzimet për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare, si dhe në udhëzimet e tjera. Udhëzime dhe orientime me të detajuara pasqyrohen në kurrikulat e gjuhës angleze, në secilën klasë. Në kurrikulat e gjuhës angleze, numri i rezultateve të të nxëniti të përcaktuara për t'u arritur gjatë një viti shkollor, është më i madh kundrejt kurrikulave të tjera lëndore, pavarësisht fondit javor të orëve mësimore.

Në dokumentin ku janë integruar kurrikulat lëndore të një klase pasqyrohen edhe plani mësimor, numri javor i orëve mësimore. Për pjesën zgjedhore - kurrikulën e përcaktuar nga shkolla, nuk ka orientime dhe sugjerime për zgjedhjet e mundshme brenda një klase. Orientime të përgjithshme pasqyrohen në Kurrikulat Bërthamë të niveleve përkatëse të arsimit, në kapitullin IV Kurrikula me zgjedhje, në Udhëzimin Administrativ përkatës për kurrikulën me zgjedhje dhe në udhëzuesin përkatës për trajnimin e mësimdhënësve që mbajnë kurrikulën me zgjedhje.

Në vitin 2019, Instituti Pedagogjik i Kosovës ka bërë publikimin e studimit: *Kurrikula e bazuar në kompetenca - Përvojat gjatë zbatimit, sfidat dhe mundësitë, si dhe nevojat për mbështetje të vazhdueshme të mësimdhënësve*. Raporti i publikuar sjell disa gjetje të vlefshme, të cilat lidhen me elementet e konsideruara si mbingarkesë kurrikulare. Ato janë plotësuar me disa gjetje shtesë nga ky studim, të cilat të përmbledhura raportohen si në vijim:

- Përshkrimet brenda secilës pjesë të strukturës së kurrikulave lëndore dallojnë si në gjuhën e formulimit dhe shtrirje të udhëzimeve, ashtu

edhe në numrin e faqeve, pavarësisht kohës mësimore që kanë lëndët mësimore në bazë të planit mësimor;

- Numri i temave dhe rezultateve të të nxënit në kurrikulat lëndore pasqyrohet me dallime të theksuara, pavarësisht kohës mësimore të njëjtë për lëndë mësimore të ndryshme, apo edhe të kohës mësimore të ndryshme;
- Shkrimi i rezultateve të të nxënit për tema mësimore ka dallime në strukturë, organizim, përdorim të foljes aktive apo pasive, përmes së cilave reflektohet veprimi që duhet të kryejnë nxënësit në kuadër të veprimitarive mësimore, aktiviteteve të veçanta, detyrave, etj.;
- Lidhja e rezultateve të të nxënit të lëndës (RNL) me rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF) nuk është bërë nga të gjitha lëndët mësimore të klasave përkatëse;
- Përmbajtja dhe gjuha e udhëzimeve metodologjike dhe udhëzimeve të tjera, me dallime të theksuara, me përsëritje në programe të klasave të ndryshme dhe me përgjithësime që nuk orientojnë mjaftueshëm punën e mësimdhënësve në procesin e planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës në klasën përkatëse;
- Në kurrikula lëndore ka udhëzime dhe orientime minimale për qasjen ndaj zhvillimit të kompetencave dhe dokumentit referues për rezultatet e kompetencave kryesore në shkallën përkatëse kurrikulare;
- Në kurrikulat lëndore/programet mësimore për klasë, ashtu si edhe në dokumentet e tjera kurrikulare, nuk ka orientime dhe udhëzime për veprime dhe iniciativa që duhet të ndërmerren në nivel shkolle, për adresimin eventual të mbingarkesës kurrikulare.

Një dallim i dukshëm në programet e lëndëve mësimore, dallim i cili përmban elemente të konsideruara mbingarkesë kurrikulare, janë strukturimi, përmbajtja dhe numri i temave mësimore dhe i rezultateve për tema mësimore, në raport me kohën mësimore që është ndarë për lëndë mësimore sipas planit zyrtar të mësimin fillor dhe të mesëm të

ulët. Disa nga gjetjet kryesore lidhur me këto aspekte pasqyrohen në pjesën në vijim të këtij raporti.

4.1.4. Disa gjetje specifike nga analiza e kurrikulave lëndore/ programeve mësimore në arsimin fillor

Për shumicën e kurrikulave lëndore të arsimit fillor vlejné gjetjet e përgjithshme të raportuara më sipër. Disa gjetje specifike, që raportohen në pjesën në vijim, lidhen me temat mësimore dhe rezultatet e të nxënit për tema mësimore (RNL), që janë përcaktime themelore për zbatimin e kurrikulës dhe që, referuar literaturës, konsiderohen aspektet kryesore të mbingarkesës kurrikulare.

Kurrikulat lëndore në arsimin fillor përmbajnë numër të përafërt të faqeve, apo me dallime të vogla, nga 94 faqe në klasën e parë deri në 121 faqe në klasën e pestë. Pra, gjithsej rreth 510 faqe për kurrikulat lëndore në klasat 1-5, ku përfshihen informacionet e përgjithshme dhe kurrikulat e secilës lëndë në klasën përkatëse. Rezultatet e të nxënit në kurrikulat lëndore zënë hapësirën kryesore në kurrikulat lëndore.

Pas hyrjes, në secilën kurrikulë lëndore pasqyrohet qëllimi i lëndës, diku i përshkruar me një-dy paragrafë, diku me renditje të disa qëllimeve. Ka shembuj specifike që qëllimet e lëndës në klasën përkatëse fokusohen në specifika konkrete, si p.sh. një nga qëllimet e lëndës së Matematikës në klasën e parë është formimi matematikor përmes të nxënit të integruar dhe në kontekstin e jetës së përditshme³. Ose një nga qëllimet e lëndës Shoqëria dhe mjedisi në klasën e parë është që nxënësi të fitojë njohuri për vetveten, bashkësinë dhe mjedisin ku jeton⁴.

Mënyra e vendosjes së qëllimeve të lëndës së njëjtë, që mësohet në klasa të ndryshme, në disa lëndë mësimore shihet si një element i mbingarkesës së mundshme për kurrikulat lëndore, në raport me klasën në të cilën mësohet lënda mësimore përkatëse dhe veçoritë specifike të klasës dhe të shkallës

³ Më gjerësisht për qëllimet e lëndës Matematika për klasën e parë, shih kurrikulën e kësaj lënde mësimore.

⁴ Më gjerësisht për qëllimet e lëndës Shoqëria dhe mjedisi për klasën e parë, shih kurrikulën e kësaj lënde mësimore.

kurrikulare. Ato shpesh nuk kanë dy-tri qëllime specifike të lëndës për klasën përkatëse, siç u raportua në paragrafin paraprak, se çfarë duhet të fitojnë nxënësit nga kurrikula lëndore në klasën përkatëse. P.sh. *Zhvillimi i njohurive dhe të kuptuarit e koncepteve shkencore dhe teknologjike përmes hulumtimit të proceseve biologjike, fizike, kimike dhe gjeografike në mjedis*, është një nga shtatë qëllimet e të mësuarit të lëndës Njeriu dhe natyra. Ky qëllim mësimit të lëndës Njeriu dhe natyra është pjesë e kurrikulës në klasën e parë dhe është përsëritur me formulim të njëjtë në çdo kurrikulë lëndore, deri në klasën e pestë⁵.

Pas qëllimit të lëndës, kurrikulat lëndore pasqyrojnë temat mësimore dhe rezultatet e të nxënit. Në kurrikulat lëndore, temat mësimore nuk janë të përshkruara, ashtu siç janë përshkruar konceptet e fushës në kurrikulat bërthamë. Mbulueshmëria, thellësia dhe gjerësia e trajtimit të temave mësimore të një lëndë mësimore, në kuadër të një klase, përcaktohen me rezultatet e të nxënit.

Rezultatet e të nxënit për tema mësimore (RNL) janë organizuar në kurrikulat lëndore në një format afërsisht të njëjtë tek të gjitha lëndët mësimore, ato në shumicën dërmuese të rasteve nuk kanë indeks të renditjes së numrave, i cili nga ana praktike konsiderohet se do të lehtësonte punën e mësimeve gjatë planifikimit për zbatimin e kurrikulës – në plan vjetor, plan për periudha mësimore, plan javor dhe plan ditor. Indeksi i RNL konsiderohet se do të ishte lehtësim edhe për zhvillues të teksteve shkollore dhe përdorues të tjerë të kurrikulave lëndore.

Ashtu siç është e pritur nga analiza e KB, numri i temave dhe rezultateve të të nxënit në kurrikulat lëndore është i ndryshëm, për shkak të specifikave të lëndëve mësimore. Mirëpo, ka dallime të theksuara në kurrikulat lëndore që kanë kohë të njëjtë mësimore të përcaktuar me planin mësimor zyrtar. Tabela në vijim pasqyron disa të dhëna krahasuese për lëndët mësimore të klasave 1, 3 dhe 5, në raport me numrin e orëve mësimore për një javë mësimi dhe numrin e temave mësimore dhe RNL për gjatë gjithë vitit shkollor.

⁵ Më gjerësisht për qëllimet e lëndës Njeriu dhe natyra, shih kurrikulat e kësaj lënde mësimore për klasat 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Tabela 8: Numri i orëve për javë mësimi, numri i temave vjetore dhe numri i RNL – vjetore në kurrikulat lëndore/programet mësimore – klasat 1, 3 dhe 5

Lëndët mësimore	Numri i orëve për javë mësimi			Numri i temave vjetore			Numri i RNL – vjetore		
	Klasat			Klasat			Klasat		
	1	3	5	1	3	5	1	3	5
1. Gjuhë shqipe	7	6	6	24	30	22	33	50	54
2. Gjuhë angleze	1	2	2	18	24	24	187	215	190
3. Edukatë figurative	1	1	1	16	14	23	41	57	42
4. Edukatë muzikore	1	1	1	11	9	8	22	22	26
5. Matematikë	5	5	5	11	14	11	72	94	90
6. Njeriu dhe natyra	1	2	2	9	11	10	31	49	56
7. Shoqëria dhe mjedisi	1	2	2	6	11	9	21	36	35
8. Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	2	2	2	11	7	7	41	20	21
9. Shkathtësi për jetë	1	1	1	6	6	5	27	30	31
10. Pjesa zgjedhore	1	1	2	Përcaktohen nga shkolla, përkatësisht mësimdhënësit që e mbajnë kurrikulën me zgjedhje.					
Totali	21	23	24	112	126	119	475	573	545

Burimi/MAShT (2018 /2019/2021): Kurrikulat lëndore/ programet mësimore për klasat 1, 3 dhe 5.

Nga tabela më sipër, shihet se ka dallime të theksuara në kurrikulat lëndore që kanë kohë të njëjtë mësimore dhe kohë të ndryshme të mësimit, të përcaktuar me planin mësimor zyrtar. Siç është rasti më lëndën e Gjuhës shqipe, ku maksimumi i RNL arrin në 54 rezultate të të nxënit në klasën e 5-të, me 6 orë mësimi në javë, ndërsa në lëndën e Gjuhës angleze maksimumi 190 rezultate të të nxënit në klasën e 5-të, me kohë mësimore 2 orë në javë. Këto dallime reflektojnë specifikat që kanë Gjuha amtare (gjuhë shqipe) me Gjuhën angleze, pavarësisht faktit se këto dy lëndë mësimore janë të një fushe kurrikulare, me koncepte të përbashkëta dhe me rezultate të përbashkëta për fushën kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi.

Dallime me kohë mësimore të njëjtë brenda një fushe kurrikulare, në fushën Artet, vërehen tek lëndët mësimore Edukatë figurative dhe Edukatë muzikore. Dallimi shpërfaqet në mënyrën e vendosjes së temave mësimore dhe në numrin e RNL, ku rreth 70 % e rezultateve të të nxënit nga këto dy lëndë mësimore, në klasat 1, 3 dhe 5, janë të lëndës Edukatë figurative. Gjuha e formulimit të kërkesave në kuadër të RNL është e përafërt, në lëndën Edukatë figurative në formulimin e RNL kryesisht përdoret lidhëza të, para foljeve që tregon veprimin që duhet të bëjë nxënësi dhe ka një numër të konsiderueshëm të RNL me fole pasive: të njohë, të kuptojë (në klasat 1-4). Këto dallime pritet të reflektohen në punën e mësueseve, meqë këto dy lëndë mësimore kryesisht i mbajnë mësuesit klasorë që i japin edhe lëndët e tjera të përgjithshme.

Ka raste kur numri i RNL të vendosura në kurrikula lëndore është i barabartë me numrin e rezultateve të fushës kurrikulare përkatëse, që janë vendosur në kurrikulën e klasës së njëjtë, siç është rasti i kurrikulës lëndore Shkathtësitë për jetë – klasa e 5-të. Ose ka raste kur numri i RNL në klasën e pestë është për 50% më i vogël se në klasën e parë, siç është rasti në lëndën mësimore Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

Përveç dallimit në numër të rezultateve, pavarësisht faktit se disa kurrikula lëndore kanë kohë mësimore të njëjtë, në disa RNL ka dallime edhe në numrin e kërkesave dhe thellësinë e tyre brenda një rezultati të nxënit, në raport me moshën e nxënësve, etj. *P.sh. në një RNL, në lëndën Njeriu dhe natyra, klasa e parë, nxënësve u kërkohet të përshkruajnë vetitë fizike të materialeve të jetës së përditshme, përfshirë: fleksibilitetin, transparencën, fortësinë dhe vetitë magnetike.*

Ose në raste të caktuara, kërkesat e RNL⁶ janë më të larta se rezultati i të nxënit të fushës kurrikulare, apo që shkojnë përtej kërkesave të rezultateve të fushës (RNF), siç paraqitet në shembullin në vijim, në kurrikulën lëndore Njeriu dhe natyra, klasa 4.

Koncepti i fushës kurrikulare (shkalla 2): MATERIA, VETITË DHE SHNDËRRIMET

Rezultati i të nxënit të fushës: Identifikon dhe hulumton materialet natyrore dhe artificiale që përdoren në jetën e përditshme sipas vetive dhe shndërimeve të tyre. (*duhet të arrihet deri në fund të kl. 5*)

Temat mësimore Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL) – kl. 4

Materialet, prejardhja, përbërja dhe vetitë e tyre

Lëndët e pastra, lëndët e përziera dhe tretësirat

Ajri dhe përbërësit e tij

- Dallon materialet në bazë të prejardhjes natyrë e gjallë dhe ajo jo e gjallë (materialet metalike, minerare, organike dhe kompozite);
- Krahason materialet e ndryshme sipas dendësisë, përcjellshmërisë termike e elektrike, sipas fortësisë dhe i ndërlidh ato me përdorimin e tyre;
- Klasifikon materialet në bazë të përbërjes në: lëndë të pastra dhe lëndë të përziera;
- Dallon përzierjet dhe tretësirat;
- Demonstron ndarjen e përzierjeve me metodën e filtrimit dhe dekantimit;
- Krahason tretjen e substancave të ndryshme në ujë dhe varshmërinë e tretshmërisë nga temperatura;
- Shpjegon se gjendja agregate e materialit varet nga kushtet e jashtme sidomos nga temperatura;
- Dallon përbërësit kryesor të ajrit (azoti, oksigjeni, dioksidi i karbonit), si dhe demonstron me anë të eksperimentit ndonjëherë nga to;
- Interpretin rëndësinë e oksigjenit për frymëmarrjen si dhe rëndësinë e mbrojtjes së ajrit prej papastërtive.

⁶ Më gjerësisht shih Kurrikulat lëndore/ programet mësimore për klasat 4 dhe 5, MASHTI (2020, 2021).

Koncepti i fushës kurrikulare (shkalla 2): Bashkëveprimi elektrik dhe magnetik

Rezultati i të nxënit të fushës: 1.5 Përshkruan bashkëveprimin e trupave, të lëndëve dhe të qenieve të gjalla. (duhet të arrihet deri në fund të kl. 5)

Temat mësimore Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL) – kl. 4

Bashkëveprimi elektrik dhe magnetik

- Ndërton elektroskopin e thjeshtë dhe me të dallon trupat që ngarkohen dhe nuk ngarkohen me elektricitet;
- Shpjegon elektricitetin atmosferik dhe mbrojtjen prej tij;
- Demonstron me dy elektroskop përçuesit dhe veçuesit e rrymës elektrike;
- Ndërton qarkun e thjeshtë elektrik, ilustron skemën e tij dhe përshkruan rolin e çdo pjese përbërëse;
- Dallon përcjellësit dhe veçuesit elektrikë me ndihmën e qarkut elektrik;
- Demonstron mbylljen e qarkut elektrik me tretësi të ujore të kripës;
- Identifikon pajisjet e përditshme në shtëpi që punojnë me rrymë, qarkun e shkurtër dhe rrezikun nga rryma elektrike;
- Shpjegon me demonstrim veprimin magnetik të magnetit në mjedise dhe dallon lëndët që magnetizohen nga ato që nuk magnetizohen;
- Ndërton elektromagnetin e thjeshtë dhe demonstroi vetitë magnetike të tij.

Siç shihet nga tabela më sipër, disa RNL janë pritshmëri tejet të larta në raport moshën e fëmijëve 9-vjeçar, të cilët e fillojnë mësimin në klasën e katërt apo fëmijëve 10-vjeçar, të cilët fillojnë klasën e pestë. Ato (RNL) ka rrezik që të reflektohen edhe në tekstet shkollore. Zinxhiri i ngarkesës së nxënësve mund të reflektohet edhe më shumë, në rastet kur mungon

kompetenca e mësimdhënësve për t'i thjeshtësuar përmbajtjet mësimore, për të praktikuar veprimtari mësimore interaktive dhe për t'i ndërlidhur mësimet me situata nga jeta e përditshme.

Ka një diskutim të ngritur për studim të mëtejshëm lidhur me thellësinë dhe koherencën e rezultateve të të nxënësve për lëndë, në raport me zhvillimin vertikal dhe horizontal të tyre, siç është për shembull një nga rezultatet e lëndës së matematikës në klasën e parë, ku specifikohet se nxënësi deri në fund të klasës së parë *lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20*. Kufizimi i çështjes së leximit të numrave vetëm deri në 20 nuk duket se e shkon për shtati moshës së nxënësve, sepse i kufizon të lexojnë numrat vetëm deri në 20, ashtu siç është e vështirë të arrihet rezultati tjetër i matematikës në këtë klasë, ku specifikohet se nxënësi deri në fund të klasës së parë *zgjdh ekuacione dhe inekuacione lineare me një të panjohur (duke përdorur vetitë aditivë dhe multiplikativë)*.

Një tjetër aspekt, që konsiderohet se mund të jetë mbingarkesë kurrikulare, është mënyra e trajtimit dhe e vendosjes së çështjeve ndërkurrikulare në kuadër të secilës kurrikulë lëndore në arsimin fillor. Në kurrikulat lëndore aktuale orientimet dhe udhëzimet për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare janë trajtuar pas udhëzimeve metodologjike. Orientimet dhe udhëzimet për çështjet ndërkurrikulare janë dhënë në forma të ndryshme në kurrikulat lëndore, në formë të përshkrimeve të përgjithshme, vetëm me vendosjen e emetimeve të çështjeve ndërkurrikulare në kurrikulën lëndore përkatëse, pa ndonjë përshkrim të veçantë, si dhe me vendosje të çështjeve ndërkurrikulare dhe më përshkrime të aspekteve të mbulimit të tyre në kuadër të kurrikulës lëndore përkatëse. Tabela në vijim pasqyron dallimet në mënyrën e trajtimit dhe të vendosjes së çështjeve ndërkurrikulare në kuadër të secilës kurrikulë lëndore në arsimin fillor.

Tabela 9. Dallimet në paraqitjen e çështjeve ndërkurrikulare në kurrikulat lëndore të arsimit fillor.

Lëndët mësimore	Çështjet ndërkurrikulare ⁷		
	Klasat		
	1	3	5
1. Gjuhë amtare/ Gjuhë shqipe	A	A	A
2. Gjuhë angleze	A	A	A
3. Edukatë figurative	C/6	C/6	B/5
4. Edukatë muzikore	C/2	C/2	C/2
5. Matematikë	A	A	A
6. Njeriu dhe natyra	B/2	B/5	C/2
7. Shoqëria dhe mjedisi	B/5	B/5	B/5
8. Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	B/4	A	A
9. Shkathtësi për jetë	B/5	B/4	B/5
10. Pjesa zgjedhore	Përcaktohen nga shkolla, përkatësisht mësimdhënësit që e mbajnë kurrikulën me zgjedhje		

Burimi/MAShT (2018, 2019, 2021): Kurrikulat lëndore/ programet mësimore për klasat 1, 3 dhe 5.

Si të tilla, në formën se si janë vendosur dhe trajtuar çështjet kurrikulare në kurrikulat këndore, ato nuk orientojnë mjaftueshëm mësimdhënësit dhe shkollat në planifikimin dhe realizimin e proceseve edukativo-arsimore për të mundur zhvillimin e kompetencave dhe në këtë mënyrë konsiderohen si një element i mbingarkesës kurrikulare, si në zhvillimin e kurrikulave lëndore ashtu edhe në planifikimin e zbatimit të kurrikulës nga ana e mësimdhënësve.

⁷ A – tregon se forma e përshkrimit është e përgjithshme; B – tregon vetëm numrin e çështjeve ndërkurrikulare të vendosura në kurrikulën lëndore përkatëse, të cilat nuk janë të përshkruara; C- tregon numrin e çështjeve ndërkurrikulare, të cilat janë përshkruar në kuadër të kurrikulës lëndore përkatëse; dhe D – tregon se kurrikula lëndore përkatëse nuk ka të dhëna asnjë të dhënë për çështjet ndërkurrikulare.

4.1.5. Disa gjetje specifike nga analiza e kurrikulave lëndore/ programeve mësimore në arsimin e mesëm të ulët

Ashtu si për kurrikulat e arsimit fillor, edhe për shumicën e kurrikulave lëndore të arsimit të mesëm të ulët vlejné gjetjet e përgjithshme të raportuara për kurrikulat lëndore në pjesën më sipër. Disa gjetje specifike, që raportohen në pjesën në vijim, lidhen me temat mësimore dhe rezultatet e të nxënít për tema mësimore (RNL), që janë përcaktime themelore për zbatimin e kurrikulës dhe që referuar literaturës konsiderohen aspektet kryesore të mbingarkesës kurrikulare.

Kurrikulat lëndore në arsimin e mesëm të ulët përmbajnë numër të faqeve, me dallime të vogla nga klasa në klasë, 175 faqe në klasën e gjashtë, deri në 229 faqe në klasën e nëntë. Pra, gjithsej rreth 800 faqe për kurrikulat lëndore në klasat 6-9. Kurrikulat lëndore për secilën klasë përmbajnë informacione të përgjithshme dhe specifike për secilën lëndë kurrikulare. Rezultatet e të nxënít në kurrikulat lëndore zënë hapësirën kryesore edhe në kurrikulat lëndore në këto klasë.

Ashtu si në kurrikulat lëndore të arsimit fillor, edhe në kurrikulat lëndore në arsimin e mesëm të ulët mënyra e vendosjes së qëllimeve të lëndës së njëjtë që mësohet në klasa të ndryshme, në disa lëndë mësimore shihet si një element i mbingarkesës së mundshme për kurrikulat lëndore, në raport me klasën në të cilën mësohet lënda mësimore përkatëse dhe veçoritë specifike të klasës dhe të shkallës kurrikulare. Kjo për shkak të përsëritjes së qëllimeve të njëjta të kurrikulës lëndore nga klasa në klasë, pa specifikuar se çfarë duhet të fitojné nxënësit nga kurrikula lëndore në klasën përkatëse.

Në raport me temat mësimore, njëjtë, sikur në kurrikulat lëndore të arsimit fillor, temat mësimore në kurrikulat lëndore të arsimit të mesëm të ulët nuk janë të përshkruara, siç janë përshkruar konceptet e fushës në kurrikulën bërthamë të këtij niveli të arsimit (KB/2). Në këtë drejtim, dallon vetëm lënda Edukatë qytetare, pasi në kuadër të udhëzimeve metodologjike janë përshkruar veprimtaritë me nxënës me specifika për temat mësimore, në klasat 8 dhe 9, dhe përmes përshkrimit të veprimtarive me nxënës, në masë të madhe, janë përcaktuar aspektet e mbulimit të temave mësimore, të cilat

janë zbërthyer edhe me RNL. Në lëndët e tjera, mbulimi, thellësia dhe gjerësia e trajtimit të temave mësimore të një lëndë mësimore, në kuadër të një klase, kryesisht përcaktohen me rezultatet e të nxënit.

Rezultatet e të nxënit për tema mësimore (RNL) janë organizuar në kurrikulat lëndore në një format afërsisht të njëjtë të të gjitha lëndët mësimore, me dallime në gjuhën angleze dhe gjuhën e dytë të huaj (gjuhë gjermane/gjuhë frënge). RNL në shumicën dërmuese të rasteve nuk kanë indeks të renditjes së numrave, i cili nga ana praktike edhe për këtë nivel të arsimit konsiderohet se do të lehtësonte punën e mësimeve gjatë planifikimit për zbatimin e kurrikulës, por do të ishte lehtësim edhe për zhvillues të teksteve shkollore dhe përdorues të tjerë të kurrikulave lëndore në arsimin e mesëm të ulët.

Numri i temave dhe rezultateve të të nxënit në kurrikulat lëndore të arsimit të mesëm të ulët është i ndryshëm, për shkak të specifikave të lëndëve mësimore në këtë nivel të arsimit. Mirëpo, ka dallime të theksuara në kurrikulat lëndore që kanë kohë të njëjtë mësimore të përcaktuar me planin mësimor zyrtar. Tabela në vijim pasqyron disa të dhëna krahasuese për lëndët mësimore në klasat 6, 8 dhe 9, në raport me numrin e orëve mësimore për një javë mësimi dhe numrin e temave mësimore e RNL përgjatë gjithë vitit shkollor.

Tabela 10: Numri i orëve për javë mësimi, numri i temave vjetore dhe numri i RNL-ve vjetore në kurrikulat lëndore/programet mësimore – klasat 6, 8 dhe 9

Lëndët mësimore	Numri i orëve për javë mësimi			Numri i temave vjetore			Numri i RNL – vjetore		
	Klasat			Klasat			Klasat		
	6	8	9	6	8	9	6	8	9
1. Gjuhë amtare	5	5	4	31	34	30	48	45	58
2. Gjuhë angleze ⁸	2	2	2	32	32	32	190	270	174
3. Gjuhë e dytë e huaj	1	1	1	3	16	16	24	37	41
4. Art figurativ	1	1	1	3	7	12	42	43	79
5. Art muzikor	1	1	1	18	13	14	23	27	32
6. Matematikë	4	4	4	18	23	11	110	65	63
7. Fizikë	2	2	2	14	10	9	70	71	66
8. Biologji	2	2	2	8	8	6	42	62	67
9. Kimi	/	2	2	/	7	4	/	80	61
10. Histori	2	2	2	10	17	16	40	50	60
11. Gjeografi	2	2	1	4	15	10	52	114	85
12. Edukatë qytetare	1	1	2	10	6	9	32	31	66
13. Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	2	2	2	8	7	8	31	16	17
14. Teknologji me TIK	2	2	2	10	8	8	58	68	60
15. Pjesa zgjedhore	2	1	2	Përcaktohen nga shkolla, përkatësisht mësimdhënësit që e mbajnë kurrikulën me zgjedhje					
Totali	29	30	30	169	203	185	762	979	929

Burimi/MAShT (2018, 2019, 2020): Kurrikulat lëndore/ programet mësimore për klasat 6, 8 dhe 9.

⁸ Rezultatet e të nxënit për lëndën Gjuhë angleze pasqyrohen specifike, më shumë rezultate të të nxënit për njësi mësimore, të cilat në lëndët e tjera mësimore përcaktohen nga mësimdhënësit gjatë planifikimit mësimor.

Nga tabela më sipër, shihet se, në raport me rezultatet e të nxënësve, ka dallime të theksuara në kurrikulat lëndore që kanë kohë të njëjtë mësimore dhe kohë të ndryshme të mësimin, të përcaktuar me planin mësimor zyrtar. Një krahasim i dallimeve nga tabela më sipër është bërë për disa lëndë mësimore, me kohë të njëjtë mësimore, 2 orë mësimi në javë në klasën 8. Dallimet në numrin e rezultateve të këtyre lëndëve mësimore pasqyrohen në figurën në vijim.




Figura 1. Numri i RNL për lëndët mësimore me 2 orë mësimore në javë (klasa 8)

Nga figura shihet se ka dallime të theksuara në numrin e rezultateve të të nxënësve në lëndët mësimore me kohë mësimore të njëjtë (2 orë në javë⁹). Kemi raste me 16 rezultate të të nxënësve për gjithë vitin shkollor (Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti) dhe me 114 rezultate të të nxënësve (Gjeografi). Në rastin e parë, numri i vogël i rezultateve mund të jetë reflektuar ngarkesë për punën e mësimdhënësve për përcaktimin e njësive mësimore bazuar në RNL. Ndërsa, në rastin e dytë mbulimi i të gjitha RNL-ve me njësi mësimore mund

⁹ Edhe gjuha angleze i ka 2 orë mësimi në javë, mirëpo nuk është përfshirë në këtë krahasim, pasi që dallimet në këtë lëndë mësimore janë të theksuara në të gjitha klasat, si në arsimin fillor ashtu edhe në atë të mesëm.

të jetë reflektuar ngarkesë për punën e mësimdhënësve, duke marrë për bazë numrin vjetor të orëve (72 orë vjetore) dhe numrin e 114 RNL-ve.

Dallime të theksuara ka edhe në raport me numrin e rezultateve të të nxënit në dy lëndë të fushës së njëjtë kurrikulare, fushës Shoqëria dhe mjedisi, për kohë mësimore të njëjtë: Histori 2 orë mësimi në javë = 50 rezultate të të nxënit për gjithë vitin; Gjeografi 2 orë mësimi në javë = 114 rezultate të të nxënit për gjithë vitin. Në anën tjetër, numri i temave mësimore për këto dy lëndë është i përafërt.

Përveç numrit në rezultatet e të nxënit, në raport me numrin javor të orëve mësimore, edhe në raport me formulimin e rezultateve të të nxënit për tema mësimore të lëndës ka dallime në strukturë, organizim, përdorim të foljes aktive, përdorim të shumësit apo njëjësit në rezultate etj. Elementi i mbingarkesës reflektohet në kërkesat dhe pritshmëritë për nxënës në disa RNL, të lëndëve të ndryshme.

Përshkrimi i rezultateve të të nxënit për tema mësimore (RNL) dallon edhe brenda një fushe kurrikulare, në lëndë të ndryshme, për shembull në lëndën Biologji, klasa e 6-të, kështu duket një RNL:

Bën dallimin mes termave organizëm, popullatë dhe bashkësi jetësore. Organizmi është qenie e gjallë. Popullata definohet si grup i bimëve ose shtazëve të llojit të njëjtë që jetojnë dhe riprodhohen në një vend dhe kohë të caktuar. Bashkësia jetësore përbëhet nga shumë popullata të cilat jetojnë në një vend të veçantë. (Biologji, klasa e 6-të).

RNL më sipër, shkon përtej kërkesave për të hartuar një RNL, i cili duhet të ketë qëllimin ose objektin, veprimin ose foljen aktive, kriterin dhe kushtin. Rezultati ka edhe shpjegime për përmbajtjen e rezultatit. Në anën tjetër, në lëndën e Fizikës, klasa e 6-të, nga e njëjta fushë kurrikulare, kemi rezultate të koncentruara më shumë vetëm në kërkesat e RNL, si p.sh.:

Tregon shembuj të proceseve ciklike të lëndës dhe trupave në natyrë (Fizikë, Kimi, Biologji dhe Gjeografi) dhe të riciklimit nga njeriu. (Fizikë, klasa e 6-të).

Kjo qasje në mbarështrimin e RNL-ve nuk reflekton qasjen e integruar në zhvillimin e kurrikulave, gjë që nuk pritet të reflektohet qasja e integruar as në zhvillimin e teksteve shkollore.

Edhe në fushën kurrikulare Shoqëria dhe mjedisi, reflektohen dallime të theksuara në shtrirjen dhe thellësinë e RNL-ve, në disa raste me kërkesa të përmbajtjes së përafërt, që shihen si mbingarkesë e panevojshme për nxënës, por edhe për mësimdhënës. Si për shembull:

- *Shpjegon marrëdhënien ndërmjet njeriut dhe mjedisit, si: pasojat e ndryshimeve klimatike në mjedis dhe në shëndet, të rreziqeve natyrore dhe atyre të krijuara nga njeriu dhe mënyra të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore (Gjeografi, klasa e 6-të).*
- *Përshkruan shkaqet dhe format kryesore të ndotjes së mjedisit dhe shpjegon pasojat e shumëfishta të ndotjes, si për njerëzit ashtu edhe për gjallesat e tjera (Edukatë Qytetare, klasa e 6-të).*

Ashtu si për RNL-të dhe temat mësimore në arsimin fillor, edhe për RNL-të dhe temat mësimore në lëndë të ndryshme të arsimit të mesëm të ulët, ka një diskutim të ngritur për studim të mëtejshëm lidhur me thellësinë, shtrirjen dhe koherencën e temave mësimore dhe rezultateve të të nxënës për lëndë.

Një tjetër aspekt, që konsiderohet se mund të jetë mbingarkesë kurrikulare, është mënyra e trajtimit dhe e vendosjes së çështjeve ndërkurrikulare në kuadër të secilës kurrikulë lëndore në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9).

Orientimet dhe udhëzimet në kurrikulat lëndore, për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare, janë trajtuar pas udhëzimeve metodologjike. Ato janë dhënë në forma të ndryshme:

- në formë të përshkrimeve të përgjithshme;
- vetëm me vendosjen e emërtimeve të çështjeve ndërkurrikulare në kurrikulën lëndore përkatëse, pa ndonjë përshkrim të veçantë;
- me vendosje të çështjeve ndërkurrikulare dhe me përshkrime të aspekteve të mbulimit të tyre në kuadër të kurrikulës lëndore përkatëse.

Tabela 11. Dallimet në paraqitjen e çështjeve ndërkurrikulare në kurrikulat lëndore të arsimit të mesëm të ulët.

Lëndët mësimore	Çështjet ndërkurrikulare ¹⁰		
	Klasat		
	6	8	9
1. Gjuhë amtare	A	A	A
2. Gjuhë angleze	A	A	A
3. Gjuhë e dytë e huaj	A	A	A
4. Edukatë figurative	B/5	B/5	B/5
5. Edukatë muzikore	C/4	C/4	C/4
6. Matematikë	A	A	A
7. Fizikë	C/2	C/2	C/2
8. Biologji	C/3	C/2	C/2
9. Kimi	/	C/2	A
10. Histori	B/5	C/2	B/5
11. Gjeografi	B/5	C/2	C/5
12. Edukatë qytetare	C/5	B/5	C/5
13. Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	C/4	C/6	C/5
14. Teknologji me TIK	B/5	B/9	B/8
15. Pjesa zgjedhore	Përcaktohen nga shkolla, përkatësisht mësimdhënësit që e mbajnë kurrikulën me zgjedhje		

Burimi/MAShT (2018, 2019, 2020): Kurrikulat lëndore/ programet mësimore për klasat 6, 8 dhe 9.

¹⁰ A – tregon se forma e përshkrimit është e përgjithshme; B – tregon vetëm numrin e çështjeve ndërkurrikulare të vendosura në kurrikulën lëndore përkatëse, të cilat nuk janë të përshkruara; C- tregon numrin e çështjeve ndërkurrikulare, të cilat janë përshkruar në kuadër të kurrikulës lëndore përkatëse; dhe D – tregon se kurrikula lëndore përkatëse nuk ka të dhëna asnjë të dhënë për çështjet ndërkurrikulare.

Tabela më sipër, pasqyron dallimet në mënyrën e trajtimit dhe e të vendosjes së çështjeve ndërkurrikulare në kuadër të secilës kurrikulë lëndore në arsimin e mesëm të ulët. Në formën se si janë vendosur dhe trajtuar çështjet kurrikulare në kurrikulat këndore, ato nuk i orientojnë mjaftueshëm mësimdhënësit dhe shkollat në planifikimin dhe realizimin e proceseve edukativo-arsimore për të mundësuar zhvillimin e kompetencave dhe, në këtë mënyrë, konsiderohen si një element i mbingarkesës kurrikulare, si në zhvillimin e kurrikulave lëndore ashtu edhe në planifikimin e zbatimit të kurrikulës nga ana e mësimdhënësve.

4.2. Gjetjet nga analiza e disa faktorëve të ndërlidhur me kurrikulën dhe krahasimi i tyre me disa shtete të rajonit dhe OECD-së

Analiza e disa aspekteve kurrikulare, në disa shtete të rajonit dhe OECD-së, është fokusuar në gjashtë aspekte: (i) Koha e mësimin të detyrueshëm në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët; (ii) Shpërndarja e kohës së mësimin për fushat kurrikulare/lëndë mësimore; (iii) Kohëzgjatja e vitit shkollor dhe e pushimeve brenda një viti shkollor; (iv) Koha e mësimin dhe arritjet e nxënësve në vlerësime ndërkombëtare dhe kombëtare; (v) Mesatarja e nxënësve në klasë dhe raporti mësimdhënës – nxënës; dhe (vi) Koha e punës së mësimdhënësve.

4.2.1. Koha e mësimin të detyrueshëm në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët

Koha e mësimin të detyrueshëm u referohet sasisë dhe shpërndarjes së orëve të mësimin të detyrueshëm, planit të mësimin, i cili mbulon secilën klasë dhe fushë kurrikulare/ lëndë mësimore që duhet të sigurohet nga çdo shkollë publike dhe duhet të ndiqet apo të frekuentohet në mjediset formale të klasës, nga të gjithë nxënësit e shkollave publike. Zakonisht kjo bëhet sipas kalendarit të vitit për shkollat publike në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, i cili përcaktohet nga sistemet arsimore të vendeve përkatëse.

Koha e mësimi të detyrueshëm në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është e lidhur me vitet e shkollimit në nivelin përkatës të arsimit dhe me ditët e mësimi në këto dy nivele të arsimit. Sipas raportit të OECD-së për vështrim të arsimit në bazë të treguesve arsimorë (OECD, 2021), arsimi fillor zgjat mesatarisht gjashtë vjet në vendet dhe ekonomitë e OECD-së, duke filluar nga katër (4) deri në shtatë (7) vjet. Kurse arsimi i mesëm i ulët zgjat mesatarisht tre (3) vjet në vendet OECD-së, duke filluar nga dy (2) deri në pesë (5) vjet. Në disa vende të OECD-së, të paktën një vit i arsimit të mesëm të lartë është pjesë e arsimit të përgjithshëm të detyrueshëm me kohë të plotë. Në vendet me arritje të larta në PISA, si Estonia dhe Finlanda, nxënësit në klasën e parë regjistrohen në moshën 7-vjeçare, arsimi fillor zgjat gjashtë vjet, ndërsa arsimi i mesëm i ulët zgjat tre vjet.

Përkundrejt mesatares së OECD-së për vitet e shkollimit në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, arsimi fillor në Kosovë përfshin pesë vjet, duke përfshirë klasat 1- 5, ndërsa arsimi i mesëm i ulët përfshin katër vjet, klasat 6-9. Klasa përgatitore/parashkollore në Kosovë akoma me legjislacion nuk është e obligueshme, me draftligjin për edukimin parashkollor kjo klasë pritet të bëhet e obligueshme në vitin shkollor 2023/2024.

Në anën tjetër, përtej viteve të shkollimit, dallime të theksuara ka edhe në numrin e orëve të mësimi, të detyrueshme, si në arsimin fillor, ashtu edhe në arsimin e mesëm të ulët. Sipas raportit të OECD-së për vështrim të arsimit në bazë të treguesve arsimorë (OECD, 2021), nxënësit nga vendet OECD-së mesatarisht kanë 7639 orë mësimi të detyrueshëm për gjatë arsimit fillor (4590 orë mësimi) dhe arsimit të mesëm të ulët (3049 orë mësimi). Polonia ka minimumin e orëve të mësimi 5334 orë, ndërsa Australia ka dyfishin e saj, 11060 orë mësimi (OECD, 2021).

Në raport me numrin e orëve mësimore vjetore, nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë, nga klasa 1-9, sipas planit mësimor në fuqi, i kanë të garantuara gjithsej 8524 orë mësimi, prej tyre në arsimin fillor (klasat 1-5) janë 4181 orë mësimi, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9) janë gjithsej 4343 orë mësimi.

Tabela 12. Vitet e shkollimit dhe orët e mësimit në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në disa vende të rajonit dhe të OECD-së

Nr.	Shtetet ¹¹	Arsimi fillor		Arsimi i mesëm i ulët		Totali i orëve mësimore në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët
		Vitet e shkollimit	Orët e mësimit	Vitet e shkollimit	Orët e mësimit	
1	Estonia	6	3964	3	2468	6432
2	Slllovenia	6	4091	3	2298	6389
3	Suedia	6	4283	3	2607	6890
4	Austria	4	2820	4	3600	6420
5	Finlanda	6	3962	3	2423	6385
6	Gjermania	4	2990	5	4502	7492
7	OECD	6	4590	3	3049	7639
8	Kosova	5	4181	4	4343	8524
9	Shqipëria	5	4025	4	4130	8155
10	Maqedonia e Veriut ¹²	6	5400	3	3348	8748

Dallimet e theksuara ndërmjet orëve mësimore në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët vijnë nga fakti se disa shtete arsimin fillor e kanë 4 vjet, disa 5 vjet (si p.sh. Kosova dhe Shqipëria) dhe disa 6 vjet (si p.sh. Finlanda, Estonia Suedia, Maqedonia), kundrejt arsimit të mesëm të ulët, të cilin disa shtete e kanë 3 vjet (si p.sh. Finlanda, Estonia Suedia).

Në anën tjetër, sipas të dhënave nga tabela më sipër, nxënësit e arsimit fillor në Kosovë mesatarisht kanë 836 orë mësimi në një klasë brenda një viti shkollor, ndërsa nxënësit e një klase të arsimit të mesëm të ulët mesatarisht kanë 1086 orë mësimi për një vit shkollor. Në vendet e OECD-së, koha e

¹¹ Burimi i të dhënave për shtetet evropiane mbështet në raportin e OECD (2021) Education at a Glance 2021: OECD Indicators, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/b35a14e5-en>

¹² Arsimi fillor në Maqedoninë e Veriut është i ndarë në tri cikle 3-vjeçare, brenda të cilit janë 9 vjet shkollim të obligueshëm.

mësimit të detyrueshëm për nxënësit e shkollës fillore është mesatarisht 807 orë në vit për një klasë, ndërsa nxënësit e mesëm të ulët për një klasë marrin mesatarisht 923 orë mësimi të detyrueshëm për një vit shkollor.




Figura 2. Mesatarja e orëve të mësimit për klasë, në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët, në disa vende të rajonit dhe të OECD-së

Përveç dallimeve në numrin e orëve mësimore, raporti i OECD-së (2021) tregon edhe për dallime në kohëzgjatjen e orës mësimore, nga 30-40 minuta, 45-50 minuta, 55-60 minuta etj., me një mesatare prej 45-50 minutash të orëve të mësimit. Në disa shtete, si Suedia, Finlanda, Italia, ora e mësimit në arsimin e mesëm të ulët zgjat 60 minuta. Në Estoni ora e mësimit zgjat 45 minuta. Në Kosovë kohëzgjatja e orës së mësimit është e njëjtë, si në arsimin fillor ashtu edhe në arsimin e mesëm të ulët, 45 minuta¹³.

¹³ Për rastin e Kosovës nuk kemi arritur të sigurojmë ndonjë dokument ligjor, i cili e përcakton kohëzgjatjen e orës së mësimit në arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë. Praktika e shkollave në Kosovë tregon se ora e mësimit planifikohet për 45 minuta, por shpesh ajo në sezonin dimëror zvogëlohet nga 45 minuta në 35-40 minuta, për shkak se shkollat, kryesisht ato urbane, punojnë në dy ndërrime.

Në raport me kohëzgjatjen e njëjtë të orës mësimore në Estoni, arsimi bazë në Kosovë ka mbi 2000 orë mësimore të obligueshme, më shumë se Estonia. Mirëpo, në Estoni përveç kohës mësimore të detyrueshme, ofrohen edhe orë mësimore jo të detyrueshme dhe forma të tjera të mbështetjes për nxënës, në funksion të arritjes së rezultateve mësimore.

Në anën tjetër, në raport me arsimin në Suedi, ku ora e mësimit zgjat 60 minuta, në arsimin bazë në Kosovë mbahen rreth 500 orë mësimi më pak, ose rreth 56 orë mësimi më pak për një klasë brenda një viti shkollor. Edhe në Suedi, ofrohen forma të ndryshme të mbështetjes për nxënës, në funksion të arritjes së rezultateve mësimore dhe zhvillimit të potencialeve të nxënësve.

Pra, sikur në Kosovë të ishte kohëzgjatja e një orë mësimore 60 minuta, për arsimin fillor, do të ishte një mesatare e ngarkesës vjetore e nxënësve kosovarë për klasë në gjithsej 627 orë mësimi, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët do të ishte një mesatare për klasë rreth 815 orë mësimi.

4.2.2. Shpërndarja e kohës së mësimit për fusha kurrikulare/lëndë mësimore

Sa i përket shpërndarjes së kohës së mësimit për lëndë mësimore dhe për klasa në kuadër të një niveli të arsimit, në Kosovë rregullohet me dokumente kurrikulare. Në dokumentin Korniza Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar (MASHTI, 2016), shpërndarja e kohës së mësimit është bërë në përqindje, për fusha kurrikulare për çdo shkallë kurrikulare.

Qasje e njëjtë ndiqet edhe në Kurrikulat Bërthamë (MASHTI, 2016) për nivele të arsimit, por krahas saj pasqyrohet edhe tabela specifike e planit të mësimit për lëndët mësimore për secilën klasë. Kjo qasje e fundit reflektohet në të gjitha kurrikulat lëndore/ programet mësimore për secilën klasë.

Praktikë afërsisht të njëjtë ndjekin edhe shumë vende të OECD-së. Sipas raportit të OECD-së (2021), në rreth një të katërtën e vendeve me të dhëna të disponueshme apo të raportuara, shpërndarja e kohës së mësimit nëpër klasa është fleksibile, d.m.th. koha e mësimit për një lëndë të caktuar përcaktohet për një numër të caktuar të klasave apo edhe për gjithë arsimin

e detyrueshëm, pa specifikuar kohën që do t'i ndahet çdo klase, gjë e cila pastaj bëhet nga autoritetet lokale apo nga shkollat. Figura në vijim pasqyron shpërndarjen e kohës së mësimimit në arsimin për fushat kurrikulare/lëndë mësimore në arsimin fillor.




Figura 3. Shpërndarja e kohës së mësimimit për fushat kurrikulare/lëndë mësimore në arsimin fillor në disa vende të rajonit dhe të OECD-së

Të dhënat nga figura më sipër tregojnë se në kurrikulat e arsimit fillor në Kosovë, në fushat kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi (Gjuhë amtare - lexim, shkrim dhe letërsi dhe Gjuhë të huaj) dhe në Matematikë, është përcaktuar rreth 57.5% e kohës së mësimimit kundrejt mësimimit të lëndëve tjera. Ndërsa, mesatarja e kohës mësimore në vendet e OECD-së në këto fusha kurrikulare është rreth 42%.

Sa i përket kurrikulës me zgjedhje, në arsimin fillor në Kosovë, ajo përfshin mbi 6% të kohës së mësimit të detyrueshëm, kurse në vendet e OECD-së koha e mësimit për kurrikulën me zgjedhje në arsimin fillor përfshin rreth 5% të kohës së mësimit të detyrueshëm në këtë nivel të arsimit.

Edhe krahasimi i kohës mësimore për fusha kurrikulare në arsimin e mesëm të ulët nxjerr dallime të kohës mësimore në këtë nivel të arsimit në Kosovë me shtetet evropiane dhe mesatares së OECD-së. Këto dallime pasqyrohen në figurën në vijim.




Figura 4. Shpërndarja e kohës së mësimit për fushat kurrikulare/lëndët mësimore, në arsimin e mesëm të ulët, në disa vende të rajonit dhe të OECD-së

Të dhënat nga figura 4, për shpërndarjen e kohës mësimore në fushat kurrikulare të arsimit të mesëm të ulët, tregojnë se në Kosovë, në këtë nivel të arsimit, në fushat kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi (Gjuhë amtare - lexim, shkrim dhe letërsi dhe Gjuhë angleze, Gjuhë e dytë e huaj dhe Gjuhët e komuniteti) dhe në Matematikë, është përcaktuar rreth 39.5 % e kohës së mësimit kundrejt mësimit të lëndëve të tjera. Ndërsa, mesatarja e kohës

mësimore në arsimin e mesëm të ulët në vendet e OECD-së, në këto fusha kurrikulare, është rreth 27%.

Sa i përket kurrikulës me zgjedhje, në arsimin e mesëm të ulët në Kosovë, ajo përfshin rreth 5% të kohës së mësimin të detyrueshëm. Ndërsa, në vendet e OECD-së koha e mësimin për kurrikulën me zgjedhje në arsimin fillor përfshin mbi 8% të kohës së mësimin të detyrueshëm në këtë nivel të arsimit.

Të dhënat e krahasuara ndërmjet shteteve, sistemeve të ndryshme arsimore, mund të dallojnë edhe në praktikat e shkollave, brenda vetë sistemeve arsimore, për shkak të politikave të ndryshme kurrikulare dhe autonomisë së autoriteteve lokale dhe shkollave. Megjithatë, të dhënat e sistemeve arsimore të krahasuara ofrojnë një tregues të përafërt se sa kohë formale mësimore konsiderohet e nevojshme për nxënësit për të arritur rezultatet e të nxënimit dhe qëllimet arsimore.

Kjo në kontekstin e Kosovës, nuk reflektohet kur krahasohet raporti i kohës mësimore për klasë me numrin e temave mësimore dhe rezultateve të të nxënimit për lëndë, në kuadër të çdo klase.

Në anën tjetër, fleksibiliteti në shpërndarjen e orëve mësimore për klasë dhe lëndë mësimore mund të lejojë ndërhyrje më të shpejta për të minimizuar ndikimin e ndërprerjeve në mësim, siç ishte periudha e pandemisë Covid 19, ndërprerjet e mësimin për shkak të faktorëve të tjerë që lidhen me kontekstet e sistemeve arsimore, siç mund të jenë kushtet klimatike në periudhën e dimrit apo të verës, për shkak të temperaturave të ulëta - të larta, por edhe për shkak të faktorëve të tjerë, subjektivë dhe objektivë.

Për kohën e mësimin jo të detyrueshme, në kurrikulat e arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë, ka fare pak udhëzime dhe orientime. Vetëm me një përshkrim shkollat orientohen për planifikimin e kohës mësimore për realizimin e aktiviteteve jashtëkurrikulare apo aktiviteteve ekstrakurrikulare.

Për sistemin arsimor në Kosovë nuk ka një evidencë të raportuar për numrin e shkollave që planifikojnë kohë mësimore jo të detyrueshme dhe e ofrojnë atë për nxënësit në baza të rregullta javore. Shkollat që punojnë në dy apo tri

ndërrime, në zonat urbane, këtë pothuajse e kanë të pamundur. Mirëpo, kjo mund të ofrohet në mënyrë të veçantë nga shkollat që punojnë në një ndërrim dhe nga shkollat që kanë numër të vogël të nxënësve në klasa.

Në anën tjetër, referuar raportit të OECD-së (2021), në dy të pestat e vendeve dhe ekonomive të zhvilluara koha e mësimi jo e detyrueshme sigurohet pothuajse nga çdo shkollë publike, por që nuk është e detyrueshme për të gjithë nxënësit. Nxënësit e këtyre vendeve gëzojnë një shumëllojshmëri të gjerë kursesh në kurrikulën jo të detyrueshme, të cilat mund të ndiqen fizikisht dhe në forma të tjera alternative. Në këto vende, koha e mësimi jo të detyrueshëm përfaqëson rreth 20% të mësimi të kohës së mësimi të detyrueshëm, mirëpo, sipas raportit, përqindjet e kësaj kohe të mësimi duhet të interpretohen me kujdes, pasi që ka dallime të shumta ndërmjet sistemeve arsimore.

Vendet evropiane me rezultate të larta të nxënësve në studimin PISA, si Estonia dhe Finlanda, kanë disa dallime të vogla në raport me ditët e mësimi, kohëzgjatjen e orës arsimore dhe lëndët arsimore që mësohen në arsimin e detyrueshëm. Sipas raportit të OECD-së (2021), në Estoni, viti shkollor përbëhet nga të paktën 175 ditë shkollore, një javë shkollore zakonisht zgjat 5 ditë, ndërsa mesatarja e kohëzgjatjes së një ore të mësimi është 45 minuta.

4.2.3. Kohëzgjatja e vitit shkollor dhe e pushimeve brenda një viti shkollor

Kalendari i vitit shkollor, numri i ditëve të mësimi, numri i pushimeve brenda një viti shkollor dhe kohëzgjatja e pushimeve, janë pjesë integrale e vitit shkollor dhe lidhen ngushtë me aspektet e zbatimit të kurrikulës në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët. Sipas kalendarit të vitit shkollor, në Kosovë brenda një viti shkollor në arsimin bazë planifikohen të realizohen 37 javë mësimi në klasat 1-8, ose 185 ditë mësimi, ndërsa 35 javë mësimi në klasën e 9-të, ose 175 ditë mësimi.

Po ashtu, sipas kalendarit të vitit shkollor në Kosovë, ka tri pushime për nxënës brenda një viti shkollor, me gjithsej 15 javë pushim. Dy pushime janë

të lejuara gjatë vitit shkollor, me gjithsej 3 javë, ndërsa pushimi tjetër përfshin kohën më të gjatë të pushimit ndërmjet dy viteve, me gjithsej 12 javë pushim. Nxënësit e klasës së 9-të për dy javë më herët e përfundojnë mësimin e rregullt, mirëpo kjo kohë dedikohet për qëllime të përgatitjes për regjistrim në arsimin e mesëm të lartë, në gjimnaze apo në shkolla profesionale.

Sipas raportit të OECD-së për vështrim të arsimit në bazë të treguesve arsimorë (OECD, 2021), mesatarja e ditëve të mësimin në vendet e OECD-së për arsimin fillor është 186 ditë mësimi, ndërsa për arsimin e mesëm të ulët është 184 ditë mësimi. Sipas raportit të njëjtë, sistemet arsimore kanë dallime si në ditë të mësimin ashtu edhe në javë dhe ditët e pushimeve për nxënës. Përveç javëve të pushimit në përfundim të vitit shkollor, në mes të përfundimit të një klase dhe fillimit të një klase të re, sistemet arsimore kanë disa javë të pushimit gjatë një viti mësimor.

Tabela 13. Ditët e mësimin dhe javët e pushimit gjatë një viti shkollor në disa vende të rajonit dhe të OECD-së

Nr.	Shtetet	Ditët e mësimin ¹⁴	Javët e pushimit në përfundim të vitit shkollor	Javët e pushimit gjatë vitit mësimor					Gjithsej javë pushimi
				Pushimi 1	Pushimi 2	Pushimi 3	Pushimi 4	Pushimi 5	
1	Estonia	175	11.4	1	2.6	1	1	/	17
2	Sllovenia	190/185 ¹⁵	9.4	1	1.2	1	1	/	13.6
3	Suedia	178	11	1	2.6	1	1	/	16.6
4	Austria	200	9	0.8	2	1	1.2	0.2	14.2
5	Finlanda	189	10	0.4	1	1	0.4	/	12.8
6	Gjermania	188	6.4	2	2.2	2	0.2	/	12.8
7	Kosova	185	10	2	1	/	/	/	13
8	Shqipëri	176	12.4	1	1	/	/	/	14.4
9	Maqedoni	180	11	2.5	0	/	/	/	13.5

Nga të dhënat e tabelës, shihet se arsimi bazë në Kosovë ka javë të pushimit për nxënës afërsisht sa vendet si Gjermania, Finlanda, dhe Sllovenia, mirëpo numri i pushimeve dallon shumë. Suedia dhe Estonia kanë javë pushimi më shumë në mesin e këtyre shteteve. Në Kosovë, sipas kalendarit të vitit shkollor, ka vetëm dy pushime gjatë vitit mësimor, me gjithsej 3 javë pushim dhe 10 javë pushim në përfundim të vitit shkollor.

4.2.4. Koha e mësimit dhe arritjet e nxënësve në vlerësime ndërkombëtare dhe kombëtare

Raporti i vitit 2015 i Programit të OECD-së për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (OECD, 2016) thekso se koha e shpenzuar për të mësuar gjatë një dite, si në shkollë, ashtu edhe jashtë kohës së mësimit në shkollë, gjegjësisht mësimit në shtëpi, nuk lidhet me performancën akademike të nxënësve. Figura në vijim pasqyron marrëdhënien midis rezultateve të PISA-s (2015) dhe kohës së mësimit, sipas raportit të OECD-së *Mbingarkesa e kurrikulës: Një rrugë përpara* (OECD, 2020).




Figura 5. Marrëdhënia midis rezultateve të PISA (2015) dhe kohës së mësimit (Burimi: OECD, 2020)

Siç shihet nga figura 5, shumë shtete, si Finlanda, Gjermania, Zvicra, etj. kanë kohë të mësimit në shkollë dhe në shtëpi (të raportuar nga nxënësit) më pak se shumë vende të tjera, rreth 8 orë mësim në ditë, por, në anën tjetër, kanë rezultate shumë më të larta se nxënësit e shumë vendeve të tjera, që

kanë 10-13 orë mësim në ditë, si Emiratet e Bashkuara Arabe, Kina, Koreja, Rusia etj.

Edhe koha e shpenzuar e nxënësve kosovarë për të mësuar gjatë një dite, si në shkollë ashtu edhe në shtëpi, nuk lidhet me performancën akademike të tyre, krahasuar me shumë sisteme arsimore, me të cilat ka kohë mësimore të përafërt në raport me numrin vjetor të orëve të mësimi në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët.

Në vitin 2015, Kosova ka marrë pjesë për herë të parë në Programin Ndërkombëtar të Vlerësimit të Studentëve (PISA) dhe nxënësit kosovarë arritën në total vetëm 347 pikë në Lexim, Matematikë dhe Shkencë, apo 150 pikë më pak se mesatarja e vendeve të OECD-së, e cila ishte 497 pikë.

Kosova ishte pjesëmarrëse dhe ka pranuar rezultatet edhe në PISA 2018. Në bazë të analizës krahasuese të rezultateve të arritshmërisë në PISA, Kosova ka shënuar një përparim minimal në arritshmëri të nxënësve, krahasuar me PISA 2015, me gjithsej 353 pikë në Lexim, Matematikë dhe Shkencë, apo 134 pikë më pak mesatarja e vendeve të OECD-së, e cila ishte 487 pikë.

Kujtojmë se testi PISA vlerëson aftësitë e nxënësve të moshës 15-vjeçare, për t'i zbatuar njohuritë e tyre që kanë përfituar në fushën e Leximit, Matematikës dhe Shkencës, në situata të jetës së përditshme. Në linjë me këtë dhe në raport me kohën e mësimi që e kanë nxënësit kosovarë, krahasuar edhe me vendet e tjera, nxënësit kosovarë nuk e kanë arritur nivelin minimal të aftësive për t'i shfrytëzuar njohuritë në jetë në tri fushat që vlerësohen në kuadër të studimit PISA: Lexim, Matematikë dhe Shkenca, pavarësisht numrit të orëve mësimore për lëndë mësimore.

Edhe në rastet kur nxënësit kosovarë mbajnë më shumë se 5 orë mësimore për një lëndë, kanë shënuar minus pikë në krahasim me nxënësit që kanë mbajtur më pak se 5 orë për një lëndë (Osdautaj, 2020). Dallime të theksuara evidentohen në rezultate të përgjithshme dhe në përqindjen e nxënësve që nuk kanë arritur nivelin minimal të aftësive.

Tabela 14: PISA 2018 - Përqindja e nxënësve që nuk kanë arritur nivelin minimal të aftësive

	Shkenca	Lexim	Matematikë
Kosova	76.6	78.7	76.6
Shqipëria	46.9	52.2	42.4
Maqedonia e Veriut	49	55.1	61
Mali i Zi	48.2	44.4	46.2
OECD-ja (mesatarja)	21.9	22.7	23.9

Të dhënat nga tabela tregojnë për dallime të theksuara me vendet e rajonit, Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, ashtu edhe me mesataren e vendeve të OECD-së.

Edhe në Testin e Arritshmërisë, të mbajtur nga Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MASHTI), në qershor të vitit 2022, koha e shpenzuar e nxënësve kosovarë për të mësuar, sipas kohës mësimore (orëve mësimore) për kurrikula lëndore, nuk lidhet me performancën akademike të tyre, në raport me arritshmërinë mesatare, e cila është 50.75%, apo si përqindje në pragun minimal të kalueshmërisë të konvertuar në shkallë vlerësimi, sipas sistemit të vlerësimit në Kosovë.

Dallime janë theksuar edhe ndërmjet lëndëve mësimore që kanë më shumë ose më pak kohë mësimore, p.sh. Gjuha shqipe në arsimin e mesëm të ulët në Kosovë ka rreth 16 % të kohës mësimore dhe mesatarja e arritshmërisë së nxënësve në testin e klasës së nëntë është 54.4%. Kundrejt saj, gjuha angleze ka rreth 7% të kohës mësimore, ndërsa mesataren në test nxënësit e kanë 74.1%.

Dallim tjetër është shënuar edhe në raport me kohën mësimore në lëndën e Matematikës, e cila ka rreth 13.5% të kohës mësimore në arsimin e mesëm të ulët dhe mesatarja e nxënësve në Testin e Arritshmërisë arrin në 46.8%, ndërsa koha mësimore për lëndën e Fizikës është 6.7%, kurse mesatarja në Testin e Arritshmërisë është e përafërt me lëndën e Matematikës, mbi 45%.

Sigurisht që dallimet në Testin e Arritshmërisë së nxënësve (klasa 9) në Kosovë nuk lidhen vetëm me kohën mësimore si përqindje të lëndëve mësimore, lidhet me procesin e mësimdhënies, ngarkesën me përmbajtje mësimore dhe rezultate të të nxënësve, por edhe me numrin e kërkesave/pyetjeve në testin, i cili është i ndryshëm për lëndë mësimore të përfshira në Testin e Arritshmërisë.

Gjithsesi në rezultate, nivelin e arritshmërisë së nxënësve, ka ndikim edhe interesimi dhe angazhimi i nxënësve për lëndë mësimore të veçanta, siç është rasti i interesimit dhe angazhimit të nxënësve për ta mësuar gjuhën angleze, për komunikim në gjuhën angleze, por edhe për përdorimin e aplikacioneve të ndryshme për lojë dhe argëtim në gjuhën angleze.

4.2.5. Mesatarja e nxënësve në klasë dhe raporti mësimdhënës–nxënës

Mesatarja e nxënësve në klasë dhe raporti mësimdhënës–nxënës kanë një ndërlidhje me mundësitë e zbatimit të kurrikulës, menaxhimin cilësor të kohës së mësimin dhe me mundësitë e ofrimit të mbështetjes individuale për secilin nxënës. Ato dallojnë në sisteme të ndryshme arsimore. Në disa sisteme arsimore, mesatarja e nxënësve në klasë dhe raporti mësimdhënës – nxënës ka rënë nga viti në vit, për shkak të zvogëlimin të numrit të nxënësve të ndikuar nga faktorë të shumtë ekonomikë, socialë dhe demografikë. Rënia e numrit të nxënësve ka ndikuar që edhe në Kosovë mesatarja e nxënësve në klasë të bjerë dhe po ashtu edhe raporti mësimdhënës – nxënës.

Një trend i ndryshimit të mesatares së nxënësve në klasë, veçanërisht raportit mësimdhënës – nxënës, vërehet edhe në sisteme të ndryshme arsimore të vendeve të OECD-së. Sipas raportit të OECD-së për vështrim të arsimit në bazë të treguesve arsimorë (OECD, 2021), në arsimin fillor në vendet e OECD-së mesatarisht ka 21 nxënës për klasë, ndërsa 23 nxënës për klasë në arsimin e mesëm të ulët. Kurse, raporti mësimdhënës–nxënës në arsimin fillor në këto vende ishte 14.5 nxënës për një mësimdhënës, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët raporti është 13.1 nxënës për një mësimdhënës.

Tabela 15. Raporti mësimdhënës – nxënës

	Shtetet	Arsimi fillor	Arsimi i mesëm i ulët
1	Estonia	12.9	10.0
2	Sllovenia	10.6	8.9
3	Suedia	13.0	11.2
4	Austria	12.0	8.5
5	Finlanda	13.5	8.8
6	Gjermania	15.1	12.9
7	OECD	14.5	13.1
8	Kosova	13.5	13.5
9	Shqipëria	12.8	13

Burimi: OECD (2021); MASHTI (2021); dhe MASR (2021)

Të dhënat për raportin mësimdhënës–nxënës në Kosovë i referohen raportit të MASHTI-t, Shënime statistikore 2021/2022 (MASHTI, 2021), sipas të cilit raporti mësimdhënës–nxënës për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët nuk ndahet, gjegjësisht raportohet i përbashkët për të dy nivelet e arsimit. Edhe në këtë studim, të dhënat raportohen njëjtë për të dy nivelet e arsimit.

4.2.6. Koha e punës së mësimdhënësve

Sipas raportit të OECD-së për vështrim të arsimit në bazë të treguesve arsimorë (OECD, 2021), mësimdhënësit në shkollat publike, në sistemet arsimore të shteteve të OECD-së dhe të shteteve tjera, që janë pjesë e këtij raporti, kanë dallime në angazhimin e mësimdhënësve për orë të mësimdhënies, punës së drejtpërdrejtë më nxënës. Mësimdhënësit e arsimit fillor mesatarisht mbajnë 791 orë mësimi në vit, ndërsa mësimdhënësit e arsimit të mesëm mbajnë 723 orë mësimi në vit, nga gjithsej 1575 orë totale të punës brenda një viti shkollor.

Në Kosovë, referuar planeve mësimore në arsimin fillor, mësimdhënësit klasorë në arsimin fillor kanë 20 deri në 22 orë mësimi për një javë mësimi. Këta mësimdhënës mesatarisht 777 orë mësimi i mbajnë me nxënës gjatë një viti shkollor, nga gjithsej 1600 orë totale të punës brenda një viti shkollor. Ndërsa, mësimdhënësit lëndorë në arsimin e mesëm të ulët, i mbajnë

mesatarisht rreth 740 orë mësimi me nxënës gjatë një viti shkollor, nga gjithsej rreth 1600 orë totale të punës brenda një viti shkollor. Pjesa tjetër e orëve të punës, që nuk lidhet drejtpërdrejt me procesin mësimor me nxënës, shpërndahet për aktivitete të tjera që lidhen me mësimdhënien, punën me nxënës, prindër, punën me dokumentacion shkollor dhe angazhimet e tjera në nivel shkolle. Këto të fundit nuk janë të normuara në orë të kohës së punës, sa duhet kaluar për shembull për punë shtesë me nxënës, për takime dhe konsulta me prindër, etj.

Sipas raporti të OECD-së (2021), mënyrat se si ndahet koha totale e punës së mësimdhënësve ndërmjet orëve të mësimit – punës së drejtpërdrejtë me nxënës, aktiviteteve jomësimore dhe shpërndarjes së orëve të punës ku zhvillohen aktivitetet, në shkollë apo gjetkë, ndryshojnë shumë në mes të sistemeve arsimore të ndryshme. Disa sisteme arsimore, si Lituania (1512 orë), Izraeli (1178 orë), Danimarka (1643 orë) etj., të gjitha orët totale të punës së mësimdhënësve duhet t'i kryejnë brenda në shkollë. Ka vende, si p.sh. Suedia, që pjesën më të madhe të orëve të punës i kryejnë në shkollë (1360 orë), mirëpo një përqindje e vogël u lejohej të bëhet nga shtëpia (407 orë).

Në Kosovë nuk ka një evidencë, në të cilën raportohet se sa kohë përtej mësimdhënies mësimdhënësit bëjnë punë në shkollë, mësimdhënësit e shkollave publike, dhe sa mund të bëjnë jashtë shkolle, përkatësisht në shtëpi. Mirëpo, një pjesë e konsiderueshme e orëve kryhen në shkollë, takimet me organet profesionale të shkollës, orët e punës që lidhen domosdo me kujdestarinë e klasës dhe punën me dokumentacionin pedagogjik, takimet me prindër etj. Kjo në masë të madhe është e lidhur me kushtet e institucioneve shkollore, pasi shumica e shkollave urbane nuk kanë mjedise të veçanta për të gjitha aktivitetet profesionale të mësimdhënësve.

Edhe në raport me detyrat dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve, përveç mësimdhënies, ka dallime ndërmjet shteteve sipas raportit të OECD-së (2021), nga detyrat dhe përgjegjësitë që janë të obligueshme për të gjithë mësimdhënësit, në detyra që janë të obligueshme për një pjesë të mësimdhënësve, detyra dhe përgjegjësi që janë kërkesa por jo të obligueshme, detyra vullnetare, si dhe detyra që në disa sisteme arsimore nuk kërkohen, mungojnë si evidencë apo nuk zbatohen. Tabela në vijim i pasqyron këto dallime të 39 sistemeve arsimore nga vendet e OECD-së.

Tabela 16. Detyrat dhe përgjegjësitë e mësimit për 39 sisteme arsimore, shteteve të OECD-së

Detyrat dhe përgjegjësitë e mësimit (2020)¹⁴	E detyrueshme për të gjithë	E detyrueshme	Kërkesa për një pjesë të mësimit	Vullnetare	Nuk kërkohet	Nuk ka evidencë	Nuk zbatohet
1. Mësimdhënia	39	0	0	0	0	0	0
2. Planifikimi individual ose përgatitja e mësimeve	38	1	0	0	0	0	0
3. Shënimi/korrigjimi i punës së nxënësve	36	3	0	0	0	0	0
4. Komunikimi dhe bashkëpunimi me prindërit ose kujdestarët familjarë	34	4	0	0	0	1	0
5. Puna e ekipore dhe bashkëpunimi me kolegë	33	3	0	1	0	2	0
6. Puna e përgjithshme administrative	30	4	0	3	1	1	0
7. Pjesëmarrja në aktivitetet e zhvillimit profesional	24	8	0	7	0	0	0
8. Mbikëqyrja e nxënësve gjatë pushimeve	16	15	0	4	2	2	0
9. Këshillimi i nxënësve	13	11	1	7	5	2	0
10. Mësues i klasës/kujdestar klase	5	19	1	8	3	3	0
11. Pjesëmarrja në menaxhimin e ndonjë detyre tjetër në shkollë, krahas detyrave mësimore/ mësimit	4	18	1	13	1	1	1
12. Pjesëmarrja në mentorimin dhe/ose mbështetja e mësimit fillestarë/ faza e induksionit	3	16	0	18	1	1	0
13. Detyra të veçanta	2	17	0	17	1	2	0
14. Mësimdhënia me orë mbi kontratën me kohë të plotë	5	10	2	15	5	1	1
15. Angazhimi në aktivitete jashtëshkollore	3	9	1	19	5	1	1

Rregullimi i kohës së punës së mësimit përmes përcaktimit të detyrave dhe përgjegjësitë të mësimit, duke marrë për bazë përshkrimet e detyrave nga tabela më sipër, shihen si një mundësi për të

¹⁴ Të dhënat i referohen raportit të OECD (2021) për 39 sisteme arsimore, shteteve të OECD.

ruajtur fokusin në mësimdhënie, si detyrë kryesore e detyrueshme për të gjithë mësimdhënësit. Por, edhe si një mundësi për të përcaktuar detyrat e detyrueshme për mësimdhënësit që kanë role të veçanta, të cilët lirohen nga disa orë mësimi për të ruajtur balancën e mbingarkesës së mësimdhënësve, përtej orëve të mësimi.

4.3. Rezultatet nga perceptimet e komunitetit të shkollës për mbingarkesën kurrikulare

Në këtë nënkapitull pasqyrohen rezultatet nga perspektivat e nxënësve, mësimdhënësve, prindërve, drejtuesve të shkollave, njohësve dhe koordinatorëve në zhvillimin e kurrikulave. Rezultatet raportohen të ndara, sipas grupeve të respondentëve pjesëmarrës në këtë studim. Gjetjet kryesore dhe përshkrimi narrativ i tyre, sipas fushave tematike të eksploruara, shoqërohen me citime të shkëputura nga të dhënat e mbledhura me intervista dhe pyetësorë.

Gjetjet e organizuara në nënkategori tematike, përveç përshkrimit narrativ, përcillen me listim të temave specifike për secilën nënkategori, të temave specifike, të cilat kanë dalë nga analizat e përmbajtjes për secilën nënkategori dhe janë të renditura sipas shpeshtësisë së informacionit të identifikuar nga të dhënat e mbledhura në kuadër të këtij studimi.

4.3.1. Perceptimi i mësimdhënësve për mbingarkesën kurrikulare

Pikëpamjet e mësimdhënësve për këtë problematikë të studimit janë informata të rëndësishme për t'i ballafaquar në diskutimin për perceptimet e qëndrimet e respondentëve të tjerë të përfshirë në këtë studim, me evidenca të tjera të këtij studimi, si dhe për të nxjerrë konkluzione se a është mbingarkesa kurrikulare perceptim apo realitet.

Mësimdhënësit e përfshirë në këtë studim kishin perceptime të ndryshme sa u përket mbingarkesës kurrikulare dhe aspekteve të saja të trajtuara në këtë studim, nga ato të argumentuara dhe të mbështetura në përvojë, deri tek ato

që më pak mbështeten në përvojën dhe përjetimet e tyre. Gjetjet kryesore nga qëndrimet e mësimdhënësve për problematikën e mbingarkesës kurrikulare janë organizuar në katër kategori tematike:

- a) Ndryshimet, risitë në kurrikulat e reja dhe vështirësitë në zbatimin e kurrikulës;
- b) Mbingarkesa kurrikulare – përshkrimi i saj dhe faktorët ndikues;
- c) Ndikimi i mbingarkesës kurrikulare te nxënësit dhe mësimdhënësit;
- d) Çfarë mund të bëhet për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare?

4.3.1.1. Ndryshimet, risitë në kurrikulat e reja dhe vështirësitë në zbatimin e kurrikulës

Zbatimi me sukses i kurrikulës, në radhë të parë, kërkon informim të plotë të komunitetit të shkollës për ndryshimet, risitë në kurrikula, kërkon ndryshim në qasje të organizimit të punës së shkollës dhe të mësimdhënies, si dhe kërkon angazhim të gjithë stafit të shkollës dhe aktorëve të tjerë mbështetës, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi kanë rol në procesin e zbatimit të kurrikulës. Pa dyshim, mësimdhënësit janë ata të cilët bartin përgjegjësinë kryesore në zbatimin e kurrikulës në nivel shkolle, i japin kuptim dhe përmbajtje asaj gjatë punës me nxënës.

Ndryshimet, risitë në kurrikulat e reja. Me mësimdhënësit e përfshirë në këtë studim, fillimisht janë diskutuar ndryshimet, risitë në kurrikulat lëndore. Mësimdhënësit, në masë të madhe, kur flasin për ndryshimet dhe risitë në kurrikula, prekin kryesisht elemente të përgjithshme që reflektojnë zhvillimet në kurrikula, si kurrikulat janë të bazuara në kompetenca, referimi në parimet e kurrikulës, autonominë e shkollës dhe të mësimdhënësve, për kurrikulat lëndore të zhvilluara pas fazës së pilotimit, temat mësimore dhe rezultate të të nxënësve etj. Ndërsa ndryshimi i qasjes ndaj mësimdhënies preket vetëm tërthorazi, këtë e ndërlidhin më shumë me tekstet shkollore për lëndët përkatëse dhe me kushtet e mësimdhënies në nivel të shkollës.

Ndryshimet, risitë në kurrikulat e reja, në mesin e mësimdhënësve diskutohen në mënyra të ndryshme. Një pjesë e trajnerëve të kurrikulës, jo

të gjithë, janë më argumentues ndaj ndryshimeve të kurrikulës, duke vënë theksin edhe në ndryshimet pozitive. Elemente të ndryshimeve në kurrikulat e reja, kështu përshkruhen nga një trajnerë i fushës kurrikulare Shkencat e natyrës.

Ndryshim pozitiv është autonomia e mësimit në përzgjedhje të burimeve mësimore, si dhe në metodologjitë e punës. Pastaj, mundësia e nxënësit që të shprehë nxënien e tij/saj në forma kreative sipas aftësive personale, si dhe shpjegim të përmbajtjeve në mënyrë kritike sipas argumenteve të pretenduara, duke mbrojtur përmes dëshmi, qofshin të qëndrueshme apo jo...(m/64, shkollë urbane).

Ndërsa, një trajnerë e kurrikulës për arsimin fillor, lidhur me ndryshimet pozitive, risitë që i promovon kurrikula e re, shprehet:

Zbatimi i kurrikulës së bazuar në kompetenca mundëson zhvillimin gradual të kompetencave kryesore të nxënies të nxënësit, të cilat më pas e përgatisin atë për një qasje më të lehtë në treg, përballen më lehtë me sfidat në jetën shoqërore etj. Si dhe fleksibilitetin që ofron të mësimit gjatë mësimit, e cila më pas ndikon në zhvillimin e kreativitetit tek ata (m/65, shkollë urbane).

Mësuesit në arsimin fillor, kur flasin për ndryshimet në kurrikula, shprehen se ndryshimet janë më të mëdha në kurrikulat lëndore të secilës klasë, duke renditur se më shumë ka ndryshime në lëndën Njeriu dhe natyra, pastaj Shoqëria dhe mjedisi, Matematika dhe Gjuha shqipe. Në raste të caktuara, duke folur për ndryshimet dhe risitë në kurrikula, mësuesit klasorë shprehen menjëherë edhe për punën me libra, tekstet shkollore që nuk janë në përputhje me kurrikulën, për ngarkesën kurrikulare që e kanë parë me tema mësimore dhe rezultate të nxënësve në lëndët Gjuhë Shqipe, Njeriu dhe Natyra, Matematikë, në klasën e 5-të, të cilat shpesh cilësohen si jo të përshtatshme për moshën e nxënësve.

Ka mësimit në arsimin fillor të cilët i përshkruajnë ndryshimet në kurrikulat lëndore dhe njëkohësisht japin informacione për mbingarkesën kurrikulare, të cilën e kanë vërejtur që në fazën e analizës së ndryshimeve në kurrikulat me të cilat ata punojnë.

Ndryshimin që vërejmë te kurrikulat lëndore është se përmes RNL-ve kontribuohet në zhvillimin e kompetencave, por që në disa raste (lëndë) është e mbingarkuar, të cilat më pas humbasin rolin që kanë. Numri i madh i tyre nganjëherë pamundëson zhvillimin e aktiviteteve praktike, të cilat ndihmojnë në përforcimin e tyre. Pra, gjatë planifikimit kemi më shumë orë zhvillimore. Këtë e vërejmë në lëndën e Matematikës dhe te Njeriu dhe natyra (m/65, mësuese klasore, shkollë urbane).

Nga mësuesit/et e arsimit fillor, shpesh bëhen ngatërime sa u përket ndryshimeve në kurrikulat lëndore, kundrejt teksteve shkollore për lëndët përkatëse dhe sfidave, me të cilat ballafaqohen. Kjo situatë gjen përshkrime të ndryshme, si:

- ka vështirësi dhe detyra jo të përshtatshme për moshën e nxënësve;
- në lëndën e Matematikës ka ngarkesa në detyra, ku në disa kapituj një njësi ka shumë detyra (klasa 3);
- Edhe pse kanë ndryshuar tekstet, në klasat 2 dhe 3, temat mësimore janë pothuajse të njëjta, në njësitë mësimore ndonjëherë ka kërkesa që nuk janë të përshtatshme për nxënës;
- Në lëndën e Matematikës (klasa 3) është shtuar tabela e shumzimit, gjë që nxënësit (shumica) kanë vështirësi në përvetësimin e saj.
- Numri i madh i nxënësve në klasë pamundëson zbatimin e kurrikulës në përpikëri, si dhe numri i madh i lëndëve që ligjërojnë mësimdhënësit klasorë.

Në arsimin e mesëm të ulët, klasat 6-9, mësimdhënësit që janë udhëheqës të aktiveve profesionale në fushat kurrikulare Gjuhët, Matematika dhe Shkencat natyrore, shprehen në mënyrë të drejtpërdrejtë për ndryshimet në kurrikulat e reja lëndore, kundrejt kurrikulave/programeve paraprake. Mësimdhënësit e tjerë, që nuk kanë rol udhëheqës në aktivet profesionale, më shumë u referohen aspekteve të përgjithshme që lidhen me KB, të cilat janë një ndryshim në qasjen e zhvillimit të kurrikulave.

Mësimdhënës të gjuhës angleze shprehen se ndryshimet kanë bërë që të ketë tema të papërshtatshme për moshën e nxënësve, si tema për punën, lidhjet e dashurisë etj. (Gjuhë angleze klasat 6-9) dhe, sipas tyre, disa prej këtyre temave, të cilat gjenden kryesisht në libra, mësohen para se bota e fëmijëve t'i kuptojë në mënyrë të drejtë këto aspekte.

Sipas mësimdhënësve të Gjuhës shqipe, në klasat 6-9 janë hequr shumë tema mësimore me karakter edukativ dhe janë futur tema që nuk përshtaten me moshën e nxënësve, më shumë referojnë për temat në tekstet shkollore.

Ka rast kur mësimdhënës nga aktivi profesional Gjuhët dhe komunikimi deklarojnë se nuk kanë informacione të plota se cilat tema saktësisht janë ndryshuar (iu referohen teksteve shkollore), në tekste ka pak ndryshime, punojmë me të njëjtat tekste, pavarësisht kërkesës për ndryshim. Kështu shprehet një mësimdhënëse e Gjuhës shqipe në një nga shkollat në zonat urbane, e cila është edhe kryetare e aktivitetit Gjuhët dhe komunikimi:

Si mësimdhënëse me një vit e pak përvojë pune, unë nuk kam informacione se cilat tema saktësisht janë ndryshuar, mirëpo nga viti i parë në të dytin të përvojës sime nuk ka ndryshime, sepse punojmë me të njëjtat tekste, pavarësisht kërkesës për ndryshim (m/52, mësimdhënëse e Gjuhës shqipe, shkollë rurale).

Për lëndën e Matematikës ka mësimdhënës të cilët theksojnë se janë shtuar disa tema mësimore, në klasat 6-9, të cilat në një mënyrë janë të riorganizuara nga programet paraprake. Disa mësimdhënës të Matematikës, që japin mësim në klasën e gjashtë (6), shprehen se ka numër të madh të RNL-ve dhe ka tema që nuk gjenden në tekstet mësimore që po u shpërndahen nxënësve në shkolla, kjo reflektohet edhe në klasat e tjera. Disa mësimdhënës tjerë të Matematikës janë shumë specifikë në përshkrimin e ndryshimeve të bëra. Lidhur me ndryshimet në kurrikulën e matematikës, kryetarja e aktivitetit të Matematikës nga një shkollë në zonë urbane, shprehet:

Janë shtuar rezultatet e kompetencave, rezultatet e fushës, dhe janë hequr njësitë mësimore. Te klasat e 6-ta ka numër të madh të RNL-ve dhe ka tema që nuk gjenden në tekstet mësimore që po u

shpërndahen nxënësve në shkolla (m/7, mësimdhënëse e Matematikës, shkollë urbane).

Në lëndën e Matematikës nuk ka shumë ndryshime sa u përket përmbajtjes dhe rezultateve të të nxënësve, përveç te vlerësimi, pra është rritur mundësia që të përdorim numër më të madh të instrumenteve të vlerësimit, që më herët është përdorur më pak (m/63, mësimdhënësi i Matematikës, shkollë urbane).

Nga pjesa më e madhe e mësimdhënësve të matematikës theksohet se ka ndryshime në kurrikulat e kësaj lënde mësimore, më shumë në klasat 8 dhe 9. Nga disa mësimdhënës theksohet se ndryshimet e bëra kanë ndikuar që programi të jetë i ngarkuar për klasat 8 dhe 9, pasi që, sipas tyre, ndryshimet nuk janë të përshtatshme, krijojnë probleme në të mësuarit e lëndës së Matematikës. Këtë vit, sipas tyre, është shtuar kapitulli i trigonometrisë për klasën e 9-të, gjë që ka qenë shumë e vështirë për t'u kuptuar nga nxënësit e kësaj moshe, por edhe për arsye se edhe arsimtarët është dashur të gjejnë materiale shtesë për këtë kapitull.

Ndryshimet, risitë në kurrikulat e lëndëve të fushës së shkencave dhe elementet e zbatimit të tyre, adresohen edhe nga mësimdhënësit e lëndëve të shkencave, Biologji, Fizikë, Kimi. Sipas mësimdhënësve të lëndës së Biologjisë, ajo çfarë është shtuar është për edukimin shëndetësor- seksual dhe që është e nevojshme për secilën klasë (klasat 6-9). Në mesin e mësimdhënësve të biologjisë, ndryshimet në kurrikula përshkruhen edhe me gjuhë të hapur dhe përgjithshme.

Kurrikulat në lëndën e biologjisë janë më të përgjithësuara, pra nuk janë të ngurta, por ofrojnë mundësi që në kontekste të ndryshme të synohen kërkesa të njëjta për të gjithë nxënësit e Kosovës (m/64, mësimdhënësi i Biologjisë, shkollë urbane).

Sipas mësimdhënësve të lëndës së Kimisë, në këtë lëndë mësimore disa nga ndryshimet e bëra janë të duhura dhe të përshtatshme për moshën e nxënësve. Ka mësimdhënës të cilët theksojnë së në klasën e 8-të lënda e Kimisë është ngarkuar në një vëllim të madh të përmbajtjeve mësimore, janë përfshirë tema/njësi që nuk kanë rol edhe aq të madh në të mësuarit e kimisë.

Ka edhe mësimdhënës të lëndës së Kimisë, të cilët ndryshimet në kurrikula i kanë barazuar me ndryshimet në tekste/libra shkollorë, pasi theksojnë se është shtuar puna me dokumente, ka qasje dhe metodologji të reja, pastaj të tjerë që konsiderojnë se nuk ka ndryshime dhe se vazhdohet kryesisht me qasjet e vjetra.

Sipas mësimdhënësve të lëndës së Fizikës, edhe në këtë lëndë mësimore ka ndryshime nga klasa në klasë. Disa mësimdhënës përshkruajnë se disa ndryshime të bëra me futje e disa RNL-ve, të cilat nuk janë në përputhje me renditjen logjike të mbarështimit, por edhe me moshën e nxënësve. Prandaj, propozojnë që disa rezultate, p.sh. te klasa 6-të, të shkojnë te klasat 7 dhe 8, sepse ka tema më shumë dhe nuk janë të nivelit përkatës. Një mësimdhënëse e lëndës së Fizikës shprehet se nuk janë hequr temat mësimore nga planet dhe programet e mëhershme, janë shtuar ato, dhe për këtë arsye është mbingarkuar kurrikula në lëndën e tyre. Disa mësimdhënës të lëndës së Fizikës, kur flasin për elementet e zbatimit të kurrikulës, flasin për mungesën e literaturës mësimore, të cilat do të duhej të kishin lidhshmëri me temat mësimore dhe RNL-të.

Struktura dhe koherenca e kurrikulave lëndore. Sa i përket strukturës dhe koherencës së kurrikulave lëndore, mësimdhënësit e përfshirë në studim shprehin qëndrime të ndryshme, pozitive, mungesën e të kuptuarit, disa të tjerë mospajtueshmëri me ndryshimet e bëra ose me qëndrim se nuk janë bërë ndryshime në kurrikulat e reja, kundrejt kurrikulave paraprake të lëndëve mësimore, të cilat i mbajnë apo i ligjërojnë. Mungesa e të kuptuarit për koherencën e kurrikulave është me shumë e pranishme në pikëpamjet e mësimdhënësve.

Në anën tjetër, mësimdhënësit që kanë qëndrim pozitiv u referohen lidhjes në mes të temave mësimore të lëndës brenda një klasë, shtrirjes së tyre në klasat e tjera, përshtatshmërisë me moshën e nxënësve, si dhe aspektit praktik të zbatimit të kurrikulave.

Në rastet kur mësimdhënësit shprehin mospajtueshmëri me ndryshimet e bëra, atë e përshkruajnë me dallimet në kurrikulat e disa lëndëve nga klasa në klasë, ku nuk janë integruar rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare

përkatëse, me renditje jo të mirë të temave mësimore, me vështirësi në arritjen e ndërlidhjes në mes të temave mësimore të lëndëve tjera, me thellësi dhe gjerësi që nuk përshtaten me moshën e nxënësve, në raste të caktuara shumë sipërfaqësore, por edhe me vështirësitë që kanë në zbatimin e kurrikulave.

Në përgjithësi, sipas mësimdhënësve, ka zgjerim të trajtimit apo përfshirjes së temave mësimore nga klasa në klasë, edhe pse, sipas tyre, gjerësia dhe thellësia e tyre dallojnë sipas lëndëve mësimore, ngase ka raste kur ka shkëputje në mes të temave dhe radhitje jo sipas një rendi logjik të mbarështrimit. Rendin logjik të mbarështrimit të temave mësimore mësimdhënësit më shumë e ndërlidhin me mbarështrimin e temave e njëjve mësimore që bëhen në tekstet shkollore.

Mësimdhënësit kur flasin për ndryshimet në kurrikula, flasin edhe për ndryshimet organizative në shkolla, të cilat lidhen me ndryshimet në kurrikula. Ata e përshkruajnë se janë rritur niveli i komunikimit në shkollë, autonomia dhe fleksibiliteti në punën e tyre.

Vështirësitë në zbatim e kurrikulës. Zbatimi i elementeve të kurrikulës në punën me nxënës, në masë të konsiderueshme, varet nga qasja e mësimdhënësve në raport me mësimdhënien dhe me angazhimin e nxënësve. Mësimdhënësit e përfshirë në studim, në forma të ndryshme, mundohen të tregojnë se, sipas kurrikulës, mësimdhënien është e orientuar në zhvillimin e kompetencave. Pothuajse secili në mënyrën e vet mundohen të përshkruajnë qasjen e tyre se si e bëjnë integrimin ndërlëndor, si i përdorin burimet e tjera të mësimdhënies dhe nxënies, për të cilat shprehen se janë të pakta dhe kanë vështirësi në sigurimin e tyre.

Sipas mësimdhënësve të përfshirë në studim, shkallët kurrikulare janë shumë të ngarkuara, me një strukturë të rezultateve të të nxënies, dhe kjo e vështirëson zbatimin në praktikë. Edhe mospërshtatja e kurrikulës me moshën e nxënësve, në disa raste, dhe problemet me tekstet shkollore përshkruhen si vështirësi në punën e tyre gjatë zbatimit të kurrikulës.

Disa mësimdhënës, kur flasin për vështirësitë në zbatimin e kurrikulës, e vënë theksin në shtimin e aktiviteteve me nxënës, që çojnë në arritjen e

kompetencave. Në anën tjetër, si elemente pozitive, që lehtësojnë zbatimin e kurrikulës theksohen rritja e shfrytëzimit të pajisjeve të TIK-ut në shkolla, njohja e gjuhës angleze nga nxënësit dhe futja e saj që nga klasa e parë, përcaktimi i rezultateve të të nxënësve për tema, të cilat i cilësojnë si lehtësim dhe orientim për planifikim dhe vlerësim.

Aspektet më të potencuara për zbatimin e kurrikulës rezultojnë të jenë ato që ndërlidhen me vlerësimin e nxënësve, posaçërisht periudhat e vlerësimit, dhe zbatimin e vlerësimit përmbledhës (VP1 dhe VP2, aspekt i cili në të njëjtën kohë përshkruhet të ketë qenë mjaft sfidues për një pjesë të madhe të mësimit dhe brenda tyre edhe elementet përmbajtësore të vlerësimit që lidhen me sfidat e vlerësimit me bazë në matjen dhe verifikimin e arritjeve të kompetencave. Në këtë drejtim, ka mësimitdhënës që i përshkruajnë aspektet e vlerësimit të nxënësve edhe në aspektin afirmativ dhe mobilizues për punën e mësimitdhënësve me nxënës.

Sipas mësimitdhënësve të shkollave të përfshirë në këtë studim, zbatimi i kurrikulës së bazuar në kompetenca vazhdon të përcillet me sfida të mëdha dhe me shumë shqetësime të ngritura nga vetë mësimitdhënësit, të cilat nuk janë adresuar tani e disa vjet nga MASHTI. Mësimitdhënësit kanë deklaruar disa nga vështirësitë, që ata i hasin në praktikë për zbatim të kurrikulës së re, lidhen me tekstet shkollore dhe sigurimin e literaturës mbështetëse, kushtet jo të mira punës në shkolla, angazhimet e mësimitdhënësve me një fokus në plotësimin e kërkesave administrative, vlerësimin e nxënësve në tri periudha të mësimit, mungesën e pajisjeve të TIK-ut dhe të mjeteve të konkretizimit etj.

Nga mësimitdhënësit e arsimit fillor, klasat 1-5, sfidë kryesore për zbatimin e kurrikulës konsiderohet numri i madh i lëndëve që i ligjërojnë mësimitdhënësit klasorë. Sfidat tjetër, më e specifikuar posaçërisht nga mësimitdhënësit e shkollave urbane, konsiderohet të jetë numri i madh i nxënësve në klasë, numri i cili, sipas mësimitdhënësve, pamundëson zbatimin efektiv të kurrikulës.

Disa mësimdhënës, kryetarë të aktiveve profesionale në arsimin e mesëm të ulët, kur flasin për vështirësitë në zbatimin e kurrikulës, i referohen edhe të kuptuarit jo të drejtë të kurrikulës, të ndryshimeve që sjell kurrikula, mundësive që ofron kurrikula etj. Një mësimdhënës, kryetar i aktivitetit të fushës Gjuhët dhe komunikimi, në një shkollë nga zonat urbane, ngrit shqetësim për mënyrën se si bëhet në disa aktive profesionale proces, i cili, sipas tij, ndodh që shpesh të bëhet nga një mësimdhënës që mund të ketë njohuri më shumë për kurrikulën e re, ose e ka pozitën e kryetarit të aktivitetit profesional.

Sa i përket planifikimit mësimor, proces të cilin shumë mësimdhënës e quajnë punë administrative, konsiderohet si një kërkesë mjaft sfiduese për një pjesë të madhe të mësimdhënësve. Sipas një numri të konsiderueshëm të mësimdhënësve, zbatimi i kurrikulës po sfidohet nga punët “administrative” në planifikimin e zbatimit të kurrikulës, ku theksi vendoset të planet ditore. Sipas mësimdhënësve që e kanë ngritur këtë shqetësim, planet ditore marrin një kohë të konsiderueshme dhe kur i bëjnë në të shumtën e rasteve i lidhin me librat shkollorë, me të cilët punojnë.

Mosinteresimi i nxënësve për mësim është një nga shqetësimet e ngritura nga shumë mësimdhënës, të cilin e ndërlidhin me kushtet e punës që ofrojnë shkollat në Kosovë, mungesën e mjeteve të konkretizimit, pajisjeve të TIK-ut, orarin e shkurtër të mësimin në disa shkolla, por edhe me numrin e madh të nxënësve në shkollat urbane, në disa raste edhe me qasjen e mësimdhënësve, si në arsimin fillor, ashtu edhe në arsimin e mesëm të ulët.

Në tabelën në vijim raportohet një përmbledhje e qëndrimeve të mësimdhënësve lidhur me disa aspekte të ndryshimeve në kurrikula, të ndara në katër zëra, të koduar në katër nënkategori: (i) Elementet pozitive të kurrikulës së re; (ii) Ndryshimet, risitë në kurrikulat e reja lëndore; (iii) Struktura dhe koherenca e kurrikulave lëndore dhe (iv) Vështirësitë në zbatimin e kurrikulës. Secili aspekt i trajtimit, zë i koduar në nënkategori, përcillet me tema specifike sipas nënkategorive, të cilat aspekte përmbledhëse të organizuara në këto nënkategori janë elemente të zërit të mësimdhënësve, të renditura sipas shpeshhtësisë së informacionit të identifikuar nga të dhënat e mbledhura me mësimdhënës.

Tabela 17: Ndryshimet, risitë në kurrikulat e reja, dhe vështirësitë në zbatimin e kurrikulës nga perspektiva e mësimdhënësve

Nënkategoria	Tema specifike nga nënkategoritë
Elementet pozitive të kurrikulës së re	<ul style="list-style-type: none"> - Autonomia, fleksibiliteti dhe llogaridhënia në nivel shkolle; - Mësimdhënie e orientuar në zhvillimin e kompetencave; - Integrimi ndërlëndor, mundësi shtesë për burime të tjera të mësimdhënies dhe nxënies; - Mundësi për rritjen e nivelit të komunikimit dhe nivelit të hulumtimit nga nxënësit dhe mësimdhënësit; - Nxënësi në qendër të vëmendjes, mundësi për të qenë aktiv në vazhdimësi; - Rezultatet e të nxënit të përcaktuara në kurrikulë janë lehtësi dhe orientim për planifikim dhe vlerësim; - Vlerësimi i nxënësve bazuar në kompetenca, mundësi për instrumente të shumta vlerësimi; - Bashkëpunimi brenda aktiveve dhe mësimdhënësve brenda dhe jashtë shkolle i rritur; - Metodologji të ndryshme të mësimdhënies dhe kërkesa për parapërgatitje (plani vjetor, dymujor, ditor); - Mundësi përshtatjeje dhe adaptim me kërkesat e të nxënit.
Ndryshimet në kurrikulat e reja lëndore	<ul style="list-style-type: none"> - Janë shtuar dhe riorganizuar temat mësimore; - Integrimi ndërlëndor me elemente shtesë; - Janë shtuar rezultatet e fushës dhe janë hequr njësitë mësimore; - Përqendrimi në rezultate të kompetencave dhe jo në përmbajtje mësimore; - Ka ndërruar mënyra e trajtimit të temave dhe ndërlidhja me jetën; - Janë shtuar çështjet ndërkurrikulare;

	<ul style="list-style-type: none"> - Ndryshime pa përshtatje me tekste shkollore; - Nuk ka ndryshime; - Tema jo të përshtatura mirë me moshën e nxënësve; - Ndryshimet nuk janë të përshtatshme, krijojnë probleme, specifikohen lëndët Matematikë, Njeriu dhe natyra.
Struktura dhe koherenca e kurrikulave lëndore	<ul style="list-style-type: none"> - Strukturë herë sipërfaqësore e herë e thellë; - Renditja e temave jo siç duhet; - Ka shkëputje në mes të temave dhe herë-herë temat janë radhitur jo sipas rendit logjik; - Ka thellësi të temave, nganjëherë dallojnë gjerësia dhe thellësia sipas lëndëve mësimore; - Shkallët kurrikulare shumë të ngarkuara, vështirësojnë zbatimin në praktikë; - Ndërlidhje e mirë dhe praktike, por me vështirësi në zbatim (mosha e nxënësve); - Strukturë që me vështirësi arrihet, ndërlidhje në mes të temave të lëndëve të tjera; - Struktura të programeve lëndore vështirë e zbatueshme; - Ndërlidhje e mirë në fushën përkatëse; - Tema të ndërlidhura mirë, por pengesë librat.
Vështirësitë në zbatimin e kurrikulës	<ul style="list-style-type: none"> - Trajnerët e kurrikulës jo të përgatitur mirë; - Mungesa e monitorimit të zbatimit të kurrikulës; - Të kuptuarit jo të drejtë të kurrikulës, të ndryshimeve që sjell kurrikula, mundësive që ofron kurrikula; - Numri i madh i lëndëve që ligjërojnë mësimdhënësit klasorë; - Zbatimi i kurrikulës në praktikë; - Realizimi praktik i njësive mësimore; - Mungesa e teksteve adekuate dhe vështirësitë në sigurimin e literaturës mbështetëse;

- Angazhimet e mësimeve me punë “administrative” rreth planifikimit mësimor;
- Ngecja e mësimit akoma me fokus te përmbajtja mësimore;
- Angazhimet e mësimeve rreth vlerësimit me tri periudha të mësimit, me shumë instrumente të vlerësimit për vlerësim përmbledhës (VP1 dhe VP2);
- Kushtet jo të mira në shkollë, si mungesa e pajisjeve të TIK-ut dhe e mjeteve të konkretizimit;
- Numri i madh i nxënësve në shkollat urbane dhe orari i shkurtër i orëve mësimore;
- Mosinteresimi i nxënësve për mësim.

4.3.1.2. Reflektimi i mësimeve për mbingarkesën kurrikulare faktorët e saj

Nga mësuesit e përfshirë në këtë studim, kemi pak përshkrime të përmbledhura për mbingarkesën kurrikulare, që përfshijnë pjesën më të madhe të elementeve që konsiderohen se e përbëjnë mbingarkesën kurrikulare, përkatësisht elementet kryesore që përkufizojnë mbingarkesën kurrikulare (kujto përkufizimin për mbingarkesën kurrikulare). Megjithatë, për aq përgjigje sa kanë dhënë mësuesit, mësojmë se sipas mësimeve me mbingarkesë kurrikulare nënkuptohet: përsëritja e temave mësimore, shtimi dhe rezultateve për fushë kurrikulare dhe tema mësimore, mungesa e teksteve shkollore dhe vëllimi i tyre me përmbajtje mësimore, numri i lëndëve mësimore, detyrat e shtëpisë, mospërputhja e planit mësimor me përmbajtjet mësimore që duhet të zhvillohen, puna administrative e mësimeve, koha e shkurtër e orëve mësimore për arritjen e rezultateve dhe pamundësia për të mbuluar të gjitha planifikimet gjithashtu konsiderohet të jetë mbingarkesë.

Disa përshkrime të mësimeve për mbingarkesën kurrikulare pasqyrohen si në vijim:

- *Mbingarkesë kurrikulare është kur ka shumë tema mësimore, shumë rezultate për fushë, për tema mësimore, pra shumë shkrime, e që në*

fund të fundit rezultatet janë të njëjta (m/38- mësimdhënëse e Gjuhës shqipe, shkollë rurale).

- *Mbingarkesë është puna e tepërt me dokumente dhe letra, pasi që çdo kurrikulë lëndore parashihet të ketë planet vjetore dhe dymujore, mirëpo që është obligative përgatitja e tyre nga mësimdhënësi (m/13 - kryetare e aktivitet të klasës së 3-të, shkollë urbane).*
- *Mbingarkesë është kur tekstit i rritet vëllimi nga 120 faqe në 180 faqe (m/31 - mësimdhënësi i lëndës së Kimisë, shkollë urbane).*
- *Mbingarkesë është kur vazhdimisht japim detyra të shtëpisë për nxënës (m/15 -mësimdhënëse e Matematikës, shkollë urbane).*

Në anën tjetër, sa i përket specifikimit të **faktorëve të mbingarkesës kurrikulare**, sërish nga mësimdhënësit preken elementet përshkruese për mbingarkesën kurrikulare dhe referimi më i theksuar është në tekstet shkollore që mungojnë, në tekstet shkollore që cilësohen të papërshtatshme për plotësimin e kërkesave të kurrikulës. Potencohen gjithashtu rezultatet e të nxënësve të ngarkuara, numri i madh i lëndëve dhe i temave mësimore e rezultateve të të nxënësve për tema mësimore, ngarkesa e nxënësve me detyra të shumta shtëpie, me aktivitete, gara, projekte etj.

Në mesin e mësimdhënëësve, ka të tillë që fare nuk e shohin mbingarkesën kurrikulare të ndërlidhur me përmbajtjen e kurrikulës, temat mësimore, rezultatet e të nxënësve dhe udhëzimet metodologjike, por atë më se shumti e lidhin me qasjen e mësimdhënëësve ndaj të mësuarit dhe ndaj përdorimit të teksteve shkollore, të cilat përshkruhen se janë të mbingarkuara me njësi mësimore të panevojshme.

Ndoshta po paraqitem si vlerësues subjektiv i programeve lëndore, pasi që jam hartues i RNL-ve, dhe po mbroj qëndrimin se programet lëndore nuk janë të mbingarkuara. RNL-të e lëndës Biologji janë dhe relevante me moshën e nxënësve/es dhe normën mësimore dy (2) orë në javë. Mësimdhënësi/ja shkakton mbingarkesën, jo pse është kërkesë e RNL –ve, por nga mungesa e të kuptuarit të kërkesës së RNL-së, pasi që nuk u është shpjeguar gjatë trajnimeve mënyra e të

lexuarit dhe të kuptuarit të kërkesës së RNL-ve (m/64, mësimdhënës i Biologjisë, shkollë urbane).

Referuar faktorëve të mbingarkesës kurrikulare, një mësimdhënëse, kryetare e aktivitetit të klasës së tretë, nga një shkollë urbane, kur flet për faktorët e mbingarkesës kurrikulare, u referohet përmbajtjeve mësimore, apo, siç shprehet:

Kurrikulat lëndore janë të mbingarkuara me tema mësimore, si rezultat nxënësit ngarkohen në klasë edhe me punë/detyra në shtëpi (m/12, shkollë urbane).

Një mësimdhënëse tjetër, kryetare e aktivitetit profesional të klasës së 5-të, nga një shkollë tjetër rurale, kohën mësimore/planin mësimor e sheh si një nga faktorët më ndikues në mbingarkesën kurrikulare. Sipas saj:

Koha mësimore në dispozicion (numri i orëve mësimore) është e pamjaftueshme për shtjellim të temave dhe arrijtjen e rezultateve të vendosura në kurrikulat lëndore të klasës së tretë. Shpesh i marrim orët nga lëndët Edukatë fizike dhe artet për t'i shtjelluar temat në lëndët tjera! (m/22 - kryetare e aktivitetit të klasës së 5-të, shkollë rurale).

Një mësimdhënëse tjetër, kur flet për mbingarkesën kurrikulare, e vë theksin te njësitë mësimore, të cilat do të duhej të caktoheshin nga vetë mësimdhënësit, mirëpo në qasjen e punës së mësimdhënësve, të bazuar në tekstet shkollore, njësitë merren nga tekstet shkollore dhe për to pastaj specifikohen rezultatet e të nxënësve. Kështu e përshkruan këtë situatë një mësimdhënëse e matematikës.

Ka mbingarkesë me numër të madh të njësive mësimore (disa të panevojshme), të cilat pastaj imponojnë shumë rezultatet e të nxënësve, të cilat duhet të arrihen gjatë punës me nxënës (m/63, mësimdhënëse e Matematikës, shkollë urbane).

Një mësimdhënëse e arsimit fillor, në një shkollë urbane, mbingarkesën kurrikulare më së shumti e lidh me lëndët mësimore Matematikë dhe Shkencat e natyrës, duke specifikuar klasat 1, 4 dhe 5. Sipas saj:

Ka mbingarkesë në të gjitha klasat, por ndoshta më shumë në klasën e parë Matematikë dhe në klasën katërt e të pestë Njeriu dhe natyra. Kjo është mjaft sfiduese, ngase numri i madh i këtyre rezultateve pamundëson zhvillimin e mjaftueshëm të aktiviteteve praktike, sidomos në lëndën Njeriu dhe natyra. E gjithë kjo reflektohet edhe te nxënësit (m/65, mësuese klase, shkollë urbane).

Një përshkrim të përafërt për mbingarkesën kurrikulare në arsimin fillor e jep edhe një mësimdhënëse e klasës së parë, nga një shkollë urbane.

Konsideroj që ka mbingarkesë të nxënësve në mësim pothuajse në të gjitha lëndët dhe atë që nga klasa e parë e deri në të pestën. Programet lëndore janë të mbingarkuara me RNL. Do veçoja: klasa e parë (6-vjeçar) ballafaqohet me 18-20 tekste mësimore, në lëndën e Matematikës në klasën e parë mësohen ekuacionet dhe inekuacionet lineare. Tekstet shkollore bashkë me fletore pune shpeshherë e mbingarkojnë nxënësin me detyra të ndryshme e nganjëherë të thata (m/13, mësuese klase, shkollë urbane).

Lidhur me tekstet shkollore, si faktor të mbingarkesës kurrikulare, ngarkesën e çantës së nxënësve me tekste shkollore, shprehen një pjesë relativisht e madhe e mësimdhënësve.

Vlen të ceket që shpesh autorët e librave, kur rezultatet i shndërrojnë në njësi mësimore, edhe më shumë e vështirësojnë atë, duke dhënë informata të detajuara rreth njësisë, gjë që nuk e kërkon rezultati, si dhe nganjëherë fjalori nuk është shumë i përshtatshëm me moshën e nxënësve. Këtë e gjejmë pothuajse te shumica e teksteve me të cilat ne punojmë (m/59, mësuese klase, shkollë urbane).

I kemi analizuar tekstet shkollore të matematikës nga klasa e pestë (5) deri te klasa e nëntë (9). Si aktiv i matematikës, kemi arritur në përfundim se tekstet e matematikës në klasat 5, 7 dhe 9 janë të mbingarkuara dhe këto tekste duhet të përmirësohen në mënyrë që të mos ketë mbingarkesë për nxënësit, pasi që pjesa më e madhe e mësimdhënësve punojnë vetëm me tekstet shkollore (m/63, mësimdhënësi i Matematikës, shkollë urbane).

Një mësimdhënës nga fusha e shkencave natyrore mbingarkesën kurrikulare e sheh të ndikuar nga tekstet shkollore dhe nga qasja e mësimdhënësve, por edhe e nxënësve dhe prindërve për përvetësimin e përmbajtjeve mësimore nga tekstet shkollore.

Tekstet shkollore kanë njësi mësimore të panevojshme dhe kjo shkakton mbingarkesë. Puna e mësimdhënësit/es është e bazuar në libër e jo në program lëndor. Mësimdhënësi/ja fokusohet në libër, pasi që edhe vlerësimi i jashtëm (testi i arritshmërisë dhe i maturës) realizohet me testim duke formuluar kërkesa nga përmbajtja e librit, e jo me kërkesa nga rezultatet e shkallëve, gjegjësisht vlerësimin e kompetencave. Mësimdhënësi bazohet në libër pasi që nxënësi dhe prindi janë këmbëngulës në vlerësim sipas librit, e libri nuk është në harmoni me programin lëndor (RNL -të)! (m/64, mësimdhënës i biologjisë, shkollë urbane).

Vlerësimi i nxënësve dhe sidomos fokusimi në shpeshësinë e vlerësimit me teste, gjithashtu, theksohet të jetë faktor i mbingarkesës kurrikulare. Angazhimi i mësimdhënësve me punë administrative, rreth planifikimit dhe përgatitjeve për zbatim, konsiderohet të jetë aspekt i mbingarkesës së mësimdhënësve. Gjithashtu, edhe kushtet dhe ambientet jo të përshtatshme të shkollave për zbatimin e kurrikulës konsiderohet si një nga faktorët kryesorë që ndikon në mbingarkesë kurrikulare në raport me përmbushjen e pritshmërive që dalin nga kurrikula për nxënës dhe për mësimdhënës.

Çështjet ndërkurrikulare, të përfshira në kurrikula lëndore, sipas shumicës së mësimdhënësve nuk konsiderohen mbingarkesë, sepse ato nuk janë të zbërthyera, nuk janë të detyrueshme për t'i përfshirë në planifikim, gjë për të cilën një pjesë relativisht e madhe e mësimdhënësve shprehen se i integrojnë vetëm formalisht në planifikimet e tyre për punën me nxënës. Ka edhe deklarime kur mësimdhënësit e tjerë deklarojnë se ndonjëherë ky integrim shkakton mbingarkesë të mësimdhënësit, por edhe të nxënësit, sidomos të arsimit fillor.

Si përmbledhje e kësaj pjese, mund të thuhet se mësimdhënësit kanë qëndrime të ndryshme sa u përket elementeve përshkruese të asaj që konsiderohet mbingarkesë kurrikulare, faktorëve specifikë që ndikojnë në mbingarkesë kurrikulare, dhe të rolit e shfrytëzimit të çështjeve

ndërkurrikulare. Mirëpo, pothuajse të gjithë mësimdhënësit kanë dhënë elemente të përvojës së tyre, që tregojnë për prezencë të mbingarkesë kurrikulare, e cila i ka atakuar edhe mësimdhënësit në punën e tyre. Një përmbledhje e qëndrimeve të mësimdhënësve lidhur me këtë aspekt pasqyrohet në tabelën në vijim, të organizuar në nënkategoritë dhe të renditur sipas shpeshësisë së informacionit të identifikuar.

Tabela 18. Mbingarkesa kurrikulare dhe faktorët e saj nga perspektiva e mësimdhënësve

Nënkategoria	Tema specifike nga nënkategoritë
Përshkrimi i mbingarkesës kurrikulare	<ul style="list-style-type: none"> - Me mbingarkesë nënkupton përmbajtjet e shumta në tekstet shkollore; - Puna administrative e mësimdhënësve; - Mbingarkesa kurrikulare nënkuptohet përsëritja e temave, si dhe rezultatet për fushë, për temë, shumë punë administrative, që në fund rezultatet janë të njëjta si me kurrikulën paraprake; - Mbingarkesë është kur vazhdimisht japim detyra të shtëpisë për nxënës; - Mbingarkesa faktor kufizues në zhvillimin e mendimit kritik; - Koha e shkurtër e orës mësimore për arritjen e kritereve të suksesit; - Numri i lëndëve mësimore, temave, dhe vlerësimi i nxënësve; - Pamundësia për të mbuluar të gjithë planin dhe programin mësimor; - Qasja e re, e cila po merr kohë deri sa mësimdhënësit të mësohen me këtë qasje të kurrikulës.
Faktorët mbingarkesës kurrikulare	<ul style="list-style-type: none"> - Tekstet shkollore; - Puna administrative; - Vlerësimi i nxënësve, testet me shkrim, kur ka edhe forma të tjera të vlerësimit;

- Numri i madh i lëndëve dhe temave;
- Rezultatet e ngarkuara në numër dhe në përmbajtje;
- Qasja ndaj mësimdhënies dhe punës me tekste shkollore;
- Angazhimi i tepërt me detyra të shtëpisë;
- Kushtet dhe ambienti punës në shkollë jo i përshtatshëm për zbatimin e kurrikulës;
- Tema mësimore të ngarkuara, si rezultat, nxënësit ngarkohen edhe me punë/detyra në shtëpi;
- Numër i madh i nxënësve nëpër klasa;
- Çantat e ngarkuara, numër i madh i librave;
- Kohë e pamjaftueshme në dispozicion për shtjellim të temave;
- Mospërshtatja e temave mësimore për nxënës;
- Shumë aktivitete, teste, detyra, gara, projekte, numër i madh i lëndëve etj.

Çështjet
ndërkurrikulare

- Po, përfshihen në planifikim, nuk mendojmë se kanë shkaktuar mbingarkesë;
- Janë pjesë të planifikimeve, por jo në masë të kënaqshme;
- Ka mbingarkesë të mësimdhënësit dhe të nxënësit e ciklit të ulët;
- Mbingarkesë më shumë të në mësimdhënësit;
- Ka raste kur shkaktojnë mbingarkesë, por mundohemi të japim udhëzime, varësisht nga niveli i nxënësve;
- Po, kanë shkaktuar mbingarkesë;
- Te nxënësit ka mbingarkesë;
- Të panevojshme dhe të porealizueshme ndonjëherë.

4.3.1.3. Pikëpamjet e mësimdhënësve për ndikimin mbingarkesës kurrikulare

Të gjeturat nga perspektiva e mësimdhënësve për ndikimin e mbingarkesës kurrikulare pasqyrohen në raport me ndikimin në arritjet/rezultatet e nxënësve, mirëqenien e nxënësve dhe në punën e vetë mësimdhënësve.

Ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në arritjet/rezultatet e nxënësve. Përshkruhet në mënyra të ndryshme nga mësimdhënësit e arsimit fillor (klasat 1-5) dhe të mesëm të ulët (klasat 6-9). Pjesa më e madhe e mësimdhënësve që konsiderojnë se ka mbingarkesë kurrikulare, shprehen se ajo ndikon në suksesin e nxënësve, të cilët nuk mund t'i arrijnë rezultatet e të nxënësve në klasat apo lëndët përkatëse.

Për më tepër, pjesëmarrëset deklaruan se ndikimet e mbingarkesës kurrikulare në arritjet apo rezultatet e nxënësve janë të shumta, ato reflektohen në pamundësinë e shumë nxënësve për t'i arritur rezultatet e të nxënësve, vështirësitë që nxënësist kanë në të nxënësve të tyre, arritjet jo të mirë në lëndët bazë, të mësuarit sipërfaqësor, të mësuarit mekanik, shpesh vetëm për të marrë nota, vlerësimin subjektiv etj.

Duhet theksuar se mësimdhënësit kur flasin për ndikimin e mbingarkesës kurrikulare në arritjet/rezultatet e nxënësve, një pjesë e madhe e mësimdhënësve, kryesisht theksin e vënë tek nxënësist me arritje të ulët në mësim, apo te nxënësist që nuk angazhohen në mësim.

Nxënësist, për shkak të mbingarkesës kurrikulare, nuk po arrijnë të kenë suksese të mira në mësim, atëherë ata po kanë një lloj tërheqje, e cila pastaj po shkakton probleme në aktivitetin e vazhdueshëm në klasë, duke reflektuar edhe në nivelin e ulët të arritjes së kompetencave të përcaktuara me kurrikulë (m/63, mësimdhënës i Matematikës, shkollë urbane).

Ka mësimdhënës të cilët ndikimin e mbingarkesës kurrikulare e ndërlidhin edhe me rezultatet e ulëta në studimin PISA, por numri i tyre është i vogël.

Puna në shkolla, bazuar në përmbajtje e jo në kompetenca, është faktori kryesor që na nxjerr dobët në PISA. Akoma në shkollat tona po punohet, vlerësohet dhe certifikohet vetëm në njohuri e dije, pa

kaluar në kompetenca, dhe nxënësit tonë nuk e kanë guximin, lirinë e brendshme dhe besimin e shpërfaqjes së kapaciteteve personale.... (m/64, mësimdhënës i Biologjisë, shkollë urbane).

Ka ndërlikime të rezultateve të kurrikulës bazë me testin PISA, por jo shumë. Dallimi është në qasje, duhet pranuar se ndryshon qasja e mësimdhënësve dhe e nxënësve në punën me kërkesat e kurrikulës, përballë qasjes ndaj testit PISA dhe testeve tjera ndërkombëtare. Tekstet shkollore kanë mungesë të materialit (pyetjeve, detyrave, alternativave, përshkrimi i ngjarjeve...), që kërkohen në detyrat/pyetjet e testeve. Mësimdhënësit kanë pak informata për materialin e testit PISA, TIMSS, PIRLS dhe rrjedhimisht nuk zhvillojnë dhe ushtrojnë formate të tilla të testeve. Në anën tjetër, nxënësit nuk kanë motiv për të përfaqësuar në mënyrë dinjitoze shtetin e Kosovës, prandaj duhet të gjenden forma të motivimit të atyre nxënësve që marrin pjesë në atë test (m/63, mësimdhënës i matematikës, shkollë urbane).

Marrë në përgjithësi, mësimdhënësit e shohin ndikimin e shumë faktorëve që lidhen me mbingarkesën kurrikulare në rezultatet e nxënësve, si numri i madh i lëndëve mësimore, numri i madh i përmbajtjeve që duhen mësuar, numri i madh i nxënësve në klasë, shpeshësia e vlerësimit, angazhimi i nxënësve me detyra të shumta të shtëpisë etj. Në mesin e mësimdhënësve, ekziston mendimi se qasja e mësimdhënësve ndaj vlerësimit të nxënësve ka bërë që nxënësit të mos angazhohen në mësim për t'i arritur rezultatet e të nxënësve, për t'i zhvilluar kompetencat kryesore, por të angazhohen vetëm për të marrë nota që sigurojnë një sukses përfundimtar numerik të mirë.

Sipas mësimdhënësve, ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në arritjet e nxënësve konsiderohet të jetë i lidhur me nivelin e angazhimit të mësimdhënësve. Sipas përshkrimeve të 4-5 mësimdhënësve, angazhimi i mësimdhënësve me punë administrative ka prodhuar si pasojë zhvendosjen e fokusit nga nxënësi te planifikimi i mësimëve, formë e cila, sipas tyre, nuk po reflekton në arritjet e nxënësve.

Në pikëpamjet e disa mësimdhënësve, mbingarkesën kurrikulare nuk e shohin si faktor me ndikim negativ në arritjet e nxënësve, por atë më shumë e shohin si faktor ndikues në punën e tyre, e cila ata i bën të jenë të ngarkuar.

Ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e nxënësve. Aspekte të mbingarkesës kurrikulare, të cekura më lart, sipas mësimdhënësve, kanë ndikuar që shkolla të bëhet e pakëndshme për shumë nxënës, të rritet numri i mungesave të nxënësve, të bjerë interesimi për realizimin e detyrave, dhe për arritje të rezultateve në përgjithësi. Sipas mësimdhënësve të përfshirë në këtë studim, në mesin e nxënësve të tyre ka lodhje, demotivim për mësim, shqetësime, stres, mungesë vullneti për mësim, dyshime në kapacitet dhe mundësitë për të mësuar, mosinteresim për realizimin e detyrave, refuzim për të mësuar, zhgënjim, dhe për pasojë edhe humbje e dëshirës dhe ambicieve për mësim, dyshime nëse qasja e re është e realizueshme, deformime trupore nga çantat e rënda etj.

Kështu e përshkruajnë disa mësimdhënës ndikimin e mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e nxënësve:

- *Ngarkesa po ndikon në aspektin emocional të fëmijëve. Fëmijët shpeshherë janë të stresuar në mosarritjen e kryerjes së detyrave me kohë dhe në formën e kërkuar (m/65 - mësuese klase, shkollë urbane).*
- *Ngarkesa po ndikon që nxënësi/ja të fokusohet në arsyetim/llogaridhënie për rezultate, para prindit, e jo në besueshmëri sipas dëshmive dhe kënaqësi për arritjet në mësim; Tendencë në rritje e prirjeve të nxënësve për mbulim të mos punës e jo ambicie për punë etj. (m/64 - mësimdhënës i Biologjisë, shkollë urbane).*
- *Disa nxënës shfaqin habi kur nuk mund të arrijnë rezultatin e duhur, ata sikur pajtohen se nuk po ia dalin me mësim, por në mundohemi t'ua kthejmë vetëbesimin dhe të vazhdojmë tutje (m/32- mësimdhënëse e Gjuhës shqipe, kryetare e aktivitetit profesional në një shkollë urbane).*

- *Është diskutuar mjaft për peshën e madhe të çantës së fëmijëve, pastaj ngarkesat e mëdha, që po shkaktojnë zhgënjim dhe për pasojë edhe humbjen e dëshirës për mësim, etj. (m/30 - mësimdhënës e Fizikës, kryetare e aktivitetit profesional në një shkollë urbane).*

Ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në punën e mësimdhënësve. Sipas mësimdhënësve, mbingarkesat në punën e tyre, që lidhen me kurrikulën, janë të shumta, si: puna administrative, me dokumente përshkruese, pastaj parapërgatitjet për lëndën, temën, njësinë, shtuar këtu edhe mungesën e teksteve, ose teksteve joadekuate. Si rrjedhojë, nevojën për hulumtime, sigurim të materialeve shpesh, trysnia nga kërkesat e prindërve rreth vlerësimit të nxënësve, koha në dispozicion e pamjaftueshme për realizimin e planifikimeve mësimore, sjelljet dhe mosinteresimi i nxënësve për arritje, puna me nxënës të painteresuar për mësim, të cilët humbin kohën pas internetit etj. Të gjitha këto, sipas mësimdhënësve, kanë bërë që mësimdhënësit të kenë lodhje, ngarkesë psikike, ngarkesë emocionale, presion, trysni mendore, huti, paqartësi, demotivim për punë, humbje të kreativitetit, shpesh të mos e realizojnë atë që e planifikojnë etj.

Kështu e përshkruajnë disa mësimdhënës ndikimin e mbingarkesës kurrikulare në punën e tyre:

- *Mësimdhënësit janë të mbingarkuar me planifikime ditore, sepse një i tillë merr shumë kohë, duke harruar ndonjëherë qëllimet kryesore që i kemi me nxënës, duke u marrë me 'letra'! (m/26 - mësimdhënës i Matematikës, shkollë rurale);*
- *Jo vetëm tek unë, por 99% e mësimdhënësve në shkollën time janë të ngarkuar me çështje të kota, me dokumente që plotësojnë kot, me plane ditore që i bëjnë sa për sy e faqe, me gjëra që nuk japin asnjë rezultat. Kjo na e bën vendin e punës të mërziqshëm dhe ka performancë të keqe, si pasojë e mbingarkesës (m/40 - mësimdhënës e Biologjisë, shkollë rurale).*
- *Ngarkesa është e madhe, duhet të përshkruajmë çdo fjalë që ka të bëjë me njësinë mësimore (të mbushim shumë letra), e mendoj se duhet të përqendrohemi më tepër në përmbajtje (m/38 - mësimdhënës e Gjuhës shqipe, shkollë urbane).*

Megjithatë, sipas një pjese të konsiderueshme të mësimit, suksesi i arritur në këto procese nuk ka munguar, falë angazhimit të tyre, por edhe mirëkuptimit që kanë arritur me nxënës dhe prindër. Ka të tillë që shprehen se si individë nuk e ndiejnë mbingarkesën kurrikulare.

Personalisht, nuk e ndiej mbingarkesën kurrikulare. Për mua mbingarkesë dhe efekt negativ ndikues në punën time paraqesin kërkesat jashtë mësimit. Unë si mësues nuk ndihem rehat që të ndaj kohë për punë administrative jashtë ndikimit të drejtpërdrejtë në procesin e mësimit, bie fjala plotësimi i dokumentacionit shkollor, libra amë, protokolle, fletëkalime etj. (m/64 - mësues i Biologjisë, shkollë urbane).

Referuar raportimeve më sipër, për ndikimin e mbingarkesës kurrikulare në arritjet dhe mirëqenien e nxënësve, si dhe në punën e mësimit, mund të thuhet se mësuesit ofrojnë evidenca të shumta për ndikimet e mbingarkesës kurrikulare që ata i kanë vërejtur te nxënësit e tyre, por edhe nga reflektimi i saj në punën e tyre. Një përmbledhje e qëndrimeve të mësimit lidhur me këto aspekte pasqyrohet në tabelën në vijim, të organizuar në nënkategori dhe tema specifike të renditura sipas shpeshtësisë së informacionit të identifikuar.

Tabela 19. Reflektimi i mësimit ndaj ndikimit të mbingarkesës kurrikulare te nxënësit dhe ndikimit në punën e tyre

Nënkategoria	Tema specifike
Ndikimi në arritjet e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> - Vështirësi në të nxënë; - Arritje jo të mira; - Nxënësit i mësojnë shpejt përmbajtjet, por edhe i harrojnë; - Shumica e rezultateve tentohet të arrihet vetëm si mësim teorik; - Fokusimi në mësim mekanik, mësim përmendesh; - Angazhimi i nxënësve vetëm për nota - suksesin përfundimtar;

	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi/ja përqendrohet në kalueshmëri e jo në zhvillim personal; - Zvogëlimi i produktivitetit në arritjen e rezultateve; - Rezultate të ulëta në PISA; - Arritja e rezultateve është e pamundshme; - Mosinteresim i nxënësve për mësim; - Të mësuarit josistematik.
Ndikimi në mirëqenien e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> - Stres te nxënësit; - Lodhje e nxënësve; - Mosinteresim për mësim; - Mbingarkesa me çanta të rënda, deformimet trupore; - Padisponueshmëri, mungesë vullneti për mësim, refuzim për të mësuar; - Tërheqje nga mësimet; - Paraqitje e mosbesimit për të arritur rezultate në mësim; - Pasiguri në mundësitë e nxënësit, shqetësime; - Zhgënjim dhe për pasoj edhe humbje e dëshirës për mësim; - Jo ambicie për angazhim në mësim; - Ka ndikuar në rënien e interesimit të nxënësve për mësim, dyshime për arritje; - Probleme në aktivitetet e angazhimit në klasë.
Ndikimi në punën e mësimitdhënësve	<p>Forma të shprehjes së mbingarkesë së mësimitdhënësve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbingarkesë administrative, kërkohet shumë punë administrative;

- Mbingarkesë me parapërgatitje;
- Mbingarkesa me lëndë mësimore në arsimin fillor;
- Mbingarkesë nga mangësitë e teksteve ekzistuese, sigurimin e burimeve plotësuese;
- Planifikimi dhe zbatimi i orës mësimore brenda trysnisë së kohës/orës mësimore;
- Mbingarkesa me strukturën e nxënësve, kërkesat e prindërve, etj.;
- Koha e pamjaftueshme në trajtimin e duhur të rezultateve.

Ndikimi në mirëqenie të mësimdhënësve

- Humbje e qetësisë emocionale;
- Mbingarkesë psikologjike, e cila në disa raste shkakton huti dhe paqartësi;
- Humbje e kreativitetit;
- Trysni mendore;
- Mbajtje presion;
- Lodhje, nervozizëm, por edhe sukses.

4.3.1.4. Çfarë mund të bëhet për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare?

Mësimdhënësit kanë përmendur disa strategji, veprime, që duhen ndërmarrë për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare, referuar aktorëve kryesorë planifikues dhe zbatues të kurrikulës. Ata konsiderojnë se MASHTI fillimisht duhet të bëjë një analizë të dokumenteve kurrikulare dhe mënyrës së zbatimit të deritanishëm. Propozojnë që të rishikohen rezultatet e të nxënësve, kurrikulat/programet lëndore, për të cilat janë ngritur shqetësime nga mësimdhënësit dhe theksi vihet te përshtatja e tyre me moshën e nxënësve. Mësimdhënësit sugjerojnë që të hartohen udhëzues të tjerë për zbatim të

kurrikulës, që ndihmojnë mësimdhënësit në veprimet e tyre. Ka sugjerime nga mësimdhënësit edhe për zvogëlimin e numrit të lëndëve dhe realizimin e mësimin përmes fushave kurrikulare e shohin si mundësi tjetër për zbutjen e mbingarkesës kurrikulare.

Disa veprime, të cilat duhet të ndërmerren nga niveli qendror deri te shkolla, që përvijohen më shumë nga mësimdhënësit, janë si në vijim:

- Hartimi i teksteve të reja për klasat që aktualisht mungojnë, rishikimi i teksteve mësimore ekzistuese;
- Rishikimi i rezultateve të nxënësve në kurrikulat/programet lëndore, për të cilat janë ngritur shqetësime dhe zvogëlimi i numrit të lëndëve mësimore (në mënyrë specifike në arsimin fillor);
- Hartimi i politikave mbështetëse dhe të zbatueshme për mësimdhënësit dhe nxënës nga ana e MASHTI-t, i domosdoshëm.
- DKA-të të përcjellin punën në shkolla dhe të krijojnë kushte më të mira për punë;
- DKA-të të ofrojnë infrastrukturë të përshtatshme për zbatimin e kurrikulës së re, si; zvogëlimin e numrit të nxënësve nëpër klasa, krijimin dhe pajisjen e kabineteve me mjete dhe të qasshme për punë praktike, internet etj;
- Udhëheqësit e shkollave të jenë në mbështetje të nxënësve dhe mësimdhënësit, sidomos në pajisje me mjete didaktike, pajisje me TIK etj.
- Prindërit të përkushtohen më shumë me fëmijët e tyre, t'i mbikëqyrin ata dhe t'i mbështesin në përdorimin e drejtë të internetit.

Në raport me mësimdhënësit, si t'i qasen trajtimit dhe zvogëlimit të mbingarkesës kurrikulare, vetë mësimdhënësit sugjerojnë se ata, për të adresuar në mënyrë të duhur këtë problematikë, duhet të jetë sa më të qartë dhe praktikë në mësimdhënie, njësitë mësimore t'i thjeshtojnë dhe t'i përshtatin me nivelin dhe moshën e nxënësve, t'i evitojnë detyrat e panevojshme të shtëpisë, t'i angazhojnë nxënësit me mësim shtesë dhe plotësues, në varësi të nevojave të nxënësve. Mësimdhënësit bëhen

vetëkritikë edhe ndaj mënyrës së planifikimeve mësimore, ata shprehen se planet mësimore duhet të përgatiten/hartohen nga vetë mësimdhënësit, për nxënësit e tyre, e jo të huazohen nga të tjerët, sepse kjo sjell vështirësi.

Veprime të tjera, që sugjerohen për mësimdhënësit nga mësimdhënësit, lidhur me trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare, prekin edhe aspekte të tjera për sa i përket punës bazuar në kurrikula - rezultate të të nxënësve, jo në libra, planifikimit të aktiviteteve më atraktive për nxënësit, shmangies nga përmbytjet mësimore jo të qarta për nxënësit dhe të papërshtatshme me moshën e tyre. Po ashtu, puna me nxënësit të jetë e bazuar në nevojat e nxënësve dhe mbi njohuritë paraprake të nxënësve, më pak detyra të shtëpisë për nxënësit, projekte për nxënësit të koordinuara, praktikimit të formave të ndryshme vlerësimit, përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie, përfshirjes së nxënësve në format alternative të mësimin, mësim plotësues, shtues, aktivitete jashtëshkollore dhe aktivitete ekstarkurrikulare.

Lidhur me mbështetjen e nevojshme, kërkesa më e theksuar e mësimdhënësit është që të përmirësohen kushtet për punë dhe zbatim të suksesshëm të kurrikulës, përfshirë krijimin e ambienteve më të përshtatshme të punës, furnizimin me mjete didaktike dhe të konkretizimit, pajisjen e klasave me teknologji, internet dhe të tjera. Zvogëlimi i numrit të nxënësve në klasa, në shkollat urbane, gjithashtu konsiderohet mbështetje.

Mësimdhënësit zhvillimin profesional me bazë në shkollë, mentorimet ndërkollegiale, ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme cilësore dhe ofrimin e mbështetjes edhe pas përfundimit të trajnimeve, rritjen e cilësisë së trajnimeve, i shohin si disa nga mënyrat dhe mundësitë për përkrahje më të avancuar të mësimdhënësit në proceset që lidhen me zbatimin e kurrikulës.

Përveç asaj që u tha më lart, mësimdhënësit sugjerojnë që të ketë sa më shumë hulumtime të ngjashme, në të cilat do të përfshiheshin më shumë mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit. Gjetjet dhe sugjerimet e dalin nga këto hulumtime të merren parasysh nga institucionet kompetente.

Vërejtjet dhe sugjerimet e mësimdhënësit të mos bien në vesh të shurdhër, siç ka qenë edhe një herë tjetër për heqjen e gabimeve nga

tekstet, ku me pas “korigjimet e teksteve” dolën me plot gabime (m/40, mësimdhënës i Gjuhës shqipe, shkollë rurale).

Them se është një hulumtim i qëlluar, duke shpresuar që do të ndikojë në shkarkimin e ngarkesave të tepërta, si për nxënësin, mësimdhënësin dhe prindërit (m/65, mësuese klase, shkollë urbane).

Gjithashtu, mësimdhënësit sugjerojnë që kur iniciohen ndryshimet në kurrikula të ftohen më shumë mësimdhënësit në takime dhe të dëgjohen drejtpërdrejt nga ta idetë dhe sugjerimet për nevojat për ndryshime, mundësitë e zbatimit të ndryshimeve në nivel shkolle, në mënyrë që pasqyra mbi gjendjen reale të jetë sa më e qartë dhe të mos ketë hezitime në zbatimin e kurrikulës, siç janë shfaqur në këtë reformë kurrikulare. Fushatat për vetëdijesimin e prindërve lidhur me rolin e tyre në edukimin e fëmijëve, gjithashtu, janë të sugjeruara nga mësimdhënësit. Mësimdhënësit thërresin që secili të kryejë punën dhe obligimin e tij me sa më përkushtim dhe përgjegjësi. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të funksionojë me sukses zinxhiri zbatues i kurrikulës dhe i edukimit të fëmijëve.

Mësimdhënësit e përfshirë studimin e shohin me interes për tri aspekte:

- nevoja e trajtimit të problematikës së mbingarkesës kurrikulare, të cilën e kanë vërejtur dhe përjetuar;
- mundësia dhe hapësira e ofruar për të shprehur pikëpamjet e tyre, për të marrë ide të reflektimit ndaj mbingarkesës që ata vetë mund ta trajtojnë gjatë punës së tyre me nxënësit;
- orientimet që pritet të dalin nga gjetjet e hulumtimit për institucionet arsimore që kanë rol në evitimin dhe zvogëlimin e mbingarkesës kurrikulare.

4.3.2. Perceptimet e nxënësve për mbingarkesën e tyre në mësim

Gjetjet kryesore për mbingarkesën e nxënësve në mësim, nga perspektiva e nxënësve, raportohen dhe prezantohen në katër nënkategori tematike, me elemente përshkruese të temave specifike nga secila nënkategori, të cilat së bashku reflektojnë gjetjet kryesore për problematikën e trajtimit të

mbingarkesës së nxënësve në mësim. Pjesa e parë raporton gjetjet kryesore për përgjigjet e nxënësve lidhur me angazhimin e tyre në mësim dhe kohën që nxënësit e ndajnë për t'u angazhuar rreth mësimëve dhe detyrave të shtëpisë. Pjesa e dytë pasqyron përgjigjet e nxënësve lidhur me mbingarkesën e tyre në mësim dhe faktorët ndikues. Pjesa e tretë raporton gjetjet kryesore nga përgjigjet e nxënësve lidhur me ndikimin që ka mbingarkesa e nxënësve në mësim, si reflektohet ajo në rezultatet dhe në mirëqenien e tyre. Ndërsa, pjesa e katërt ofron disa ide të nxënësve për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës së nxënësve në mësim.

4.3.2.1. **Angazhimi i nxënësve në mësim dhe koha e angazhimit**

Angazhimi i nxënësve në procesin e të mësuarit varet nga faktorë të shumtë. Angazhimi i tyre në mësim nuk është i njëjtë në të gjitha lëndët mësimore dhe as nuk mund të flasim për kohën e njëjtë të angazhimit të nxënësve, për arritjen e rezultateve të të nxënësve në lëndët apo klasën përkatëse.

Lidhur me angazhimin e nxënësve në mësim, nxënësit e përfshirë në këtë studim janë pyetur për lëndët mësimore në të cilat ata janë më shumë të angazhuar, mësojnë më shumë, arsyet apo faktorët që ata i nxisin të mësojnë më shumë, si dhe për kohën mesatare të angazhimit të tyre gjatë një dite për mësim dhe detyra të shtëpisë. Këto elemente janë diskutuar tërthorazi me nxënës për të nxjerrë edhe aspektet e mbingarkesës së tyre në mësim.

Angazhimi i nxënësve në mësim dhe lëndët mësimore në të cilat nxënësit mësojnë më shumë. Referuar përgjigjeve të marra nga nxënësit, shohim se angazhimi i nxënësve në mësim dallon nga lënda në lëndë mësimore. Mësimi i asnjë lënde mësimore nuk përjashtohet nga nxënësit e klasave të 8-ta dhe të 9-ta, që ishin pjesë e këtij studimi.

Veçimi i disa lëndëve mësimore, për të cilat nxënësit shprehen se mësojnë dhe janë më shumë të angazhuar, është evident në reflektimet e nxënësve të këtij studimi. Lëndët mësimore në të cilat nxënësit e përfshirë në studim angazhohen më shumë që të mësojnë janë Gjuha shqipe, lëndët nga fusha e shkencës (Biologji, Kimi dhe Fizikë), pastaj lënda e Matematikës, Gjuha angleze, Edukata qytetare etj. Për secilën lëndë mësimore që nxënësit kanë specifikuar se angazhohen më shumë të mësojnë janë edhe arsyet e angazhimit të tyre në lëndët mësimore përkatëse, të përshkruara më sipër,

dhe një pjesë e madhe e tyre lidhen me faktorin mësimdhënës dhe me praktikën e mësimdhënies së tyre.

Në anën tjetër, arsyet apo faktorët që nxënësit i nxisin të mësojnë më shumë në lëndët mësimore, në të cilat ata angazhohen më shumë në mësim, sipas nxënësve, janë nga interesimet e tyre për lëndë mësimore të caktuara, perspektiva e disa lëndëve në shkollimin e mëtejshëm, si dhe nga faktorë të tjerë që lidhen me qasjet metodologjike të mësimdhënies që praktikohen gjatë punës me nxënës, komunikimi me nxënës, ndikimet nga familja dhe moshatarët, perspektiva e gjuhës angleze, përmbajtjet më atraktive, por edhe përfshirja e lëndëve në Testin e Arritshmërisë.

Sipas nxënësve, ata mësojnë për shkak se dëshirojnë të fitojnë njohuri të caktuara në lëndët e klasës përkatëse, ose ngaqë janë të interesuar për ndonjë lëndë të veçantë për shkak të interesimit të tyre, shkollimit të mëtejshëm, dhe nxitjeve që u bëjnë mësimdhënësit me punën e tyre.

Koha e angazhimit të nxënësve në mësim pas mësimit të rregullt në shkollë. Angazhimi i nxënësve në mësim, pas mësimit të rregullt në shkollë, në masë të madhe i referohet gatishmërisë së tyre për të marrë pjesë dhe për të pasur sukses në procesin e mësimit të tyre dhe detyrave që marrin nga mësimdhënësit, duke përfshirë edhe detyrat e shtëpisë.

Koha e angazhimit të nxënësve për mësim në shtëpi, sipas nxënësve, është e lidhur me përmbajtjet mësimore që i mësojnë në shkollë, për të cilat shprehen se janë shumë të zgjeruara dhe kanë shumë gjëra të vështira që duhet të përsëriten disa herë në shtëpi për t'i kujtuar dhe përvetësuar më mirë.

Përgjigjet e nxënësve rreth kohës së angazhimit të tyre në mësim dhe detyra të shtëpisë përshkruhen të jenë me dallime të mëdha. Më shumë se gjysma e mostrës së studimit me nxënës deklarohen se angazhohen për mësim dhe detyra të shtëpisë mesatarisht 4-5 orë gjatë një dite, rreth 40 % rreth 1-3 orë, pjesa tjetër, rreth 10 %, deklarojnë se kanë mbi 5 orë angazhim për mësim në shtëpi dhe detyra të shtëpisë.

Sipas nxënësve, angazhimi i tyre për mësim në shtëpi dallon sipas orarit mësimor ditor që kanë në shkollë dhe numrit të lëndëve mësimore. Në lëndët ku ka mungesë të librave shkollorë ose kur njësitë mësimore nuk i kanë në

librat që mësojnë, ata shprehen se angazhohen në kohë më shumë për të siguruar materiale nga burime të ndryshme, kryesisht u referohen burimeve të internetit.

Një periudhë e angazhimit të nxënësve për mësim në shtëpi lidhet me vlerësimet me nota. Sipas nxënësve, angazhimi i tyre për mësim në shtëpi dallon nga periudha në periudhë e vitit shkollor, gjatë kohës së vlerësimit të nxënësve me gojë ose me teste, ku kjo kohë përshkruhet të jetë edhe më e gjatë.

Koha e angazhimit të nxënësve vetëm për detyra të shtëpisë. Janë detyrat e shtëpisë ato të cilat mbeten ndër aktivitetet jo të pëlqyera për shumë nxënës, të cilat sipas nxënësve marrin kohën më të madhe të angazhimit të tyre rreth mësimin në shtëpi. Nga intervistat me nxënës, rezulton se më tepër se gjysma e tyre mesatarisht gjatë një dite ndajnë kohë për detyra të shtëpisë 2-3 orë, rreth 1/3 e tyre nga 1 orë, kurse të tjerët mbi 3 orë vetëm në kryerjen e detyrave të shtëpisë.

Pikëpamjet e nxënësve për angazhimin e tyre në mësim dhe kohën e angazhimit pasqyrohen në tabelën në vijim, në të cilën pikëpamjet e nxënësve janë organizuar në tri nënkategori të përshkruara më sipër, pastaj për secilën nënkategori janë të renditura tema specifike, sipas shpeshtësisë së informacionit të identifikuar nga të dhënat e mbledhura me nxënës.

Tabela 20. Angazhimi i nxënësve në mësim - koha e angazhimit

Nënkategoria	Tema specifike
Arsyet kryesore për angazhimin më të madh të nxënësve për mësim në disa lëndë mësimore	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Mënyrat e shpjegimit nga mësimdhënësit;</i> - <i>Qasja e komunikimit të mësimdhënësve rreth mësimve;</i> - <i>Interesimi i nxënësve për lëndë mësimore;</i> - <i>Perspektiva e disa lëndëve mësimore, specifikisht e gjuhës angleze për arsye të përdorimit të saj në tërë botën dhe për mundësi të komunikimit;</i> - <i>Ana praktike;</i>

	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Nxitja nga familja dhe bashkëmoshatarët;</i> - <i>Përfshirja e lëndëve në testin e arritshmërisë;</i> - <i>Orientimi i nxënësve për shkollim të mëtejshëm;</i> - <i>Përmbajtjet atraktive në disa lëndë mësimore.</i>
Koha e angazhimit të nxënësve për mësim në shtëpi	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Të angazhuar në shtëpi rreth mësimave dhe detyrave të shtëpisë, çdo ditë deri në 5 orë;</i> - <i>Në ditët e përfundimit të periudhës mësimore, koha e të mësuarit shkon nga 4 deri në 6 orë;</i> - <i>Angazhimi me shumë orë për mësim dhe detyra në shtëpi, me dallime në kohë - është i lidhur me mungesën njësisive mësimore në tekste shkollore, ngarkesën e përmbajtjeve mësimore që duhet të mësohen;</i> - <i>Angazhimi për mësim në shtëpi me dallime në kohë – në varësi varet nga numri i lëndëve që kanë dhënë detyra të shtëpisë dhe orari mësimor për ditën e nesërme;</i> - <i>Gjatë periudhës së testeve apo për vlerësim me gojë, nxënësit shprehen se janë të ngarkuar 6-8 orë.</i>
Koha e angazhimit të nxënësve vetëm për detyra të shtëpisë	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Angazhimi për detyra të shtëpisë, deri në 3 orë;</i> - <i>Angazhimi për detyra të shtëpisë, deri në 4 orë;</i> - <i>Angazhimi për detyra të shtëpisë, çdo ditë së paku 2 orë;</i> - <i>Ngarkesa për bërjen e detyrave të shtëpisë është shumë e madhe;</i> - <i>Ka shumë detyra të shtëpisë dhe pak udhëzime;</i> - <i>Koha e angazhimit për detyrat e shtëpisë e pakufizuar lidhet edhe me ruajtjen e suksesit në lëndët që japin edhe detyra të shtëpisë.</i>

E gjithë kjo që u përshkrua më sipër dhe u pasqyruara në tabelën më sipër tregon se lëndët mësimore në të cilat nxënësit mësojnë apo angazhohen më shumë dhe kohëzgjatja e mësimit të tyre në shtëpi, për mësim dhe detyra të shtëpisë, është e ndryshme, në masë të madhe është individuale dhe e varur nga obligimet që marrin nga mësimdhënësit dhe mënyra e të mësuarit të tyre.

4.3.2.2. **Reflektimi i nxënësve për faktorët e mbingarkesës së tyre në mësim**

Për aq përgjigje sa kanë dhënë nxënësit, mësojmë se mbingarkesa e tyre me mësim është e pranishme si te nxënësit e klasës së 8-të, ashtu edhe te nxënësit e klasës së 9-të. Mbingarkesa e nxënësve në mësim, sipas përshkrimeve të vet nxënësve, dallon nga nxënësi në nxënës, sepse shumica e nxënësve mbingarkesën e tyre e ndërlidhin më shumë me kohën e angazhimit për mësim dhe detyra të shtëpisë, si dhe në temat mësimore, të cilat kërkojnë angazhim më të madh. Ka nxënës që flasin edhe për mbingarkesën me numër të lëndëve mësimore. Kur iu referohen numrit të madh të lëndëve mësimore, nxënësit specifikojnë lëndë mësimore të cilat nga emërtimi që ofrojnë nënkuptohet se referimi bëhet në lëndët e kurrikulës me zgjedhje, si p.sh. Orientimi në karrierë, Kima e thelluar etj. Sipas nxënësve, në kuadër të disa lëndëve (nuk specifikohen lëndët) ka tema të cilat kërkojnë angazhim më të madh dhe për ta kjo paraqet ngarkesë më shumë sesa që duhet. Kështu shprehet një nxënëse e klasës së 9-të nga një shkollë urbane:

Mendoj se për moshën tonë angazhimi që bëjmë paraqet ngarkesë më shumë sesa që duhet. Temat mësimore janë më në detaje se zakonisht dhe gjithashtu janë mësimore që vite më parë janë mësuar në shkolla të mesme të larta, tani janë bartur në klasën e 9-të.

Faktorët kryesorë që ndikojnë në mbingarkesën e nxënësve në mësim, janë të shumtë, si: numri i lëndëve mësimore; numri i temave/njësive mësimore të ngarkuara me fakte historike - data, numra, teori, informacione të parëndësishme, të dhëna formale etj.; mbingarkesa me tekste dhe materiale mësimore (libra, fletore pune, doracakë); mbingarkesa me aktivitete

mësimore dhe jashtëmësimore; mbingarkesa me detyra të shtëpisë; shpeshësia e vlerësimeve me teste; mësimdhënia dhe nxënia etj.

Të gjithë këta faktorë reflektohen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë nga nxënësit e këtij studimi, disa nga një numër më i madh i nxënësve dhe disa nga një numër më i vogël i nxënësve. Disa nxënës kanë lustruar 2- 3 faktorë kryesorë që ndikojnë në mbingarkesën e tyre në mësim. Nga kuantifikimi i përgjigjeve të nxënësve lidhur me faktorët kryesorë që ndikojnë në mbingarkesën e tyre në mësim, kemi arritur të nxjerrim një renditje të faktorëve më ndikues, e cila pasqyrohet si në vijim:

- shpeshësia e vlerësimeve me teste (shprehen rreth 44 % e nxënësve);
- temat/njësitë mësimore në kuadër të disa lëndëve (shprehen rreth 43 % e nxënësve);
- tekstet shkollore (shprehen rreth 40 % e nxënësve);
- detyrat e shtëpisë (shprehen rreth 39 % e nxënësve);
- mësimdhënësit dhe mësimdhënia (shprehen rreth 34 % e nxënësve);
- faktorë të tjerë (shprehen rreth 20 % e nxënësve).

Mbingarkesa nga shpeshësia e vlerësimeve me teste. Nxënësit, kur flasin për mbingarkesën e tyre me shpeshësinë e vlerësimeve me teste që realizohen në lëndë të ndryshme mësimore, atë e ndërlidhin me testet e vlerësimit për tri periudhat mësimore në kuadër të vlerësimit përmbledhës VP2, por edhe me testet dhe instrumentet e tjera të vlerësimit, që përdoren në nga mësimdhënësit në kuadër të vlerësimit përmbledhës VP1. Nxënësit, kur flasin për instrumentet e vlerësimit, flasin edhe për përdorimin e panevojshëm të disa prej instrumenteve të vlerësimit, siç specifikohen për shembull instrumenti i dosjes dhe instrumenti i hulumtimit në lëndët shkencore, për të cilat shprehen se nuk i kanë të qarta kriteret e vlerësimit. Kjo, gjithashtu, lë për të kuptuar, sepse nxënësit nuk janë të informuar me qëllimet e përdorimit të më shumë se një instrumenti të vlerësimit gjatë një periudhe të mësim.

Në përshkrimet e tyre nxënësit shprehen se ka raste kur brenda një ditë të mësimit i kanë deri në 2-3 teste, ose raste kur në lëndë mësimore të caktuara brenda një periudhe mësimi vlerësohen me gojë tri herë. Një element tjetër që nxënësit e prekin në përshkrimet e tyre, që lidhet me vlerësimin për arritjet në mësime, nxënësit shprehen se në vend të vlerësimeve të shpeshta me teste, preferojnë më shumë përsëritje dhe përforsime, të cilat, sipas tyre, bëhen rrallë nga mësuesit.

Mbingarkesa me tema/njësi mësimore. Disa nga lëndët mësimore, të cilat përmbajnë tema/njësi të tepërta, sipas deklarimeve të nxënësve, janë: Biologjia, Fizika, Matematika, Gjeografia dhe Gjuha shqipe. Temat, sipas tyre, janë shumë të gjata dhe të paqarta. Nxënësit, kur flasim për temat mësimore të parapara me kurrikulat lëndore apo njësitë mësimore që shpjegohen gjatë orëve mësimore, kryesisht u referohen temave apo njësive mësimore në tekstet shkollore me të cilat punojnë. Kjo lë për të kuptuar se nxënësit nuk janë të informuar me temat mësimore dhe rezultatet e të nxënësve që priten të realizohen në periudhat mësimore.

Sipas nxënësve, në disa lëndë mësimore, nga ngarkesa me njësi mësimore që duhet të shpjegohen nga mësuesit, shpesh nuk arrihet të shpjegohen nga mësuesit, të cilat pastaj u japin për detyrë që nxënësit t'i mësojnë mësime edhe pa u shpjeguar në klasë. Në këtë drejtim, sfida sipas nxënësve shtohet, kur mungojnë shembuj praktikë nga mësuesit, shembuj në tekstet shkollore, si dhe mundësitë për të marrë informacione të tjera nga burime të sigurt. Në raste të tilla të mbingarkesës me tema/njësi mësimore, nxënësit sugjerojnë që mësuesit gjatë mësimit t'i ndajnë temat në pjesë më të vogla, të shpjegojnë ngadalë, qartë dhe vetëm gjërat elementare.

Mbingarkesa me tekste shkollore. Në kontekstin e organizimit të mësimit në shkollat e Kosovës, teksti shkollor shikohet si mjeti kryesor për mësime, i cili përgatitet për nxënës dhe shfrytëzohet edhe nga mësuesit për ta mbarështuar e organizuar mësuesin në punën me nxënës. Tekstet shkollore paraqesin një tjetër faktor të mbingarkesës së nxënësve në mësime, të theksuar edhe nga nxënësit e përfshirë në këtë studim. Elementet e mbingarkesës me tekste shkollore, që referohen më shumë nga nxënësit, janë numri i njësive mësimore në tekste, përmbajtjet e gjata, përmbajtje jo

adekuate me moshën e nxënësve, apo edhe të panevojshme, gjuha e të kuptuarit të teksteve etj.

Sipas nxënësve, tekstet shkollore që ndikojnë më së tepërmi në mbingarkesën e tyre në mësim janë tekstet e lëndës së Gjeografisë, Gjuhës shqipe, Matematikës, Fizikës dhe Biologjisë, në klasa të ndryshme. Disa përmbajtje të këtyre teksteve, sipas nxënësve, janë të gjata dhe të panevojshme. Nxënësit shprehen se shpesh ka mospërputhje të librit bazë me fletoren e punës, si dhe mospërputhje të programit me tekstet me të cilat punojnë.

Referuar klasave, në të cilat nxënësit e vijojnë mësimin këtë vit, tekstet e klasës së 9-të del të kenë më shumë ngarkesa sa u përket përmbajtjeve për të cilat nxënësit shprehen se nuk mund të mësojnë.

Një problem tjetër, që deklarojnë nxënësit e këtij studimi, është mungesa e teksteve adekuate në disa lëndë mësimore dhe, si rrjedhojë, ata janë të detyruar të mësojnë nga shënime që janë dhënë nga disa mësimdhënës dhe nga burime të tjera.

Mbingarkesa me detyra të shtëpisë. Nxënësit në shkollë nuk mund t'i përvetësojnë të gjitha njohuritë dhe të gjitha shkathtësitë që duhet t'i përvetësojnë gjatë orarit mësimor, kështu që detyrat e shtëpisë për ta jenë të pashmangshme, për përvetësimin e këtyre njohurive dhe shkathtësive. Në kontekstin e shkollave në Kosovë, ku shumica punojnë në dy ndërrime dhe shpesh në sezonin dimëror me orare të shkurtuara, detyrat e shtëpisë vazhdojnë të jepen nga shumica e mësimdhënësve.

Nga rreth 39% e nxënësve, të cilët janë shprehur se detyrat e shtëpisë janë një nga faktorët kryesorë të mbingarkesës së tyre në mësim, mbi gjysma e tyre shprehen se ata janë shumë të ngarkuar me detyra të shtëpisë, kurse pjesa tjetër shprehen se janë deri diku të ngarkuar me detyra të shtëpisë.

Një numër relativisht i vogël i nxënësve mendojnë se nuk janë të ngarkuar me detyra të shtëpisë, përkundrazi, sipas tyre, duhet të ketë më shumë detyra të shtëpisë, në mënyrë që nxënësit të jenë më të angazhuar në mësim.

Lënda nga e cila nxënësit më së tepërmi ngarkohen me detyra është ajo e Matematikës. Përveç në matematikë, sipas nxënësve, edhe në Gjuhë shqipe ata ngarkohen me shumë detyra të shtëpisë, pa specifikuar ndonjë aspekt të kësaj mbingarkese. Lëndë tjera të ngarkuara me detyra, sipas nxënësve, janë Biologjia dhe Fizika.

Nxënësit, kur shprehen për ngarkesën me detyra të shtëpisë, më shumë flasin për numrin e detyrave të shtëpisë dhe më pak për nivelin e vështirësive të tyre. Atë më shumë shprehin shqetësim për kohën e angazhimit të tyre për t'i bërë detyrat e shtëpisë, pasi mbi gjysma e nxënësve i kalojnë së paku 2 orë vetëm për kryerjen e detyrave të shtëpisë. Nxënësit tërthorazi flasin edhe për mungesën e udhëzimeve për bërjen e detyrave të shtëpisë dhe përfitimet në mësim që i kanë nga detyrat e shtëpisë. Këto të fundit, përfitimet nga detyrat e shtëpisë, nxënësit kryesisht i lidhin me vlerësimet në fund të periudhave mësimore, jo me përparimin e vazhdueshëm dhe me përkrahjen shtesë që mund të marrin nga mësimitdhënësit e tyre.

Mbingarkesa nga mësimitdhënësit dhe mësimitdhënësia. Sipas nxënësve, në shkollat e tyre përballen me një numër të mësimitdhënësve që shpjegojnë shumë përmbajtje mësimore, pa u kujdesur për atë se sa nxënësit e kanë përvetësuar përmbajtjen e mësuar. Nxënësit nxjerrin edhe dallime në mënyrën se si mësimitdhënësit punojnë me ta, metodologjinë e punës, dhe theksi vihet në mënyrën e shpjegimeve të njësisve mësimore, të shpjeguarit me kuptim apo pa kuptim, lidhjen e mësimit me shembuj praktikë dhe me jetën, angazhimin e nxënësve gjatë mësimit, udhëzimet për punë në grupe, udhëzimet për detyrat e shtëpisë, përdorimin e TIK-ut në mësim, shfrytëzimin e burimeve shtesë etj. Të gjitha këto aspekte, që prekin elementet e rolit të mësimitdhënësve dhe të mësimitdhënies, përshkruhen nga nxënësit se kanë ndikim dhe luajnë rol që nxënësit të jenë aktiv apo pasiv në mësim, të jenë të ngarkuar gjatë mësimit apo kur praktikohen mirë të jenë të relaksuar dhe të mësojnë me nxitje, vullnet dhe t'i duan lëndët mësimore më shumë.

Mbingarkesa e nxënësve në mësim dhe koha e lirë për aktivitetet jashtëmësimore. Për zhvillimin e gjithanshëm të nxënësit, së bashku me edukimin, një rol të veçantë luajnë koha e lirë dhe aktivitetet

jashtëmësimore. Ato janë pjesë përbërëse e jetës dhe zhvillimit të nxënësve, jo vetëm e tyre. Lidhur me këto aspekte, është diskutuar me nxënësit e përfshirë në studim, me theks të veçantë për kohën në dispozicion pas mësimit dhe detyrave të shtëpisë, kohën për pushim, aktivitete të lira, lojë, shoqëri me bashkëmoshatarë, gjumë etj.

Pavarësisht ngarkesave që nxënësit i kanë pasqyruar në kohën për mësim në shtëpi, për bërjen e detyrave të shtëpisë, mbi 66 % e nxënësve të përfshirë në studim janë shprehur se kanë kohë të mjaftueshme për pushim, aktivitete të lira, lojë dhe shoqëri me bashkëmoshatarë, edhe pse herë pas here thuhet se në periudha të caktuara u mungon kjo kohë, kurse rreth 33% e nxënësve janë shprehur se nuk kanë kohë të mjaftueshme për këto aktivitete, për shkak të ngarkesave që kanë lidhur me mësimet dhe detyrat e shtëpisë.

Gjatë kohës së testimave dhe vlerësimeve, sipas nxënësve, mbetet pak kohë e lirë dhe pak kohë për aktivitete jashtëmësimore. Për arritjen e rezultateve të mira dhe ruajtjen e suksesit, nxënësit shprehen se duhet të angazhohen vazhdimisht, kështu që nuk u mbetet shumë kohë e lirë.

Sipas nxënësve, ata kryesisht kohën e lirë e kalojnë duke u shoqëruar me shokët jashtë shtëpisë, duke dëgjuar muzikë, si dhe duke qëndruar në rrjetet sociale. Mënyra se si e përshkruajnë nxënësit shfrytëzimin e kohës së lirë për pushim, aktivitete të lira, lojë, shoqëri me bashkëmoshatarë etj., tregon se ajo ndryshon shumë ndërmjet nxënësve, nuk ka elemente të planifikimit për shfrytëzim kreativ të kësaj kohe dhe është e varur prej angazhimeve që marrin nga shkolla/mësimdhënësit, përkatësisht mësimave dhe detyrave të shtëpisë.

Si përfundim, mund të thuhet se nxënësit kanë argumente të shumta rreth faktorëve që ndikojnë në mbingarkesën e tyre në mësim. Nxënësit kanë dhënë tema specifike për secilin nga faktorët që ata mendojnë se janë të ngarkuar në mësim. Detajet e temave specifike për faktorët e mbingarkesës, apo sipas kodimit nënkategoritë e faktorëve të mbingarkesës, të cilat janë shqyrtuar më sipër, pasqyrohen në tabelën në vijim.

Tabela 21. Faktorët e mbingarkesës së nxënësve në mësim - përshkrime të elementeve të mbingarkesës nga perspektiva e nxënësve

Nënkategoria	Tema specifike dhe përshkrime të nxënësve
Mbingarkesa nga shpeshësia e vlerësimeve me teste	<ul style="list-style-type: none"> - Të ngarkuar me shumë instrumente të vlerësimit; - Vazhdimisht të ngarkuar me teste, 2-3 teste brenda një dite; - Instrumente të vlerësimit të ndryshme nga lënda në lëndë ; - Vlerësime me teste shumë shpesh; - Përsëritjet dhe përforcimet bëhen shumë rrallë; - Ngarkohemi me teste, nuk mësojmë prej tyre; - Të ngarkuar me vlerësime me gojë në lëndët shkencore brenda një periudhe të mësimt.
Mbingarkesa me tema/njësi mësimore	<ul style="list-style-type: none"> - Ka ngarkesë me tema/njësi mësimore, sepse ka shumë lëndë që mësohen brenda një viti shkollor; - Nuk nxirren gjërat kryesore për t'i shpjeguar; - Temat në librin e gjeografisë përmbajnë shumë tekst të zgjeruar, shumë të dhëna; - Në lëndën e Gjeografisë shpesh mësimi është shumë i paqartë. - Njësitë mësimore janë të stërzgjatura pa nevojë, kurse në lëndën e Biologjisë (klasa 9) gjatë gjithë vitit njësitë janë marrë nga interneti e shpesh kemi hasur në burime të pasakta; - Lëndët shkencore janë më të ngarkuarat në krahasim me lëndët tjera, sidomos lënda e Kimisë; - Disa tema nuk janë të pakapshme për nxënësit, arsimtarët nuk përdorin material (burime) shtesë;

	<ul style="list-style-type: none"> - Në <i>Biologji</i> temat mësimore janë të ngarkuara, ndonjëherë edhe të panevojshme. Mësimdhënësit duhet të gjejnë mënyrë t'i thjeshtësojnë njësitë mësimore; - Lënda e historisë ka shumë tema dhe njësi mësimore, mësimdhënësit duhet t'i largojë një pjesë të tyre.
Mbingarkesa me tekste shkollore.	<ul style="list-style-type: none"> - Në librat e gjeografisë, klasat 8 dhe 9, ka tema të zgjeruara që nxënësit nuk mund t'i mësojnë për orët e mësimimit në javë, mësimdhënësit duhet t'i thjeshtojnë njësitë mësimore; - Të dhënat ne tekstin e gjeografisë, klasa 9, janë të vjetra; - Në librin e lëndës së fizikës, klasa 9, ka shembuj dhe informata që nuk janë të nevojshme; - Në librat e biologjisë dhe fizikës, klasa 9, temat që realizojnë mësimdhënësit nuk janë në librat me të cilat ne punojmë; - Në lëndët <i>Biologji</i> dhe <i>Fizikë</i>, klasa 9, nuk ka libra adekuatë, nxënësit kryesisht mësojnë nga shënimet dhe informata që mund të nxjerrin nga interneti; - Librat e klasës 9, në lëndët <i>Gj. Shqipe</i> dhe <i>Matematikë</i>, janë më të ngarkuara. - Tekstet e lëndës së <i>Matematikës</i>, në klasat 8 dhe 9, janë shumë të ngarkuara me detyra, të cilat nxënësit nuk i kuptojnë.
Mbingarkesa me detyra të shtëpisë	<ul style="list-style-type: none"> - Shumë të angazhuar në detyra, aktivitete, teste; - Duhet të ketë më pak detyra shtëpie; - Lënda e matematikës është vetë si lëndë e ngarkuar, por edhe detyrat po ashtu janë ngarkesë; - Nga ngarkesa me detyra të matematikës, shpesh ndodh që mos të kryhen nga nxënësit;

- Në Gjuhë shqipe dhe në Teknologji ngarkohemi me shumë detyra të shtëpisë;
- Në biologji, për shkak të mungesës së librit, duhet hulumtuar njësinë e çdo ore mësimore nga vetë nxënësit në përgatitjen e dosjeve, projekteve etj.

Ka disa nxënës të cilët nuk i shohin detyrat e shtëpisë si mbingarkesë:

- Nuk jemi të mbingarkuar;
- Mësimdhënësit na japin detyra aq sa është e nevojshme;
- Detyrat e shtëpisë nuk janë të tepërta, por përkundrazi në disa lëndë janë të pakta.

Mbingarkesa nga mësimdhënësit dhe mësimdhënia

- Pak mësimdhënës e përmbledhin mësimin në pika të shkurtra dhe konkrete;
- Mësimdhënësit e Gjuhës shqipe, Matematikës, Kimisë dhe Fizikës i shpjegojnë njësitë mësimore me përmbajtje të madhe, duhet t'i ndajnë ato në dy-tri pjesë;
- Mësimdhënësit e Teknologjisë duhet që njësitë mësimore t'i shpjegojnë në mënyrë praktike, me ngadalë dhe në mënyrë më të qartë;
- Shpjegimi nga mësimdhënësit e Edukatës qytetare duhet të lidhet më shumë me shembuj nga jeta, në mënyrë që ato të kuptohen nga nxënësit;
- Nxënësit ngarkohen kur duhet të shkruajnë gjithë njësinë mësimore në fletore;
- Nxënësit kanë nevojë për një mënyrë tjetër të shpjegimit nga mësimdhënësit, në mënyrë që t'i kuptojnë mësimet;

	<ul style="list-style-type: none"> - Në mungesë të librit të biologjisë, në klasën e 9-të mësimdhënësit duhet t'i thjeshtojnë mësimet për nxënës, me shembuj praktikë;
Mbingarkesa e nxënësve në mësim dhe koha e lirë për aktivitetet jashtëmësimore	<ul style="list-style-type: none"> - Kohën më të madhe në shtëpi e kalojmë rreth mësimëve dhe detyrave të shtëpisë; - Nuk kemi kohë për familje dhe as për aktivitete tjera; - Gjatë kohës së mbajtjes së testeve duhet mësuar të paktën 7-8 orë; - Në kohën e lirë dalim në shëtitje dhe shikojmë filma; - Pas mësimit nuk më mbetet shumë kohë e lirë. Atë që mbetet e shfrytëzojmë për sport dhe muzikë; - Gjatë kohës së lirë merremi me sport, vijoj kursin e anglishtes, shoqëri, komunikojmë përmes rrjeteve sociale etj.

4.3.2.3. Perspektivat e nxënësve për ndikimin e mbingarkesës së tyre me mësim

Ndikimi i mbingarkesës së nxënësve me mësim reflektohet në arritjet e nxënësve, por edhe në mirëqenien e tyre. Nxënësit pjesëmarrës në këtë studim raportuan elemente të ndryshme që lidhen me mbingarkesën e tyre në mësim, e cila reflektohet në rezultatet e tyre në mësim, por edhe në mirëqenien e tyre, ku lodhja paraqitet të jetë një shqetësim mjaft i diskutuar nga ana e nxënësve.

Sa u përket rezultateve, arritjeve të nxënësve në mësim, nxënësit konfirmuan se atyre u duhet angazhim i vazhdueshëm në mësim, për të arritur rezultatet e synuara, për të rritur mundësitë e tyre të të mësuarit dhe përgatitjen për të ardhmen. Pothuajse të gjithë nxënësit që ishin pjesë e këtij studimi kanë sukses të shkëlqyeshëm apo të shumë mirë. Për arritjen e këtij sukcesi, sipas nxënësve, është kërkuar angazhim i madh nga ana e tyre, gjë për të cilën nxënësit shprehen se e kanë bërë në mënyrë të vazhdueshme, pavarësisht se në periudha të caktuara kanë qenë të ngarkuar me mësim dhe detyra të shumta.

Për të arritur suksesin e dëshiruar në mësim dhe përgjithësisht në shkollë, pashmangshëm diskutohen shumë aspekte dhe njëra prej tyre është lodhja për shkak të energjisë së humbur nga angazhimet e shumta. Edhe nxënësit e konfirmojnë se lodhja e tyre shpesh paraqitet si rezultat i angazhimit të tepërt ose mbingarkesës me kohë mësimore, mësimet dhe detyra të lidhura me mësimet. Shenjat e lodhjes, siç i përshkruajnë nxënësit, janë të ndryshme, por themelore janë shpërqendrimi, zvogëlimi i aftësisë për përcjelljen normale të mësimin, shqetësimet emocionale, stresi, mungesa e disponimit etj.

Ndikimi i mbingarkesës së nxënësve në mësim vjen si rezultat i mësimave në shkollë, por edhe si rezultat i mësimave dhe detyrave që zhvillohen në shtëpi. Elementet e ndikimeve të mbingarkesës së nxënësve në mësim nga këto dy aspekte shpërfaqen edhe nga nxënësit e përfshirë në këtë studim, të cilët pasqyrojnë këto ndikime nga perspektiva e tyre për ndryshimet dhe shqetësimet që i kanë vërejtur te vetja e tyre, ndryshimet dhe shqetësimet që i kanë vërejtur te bashkëmoshatarët e tyre, të cilët kanë rezultate të ulëta në mësim, por edhe nga shqetësimet që i kanë vërejtur te prindërit për fëmijët e tyre.

Ndryshimet dhe shqetësimet që kanë nxënësit kur kthehen në shtëpi dhe ndërlidhja me mësimet në shkollë. Ndikimi i mbingarkesës së nxënësve me mësim vërehet gjatë punës së përditshme dhe angazhimit në klasë, mirëpo nga vetë nxënësit mund të vërehet apo përjetohet pas kthimit në shtëpi, si dhe gjatë bërjes së detyrave të shtëpisë. Pjesa më e madhe e nxënësve shprehen se pas kthimit në shtëpi nga shkolla, ndiejnë se kanë lodhje, stres, shqetësimet, që kryesisht lidhen me mësimet në shkollë dhe obligimet që kanë ndaj mësimave shtesë dhe detyrave të shtëpisë. Nga mënyra se si ato përshkruhen nga nxënësit, shihet se këto aspekte që reflektojnë mirëqenien e nxënësve manifestohen në mënyra të ndryshme, varësisht nga gatishmëria dhe përvoja për përballje me to.

Ka nxënës të cilët shprehen se shumica e ndryshimeve dhe shqetësimeve të tyre nga ngarkesa në mësim ndërlidhen me shkollën, sidomos në periudhën e testeve, kur duhet të marrin notat që kanë ndikim në suksesin e tyre në periudha mësimore, kur bëhet përmbyllja e notave.

Mirëpo, ka edhe nxënës që shprehen se jo gjithmonë këto shqetësime lidhen me mësimet në shkollë. Sipas këtyre nxënësve, në shqetësimet e tyre mund të ndikojnë edhe disa faktorë tjerë dhe shoqëria e familja janë dy nga faktorët e tjerë më të cituar nga nxënësit.

Ndryshimet dhe shqetësimet e nxënësve në shtëpi, gjatë mësimet dhe kryerjes së detyrave të shtëpisë. Nxënësit vlerësojnë se kanë shqetësime gjatë mësimet në shtëpi, gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë, sepse konsiderojnë se janë të ngarkuar me to. Kjo është pasqyruar edhe në kohën fizike 2-3 orë, të cilën nxënësit e ndajnë vetëm për detyrat e shtëpisë.

Sipas nxënësve, ata hasin në mjaft vështirësi në bërjen e detyrave të shtëpisë, të cilat vijnë edhe si pasojë e mosqarimeve dhe udhëzimeve të duhura nga mësimdhënësit. Sipas nxënësve, nga vështirësitë që kanë në mësimet dhe detyrat e shtëpisë që duhet t'i kryejnë, vijnë shumë shqetësime, të cilat manifestohen në forma të ndryshme. Këto shqetësime, sipas nxënësve, manifestohen si stres, dekoncentrim, lodhje dhe frikë nga zgjedhjet e pasakta të detyrave të shtëpisë.

Për një numër të nxënësve, të mësuarit në shtëpi dhe kryerja e detyrave nuk shkaktojnë ndonjë ndryshim në sjelljen e tyre apo ndonjë lloj shqetësimi, sepse konsiderojnë se nuk ka mbingarkesë, prandaj nuk ka as arsye shqetësimi. Një numër i nxënësve këtë e lidhin me përkrahjen që u ofrojnë prindërit apo anëtarët e familjes, kur ata kanë nevojë rreth mësimet dhe detyrave të shtëpisë.

Shqetësimet e prindërve lidhur me mësimet dhe rezultatet e fëmijëve të tyre. Angazhimi i madh i nxënësve për mësimet dhe detyrat e shtëpisë kërkon edhe mbështetje nga familja, në radhë të parë nga prindërit, me krijim të kushteve e mjedisit të përshtatshëm për mësim, por edhe me udhëzime e këshilla të nevojshme në raport me mësimet dhe detyrat gjegjëse.

Nxënësit e përfshirë në këtë studim, në masë relativisht të mirë, e konfirmojnë se prindërit e tyre janë ata që kujdesen për mësimet dhe rezultatet e nxënësve në shkollë. Gjithashtu, nga pjesa më e madhe e nxënësve konfirmohet se te prindërit e tyre vërejnë shqetësime kur nuk janë mirë me rezultatet në mësimet, kur i informojmë për mësimet dhe detyrat që

vetë nuk mund t'i kryejmë, kur ankohen se janë të ngarkuar me numrin e teksteve, por edhe të mësimëve që dalin nga një ditë e mësimit.

Sipas deklarimeve të nxënësve, pothuajse të gjithë prindërit kanë shqetësime për përparimin e tyre në mësim, bërjen e detyrave të shtëpisë, për kohën që ndajnë rreth mësimëve, lodhjen dhe stresin që lidhet me mësimet dhe përgjithësisht me shkollën etj. Sipas nxënësve, ngarkesa me detyra të shumta, si dhe arritjet dhe sukcesi në testet që zhvillohen në shkollë, janë preokupimet dhe shqetësimet më të mëdha të prindërve të tyre.

Shqetësim tjetër për disa nga prindërit, sipas nxënësve, është qëndrimi i gjatë para kompjuterëve dhe pajisjeve të tjera teknologjike për komunikim dhe lojëra.

Në mesin e nxënësve të përfshirë në studim, ka prej tyre që deklarojnë se prindërit e tyre nuk shqetësohen fare për ta, sepse ata (nxënësit) qëndrojnë mirë me mësimet, janë të shkëlqyeshëm, qëndrojnë mirë në sjellje dhe me bashkëmoshatarë etj. Disa nxënës deklarojnë se ata nuk duan t'i ngarkojnë prindërit e tyre me kurrfarë shqetësimi, prandaj angazhohen sa më shumë në mësimet.

Ndryshimet dhe shqetësimet e nxënësve që kanë rezultate të ulëta në mësim, të vërejtura nga bashkëmoshatarët e tyre. Pavarësisht përparimit, performanca e ulët e nxënësve në përgjithësi ka gjasa që të ketë ndikim negativ te mundësitë për mirëqenien e tyre. Shqetësimet që nxënësit i vërejnë te shokët e klasës së tyre me sukse/rezultate të ulëta në mësim, kur ata nuk arrijnë të mësojnë ose t'i kryejnë detyrat e shtëpisë, janë të ndryshme. Rreth gjysma e nxënësve të përfshirë në këtë studim deklarojnë se shokët dhe shoqet e tyre me rezultate jo të mira shqetësohen kur nuk arrijnë të mësojnë ose t'i kryejnë detyrat e shtëpisë.

Shqetësimet e bashkëmoshatarëve të tyre, sipas nxënësve, ndërlidhen me mësimet dhe rezultatet në mësimet dhe manifestohen me stres, humbje kontrolli, nganjëherë edhe konflikte me mësimdhënës dhe konflikte ndërmjet nxënësve.

Ndryshimet dhe shqetësimet e vërejtura te bashkëmoshatarët me sukses/rezultate mesatare ose të ulëta në mësim, siç shprehen nxënësit, varen

nga formimi i nxënësve dhe interesimi për mësim. Në mesin e nxënësve me rezultate të ulëta, ka dhe të atillë që nuk shqetësohen fare për të mësuar dhe as për suksesin e tyre.

Pikëpamjet e nxënësve për nënkategoritë e përshkruara më sipër, lidhur me ndikimin e mbingarkesës së nxënësve në mësim, pasqyrohen në tabelën në vijim. Për secilën nënkategori janë të renditura tema specifike, sipas shpeshhtësisë së informacionit të identifikuar nga të dhënat e mbledhura prej nxënësve të përfshirë në këtë studim.

Tabela 22. Ndryshimet dhe shqetësimet e nxënësve nga ndikimi i mbingarkesës me mësim

<i>Nënkategoria</i>	<i>Tema specifike dhe përshkrime të nxënësve</i>
<i>Ndryshimet dhe shqetësimet e nxënësve nga mësimet dhe angazhimet në shkollë</i>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Të lodhur e të rraskapitur nga pesha e çantës dhe të stresuar nga mësimet;</i> - <i>Ndiejmë lodhje;</i> - <i>Ndihemi të lodhur, pa disponim dhe të stresuar nga vlerësimet e tepërta;</i> - <i>Kemi shqetësime;</i> - <i>Ndihemi të stresuar dhe me nerva gjatë kohës;</i> - <i>Kemi shqetësime edhe nga situata në familjen time;</i> - <i>Shqetësime me sjelljen e pa përshtatshme të nxënësve në shkollë.</i> <p><i>Ka disa nxënës të cilët nuk kanë ndryshime dhe shqetësime nga mësimet dhe angazhimet në shkollë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Ndihemi mirë me mësimet në shkollë;</i> - <i>Nuk kemi probleme rreth mësimëve në shkollë.</i>
<i>Ndryshimet dhe shqetësimet e nxënësve nga mësimet dhe detyrat e shtëpisë</i>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Shqetësime nga mësimet dhe detyrat e shumta për t'i kryer në shtëpi;</i> - <i>Shqetësime kur nuk mund të japim përgjigje në detyrat e shtëpisë;</i> - <i>Shqetësimi lidhet me atë se a janë përfunduar mirë apo jo mirë detyrat e shtëpisë;</i>

- Nganjëherë ka stres dhe panik nga detyrat e shtëpisë.

Ka disa nxënës të cilët nuk kanë shqetësime rreth mësimëve dhe detyrave të shtëpisë:

- Ndihehi mirë me mësimet dhe detyrat në shtëpi;
- I kuptojmë mirë mësimet në shkollë, nuk kemi probleme me detyrat e shtëpisë;
- Detyrat në shtëpi i shfrytëzojmë për të mësuar më shumë.

Shqetësimet e prindërve lidhur me mësimet dhe rezultatet e fëmijëve të tyre

- Shqetësohen për suksesin e nxënësve, sepse ata i shtojnë fëmijët e tyre që t'i bëjnë detyrat, të mësojnë etj.

Shqetësohen për lodhjen, pagjumësinë dhe ankthin e fëmijëve nga puna dhe angazhimi në mësim;

- Shqetësimet e prindërve lidhen me shumë me notat dhe suksesin përfundimtar;
- Shqetësohen kur qëndrojmë tepërt në teknologji dhe rrjete sociale;
- Shqetësohen kur kemi stres dhe kalojmë kohë të gjatë duke mësuar dhe duke bërë detyrat.

Ka disa nxënës të cilët shprehen se nuk shohin shqetësime të prindërve lidhur me mësimet dhe rezultatet e tyre:

- Nuk shqetësohen, sepse ata ndihen shumë të kënaqur me suksesin dhe sjelljen në shkollë;
- Nuk shqetësohen për angazhimet, mësimet dhe detyrat e shtëpisë;
- Mendohehi që shqetësimet tona mos t'i transmetojmë te prindërit, në mënyrë që mos t'i ngarkojmë edhe ata;
- Nuk interesohen sa duhet për mësimet tona.

Ndryshimet dhe

shqetësimet e

nxënësve që kanë

rezultate të ulëta në

mësim, të vërejtur nga

bashkëmoshatarët e

tyre

- *Ata e përjetojnë shumë keq këtë situatë, sepse edhe ata dëshirojnë të arrijnë rezultate të larta në mësim;*
- *Nxënësit kur nuk arrijnë rezultate të mira, mërziten, humbin kontrollin, bëjnë gjëra që nuk duhet bërë, duke përfshirë edhe konflikte me mësimdhënësit;*
- *Janë të emocionuar, me stres dhe kanë frikë se nuk do të jenë të suksesshëm;*
- *Varet nga nxënësit. Disa ndihen keq dhe përballojnë vështirë, kurse disa të tjerë tashmë veç janë mësuar me këtë gjë;*
- *Disa nga këta nxënës nuk shqetësohen për rezultatet e tyre në përfundim të vitit shkollor;*
- *Kemi nxënës në klasën tonë që fare nuk tregojnë interesim për mësim dhe nuk shqetësohen për asgjë.*

4.3.2.4. Ide nga nxënësit për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës së tyre në mësim

Nxënësit kishin mundësi të ofronin komente apo sugjerime nga ana e tyre, për veprime konkrete që do të mund të ndërmerreshin nga mësimdhënësit dhe shkolla, lidhur me trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës së tyre në mësim. Sugjerimet e tyre për veprime konkrete pothuajse prekin të gjithë faktorët që ndikojnë në mbingarkesën e tyre me mësim, të cilat prej tyre janë prezantuar si faktorë më ndikues në mbingarkesën e tyre, si: vlerësimin e nxënësve, temat/njësitë mësimore, tekstet shkollore, detyrat e shtëpisë, mësimdhënësit dhe mësimdhënia etj.

Disa veprime që duhet të ndërmerren ndaj trajtimit dhe zbutjes së mbingarkesës së nxënësve me mësim në shkollë, që përvijohen më shumë nga nxënësit, janë si në vijim:

- Gjatë një viti shkollor, vlerësimi i nxënësve të bëhet në dy periudha të mësimt;

- Të ketë sa më shumë aktivitete me nxënës brenda orës mësimore dhe ajo të jetë sa më interaktive;
- Të ketë më pak detyra të shtëpisë për nxënës;
- Tekstet shkollore të jenë më të përshtatshme (më të kapshme) për nxënës. Tekstet të përmbajnë më shumë aktivitete praktike dhe me interes për nxënës;
- Të rritet numri i orëve mësimore që kanë shumë tema mësimore (specifikohet lënda e Gjeografisë në klasën e 9-të, për shkak të shumë përmbajtjeve mësimore);
- Të ketë më pak ngarkesë me lëndë mësimore, tema mësimore, njësi mësimore;

Disa nga sugjerimet e nxënësve për veprime në trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës së tyre me mësim në shkollë shkojnë për vetë nxënësit, bashkëmoshatarët e tyre. Përmbledhja e tyre del si një kërkesë e artikular për nxënës që të mësojnë më shumë dhe vazhdimisht të angazhohen dhe të jenë aktivë gjatë orëve të mësimin, në mënyrë që mësimet që zhvillohen në shkollë të përvetësohen më mirë.

Nxënësit si ngarkesë të tyre e shohin edhe Testin e Arritshmërisë, për të cilin kërkojnë që të ketë ndryshime, në vend të 200 kërkesave dhe mbajtjes së testit në dy ditë, kërkojnë të kthehet forma paraprake, me 100 kërkesa dhe një ditë të vetme të testimit. Mënyra se si nxënësit i qasen kësaj kërkesë lë për të kuptuar se nxënësit e klasave 8 dhe 9 nuk janë të informuar sa duhet më qëllimin e Testit të Arritshmërisë, përdorimin e rezultateve nga ky vlerësim, dhe nuk janë të mbështetur nga shkolla me përgatitje të duhura për t'iu nënshtruar këtij testi në fund të arsimit të detyrueshëm.

4.3.3. Perspektiva nga prindërit për mbingarkesën e nxënësve në mësim

Rezultatet në vijim, sipas fushave të shqyrtuara, nga perspektiva e prindërve për mbingarkesën e nxënësve në mësim, ndryshonin varësisht nga roli që prindërit kishin në shkollë, nga niveli i shkollimit të tyre, por edhe nga niveli

i arsimit ku prindërit e përfshirë në studim i kishin fëmijët duke e vijuar shkollimin. Pjesa më e madhe e tyre reflektonin përvojën e tyre individuale në raport me shkollën, mësimdhënësit dhe me mësimet e fëmijëve të tyre.

Pavarësisht dallimeve në përshkrimet e tyre rreth aspekteve të trajtuara lidhur me mbingarkesën e nxënësve në mësim, referimet e tyre, mendimet e tyre për këtë temë, siguruan gjetje të vlefshme dhe me interes për këtë studim, të cilat janë përmbledhur në katër nëntema të veçanta, siç prezantohen në pjesën më poshtë:

- Informimi i prindërve me ndryshimet në kurrikula/programe mësimore, sfidat dhe vështirësitë e mësimdhënësve dhe nxënësve në zbatimin e kurrikulës;
- Mbingarkesa e nxënësve në mësim dhe faktorët ndikues;
- Ndikimi i mbingarkesës në mësim në ndryshimin e sjelljes së nxënësve;
- Mundësitë e prindërve për përkrahje të fëmijëve në zvogëlimin e mbingarkesës në mësim dhe kërkesat e tyre për mbështetje nga shkolla/institucionet arsimore.

4.3.3.1. Informimi i prindërve me ndryshimet në kurrikula/programe mësimore, sfidat dhe vështirësitë e mësimdhënësve dhe nxënësve në zbatimin e kurrikulës

Informimi i gjithë komunitetit të shkollës për ndryshimet në kurrikula apo programe mësimore, në mënyrë të veçantë informimi i prindërve, është një nga parakushtet për rritjen e bashkëpunimit të shkollës me prindër dhe për ngritjen e përgjegjësisë së prindërve për kujdes më të shtuar ndaj punës me fëmijët e tyre, përcjelljen e përparimit të tyre dhe për ofrimin e mbështetjes në procesin e të mësuarit. Nga kjo pikënisje, për prindërit e përfshirë në këtë studim kemi shtruar pyetje lidhur me informimin e tyre me ndryshimet kurrikulare/ programet mësimore, risitë dhe mundësitë që sjellin ato.

Nga analiza tematike, bërë përgjigjeve të dhëna nga prindërit e përfshirë në hulumtim, janë identifikuar disa aspekte të rëndësishme që lidhen me

informimin e prindërve lidhur me kurrikulat/programet mësimore, përfshirë informimin që kanë marrë nga shkolla/ mësimdhënësit për punën që bëjnë në shkollë lidhur me procesin mësimor, si dhe informimin që kanë prindërit për sfidat në zbatimin e kurrikulës, për ankesat, problemet dhe shqetësimet që prindërit i kanë dëgjuar dhe diskutuar në raste të caktuara me mësimdhënësin dhe me fëmijët e tyre.

Sa i përket aspektit përmbajtjesor të informimit të prindërve nga shkolla/mësimdhënësit, që lidhet me ndryshimet në kurrikula, referuar përshkrimeve të prindërve, nuk reflektohet një sistem i brendshëm i shkollave lidhur me informimin e prindërve për ndryshimet e bëra në kurrikula, për risitë dhe mundësitë që ofron kurrikula e bazuar në kompetenca. Konstatohet se informatat që kanë prindërit për këtë temë janë shumë të përgjithshme, ato kryesisht kanë bazë për ndryshimet në tekstet shkollore apo për tekstet që i përdorin nxënësit.

Prindërit, në raport me informimin e tyre për organizimin e mësimit, raportuan për atë se e dinë numrin e lëndëve mësimore në klasat që i kanë fëmijët, për tekstet shkollore me të cilat i kanë fëmijët apo që nuk i kanë fëmijët e tyre, pa u specifikuar elementet që lidhen me përmbajtjet mësimore dhe rezultatet e të nxënësve në lëndë mësimore dhe klasë të caktuara. Pra, nga mënyra se si përshkruhet praktika e informimit të tyre që lidhet me kurrikulat dhe tekstet shkollore, shihet se prindërit kryesisht janë informuar me numrin e lëndëve mësimore për klasë, për sigurimin e teksteve shkollore, tekstet që mungojnë etj.

Pavarësisht nivelit të informimit, disa prindër japin edhe cilësime për ndryshimet në kurrikula. Në disa raste, ndryshimet cilësohen si të mira, që e bëjnë më atraktiv të mësuarit dhe se duhet kohë për t'u parë rezultatet. Por, ka edhe raste që theksojnë se ndryshimet janë të paparashikuara nga profesionistët dhe se ka mjaft paqartësi si të punohet me këtë kurrikulë, me këto tekste shkollore.

Ka prindër që janë më të rezervuar në cilësimet e tyre për ndryshimet në kurrikula. Kështu shprehet një prind: *Kam përcjellë prej fillimit ndryshimet që janë sjellë me Kurrikulën e re. Ka risi si dhe mundësi të mira, por që duhet kohë deri te vlerësimi real i tyre (p/35- kryetar i KDSH, shkollë në zonë*

urbane). Mirëpo, ka prindër që këtë nuk hezitojnë ta bëjnë, pavarësisht nivelit të informimit të tyre. Kështu shprehet një prind: *Nuk jemi të informuar shumë me programet mësimore, si dhe ndryshimet kurrikulare që bëhen, ne po i shohim ato pa ndonjë analizë të profesionisteve (p/14- shkollë në zonë rurale)*.

Referuar elementeve të përshkruara nga prindërit lidhur me informimin e tyre rreth kurrikulave, del se prindërit që kanë rol në Këshillin Drejtues të Shkollës ose janë përfaqësues të prindërve të klasës, janë të informuar më shumë për ndryshimet e përgjithshme në kurrikula, kundrejt prindërve tjerë, që nuk kanë role të veçanta në shkollë. Prindërit e nxënësve nga zonat rurale dhe prindërit e nxënësve me nevoja të veçanta japin më së paku elemente të informimit të tyre për aspektet e kurrikulës me të cilën punohet me fëmijët e tyre. Këto dallime shpërfaqen në përshkrimet në vijim:

Unë, si përfaqësues i klasës, personalisht jam mjaft i informuar për çdo ndryshim mësimor dhe kemi një komunikim të vazhdueshëm për risitë mësimore me mesimdhënës dhe drejtorin (p/13 - shkollë në zonë rurale);

Nuk jemi mjaft të informuar, për shkak se ka mjaft paqartësi në lëndët të cilat zhvillohet mësimi (p/36 - kryetar i Këshilli i Prindërve, shkollë në zonë urbane);

Nuk jemi të informuar (p/11 - shkollë në zonë rurale).

Niveli i informimit të prindërve dallon edhe në raport me klasat ku i vijnë mësimet fëmijët e tyre. Bazuar në elementet e përshkruara nga prindërit lidhur me informimin e tyre rreth kurrikulave dhe mënyrën e informimit të tyre, del se prindërit që i kanë fëmijët në arsimin fillor, klasat 1-5, janë më të informuar kundrejt prindërve që fëmijët i kanë në arsimin e mesëm të ulët, klasat 6-9. Informacioni i këtyre të fundit kryesisht bëhet nga kujdestarët e klasave, të cilët ofrojnë informata të përgjithshme për fillimin e vitit shkollor, lëndët mësimore sipas klasave dhe mesimdhënësit që i ligjërojnë/mbajnë ato, pajisjen me tekstat shkollorë dhe informacione për suksesin e disiplinën e nxënësve në mbledhjet që mbahen me prindër. Ndërsa, prindërit që i kanë fëmijët në arsimin fillor kanë mundësi më të mëdha për komunikim me prindërit e nxënësve të tyre për aspektet që lidhen

me të gjitha lëndët mësimore që ata i mbajnë. Kështu shprehet një prind që fëmijën e ka në klasën e tretë:

Për ndryshimet në programet mësimore informohem nga komunikimet me mësuesen, gjatë mbledhjeve apo në raste të ndryshme kur hasim në probleme të llojllojshme në të kuptuarit e mësimëve nga nxënësit (p/20 - kryetar i Këshillit të Prindërve, shkollë në zonë urbane).

Sa i përket informimit që kanë prindërit nga mësimdhënësit, për vështirësitë, sfidat dhe shqetësimet e tyre lidhur me zbatimin e kurrikulës, ato në shumë raste janë përshkruar apo paraqitur si perceptime të vetë prindërve, jo si informacione që kanë bazë të argumentuar në diskutimet e prindërve të zhvilluara me mësimdhënësit apo anasjelltas, me ndonjë përjashtim kur ndonjë prind ka rastisur që të jetë mësimdhënësi në një shkollë tjetër.

Sipas prindërve, shqetësimet e mësimdhënësve për vështirësitë dhe sfidat që kanë në punën e tyre lidhen me tekstet shkollore, gabimet në përmbajtje dhe detyra të teksteve shkollore; numrin e madh të fëmijëve në klasë (u referohen shkollave urbane); kohën e shkurtër për të shtjelluar si duhet përmbajtjet mësimore; detyrat e shtëpisë; literatura e ngarkuar; mangësi në cilësinë e leximit të një numri të nxënësve; mungesa e mjeteve të konkretizimit dhe internetit në klasa; pesha e çantave; kërkohet shumë nga nxënësit; nevoja që nxënësit të mësojnë më shumë dhe në mënyrë logjike; lëndë mësimore të njëjta për të cilat përdoren dy tekste shkollore nga botime të ndryshme etj. Një pjesë e këtyre shqetësimeve pasqyrohen në përshkrimet në vijim:

Kemi diskutuar shumë herë me mësuesen. Në rast se jemi ankuar gojarisht si prindër për ngarkesën e madhe që kanë fëmijët me mësim, përgjigjja ishte se kështu e kërkon kurrikula (p/3 - kryetar i Këshillit të Prindërve, shkollë në zonë urbane);

Kur kemi diskutuar me mësimdhënësin, ata ankohen për mundësitë e kufizuara për të realizuar mësimin ashtu siç e parasheh kurrikula. Pra, nuk ka mundësi të realizohet kurrikula e plotë (p/4 - shkollë në zonë urbane);

Mësimdhënësit ankohen për ngarkesën e madhe me përmbajtje në tekste shkollore, dallimi shumë i madh ndërmjet teorisë dhe praktikës, numri i madh i nxënësve në klasë (p/7 - kryetar i prindërve të klasës, shkollë në zonë urbane).

Gjatë komunikimit me mësimdhënësit, është vërejtur shpejtësia e trajtimit të njësive mësimore nga mësimdhënësit, pavarësisht sa kanë mësuar nxënësit (p/19 - anëtar i KDSH-së, shkollë në zonë urbane).

Në anën tjetër, sa u përket vështirësive dhe shqetësimeve të fëmijëve/nxënësve lidhur me mësimet e tyre, shumica e prindërve, të cilët janë shprehur se me fëmijët e tyre flasin shpesh për mësimet në shkollë, tekstet mësimore, detyrat e shtëpisë, vështirësisë që kanë në lëndë të caktuara mësimore, sukseset në mësimet, etj., në përshkrimet e tyre kanë dhënë elemente të mjaftueshme të cilat tregojnë se fëmijët e tyre ballafaqohen me sfida të ndryshme dhe kanë shqetësime në aspekte të ndryshme që lidhen me procesin mësimor.

Përmbledhja e shqetësimeve të nxënësve që lidhen me mësimet e tyre, zbatimin e kurrikulës, sipas prindërve, janë mungesa e librave të reja sipas kurrikulës në zbatim, numri i madh i librave me të cilat punojnë nxënësit në disa klasa, çështjet që lidhen me detyrat e shtëpisë, si numri i tyre, ashtu edhe shpeshtësia e dhënies së detyrave të shtëpisë, por edhe qasja e mësimdhënësit ndaj shpjegimit në klasë dhe ndaj udhëzimeve për detyrat e shtëpisë.

Një nga shqetësimet e ngritura nga fëmija im lidhet me lëndën e Biologjisë, klasa e 6-të, ku mësimdhënësi brenda 2 muajve ka shpjeguar më shumë se gjysmën e librit, me arsyetimin se kështu është në plan-program (p/8 - kryetar i KP, shkollë në zonë rurale);

Shqetësimet e fëmijëve tanë lidhen me numrin e librave shkollorë dhe detyrave të shtëpisë të klasat e ulëta (p/13- shkollë në zonë rurale);

Tani ka më shumë angazhime për nxënësit në shkollë, ka më shumë detyra të shtëpisë, por me ndihmën e mësueses dhe në prindërve fëmija im po arrin t'i tejkalojë vështirësitë që i ka gjatë mësimin dhe detyrave (p/15 - shkollë në zonë urbane).

Një përmbledhje e shqetësimeve të ngritura nga mësimdhënësit dhe nxënësit, gjithnjë sipas prindërve, pasqyrohet në tabelën në vijim. Ato janë të organizuara në nënkategori dhe tema specifike, e të renditura sipas shpeshtësisë së informacionit të identifikuar.

Tabela 23. Problemet dhe shqetësimet e mësimdhënësve dhe nxënësve në zbatimin e kurrikulës, nga perspektiva e prindërve

Nënkategoria	Tema specifike nga nënkategoritë
Problemet dhe shqetësimet e dëgjuara/diskutuara nga mësimdhënësit	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i madh i lëndëve në nivelin fillor; - Mungesë e mjeteve të konkretizimit dhe internetit në klasa; - Mundësitë e kufizuara për të realizuar mësimin, ashtu siç e parasheh kurrikula. - Shumë tema, koha e pamjaftueshme (Gjuhë shqipe, Matematikë - klasa e 5-të); - Numri i madh i nxënësve në klasa; - Ka përmbajtje mësimore të vështira në raport me moshën e nxënësve; - Programi mësimor është i ngjeshur dhe nuk mund të punojnë me nxënësit që nuk i arrijnë mësimet; - Tema mësimore të ngarkuara, ndërsa koha e pamjaftueshme për t'i shtjelluar si duhet; - Nuk korrespondojnë programet me tekstet shkollore që janë shpërndarë për nxënës, gabime në tekste shkollore; - Vështirësi në vlerësim, kriteret e vlerësimit të shumta; - Pamundësia për ngeljen e nxënësit deri në klasën e pestë, nëse nuk është i suksesshëm.

Problemet dhe shqetësimet e dëgjuara/diskutuara nga fëmijët e tyre	<ul style="list-style-type: none"> - Ka shumë nxënës në një klasë; - Shumë detyra të shtëpisë, të vështira dhe pa udhëzime; - Vështirësi në zgjedhjen e detyrave; - Mësimdhënësit shpjegojnë shumë dhe shpejt; - Nxënësit punojnë me tekste shkollore që kanë shumë mësim dhe detyra; - Disa tekste shkollore kanë gabime; - Tekste shkollore joadekuate për shumë lëndë mësimore; - Çanta e ngarkuar me libra shkollorë; - Ka mësim që i jep mësimdhënësi pa i shpjeguar fare në shkollë; - Shumë kërkesa për të hulumtuar në internet, për të përgatitur prezantime, projekte; - Nxënës të lodhur në shkollë, pa kohë për argëtim e shoqëri.
--	---

4.3.3.2. **Mbingarkesa e nxënësve në mësim dhe faktorët ndikues nga perspektiva e prindërve**

Të gjeturat që raportohen në vijim u referohen qëndrimeve të prindërve për mbingarkesën e nxënësve në mësim dhe faktorët ndikues, për atë se sipas prindërve ka apo nuk ka mbingarkesë të nxënësve në mësim, a ka anë pozitive apo negative mbingarkesa e nxënësve në mësim, cilët janë faktorët që ndikojnë në mbingarkesën e nxënësve në mësim dhe elementet specifike të tyre?

Mbingarkesa e nxënësve në mësim. Sa i përket përgjigjes së prindërve në një pyetje të drejtpërdrejtë, se a ka mbingarkesë të nxënësve në mësim, shumica e prindërve, rreth 60% e tyre, janë përgjigjur se ka mbingarkesë deri diku, rreth 30% e prindërve janë përgjigjur se ka shumë ose tepër shumë

ngarkesa të nxënësve, ndërsa rreth 10% e prindërve janë përgjigjur që nuk ka ngarkesa të nxënësve në mësim apo që këtë nuk e dinë.

Në kërkesën vijuese për të argumentuar përgjigjen e dhënë lidhur me ngarkesën e nxënësve në mësim, pothuajse janë të gjitha elementet që janë pasqyruar nga prindërit si vështirësi apo shqetësime të mësimdhënësve dhe nxënësve për zbatimin e kurrikulës, me ndryshime të vogla në gjuhën e përshkrimit. Në argumentimet e tyre, prindërit kanë theksuar se ka përmbajtje të ngarkuar dhe shpesh të panevojshme, pastaj tekstet e ngarkuara dhe mungesa e tyre për disa lëndë dhe klasë, detyrat e shtëpisë, orari i shkurtër për ta shtjelluar mirë përmbajtjen, përmbajtje të mbingarkuara për moshën e nxënësve, orë joefektive, obligime e detyra në shtëpi pa i shtjelluar në klasë, mbingarkesë me teste, pesha e rëndë e librave, një lëndë deri në tri tekste etj.

Efektet pozitive apo negative të mbingarkesës së nxënësve në mësim.

Shumica e prindërve kanë deklaruar se mbingarkesa ka efekt negativ, sepse fëmijët nuk mund t'i absorbojnë të gjitha përmbajtjet. Sipas tyre, mbingarkesa po ndikon shumë në shëndetin mendor të fëmijëve dhe në zhvillimin e tyre. Ata deklarojnë se mund të mësojnë mirë fëmijët edhe pa u ngarkuar shumë me përmbajtje mësimore. Ka edhe prindër që mendojnë se rezultatet e PISA-s tregojnë mbingarkesën, sepse gjatë mësimin në shkollë nuk është duke u bërë adresimi praktik e logjik i përmbajtjeve që mësohen nga nxënësit.

Prindërit që deklaruan se efekti i mbingarkesës së nxënësve në mësim është negativ, atë e argumentuan me elemente të ndryshme që lidhen me mirëqenien e fëmijëve, me ndjenjën e pasigurisë për të mësuar, humbjen e vetëbesimit të nxënësve për mësim, humbjen e vullnetit për shkollë, humbjen e interesimit për mësim, me lodhje dhe stres, me pamundësinë për të marrë pjesë në aktivitete jashtë mësimore, aktivitetet sportive etj. Dy prindër, respondentë të këtij studimi, kështu e përshkruajnë në mënyrë më të zgjeruar ndikimin negativ, që sipas tyre ka mbingarkesa e nxënësve në mësim:

Mbingarkesën unë e konsideroj negative. Me këtë ngarkesë që kanë fëmijët tanë, ata po e dëmtojnë gradualisht shëndetin mendor. Ata shpesh qajnë nga detyrat e rënda që u jepen për detyrë shtëpie dhe gjatë procesit mësimor. Shpesh po marrin mësim që nuk korrespondojnë me moshën e tyre (p/3 - kryetar i Këshillit të prindërve, shkollë në zonë urbane);

Mbingarkesën e nxënësve në mësim e konsideroj negative, sepse mendoj që ndikon në humbjen e vetëbesimit të fëmijët dhe të shkuarja me vullnet në shkollë, shpesh fëmijët konsiderojnë se shumë gjëra në mësim nuk po i dinë (p/20 - kryetar i Këshillit të Prindërve, shkollë në zonë urbane).

Një numër më i vogël i prindërve të përfshirë në këtë studim mendojnë se mbingarkesa e nxënësve në mësim ka efekte pozitive. Këtë e arsyetojnë me atë se nxënësit sa më shumë që angazhohen, janë më të suksesshëm. Ky grup i prindërve ngarkesën me mësim e krahasojnë si më pozitive, duke theksuar se më mirë të mësojnë sesa të merren me mjete teknologjike, rrjete sociale, shoqëri në rrugë dhe humbje kohe. Në mesin e prindërve, ka prindër që kanë deklaruar se nxënësit duhet të jenë të ngarkuar, që ata të jenë të suksesshëm në mësim, por duhet të ndihmohen nga prindërit për ta kaluar këtë ngarkesë.

Gjithashtu, në mesin e prindërve, ka prindër që kanë deklaruar se nga mbingarkesa e nxënësve në mësim shohin anë pozitive, por edhe negative.

Mendoj se këtu ka diçka pozitive, diçka negative. Kur mendoj pozitive e forcon fëmijën të jetë më i përgatitur për jetë. Për anën negative, mendoj se pak kanë kohë me u marrë me aktivitete apo hobi (p/18 - shkollë në zonë urbane).

Aspektet përmbledhëse në nënkategori dhe tema specifike nga nënkategoritë, të renditura sipas shpeshësisë së informacionit të identifikuar, që adresohen nga prindërit, për efektet negative dhe pozitive të mbingarkesës së nxënësve në mësim, pasqyrohen në tabelën në vijim.

Tabela 24. Ndikimi i mbingarkesës së nxënësve në mësim – efektet negative dhe pozitive

Nënkategoria	Tema specifike nga nënkategoritë
Efektet negative të mbingarkesës së nxënësve në mësim	<ul style="list-style-type: none"> - Mbingarkesa po ndikon në shëndetin mendor të fëmijëve; - Fëmijët kanë shumë stres e shumë obligime, shumë pak kënaqësi dhe se duhet të ketë paralele mes obligimeve të fëmijëve për mësim dhe aktiviteteve që fëmijët i bëjnë të ndihen të kënaqur dhe të relaksuar; - Fëmijët janë të lodhur nga mbingarkesa me disa përmbajtje, të cilat janë të panevojshme për jetë dhe për realitetin, janë të lodhur nga mbingarkesa me tekste shkollore; - Rezultatet e PISA-s tregojnë mbingarkesën e jo adresimin praktik e logjik në mësim; - Ka humbje të vetëbesimit te fëmijët, shpesh nuk kanë vullnet për të shkuar në shkollë; - Negative, sepse mësohen shumë gjëra që nuk praktikohen në jetë dhe nuk mbahen mend lehtë; - Ngarkesa negative po bëhet me mësim ku kërkohet përdorimi i teknologjisë, në anën tjetër theksohet se mungon teknologjia në shkolla; - Ka lodhje dhe stres të fëmijët, sidomos në rastet kur mësimdhënësit nuk mund ta zërthejnë mësimin/materialin mjaftueshëm e i angazhojnë fëmijët/nxënësit për ta bërë atë, etj. - Fëmijët kanë pak kohë me u marrë me aktivitete jashtë mësimi apo me hobi ku kanë prirje.
Efektet pozitive të mbingarkesës së nxënësve në mësim	<ul style="list-style-type: none"> - Fëmijët angazhohen më shumë në mësim; - Nxiten më shumë për të mësuar; - Nuk qëndrojnë shumë në internet, në rrjetet sociale; - Fëmijët nuk qëndrojnë shumë në rrugë; - Forcon fëmijën të jetë më i përgatitur më mirë për jetë.

Faktorët që ndikojnë në mbingarkesën e nxënësve në mësim. Sa u përket aspekteve apo faktorëve të mbingarkesës së nxënësve në mësim, numri më i madh i prindërve deklarojnë se tekstet shkollore janë një nga faktorët kryesorë që ndikojnë në mbingarkesë të nxënësve në mësim. Gjithashtu, një numër i madh i prindërve deklarojnë se një nga faktorët kryesorë të mbingarkesës së nxënësve në mësim është edhe numri i lëndëve mësimore dhe përmbajtjet mësimore që mësohen në kuadër të lëndëve mësimore. Një numër relativisht i lartë i prindërve shprehen se faktorë të tjerë që ndikojnë në mbingarkesën e fëmijëve të tyre në mësim janë detyrat e shtëpisë dhe koha që duhet ndarë për detyra të shtëpisë, pastaj mësimdhënësit dhe mësimdhënia, si dhe shpeshtësia e vlerësimit me teste.

Në një renditje të faktorëve ndikues në mbingarkesë të nxënësve në mësim, sipas prindërve, reflektohet si në vijim:

- Tekstet shkollore;
- Numri i lëndëve mësimore;
- Përmbajtjet mësimore;
- Detyrat e shtëpisë;
- Mësimdhënësit dhe format e mësimdhënies;
- Shpeshtësia e vlerësimeve me teste.

Prindërit që kanë deklaruar se një nga faktorët kryesorë të mbingarkesës së nxënësve në mësim është mbingarkesa me tekste shkollore kryesisht u referohen numrit të teksteve shkollore brenda një klase, vetëm në raste të caktuara prekin elementet e ngarkesës së teksteve shkollore dhe mospërputhjen e tyre me kurrikulën.

Pjesa më e madhe e prindërve që kanë deklaruar se ka mbingarkesë me tekste u referohen klasave në të cilat ata i kanë fëmijët. Tekstet shkollore që cilësohen më të ngarkuara me përmbajtje dhe detyra janë tekstet e Matematikës në nivelin fillor, pastaj tekstet Njeriu dhe natyra po ashtu në nivelin fillor, Gjuhë shqipe 3B etj. Ndërsa, në klasat 6-9, specifikohen tekstet nga Gjuha gjermane (nuk specifikohen klasat), Histori kl. VII, Biologjia kl. IX, Matematika kl. VII dhe Gjeografia (nuk specifikohen klasat), etj. Kështu e përshkruajnë dy prindër mbingarkesën me tekste shkollore:

Mbingarkesë i konsideroj dy libra për një lëndë mësimore dhe plus detyrat me i shënuar në fletore (p/21 - prind me fëmijë me nevoja të veçanta, shkollë në zonë urbane);

Në Matematikën e klasës VII ka detyra që janë të klasës IX apo të klasës X të shkollës së mesme (p/11 - shkollë në zonë urbane).

Përveç mbingarkesës në mësim nga përmbajtjet e teksteve shkollore, nga prindërit paraqiten edhe përmbajtjet tjera, si ese-të që obligohen nxënësit, portfoliot, detyrat e shtëpisë nga tekstet dhe jashtë tyre, hulumtimi shtesë në internet, shumë lektyra shkollore, barra e rëndë e çantës, etj.

Prindërit në raste të caktuara i referohen shqetësimit të tyre që kanë edhe për mungesë të teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore për fëmijë me nevoja të veçanta. Njëkohësisht, ata kërkojnë që të këtë tekste shkollore dhe materiale mësimore edhe për këtë kategori të fëmijëve.

Kërkoj që të bëhen tekste shkollore e materiale mësimore edhe për fëmijët me Sindrom Down ose në përgjithësi për fëmijët me nevoja të veçanta (p/1 – prind i fëmijës me nevoja të veçanta, shkollë në zonë urbane).

Për numrin e madh të lëndëve mësimore shprehen si prindërit që i kanë fëmijët në arsimin fillor, klasat 1-5, ashtu edhe prindërit që fëmijët i kanë në arsimin e mesëm të ulët, klasat 6-9, mirëpo është shumë më i madh numri i prindërve që referojnë numrin e lëndëve në arsimin fillor, duke e ndërlidhur atë me moshën e fëmijëve.

Prindërit që kanë deklaruar se një nga faktorët kryesorë të mbingarkesës së nxënësve në mësim është mbingarkesa me përmbajtje mësimore/ tema dhe njësia mësimore, kanë dhënë argumente të ndryshme, të cilat prekin lëndët mësimore, klasat, por edhe disa aspekte të përmbajtjeve mësimore që lidhen me të kuptuarit e tyre nga nxënësit.

Sa u përket lëndëve mësimore të ngarkuara me përmbajtje mësimore, prindërit për arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9) më shumë kanë theksuar se ka mbingarkesë në lëndët: Biologji, Matematikë (pjesa e gjeometrisë), Histori, TIK, Kimi, Gjuhë gjermane dhe Fizikë. Ndërsa për nivelin e shkollës fillore është theksuar se janë të mbingarkuara lënda e Gjuhës

shqipe, Gjuha angleze, Matematika, Njeriu dhe natyra. Prindërit kanë deklaruar se, sipas mendimit të tyre, një pjesë e përmbajtjeve mësimore në këto lëndë mësimore nuk përkon me moshën e nxënësve.

Përveç konstatimit se në lëndët mësimore më sipër ka mbingarkesa me përmbajtje mësimore/ tema dhe njësi mësimore, prindërit japin edhe disa sugjerime për atë se çfarë duhet bërë, si të evitohet ose zvogëlohet mbingarkesa e nxënësve në mësim. Prindërit sugjerojnë që të:

- reduktohen disa rezultate të të nxënësve në Kimi, Fizikë, Matematikë, Biologji;
- përmbajtjet që shpjegohen të thjeshtësohen nga mësimdhënësit që ato të jenë më të kuptueshme për nxënës;
- mësimi i gjuhës angleze në nivelin fillor të bëhet më me kujdes;
- bëhet freskim i përmbajtjeve mësimore, krahas me realitetin që e jetojnë fëmijët;
- detyrat për nxënës të jenë sa më të thjeshta dhe të kuptueshme;
- këtë një koordinim më të mirë në përdorimin e teksteve shkollore, në lëndët mësimore me 2-3 tekste shkollore;

Disa prindër kështu i përshkruajnë sugjerimet e tyre për atë se çfarë duhet bërë, si të evitohet ose të zvogëlohet mbingarkesa e nxënësve në mësim:

- *Për të evituar këtë ngarkesë, duhet të bëhen ndryshime në kurrikulë, sepse shpjegohen njësi mësimore të rënda, duke marrë parasysh moshën e nxënësve (p/3 - kryetar i prindërve të kl. 3, shkollë në zonë urbane);*
- *Nevojitet reformim në përmbajtje, freskim i përmbajtjeve me realitetin dhe kohën (p/14 - kryetar i prindërve kl. 7, shkollë në zonë urbane);*
- *Nxënësi është nxënës, duhet të mësojë mësimet, por duhet të merret edhe më shumë me aktivitetet edukative (p/24 – shkollë në zonë urbane);*

- *Shkolla duhet që ta lehtësojë mësimin për fëmijët, pak më shumë dhe ta thjeshtësojë atë për shkak të mbingarkesave që bartin fëmijët (p/36 - kryetar i prindërve kl. 3, shkollë në zonë urbane).*

Një numër fare i vogël i prindërve kanë deklaruar se detyrat e shtëpisë nuk janë mbingarkesë për nxënësit dhe se mësimdhënësit japin aq detyra sa nxënësit mund t'i kryejnë pa u mbingarkuar shumë. Ky grup i prindërve këtë e sheh si lehtësi e krijuar nga përdorimi i mjeteve teknologjike për komunikim dhe kontrollim të detyrave të shtëpisë.

Në anën tjetër, pjesa më e madhe e prindërve kanë deklaruar se nxënësit janë të mbingarkuar me detyra të shtëpisë. Këtë e arsyetojnë në mënyra të ndryshme, duke filluar nga ajo se shpesh u jepen detyra pa u sqaruar mirë në klasë, pastaj ka raste kur një fëmijë i punon detyrat të tjerët i kopjojnë nga ai, mungesa e kohës për t'u sqaruar sa duhet në klasë detyrat. Shqetësimin më të madh lidhur me detyrat e shtëpisë e kanë për mungesën e udhëzimeve dhe sqarimeve që nxënësit i marrin. Kështu shprehet një prind:

Unë mendoj që detyrat e shtëpisë duhet të jenë motivim dhe më praktike për nxënësin, të ketë udhëzime që të jenë më të kuptueshme për fëmijët (p/26 - anëtar i KDSh-së, shkollë në zonë urbane).

Ka edhe kërkesa të ndryshme nga prindërit për detyrat e shtëpisë, që të mos ketë detyra gjatë vikendit, të mos u kërkohej të mësojnë vjersha përmendësh, të jepen detyra praktike, të zgjaten orët mësimore ose të mbahen orë shtesë, sipas nevojës, të jenë detyrat motivuese për nxënësin, të bëhen shkollat me qëndrim tërëditor, që fëmijët të kryejnë detyrat në shkollë, si dhe të zvogëlohet kriteri i vlerësimit për nxënësit.

Kështu i parashtrojnë kërkesat e tyre dy prindër lidhur me qasjen ndaj detyrave të shtëpisë:

- *Detyrat e klasës duhet të kryhen në klasë. Temat/njësitë mësimore të shpjegohen nga mësuesit para se të japin detyra për nxënësit, si duket në mungesë kohe për mësim në klasë mësuesit japin shumë detyra në shtëpi (p/8 - kryetar i prindërve kl. 8, shkollë në zonë rurale);*
- *Gjatë vikendeve nxënësit mos të kenë detyra, me qëllim që vikendi të kalojë pa ngarkesë me detyra dhe të fillojë shkollën me vullnet edhe*

vikendin ta kalojë me familje pa ngarkesë (p/14 - kryetar i prindërve kl. 7, shkollë në zonë rurale).

Gjithashtu, prindërit pjesëmarrës në studim raportuan si faktorë të mbingarkesës edhe mësimdhënësit dhe format e mësimdhënies që i aplikojnë një numër i mësimdhënësve. Ata i referohen ngarkesës që mësimdhënësit e shkaktojnë për disa fëmijë gjatë punës apo detyrave në grupe, prezantime dhe projekte, pasi një nxënës pothuajse vetëm punon, në anën tjetër marrin notë të njëjtë të gjithë nxënësit. Pastaj u referohen disa mësimdhënësve, të cilët nuk janë atraktivë në mësimdhënie, nuk i shpjegojnë mirë mësimet apo nuk i shpjegojnë fare dhe për pasojë, sipas tyre, fëmijët nuk i kuptojnë mësimet, stresohen rreth mësimëve etj. Në linjë me këto aspekte, prindërit kërkojnë që:

Mësimdhënësit të mos kërkojnë më shumë nga fëmijët, më shumë sesa ata ofrojnë për fëmijët (p/4 - kryetar i prindërve kl. 8, shkollë në zonë urbane);

Mos të obligohet fëmija të mësojë tema të pashpjeguara nga mësimdhënësi (p/7 - kryetar i prindërve kl. 5, shkollë në zonë urbane);

Mësimdhënësit të jenë më atraktivë në mësimdhënie, të informojnë nxënësit për gabimet në tekste dhe t'i evitojnë ato gjatë punës me nxënës (p/18- kryetar i prindërve kl. 8, shkollë në zonë urbane).

Ka prindër, individ, që akoma kërkon qasje tradicionale të edukimit të fëmijëve, gjë për të cilën kërkohet që mësuesit klasorë dhe arsimtarët lëndorë të jenë më të rreptë ndaj fëmijëve, por edhe pak agresivë, në mënyrë që fëmija të ketë frikë!

Rreptësia nga ana e arsimtarëve, mësuesve, të jetë pak ma agresive, që fëmija të ketë frikë prej dikujt(p/24 - shkollë në zonë urbane).

Në anën tjetër, prindërit kur flasin për shpeshtësinë e vlerësimeve me teste, si faktorë ndikues në mbingarkesën e nxënësve, u referohen periudhave të vlerësimeve me testeve, të cilat, sipas tyre, shkaktojnë ngarkesa të njëpasnjëshme.

Si përfundim, mund të thuhet se, edhe pse prindërit nuk i përshkruajnë të gjitha elementet e faktorëve ndikues në mbingarkesën e nxënësve në mësim, ata flasin mjaft për mbingarkesën që e shohin te fëmijët e tyre.

4.3.3.3. Ndikimi i mbingarkesës në mësim në ndryshimin e sjelljes së nxënësve

Prindërit pjesëmarrës në studim raportuan elemente të ndikimit të mbingarkesës së nxënësve në mësim, të cilat, sipas tyre, reflektohet në forma dhe sjellje të ndryshme te fëmijët e tyre, në varësi të ngarkesës që kanë, me elemente që më shumë lidhen me mirëqenien e fëmijëve.

Prindërit deklarimet e tyre për ndikimin e mbingarkesës së nxënësve në mësim i mbështesin në sjelljet e ndryshme të fëmijëve të tyre, të cilat prindërit i kanë vërejtur në periudha të ndryshme të vitit mësimor, kur fëmijët kthehen në shtëpi nga shkolla.

Shumica e prindërve kanë deklaruar se fëmijët e tyre kur të vijnë në shtëpi janë të lodhur nga mësimet dhe angazhimet në shkollë. Sipas tyre, ata (fëmijët e tyre) shpesh janë pa humor, pa disponim, të tensionuar se nuk i kanë kuptuar mirë mësimet në shkollë, shfaqin shqetësime të shumta për tema mësimore, të cilat nuk i shohin me interes për ta. Gjithashtu, sipas prindërve, fëmijët e tyre shpesh shfaqin shqetësime ndaj punës së disa mësimdhënësve, të cilët kërkojnë shumë nga nxënësit e vetë bëjnë pak, japin shumë detyra të shtëpisë, nuk kanë kreativitet në nxënie etj.

Po ashtu, prindërit shprehen se fëmijët e tyre janë të shqetësuar edhe për testet, vlerësimet e shpeshta që u bëhen për vendosjen e notave në lëndë të ndryshme. Sipas prindërve, fëmijët janë shumë të stresuar në kohën e testeve, para testeve dhe deri në marrjen e rezultateve të tyre. Por ka edhe prindër që mendojnë se shqetësimet e fëmijëve të tyre nuk vijnë vetëm nga mësimet, angazhimet, vlerësimet, por edhe nga mosha e tyre e adoleshencës dhe nga shoqëria, si dhe nga ndikimi që kanë sot celularët dhe mjetet e komunikimit social.

Fëmija sa të kthehet në shtëpi, fjala e parë „O nana shumë kam detyra”. „Nesër kemi test”, “Jam i shqetësuar”. Ndoshta jo shpesh, vetëm po e shohim se fëmijët sot më shumë shqetësohen për nota sesa për diçka që kanë mësuar (9/25 – anëtare e Taskforcës së Shkollës, shkollë në zonë urbane).

Jo të gjithë prindërit janë shprehur se fëmijët e tyre kanë shfaqur ndryshime në sjellje apo shqetësime nga ngarkesa me mësim në shkollë, pra, një numër i vogël i prindërve kanë theksuar se nuk kanë hetuar shqetësime, lodhje apo ndryshim në sjelle të fëmijëve të tyre nga mbingarkesa e nxënësve me mësim.

Ngarkesa me mësim dhe detyra të shtëpisë. Pothuajse pjesa më e madhe e prindërve ndajnë mendimin se fëmijët janë të ngarkuar me mësim dhe detyra në shtëpi. Ata, gjithashtu, shprehen se pjesa më e madhe e mësimit në shtëpi që japin detyra të shtëpisë për nxënësit, nuk i japin udhëzimet e nevojshme për detyrat, sidomos për ato detyra që nuk i kanë ushtruar apo praktikuar gjatë mësimit në klasë.

Sipas prindërve, ka ndryshime në sjellje apo shfaqje të shqetësimeve nga fëmijët e tyre kur kanë shumë mësim dhe detyra të shtëpisë, si dhe kur nuk i kuptojnë dhe nuk arrijnë t’i kryejnë detyrat e shtëpisë. Prindërit shprehen se në këto raste të fëmijët e tyre vërejnë hezitime për të vazhduar me detyrat, shfaqje të dyshimeve dhe të mosbesimit në aftësitë e tyre, mungesë përqendrimi, shpesh edhe nervozizëm, deri në rastet kur në forma të ndryshme shprehin mosdëshirë për të shkuar në shkollë.

Ka një numër të konsiderueshëm të prindërve, të cilët deklarojnë se fëmijët e tyre nuk kanë shqetësime lidhur me mësimet dhe detyrat e shtëpisë, pasi i kryejnë detyrat me vullnet dhe për këtë prindërit shpesh i motivojnë fëmijët e tyre. Në mesin e tyre, disa prindër deklarohen se duhet t’i ndihmojnë fëmijët në kryerjen e detyrave të shtëpisë, pasi që paraprakisht e kanë të ditur se ata (fëmijët e tyre) nuk mund t’i kryejnë vetë. Disa prindër thonë se fëmijët e tyre i fillojnë me përtesë detyrat e shtëpisë, duke insistuar në përkrahjen e prindit, gjë të cilën prindërit detyrohen që ta japin për fëmijët e tyre.

Jo të gjithë prindërit u përgjigjen kërkesave të fëmijëve për t'u ndihmuar rreth detyrave të shkollës që duhet t'i kryejnë në shtëpi, sipas arsytimeve të tyre, për shkak të kohës, si dhe për shkak se nuk i njohin përmbajtjet e detyrave, thjesht vlerësojnë se duhet shkolla dhe mësimit të japin më shumë udhëzime rreth detyrave, në mënyrë që fëmijët të mësohen t'i punojnë ato në mënyrë të pavarur.

Shqetësimet e familjes për vlerësimin e fëmijës. Preokupim dhe shqetësim për prindërit dhe familjen e nxënësve paraqiten të jenë vlerësimi dhe notat e fituara nga fëmijët e tyre në shkollë. Secilin shqetësim prindërit e lidhin me rezultatet e arritura të fëmijës, notat, por në disa raste edhe me mirëqenien e fëmijëve. Disa prindër deklarohen se fëmijëve nuk u intereson nota, ndërsa disa paraqesin pikërisht vlerësimin me nota si shqetësim, duke treguar kështu që një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve mësojnë për notë dhe jo për dije. Kjo pastaj, sipas prindërve, kthehet në shqetësime familjare dhe do të duhej të jetë edhe shqetësim i shkollës dhe shoqërisë.

Ka prindër të cilët nuk hezitojnë ta thonë se, kur fëmijët e tyre marrin nota të ulëta, ata dekurajohen dhe traumatizohen, edhe kjo pastaj përbën shqetësim për ta si prindër dhe për gjithë familjen. Një pjesë e konsiderueshme e prindërve e paraqesin veten si pjesëmarrës të angazhimit të fëmijëve në secilin hap, pra, ata deklarojnë se mundohen jashtëzakonisht shumë që fëmijët e tyre t'i kuptojnë drejt dhe të ua ofrojnë ndihmën kur munden.

Prindërit shqetësohen kur nuk i dinë vetë detyrat për t'i ndihmuar fëmijët e tyre, shqetësohen kur e dinë që fëmijët munden edhe më shumë të arrijnë, por nuk e bëjnë një gjë të tillë për shkak të ndikimeve tjera, përfshirë ato të moshës, shoqërisë, rrjeteve sociale etj. Kjo e fundit, nga disa prindër shfrytëzohet si orientim për të nxitur diskutime në familje, për tema të ndryshme sociale, religjioze dhe nacionale, në mënyrë që të ndihmojnë fëmijët e tyre të kuptojnë realitetin në të cilin jetojnë dhe nevojën për t'u përballur me sfidat e jetës.

Një pjesë e konsiderueshme e prindërve deklarohen se i përkrahin dhe i mbështesin shumë fëmijët në detyra të shtëpisë, në thjeshtësimin e përmbajtjes, në zgjimin e interesimit për mësim, në ofrimin e alternativave

të ndryshme për të bërë të mësuarit më të kuptueshëm, më logjik, në përmbushjen e zbrazëtirave, duke i dërguar në kurse, në krijimin e kushteve materiale për mësim, duke i motivuar etj. Kështu shprehet një prind:

Shqetësimet tona lidhen më së shumti me rezultatet e ulëta në mësim, mundohemi t'i ndihmojmë fëmijët tanë, detyrohemi t'i angazhojmë në kurse dhe aktivitete të ndryshme (p/7 - kryetar i prindërve kl. 5, shkollë në zonë urbane).

Ndryshimet/shqetësimet e fëmijëve, të prindërve dhe familjes, lidhur me mbingarkesën me mësim dhe detyra gjatë mësimin në shkollë dhe në shtëpi, nga perspektiva e prindërve, janë përmbledhur në tabelën në vijim, në tri nënkategori dhe disa në tema specifike nga nënkategoritë – sipas shpeshhtësisë së informacionit të identifikuar.

Tabela 25. Ndikimi i mbingarkesës në ndryshimet emocionale dhe në sjellje të fëmijët, ndryshimet dhe shqetësimet që ndodhin në familje

Nënkategoria	Tema specifike nga nënkategoritë
Ndryshimet emocionale dhe në sjellje të fëmijëve nga mbingarkesa me mësim dhe detyra gjatë mësimin në shkollë – të vërejtura nga prindërit.	<ul style="list-style-type: none"> - Fëmijët shpesh rrinë pa humor, janë të lodhur; - Shohim nervozë, shqetësim, lodhje, shkak i ngarkesave gjatë ditës së mësimin në shkollë; - Stresi nga testet; - Shpesh ndryshme që shfaqen me panik, traumë, lodhje psikike, pagjumësi nga ngarkesa e testeve të njëpasnjëshme; - Shqetësime për temat mësimore që nuk i ka kuptuar në shkollë; - Fjalë jo të mira për mësimdhënësit që nuk i ndihmojnë në mësimet që nuk i kuptojnë, që kërkojnë shumë nga nxënësit e japin pak për ta.

<p>Ndryshimet emocionale dhe në sjellje të fëmijëve nga mbingarkesa me mësim dhe detyra të shtëpisë – të vërejtura nga prindërit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Ndryshimet vërehen gati çdo ditë, ndjenja të ndryshme, jo të mira, të mërzitur;</i> - <i>Mungesë motivimi;</i> - <i>Hezitim, nervozizëm, humbje e durimit;</i> - <i>Fëmijët janë nervozë, të lodhur dhe shpesh kanë reagime jo të mira;</i> - <i>Shumë lodhje dhe stres;</i> - <i>Mungesë interesimi për detyra;</i> - <i>Ankesa në detyra, shpesh kërkojnë ndihmë për t'i bërë detyrat.</i>
<p>Ndryshimet dhe shqetësimet që ndodhin në familje lidhur me mësimet dhe rezultatet e fëmijëve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Shqetësimi kur fëmijët sjellin rezultate negative në shtëpi</i> - <i>Të mërzitur kur rezultati që arrijnë fëmijët është i ulët;</i> - <i>Shqetësimi për fëmijët që mund të arrijnë më shumë, ndërsa ata nuk angazhohen në mësim;</i> - <i>Shqetësimi për fëmijët po luftojnë më shumë për nota e jo për dije;</i> - <i>Shqetësime kur nuk mund të ndihmohen fëmijët në mësim dhe detyra;</i> - <i>Preokupimi kryesor është mbivlerësimi që u bëhet nganjëherë fëmijëve në klasat e ulëta;</i> - <i>Rezultati i fëmijës është edhe rezultat i prindërve dhe familjes, prandaj ky është shqetësimi.</i>

Shfrytëzimi i kohës së lirë nga fëmijët/nxënësit. Mbingarkesa në mësim ndikon edhe në mundësitë e shfrytëzimit të kohës së lirë nga fëmijët/nxënësit. Lidhur me kohën e lirë për fëmijët/nxënësit dhe mundësitë

e shfrytëzimit të saj, prindërit e përfshirë në këtë studim janë të ndarë në dy grupe.

Grupi i parë i prindërve, pak më shumë se gjysma e prindërve të përfshirë në studim, janë të mendimit se fëmijët e tyre kanë kohë të lirë të mjaftueshme, e cila mund të shfrytëzohet për aktivitete të shumta. Këtë e arsyetojnë me kujdesin që ata tregojnë lidhur me organizimin e orarit të mësimin në shtëpi për fëmijët e tyre dhe mundësi të tjera për aktivitete të tjera. Kështu e përshkruan një prind mundësinë që kanë fëmijët për shfrytëzimin e kohës së lirë:

Po, kanë kohë të mjaftueshme edhe për lojë, edhe për mësim, edhe për detyra, të gjitha. Duhet secili prind të dijë si ta organizojë kohën për fëmijën e vet (p/15 - shkollë në zonë urbane).

Ndërsa, grupi i dytë, pjesa tjetër e prindërve, deklarojnë se fëmijët e tyre nuk kanë kohë të lirë të mjaftueshme, sepse kanë shumë detyra dhe angazhime në mësim, sidomos fëmijët e ciklit të ulët. Disa këtë e argumentojnë me kohën që fëmijët duhet të mësojnë në shtëpi, 4-5 orë fëmijët duhet të punojnë në shtëpi për të arritur rezultate të mira në vlerësim.

Disa prindër të tjerë, këtë e argumentojnë me lodhjen e fituar nga mësimet në shkollë, pesha e rëndë e çantës me shumë libra, por edhe me lodhjen që fëmijët e kanë nga detyrat e shtëpisë. Kështu e përshkruan një prind pamundësinë e fëmijëve që të kenë kohë të lirë:

Prej përvojës po them se fëmijët e arsimit fillor nuk kanë kohë për aktivitete tjera, përveç mësimin. Deri në ora 22:00 mbetemi duke bërë detyra si dhe ushtrime. Kjo vjen nga ngarkesa me detyra dhe për shkak të aftësisë/ shpejtësisë së bërjes së detyrave që kanë fëmijët në këtë moshë (p/35 - kryetar i KDSH-së, shkollë në zonë urbane).

4.3.3.4. Mundësitë e prindërve për përkrahje të fëmijëve në zvogëlimin e mbingarkesës në mësim dhe kërkesat e tyre për mbështetje të nxënësve nga institucionet arsimore

Përgjigjet/mendimet e prindërve për mundësitë e tyre në përkrahje të fëmijëve të tyre për zvogëlimin e mbingarkesës në mësim janë të shpërndara,

të ndryshme, varësisht nga zonat prej nga vijnë (rurale apo urbane), nivelet e shkollimit të tyre, përvojën e tyre me përkrahje të fëmijëve rreth të mësuarit, si dhe me ballafaqimet që ata i kanë me fëmijë, apo nevojat e fëmijëve të tyre.

Prindërit me nivele të ulëta të shkollimit, me shkollim fillor apo të mesëm, janë shumë skeptikë në mundësitë e tyre për të përkrahur fëmijët në mësim, me arsyetimin se ata nuk i njohin mirë përmbajtjet me të cilat sot fëmijët mësojnë dhe se ndihen keq apo shqetësohen kur nuk mund t'i mbështesin fëmijët e tyre, siç shprehet një prind:

Shqetësohem kur nuk mundem me i ditë detyrat që t'i tregoj apo ndihmoj fëmijës tim (p/30 – FNV, shkollë në zonë rurale).

Në anën tjetër, prindërit me nivele të larta të shkollimit të tyre universitar përshkruajnë më shumë përvoja dhe mundësi që i praktikojnë për përkrahje të fëmijëve të tyre në mësim dhe detyra, ku përmes përkrahjes së ofruar shprehen se i kontribuojnë zvogëlimit të mbingarkesës në mësim të fëmijëve të tyre. Kështu shprehet një prind:

E inkurajoj fëmijën tim, duke i treguar se vetëm mësimi (dija) është përgjegjësi dhe derë që t'i hapë dyert kudo, andaj angazhohemi bashkë për të arritur më shumë (p/14 - kryetar i prindërve kl. 7, shkollë në zonë urbane).

Ka prindër, pavarësisht nivelit të shkollimit që në mundësitë që kanë të gjejnë forma të ndryshme të mbështetjes për fëmijët e tyre, pa i specifikuar ato si qasje pune apo mbështetje teknike, siç shprehen prindërit:

Me ato mundësitë tona ne si prindër mundohemi aq sa të mundemi t'i përkrahim në mësim. Mundohemi që as një gjë të mos u mungojë gjatë viti shkollor (p/9 - kryetar i prindërve, kl. 3, shkollë në zonë rurale);

Ne si prindër i përkrahim në çdo formë fëmijët tanë që të na lehtësojnë punën gjatë gjithë kohës, që të arrihen rezultatet e kërkuara (p/19 - anëtar i KDSH-së, shkollë në zonë urbane);

Fëmijën tim e përkrahim dhe i japim vullnet për të mësuar (p/33 – anëtar i Këshillit të prindërve, shkollë në zonë rurale).

Në situatë më të pafavorshme për të ndihmuar fëmijët e tyre del të jenë prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta. Ata shprehen së janë shumë të kufizuar në mundësitë që kanë dhe në përvojën e tyre për të mbështetur fëmijët në mësim, edhe pse shprehen se ftohen nga shkolla në përpjekje për të ndihmuar fëmijët në këtë drejtim. Ky grup i prindërve, kur diskutojnë mundësitë e tyre në përkrahje të fëmijëve, më shumë i drejtojnë në formë të kërkesave për institucionet arsimore, se si të punojnë me fëmijët me nevoja të veçanta. Kështu shprehet një prind, i cili e ka fëmijën me Sindrom Down:

Unë si prind i fëmijës me Sindrom Down, kërkoj nga Ministria e Arsimit që të bëjë diçka në lidhje me tekstet shkollore për fëmijët tanë. Në çdo shkollë të evidentohen rastet dhe në bazë të njohurive të tyre të mësohen me tekste adekuate, jo me tekste të njëjta si fëmijët tjerë. Kërkoj që në bazë të arritjeve të fëmijës të bëhet plani individual e jo vetëm në Gjuhë shqipe e Matematikë, sepse vajza ime është e aftë të mësojë edhe nga lëndët e tjera. Kërkoj shumë që të merren parasysh këto kërkesa. Gjithashtu, kërkoj që të kenë dhe të sjellin tekste edhe për fëmijët me shikim të dobët (p/1 - FNV, shkollë në zonë urbane).

Ka prindër të cilët rolin e tyre mbështetës për fëmijët e shohin si një mundësi që nuk duhet bërë çdoherë dhe menjëherë kur kërkohet nga fëmija, në mënyrë që fëmijët të ndihmohen në pavarësimin e tyre në mësim dhe kryerjen e detyrave dhe obligimeve të shkollës që i kanë. Kështu shprehet një prind:

Mendoj se fëmijët duhet të kuptojnë se detyrat dhe obligimet u takojnë atyre, e ne prindërit duhet të jemi në rrjedha të vazhdueshme dhe t'i përkrahim kur kanë nevojë (p/4 - kryetar i prindërve kl. 8-të, shkollë në zonë urbane).

Në anën tjetër, sa i përket diskutimit për kërkesat e prindërve ndaj shkollave/institucioneve arsimore që lidhen me veprimet që duhet të ndërmerren për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare, ato kryesisht i referohen fuqizimit të bashkëpunimit mësimdhënës-prind-

nxënës, si dhe veprimeve tjera që çojnë në përkrahje të drejtpërdrejtë për fëmijët e tyre.

Shumica e prindërve e shohin të nevojshme që të këtë bashkëpunim më të ngushtë mesimdhënës-prind-nxënës, të mbështeten më shumë fëmijët që nuk kanë rezultate të mira, të organizohen takime më të shpeshta për t'u njoftuar me problemet dhe të kërkohet zgjidhje, të zgjatet orari i qëndrimit të nxënësve në shkollë, nga mesimdhënësit të sqarohen njësitë mesimore deri në nivelin që janë të kuptueshme për nxënësit, të këtë aktivitete, kurse të organizuara në shkollë që të lirohen nxënësit nga ngarkesat, të këtë mbështetje pedagogjike e psikologjike, të krijohen kushte të mira për mesim, kabinete, mjete teknologjike, biblioteka, libra të rinj etj. Gjithashtu, kërkohet nga shkolla të këtë raporte më të shpeshta për arritjet dhe ngeçjet e nxënësve.

Është një numër i vogël i prindërve të cilët kanë paraqitur ide se prindërit mos të përfshihen shumë në shkollë për çështjet e kurrikulave, sepse nuk janë profesionistë dhe mund të jenë subjektivë.

Një grup tjetër i prindërve sugjerojnë që të merren praktika të mira të punës në grupe, sepse, sipas fëmijëve të tyre, në mënyrën se si aktualisht mësojnë në grupe, nuk mësojnë të gjithë fëmijët brenda një grupi dhe në të shumtën e rasteve një individ në grup punon të tjerët vlerësohen dhe i marrin meritat. Të këtë më pak teori, më shumë të mesuar logjik dhe mesimdhënësit mos ta kalojnë kohën e mesimit vetëm duke bashkëbiseduar me nxënësit, por të ofrojnë shpjegime adekuate, me shembuj praktikë.

Ka disa kërkesa të prindërve që të zgjatet orari i qëndrimit në shkollë, të realizohet ora e edukatës fizike në arsimin fillor, sepse, sipas tyre, këto orë të mesimit nuk realizohen rregullisht gjatë vitit shkollor, ndërsa ndodh që në periudhën e dimrit fare të mos realizohen.

Mjetet teknologjike u referohen më shumë përdorimit të tyre në rrjetet sociale, shihen si ngarkesë për fëmijët, të cilat gjithnjë e më shumë po ndikojnë që fëmijët të bëhen të varur nga ato dhe, si pasojë, të humbin interesimin për mesim. Në linjë me këtë, nga prindërit kërkohet të gjenden metoda që të motivohen fëmijët që të duan mesimin dhe të largohen më shumë nga përdorimi i teknologjisë që nuk është e lidhur me mesimin në shkollë.

Nga Ministria e Arsimit kërkohet të bëjnë lehtësira që lidhen me mësimin dhe mësimdhënien në shkolla, të shkarkojnë çantën e nxënësve nga librat e shumta, të sigurojnë asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta, të bëjnë zvogëlimin e numrit të lëndëve mësimore dhe të teksteve shkollore, të monitorohen mësimdhënësit për cilësinë që ofrojnë, mësimi deri në klasën e pestë të jetë mësim më shumë i fokusuar në shkrim-lexim dhe katër veprimet themelore matematikore.

4.3.4. Mbingarkesa kurrikulare nga perspektiva e drejtorëve të shkollave dhe koordinatorëve të cilësisë në shkolla

Rezultatet në këtë pjesë pasqyrojnë gjetjet kryesore nga perspektivat e drejtorëve të shkollave dhe koordinatorëve të cilësisë në shkolla, pjesëmarrës në studim, për aspektet e hulumtuara lidhur me mbingarkesën kurrikulare në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët. Gjetjet kryesore janë përdorur për të bërë përshkrimin narrativ të fushave të hulumtuara, ato shoqërohen me citime nga të dhënat e mbledhura me intervistat e realizuara. Rezultatet janë kategorizuar dhe prezantohen në katër tema të emërtuara sipas fushave të hulumtuara, ku secila prej tyre përcillet edhe me nënkategori tematike të veçanta dhe tema specifike nga secila nënkategori, të cilat janë të renditura sipas shpeshësisë së informacionit të identifikuar nga të dhënat e mbledhura me intervistat e realizuara.

4.3.4.1. Zbatimi i kurrikulës në nivel shkolle

Drejtorët e shkollave dhe koordinatorët e cilësisë në nivel të shkollës, në diskutimet e tyre lidhur me zbatimin e kurrikulës në nivel shkolle, prekën elemente të ndryshme, që lidhen me koordinimin e aktiviteteve për zbatimin e kurrikulës në nivel shkolle, sigurimin e dëshmive për zbatimin e kurrikulës së re, gatishmërinë dhe besimin e mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës, si dhe për vështirësitë, sfidat dhe shqetësimet e ngritura nga mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit lidhur me zbatimin e kurrikulës.

Koordinimi i aktiviteteve për zbatimin e kurrikulës në nivel shkolle. Aspektet më të theksuara nga drejtorët e shkollave dhe KC lidhur me koordinimin e aktiviteteve për zbatimin e kurrikulës në nivel shkolle

kryesisht i referohen mbështetjes së trajnimeve për zbatimin e kurrikulës, të organizuara nga MASHTI në bashkëpunim me DKA-të, pastaj punën e bërë me aktivet profesionale në planifikimet që lidhen me zbatimin e kurrikulës, përgatitjen e instrumenteve të vlerësimit.

Drejtorët e shkollave në masë të madhe i referohen koordinimit të aktiviteteve që lidhen me krijimin e kushteve, përkrahjen teknike, si dhe me sigurimin e pajisjeve të TIK-ut. Përfshirjen e drejtorit të shkollës në koordinimin e aktiviteteve për zbatimin e kurrikulës kështu e përshkruan një drejtor shkolle: *Mund të veçoj sigurimin e kabineteve dhe mjeteve të konkretizimit, SMART TV në disa klasa, sigurimin e dollapëve për mësimdhënës për vendosjen e dosjes së punës dhe mjeteve tjera që atyre u duhen për procesin mësimor* (d/5- shkollë urbane).

Kontrollimi i dosjeve të mësimdhënësve të përfshirë në trajnimin për zbatimin e kurrikulës zë një hapësirë të konsiderueshme në kuadër të aktiviteteve të drejtorëve dhe KC në nivel shkolle, lidhur me koordinimin e përgatitjeve të shkollës për zbatimin e kurrikulës. Mirëpo, nga përshkrimet e bëra shihet se kjo është bërë më shumë për çështje të certifikimit të mësimdhënësve sesa për të siguruar një përgatitje efektive për zbatimin e kurrikulës në nivel të shkollës.

Në përshkrimet e bëra nga drejtorët e shkollave dhe KC të përfshirë në hulumtim, aspektet e informimit dhe sensibilizimit të vazhdueshëm të komunitetit shkollor për mundësitë dhe kërkesat e reja të kurrikulës, nuk duket të jenë të përfshira si aktivitete kryesore dhe të organizuara për qëllime të informimit, me një përjashtim të theksuar nga tre drejtorë dhe tre koordinatorë për sigurim të cilësisë, të shkollave të njëjta.

Gjithashtu, në përshkrimet e bëra nga drejtorët e shkollave dhe KC të përfshirë në hulumtim, në asnjë rast nuk referohet se shkollat kanë shkëputur nga PZhSh një plan të veçantë të veprimit për zbatimin e kurrikulës, kryesisht i referohen një plani vjetor të punës së shkollës, në të cilin janë përfshirë të gjitha aspektet teknike e organizimit të punës vjetore të shkollës.

Si aktivitete koordinimi për zbatimin e kurrikulës në nivel shkolle, të cilat iu referohen drejtorët e shkollave dhe KC, janë edhe puna me aktivet profesionale, organizimi i diskutimeve për kurrikulën në nivel shkolle,

përkrahja në përcaktimin e instrumenteve të vlerësimit, realizimi i vlerësimit të performancës së shkollës, trajtimi i aktiviteteve ekstarkurrikulare etj.

Sigurimi i dëshmive për zbatimin e kurrikulës së re. Sa i përket sigurimit të dëshmive për zbatimin e kurrikulës së re, drejtorët dhe KC të shkollave të përfshira në studim kryesisht vënë theksin në dosjet e mësimdhënësve nga trajnimet për kurrikulë, dosjet e planeve vjetore dhe për periudha mësimore që përgatiten në nivel të aktiveve profesionale, ditarët personalë të mësimdhënësve për vlerësimin e nxënësve dhe në disa raste edhe raportet që janë përgatitur për DKA-të ose për MASHTI-n, të cilat kryesisht janë raporte informative të kërkuara.

Vetëm në tri raste specifikohet se, në kuadër të VBSH-së kanë raporte më të detajuara, që lidhen me zbatimin e kurrikulës, sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen shkollat në zbatimin e kurrikulës së re.

Sipas drejtorëve të shkollave dhe KC të përfshirë në studim, shkollat përgatisin raporte të punës sipas periudhave mësimore dhe në fund të vitit shkollor, të cilat nga drejtorët e shkollave dërgohen në DKA dhe pastaj përcillen në MASHTI. Modelet e 3-4 raporteve të analizuara përshkruajnë aspektet e përgjithshme që e karakterizojnë një periudhë mësimore, kryesisht me gjuhë pozitive, pa një fokus të veçantë në zbatimin e kurrikulës dhe pa analizë dhe përshkrim të progresit të arritur, sfidave dhe vështirësive, me të cilat janë ballafaquar, dhe hapave të mëtejme. Sipas raportit nga shkolla nr.1, kemi një formulim në linjë me këtë që u përshkrua më sipër:

Janë realizuar të gjitha orët mësimore të planifikuara për këtë periudhë të mësimin, nuk kemi fare orë mësimore të humbura, zbatimi i kurrikulës bëhet sipas planifikimeve.

Ka shkolla të cilat kanë bërë përpjekje që t'i raportojnë në mënyrë të detajuar problemet e ngritura nga aktivet profesionale për çështjen e kurrikulës, si p.sh. raporti nga shkolla nr. 3:

Disa nga rezultatet e lëndës Biologji kl.6 dhe Fizikë kl.7 nuk korrespondojnë me temat mësimore; librat e shkollës III në fushën e shkencave natyrore nuk janë në përputhje të plotë me kurrikulën, ka mangësi në programet lëndore të matematikës, në kl.8 dhe 9.

Sipas drejtorëve të shkollave dhe KC të përfshirë në studim, nga MASHTI çdo vit kanë pranuar instrumentin për të dhëna rreth kurrikulave lëndore, të cilin e kanë plotësuar dhe dërguar përmes DKA-ve, me vërejtje dhe sugjerime, për të cilat nuk kanë marrë informata kthyesë për adresimin e tyre. Lidhur me këtë, njëri nga KC, nga një shkollë rurale, shprehet:

Në shumicën e rasteve, sugjerimet e aktiveve profesionale nuk i kemi parë në programet/kurrikulat e reja që janë adresuar, siç janë propozimet e mësimdhënësve që lidhen me heqjen apo shtimin e disa temave mësimore (KC/3 – shkollë rurale).

Gatishmëria dhe besimi i mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës. Sa u përket gatishmërisë dhe besimit të mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës, drejtorët dhe KC e përfshirë në këtë studim shprehen se fillimi i zbatimit të kurrikulës ishte me shumë skepticizëm, me kalimin e kohës kurrikula si e tillë është duke u pranuar. Ata e përshkruajnë se faza e pilotimit ishte tepër ngarkesë për mësimdhënës dhe për drejtorët e shkollave. Kështu shprehet njëri nga drejtorët e shkollave rurale:

Prej një kurrikulë të detajuar, kërkesa për mësimdhënës dhe shkolla lidhur me hartimin e programeve lëndore, bazuar në Kurrikulat Bërthamë dhe përvojën e vetë mësimdhënësve, ishte tepër ambicioze, ishte kërkesë, e cila as sot nuk mund të realizohet në nivel shkolle!(d/1- shkollë rurale).

Gatishmëria dhe besimi i mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës përshkruhen të jenë në rritje, por me sfida të shumta. Sipas drejtorëve të shkollave dhe KC akoma ka hezitime nga disa mësimdhënës. Në përshkrimet e tyre theksi vihet te mësimdhënësit më në moshë, kryesisht ata që janë para pensionimit, te mësimdhënësit që kanë mungesë të kompetencës digjitale, si dhe te mësimdhënësit që nuk janë të interesuar apo të motivuar të ndryshojnë qasjen e punës së tyre.

Një drejtoreshë shkolle, nga një zonë urbane, gjatë diskutimit për gatishmërinë dhe besimin e mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës, shprehet: *Si mund të zbatohet kurrikula kur ajo refuzohet nga një drejtor shkolle ose drejtor i DKA-së?*, prandaj sugjeron që të punohet në këtë nivel në mënyrë që të ndikohet në rritjen e gatishmërisë dhe besimit të

mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës. Sepse, sipas saj, kurrikula dhe mësimdhënësit nuk janë fajtorë, por, si duket, ka munguar një udhëheqje e harmonizuar në mes të hallkave të sistemit, nga MASHTI deri te shkolla.

Disa nga vështirësitë, sfidat dhe shqetësimet e ngritura nga mësimdhënësit, të cilat prezantohen nga drejtorët e shkollave dhe KC.

Sipas drejtorëve të shkollave dhe KC të përfshirë në studim, vështirësitë, sfidat dhe shqetësimet më të mëdha, të shfaqura nga mësimdhënësit lidhur me zbatimin e kurrikulës, janë si në vijim: mospërputhja e programeve lëndore me tekstet shkollore, administratë e ngarkuar, punë shtesë administrative për planifikim dhe për vlerësim, vlerësimi në tri periudha mësimore, vlerësimi për shkallë kurrikulare, kushtet e punës jo të mira, mungesë e mjeteve të konkretizimit dhe pajisjeve të TIK-ut.

Ka drejtorë dhe KC të përfshirë në këtë studim, të cilët specifikojnë edhe shqetësime të tjera të ngritura nga mësimdhënësit, si numri i madh i RNL-ve, në disa klasa RNL-të janë të larta për nivelin dhe moshën e nxënësve, disa tekste shkollore janë me terminologji jo të qarta, të mangëta me informata dhe jo në harmoni me programet lëndore, numri i madh i nxënësve në klasa pamundëson realizimin e RNL-ve (shkollat urbane), koha mësimore e pamjaftueshme për arritjen e RNL, për përforsim apo përsëritje – specifikohet në mënyrë të veçantë lënda e Gjeografisë, në klasat 8 dhe 9.

Tre KC dhe një drejtor shkolle, të përfshirë në studim, shprehen se një pjesë e mësimdhënësve të shkollave të tyre kanë shfaqur shqetësim për vështirësitë që kanë në të kuptuarit e kurrikulës, zbatimin e saj dhe në arritjet e rezultateve të të nxënësve nga një numër i madh i nxënësve, duke vërë theksin në lëndët e shkencave dhe në matematikë. Vetëm një drejtor shkolle u referohet vështirësive të mësimdhënësve për të kuptuarit dhe integrimin e çështjeve ndërkurrikulare në përmbajtjet mësimore që shtjellohen me nxënës.

Disa nga vështirësitë, sfidat dhe shqetësimet, e ngritura nga nxënësit dhe prindërit. Edhe nxënësit dhe prindërit, sipas drejtorëve të shkollave dhe KC të përfshirë në studim, shfaqin ankesat dhe shqetësimet e tyre kryesisht për mungesën e teksteve sipas kurrikulës për disa lëndë mësimore në disa

klasa (veçohen klasat për të cilat nuk është arritur që deri në këtë vit shkollor të zhvillohen tekstet e reja, klasat 4, 5 dhe 9), për numër të madh të teksteve të një lënde në klasë të njëjtë (më shumë në nivelin fillor), si dhe për sistemin e vlerësimit me tri periudha, me VP1 dhe VP2¹⁵.

Sipas drejtorëve të shkollave, prindërit shfaqin shqetësimet e tyre edhe për sigurimin e burimeve për disa tema mësimore që nuk janë në tekstet shkollore, çantat e ngarkuara për nxënës me shumë libra, vështirësitë që kanë fëmijët e tyre në punën me tekste të vjetra të klasave të ndryshme, p.sh. tekstet e klasës së 8-të janë përdorur në klasën e 6-të, për disa tema mësimore.

Rreth 50% e drejtorëve të shkollave dhe KC të përfshirë në studim tregojnë se prindërit në masë të madhe shfaqin shqetësimet e tyre për qasjen në mësimdhënie dhe në vlerësim nga një pjesë e mësimdhënësve. Po ashtu, për mungesë të informimit për notat, pasi që ato vendosen në ditarin personal të mësimdhënësit; për detyrat e shtëpisë, të cilat në të shumtën e rasteve u jepen nxënësve pa qëllime të caktuara dhe pa udhëzime përcjellëse, gjë që, sipas tyre u shkakton vështirësi nxënësve, por edhe vetë prindërve, të cilët deklarojnë se nuk mund t'u ndihmojnë fëmijëve të tyre në detyra të shtëpisë.

Si përmbledhje e kësaj pjese, mund të thuhet se drejtorët e shkollave dhe KC të përfshirë në studim ofrojnë pikëpamje të ndryshme lidhur me aspektet e hulumtuara për zbatimin e kurrikulës, ato dallojnë në varësi të specifikave të shkollave dhe të ballafaqimeve të tyre në zbatimin e kurrikulës, por edhe nga qasjet e punës së vetë drejtorëve dhe KC të përfshirë në këtë studim.

Pikëpamjet e drejtorëve të shkollave dhe KC për pesë nënkategoritë e lidhura me zbatimin e kurrikulës, të përshkruara më sipër, pasqyrohen në tabelën në vijim dhe për secilën nënkategori janë renditur tema specifike, sipas

¹⁵ Udhëzimi i ri administrativ për Vlerësimin e nxënësve (nr. 06/2022), ka disa risi që lidhen me kalimin e vlerësimit nga tri periudha mësimore në dy gjysmëvjetorë, krijimin e disa lehtësirave, fleksibilitetin dhe autonominë e mësimdhënësve në raport me përdorimin e instrumenteve që lidhen me vlerësimin përmbledhës. Disa nga sfidat dhe shqetësimet, e ngritura nga nxënësit dhe prindërit për VP1 dhe VP2, tashmë janë adresuar me udhëzimin e ri për vlerësimin e nxënësve. Më gjerësisht shih: <https://masht.rks-gov.net/udhezimi-administrativ-mashti-06-2022-per-vleresimin-e-nxenesve-ne-arsimin-paraunivesitar-te-republikes-se-kosoves/>

shpeshëtisë së informacionit të identifikuar nga të dhënat e mbledhura me intervistat e realizuara.

Tabela 26. Pikëpamjet e drejtorëve të shkollave dhe KC për aspekte të lidhura me zbatimin e kurrikulës dhe rolin e tyre

Nënkategoria	Tema specifike nga nënkategoritë
Koordinimi i aktiviteteve për zbatimin e kurrikulës në nivel shkolle	<ul style="list-style-type: none"> - Mbështetja e trajnimeve për kurrikulë, të organizuara nga MASHTI në bashkëpunim me DKA-të; - Kontrollimi i dosjeve të mësimdhënësve; - Përkrahje teknike; - Sigurimi i pajisjeve të TIK-ut; - Puna me aktivet profesionale; - Diskutime dhe punëtori në nivel shkolle; - Përkrahje në përcaktimin e instrumenteve të vlerësimit; - Vlerësimi i performancës së shkollës; - Trajtimi i aktiviteteve ekstarkurrikulare.
Sigurimi i dëshmime për zbatimin e kurrikulës së re	<ul style="list-style-type: none"> - Dosjet e mësimdhënësve nga trajnimet; - Dosjet e planifikimeve për zbatimin e kurrikulës; - Raportet dhe evidencat nga takimet me organet profesionale të shkollës; - Ditarët personalë të vlerësimit; - Raporti i VBSH; - Raportimet në DKA.
Gatishmëria dhe besimi i mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës	<ul style="list-style-type: none"> - Fillimi me shumë skepticizëm, me kalimin e kohës është duke u pranuar; - Faza e pilotimit tepër ngarkesë për mësimdhënës;

	<ul style="list-style-type: none"> - Kërkesa për hartimin nga vetë mësime të mësimdhënësve të tepër ambicioze; - Ka pasur fluturim herë andej – herë këndej; - Ka zhvillim pozitiv nga pilotimi; - Ka gatishmëri në rritje, me sfida të shumta, akoma me disa hezitime; - Besimi është prezent falë mbështetjes nga shkollat; - Ka mungesë të gatishmërisë të disa mësime të mësimdhënësve, por edhe drejtues të shkollave.
<p>Ankesat, vështirësitë, sfidat dhe shqetësimet e mësime të mësimdhënësve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Mospërputhja e programeve lëndore me tekste shkollore; - Administratë e ngarkuar, punë shtesë administrative për planifikim dhe për vlerësim; - Vlerësimi në tri periudha mësimore, teste të shpeshta, vlerësimi për shkallë kurrikulare; - Ankesat lidhen me ngarkesë të temave mësimore, njësi mësimore, me moszbatim të kurrikulës. - Numri i madh i RNL, në disa klasa RNL janë të larta për mundësitë dhe moshën e nxënësve; - Disa tekste shkollore me terminologji jo të qarta, të mangëta me informata dhe jo në harmoni me programet lëndore; - Numri i madh i nxënësve pamundëson realizimin e RNL (shkollat urbane); - Kohë mësimore e pamjaftueshme për arritjen e RNL në disa lëndë mësimore; - Kushtet e punës jo të mira, mungesë e mjeteve të konkretizimit dhe pajisjeve të TIK-ut;

	<ul style="list-style-type: none"> - Të kuptuarit e kurrikulës, përgatitja për zbatim etj. - Trajnimet jociësore për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e kurrikulës - Mungesë e informatave kthyesë për kërkesat dhe shqetësimet e ngritura nga mësime të ndryshme lidhur me çështjet e kurrikulës.
<p>Ankesat, vështirësitë, sfidat dhe shqetësimet e nxënësve dhe prindërve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e teksteve sipas kurrikulës për disa lëndë mësimore në disa klasa; - Qasja në mësime dhe në vlerësim; - Detyrat e shtëpisë, pa qëllime të caktuara dhe pa udhëzime përcjellëse; - Tekste të papërshtatshme dhe numri i madh i teksteve; - Vlerësimi me VP2, testet ngarkesë për nxënës; - Mungesë e informimit për notat pasi që ato vendosen në ditarin personal të mësime të ndryshme; - Numri i madh i nxënësve (shkollat urbane); - Mospërdorimi i TIK për mësim; - Vështirësitë e fëmijëve për arritjen e RNL në klasën e parë; - Sigurimi i materialeve kur mësimet nuk janë në tekstet shkollore; - Çanta e ngarkuar për nxënës, shumë libra dhe nxënësit e ngarkuar me informacione të tepërta; - Nuk mund t'u ndihmojnë nxënësve në detyra të shtëpisë; - Puna me tekste të vjetra të klasave të ndryshme.

4.3.4.2. **Perceptimi i drejtorëve të shkollave dhe KC për mbingarkesën kurrikulare dhe faktorët ndikues**

Të kuptuarit në thelb të asaj që konsiderohet mbingarkesë kurrikulare dhe njohja e faktorëve ndikues të mbingarkesës kurrikulare përbën hapin e parë për ngritur debatin profesional për këtë problematikë në nivel shkolle dhe për të ndërmarrë veprime konkrete për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare. Këto aspekte ishin orientim për të trajtuar me drejtorët e shkollave dhe KC mbingarkesën kurrikulare dhe faktorët ndikues.

Përshkrimi i mbingarkesës kurrikulare. Sa i përket përshkrimit se si e shohin drejtorët e shkollave dhe KC mbingarkesën kurrikulare, rezultatet tregojnë se ka dallime në përshkrimet e tyre. Pjesa më e madhe e drejtorëve të shkollave dhe KC të përfshirë në studim mbingarkesën kurrikulare e lidhin me mosharmonizimin apo mospërputhjen e teksteve shkollore me kurrikulat lëndore dhe me mungesën e kushteve dhe materialeve mësimore për mësimdhënës dhe nxënës.

Në mesin e përshkrimeve të drejtorëve të shkollave për mbingarkesën kurrikulare, kemi edhe përshkrime që kombinojnë elementet e kushteve të punës, përmbajtjes dhe kërkesave të kurrikulës që lidhen me atë se çfarë duhet të mësojnë nxënësit dhe atë se çfarë duhet të arrijnë, si dhe elementet që referojnë ngarkesën administrative, siç e quajnë një pjesë të punës së mësimdhënësve.

Mbingarkesën kurrikulare duhet parë në dy drejtime: a) mbingarkesë e tepruar në kurrikulat lëndore sa u përket rezultateve të temave mësimore; dhe b) orientimi në dy apo më shumë burime informimi për tema të caktuara, gjë e cila po u merr kohë mësimdhënësve (d/9 - drejtor shkolle në një zonë urbane dhe trajner i kurrikulës);

Mbingarkesa kurrikulare ndërlidhët me përmbajtjen për nxënës dhe ngarkesën administrative për mësimdhënës (d/4-drejtor shkolle, shkollë në zonë rurale);

Mungesa e kushteve për mësimdhënës dhe nxënës, numri i madh i temave mësimore, mungesë e prioritizimit të temave specifike, që duhet të jetë në autonomi të mësimdhënësve, si dhe aspektet tjera të

përmbajtjes që janë sfidues për nxënës dhe mësimitdhënës, është mbingarkesë kurrikulare (d/2-zëvendës drejtor shkolle dhe trajner i kurrikulës, shkolla në zonë urbane).

Koordinatorët e cilësisë, për dallim nga drejtorët e shkollave, kur falsin për mbingarkesën kurrikulare, theksojnë më shumë edhe aspekte të tjera si: numri i madh lëndëve mësimore, numri i madh i temave mësimore në disa lëndë, numri i madh i RNL që nuk arrihen të realizohen, qasja e mësimitdhënësve që nuk e lehtëson punën për nxënës. Një KC nga një shkollë rurale mbingarkesën kurrikulare e përshkruan me informata të tepërta për moshën e nxënësve në tekstet shkollore, ndërsa një KC nga një shkollë urbane mbingarkesën kurrikulare e përshkruan me numrin e madh të rezultateve të të nxënësve që nuk arrihen nga nxënës.

Faktorët e mbingarkesës kurrikulare. Tashmë dihet se faktorë të ndryshëm ndikojnë në mbingarkesën kurrikulare. Në pyetjen drejtuar drejtorëve dhe KC të përfshirë në këtë studim: *A konsideroni se ka mbingarkesë kurrikulare, mbingarkesë të nxënësve në mësim, nëse po a mund t'i specifikoni disa nga faktorët që vlerësoni se janë duke ndikuar më shumë në mbingarkesë?*, mbi 50% e tyre shprehën se ka mbingarkesë kurrikulare. Ata të cilët vlerësojnë se ka mbingarkesë kurrikulare si faktorë të mbingarkesës kryesisht, apo në numër më të madh i referohen numrit të lëndëve mësimore për klasë, numrit të orëve mësimore për lëndët që konsiderojnë që kanë shumë tema mësimore, teksteve shkollore, qasjeve praktike të mësimitdhënies, vlerësimit të nxënësve, detyrave të shtëpisë dhe aspekteve tjera që lidhen me kushtet e shkollës dhe me punën e mësimitdhënësve.

Ja se si i përmbledhin faktorët e mbingarkesës kurrikulare disa nga drejtorët dhe KC të përfshirë në studim:

Tekstet mësimore të papërshtatshme dhe joadekuate, numri i madh i lëndëve mësimore dhe i temave mësimore (KC/2 – shkollë urbane);

Përmbajtjet mësimore, detyrat e shtëpisë, tekste shkollore, puna administrative e mësimitdhënësve (d/5 – shkollë rurale);

Përmbajtja e teksteve dhe terminologjia e përdorur, RNL në disa lëndë nuk janë në përputhje me mundësitë e nxënësve, qasjet në mësimdhënie, periudhat mësimore të pabarabarta (KC/4 – shkollë urbane);

Tekstet shkollore – ato nuk mundësojnë qasjen e mësimdhënies për të zhvilluar kompetencat e nxënësve t'u përgjigjen kërkesave të studimit PISA. Gjuha e teksteve në arsimin fillor në shumë raste është e papërshtatshme për nxënës. Konsideroj se mospërgatitja e teksteve në kohën e duhur - paralel me futjen në zbatim të kurrikulave lëndore ka qenë ndër faktorët më ndikues në paraqitjen e mbingarkesës kurrikulare (d/10 – shkollë urbane).

Përqendrimi i mësimdhënësve në punën me nxënës. Kurrikula e bazuar në kompetenca kërkon ndryshimin e qasjeve në mësimdhënie, nga fokusi në përmbajtje – njohuritë në fokusin në procesin e të nxënës dhe zhvillimin e kompetencave. Për atë se sa ka ndryshuar qasja në mësimdhënie në këtë drejtim, i kemi pyetur drejtorët e shkollave dhe KC të përfshirë në këtë studim. Dominon konstatimi se pjesa më e madhe e mësimdhënësve vazhdojnë të kenë një fokus më të madh në zhvillimin e përmbajtjeve mësimore, në shpjegimin e njësisve mësimore sipas teksteve shkollore të lëndëve mësimore përkatëse.

Për sa i përket përqendrimit të mësimdhënësve në punën me nxënës, drejtorët e shkollave dhe KC, referuar vëzhgimeve të tyre në orë të mësimit, diskutimeve me mësimdhënës dhe nxënës, shprehin bindje se dominon përqendrimi i mësimdhënësve te përmbajtjet dhe njohuritë. Ka edhe drejtorë dhe KC të cilët, bazuar në evidencat e tyre për disa mësimdhënës, shprehin se qasja e disa mësimdhënësve që ndjekin në punën e tyre ka bërë që përqendrimi i tyre të jetë në detyra dhe projekte me nxënës, të cilat shpesh përcillen me pak udhëzime dhe me pak informata për qëllimet e mësimit. Kjo, sipas tyre, ka bërë që nxënës shpesh të jenë të mbingarkuar me detyra dhe projekte, të cilat nuk sigurojnë mësim efektiv dhe gjithëpërfshirje në mësim, pasi që disa nxënës i bëjnë detyrat dhe projektet për gjithë grupin dhe një pjesë e nxënësve vazhdojnë të mos jenë aktivë në procesin e të nxënës.

Referuar përshkrimeve të drejtorëve dhe KC për përqendrimin e mësimdhënësve në punën me nxënës, fitohet përshtypja se shpesh përqendrimi i mësimdhënësve në punën me nxënës, që ka në fokus përmbajtjet dhe njohuritë, merr orientim se si i shohin mësimdhënësit vlerësimet në nivel shkolle.

Përqendrimi i mësimdhënësve në punën me nxënës është te përmbajtjet mësimore - njohuritë, ato që lidhen me tekstet që përdoren, kjo sepse nuk bëhet ndonjë vlerësim për matje të rezultateve të kompetencave (KC/1, shkollë urbane).

Ka drejtorë të shkollave dhe KC të cilët theksojnë se disa mësimdhënës në shkollat e tyre janë duke i kushtuar më shumë kujdes gjatë punës me nxënës procesit të të nxënës dhe zhvillimit të kompetencave dhe kjo ka bërë që nxënësit e tyre të jenë më aktivë dhe më bashkëpunues në mësim.

Pikëpamjet e drejtorëve të shkollave dhe KC për mbingarkesën kurrikulare, faktorët e mbingarkesës, dhe për përqendrimin e mësimdhënësve në punën me nxënës, pasqyrohen në tabelën në vijim, ku për secilën nënkategori janë të renditura tema specifike, sipas shpeshtësisë së informacionit të identifikuar nga të dhënat e mbledhura me këtë grup të respondentëve.

Tabela 27. Pikëpamjet e drejtorëve të shkollave dhe KC për mbingarkesën kurrikulare dhe faktorët e mbingarkesës

Nënkategoria	Tema specifike nga nënkategoritë
Përshkrimi i mbingarkesës kurrikulare	<ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e kushteve dhe materialeve mësimore për mësimdhënës dhe nxënës; - Numri i madh i temave mësimore dhe mosprioritizimi i temave mësimore; - Mosharmonizimi i teksteve shkollore me programet/kurrikulat lëndore; - Më shumë lidhet me aspektet teknike sesa profesionale; - Niveli i realizimit apo mosrealizimit të kurrikulës; - Të gjitha ato që nuk janë në harmoni me kurrikulën; - Mosplanifikimi, realizimi dhe zbatimi i të gjitha aspekteve të kurrikulës;

	<ul style="list-style-type: none"> - Informata të tepërta për moshën e nxënësve; - Numri i madh i RNL që nuk realizohen; - Qasja e mësimdhënësit që nuk e lehtëson punën për nxënës.
Faktorët e mbingarkesës kurrikulare	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i lëndëve mësimore për klasë (vihet theksi në arsimin fillor); - Tekstet shkollore, përmbajtja e teksteve dhe terminologjia e përdorur; - Numri i temave mësimore dhe rezultateve të nxënit; - Koha mësimore në raport me përmbajtjet dhe RNL; - Qasja në mësimdhënie; - Vlerësimi i nxënësve; - Detyrat e shtëpisë; - Aspektet e organizimit të përmbajtjeve mësimore në kurrikula; - Puna administrative e mësimdhënësve; - Periudhat mësimore të pabarabarta; - Infrastruktura për mësim.
Përqendrimi i mësimdhënësve në punën me nxënës	<ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënësit përqendrohen te përmbajtjet e lëndës/librit shkollore; - Tek njohuritë, ato që lidhen me tekstet që përdoren; - Fokusi në dhënien e informacioneve të reja; - Më shumë te njohuritë në dhënien e informacioneve të reja; - Te njohuritë, ato që lidhen me tekstet që përdoren; - Fokusi në atë që shkruajnë në planet e tyre; - Tek njohuritë me përpjekje për zhvillim të kompetencave; - Tek njohuritë, ato që lidhen me tekstet që përdoren, kjo sepse nuk bëhet ndonjë vlerësim për matje të rezultateve të kompetencave.

4.3.4.3. **Perceptimi i drejtorëve të shkollave dhe KC për ndikimin e mbingarkesës kurrikulare**

Për sa i përket ndikimit të mbingarkesës kurrikulare në arritjet/rezultatet e nxënësve, mirëqenien e nxënësve dhe në punën e mësimdhënësve, drejtorët e shkollave dhe KC, në radhë të parë, shprehen se në rrethanat se si është duke zbatuar kurrikulën e re, ajo pashmangshëm është duke ndikuar më së shumti te nxënësit dhe mësimdhënësit. Në përgjithësi, pikëpamjet e tyre janë të njëjta sa i përket ndikimit të mbingarkesës kurrikulare, me përjashtim të numrit dhe renditjes së elementeve që pasqyrojnë ndikimin në nxënës dhe në punën e mësimdhënësve.

Ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në arritjet/rezultatet e nxënësve.

Përshkruhet në mënyra të ndryshme, si nga drejtorët e shkollave ashtu edhe nga KC të përfshirë në këtë studim. Pjesa më e madhe e atyre që konsiderojnë se ka mbingarkesë kurrikulare shprehen se ajo reflektohet në nivelin e të mësuarit të nxënësve, duke vënë theksin në suksesin e nxënësve mesatarë dhe nënmesatarë, në suksesin e nxënësve në lëndën e Matematikës dhe në lëndët e shkencave natyrore.

Kur flasim për ndikimin e mbingarkesës në rezultate të nxënësve, ajo që është më e rëndësishme, mungon mbështetja në evidenca për rezultatet, në krahasime të rezultateve etj. Në këtë drejtim, KC dhe drejtorët e shkollave më shumë u referohen qëndrimeve të tyre apo deklaratave të nxënësve dhe më pak referimit në evidenca nga raportet e shkollës për punën dhe arritjet e nxënësve apo krahasimet e bëra me të dhëna dhe tregues të tjerë.

Pra, një qasje për të pasqyruar ndikimin e mbingarkesës kurrikulare është referimi në argumentet e drejtorëve të shkollave dhe KC se vetëm nxënësit e mirë arrijnë t'i zotërojnë programet si duhet. Nxënësit nuk i arrijnë rezultatet e të nxënit sepse shumë njësi mësimore në tekste nuk përputhen me programin, ka rënë interesimi dhe motivimi i nxënësve për mësim. Pastaj referimi në deklaratat e nxënësve, ku sipas drejtorëve dhe KC nxënësit me të cilët mbajnë takime shumë shpesh shprehen se *për shkak të temave mësimore të shumta nuk mund t'i përcjellim mësimet në të gjitha lëndët mësimore dhe nuk kemi rezultate të mira.*

Sipas një grupi të drejtorëve të shkollave dhe KC, ndikimi i mbingarkesës kurrikulare është më i madh sesa realisht pasqyrohet në ditarët e klasës dhe në raportet e suksesit. Sipas tyre, ndikimi reflektohet në numrin e nxënësve që realisht nuk i arrijnë rezultatet e të nxënësve, në rezultatet e Testit të Arritshmërisë, ku pjesa më e madhe e nxënësve mezi marrin pikët e krahasueshme me notën 2, por edhe në krahasimin me rezultatet e nxënësve kosovarë në studimin PISA 2015 dhe 2018.

Ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e nxënësve.

Konceptet që referojnë mirëqenien e nxënësve në shkollë, të cilat përdoren më së shumti nga drejtorët e shkollave dhe KC të përfshirë në këtë studim, kur flasin për ndikimin e mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e nxënësve, janë si në vijim: ngarkesë psikologjike, ngarkesë fizike, lodhje, pasivitet, humbje e interesimit për mësim, stres, ngacmime, deri në bullizëm në raste të caktuara, nxënës që largohen nga shkolla – për të cilët u referohen kushteve familjare, por edhe rezultateve të ulëta në mësim.

Drejtori i shkollës (d/8-shkollë rurale) shprehet se nga ngarkesa me përmbajtje mësimore të disa nxënës vërehet rënie dhe humbje e interesimit për mësim. Kurse, sipas drejtorit të shkollës (d/5-shkollë urbane) ngarkesa me përmbajtje mësimore, por edhe me numër të nxënësve në një klasë, po shkakton lodhje të nxënësve, vështirësi në mësim, stres, ngacmime. Në anën tjetër, një KC (KC/2-shkollë urbane) shprehet se prej stresit të krijuar nga mësimet dhe detyrat e shumta shpesh kemi vërejtur paraqitje të elementeve të bullizmit në mesin e nxënësve.

Një drejtor tjetër i shkollës (d/8 – shkollë urbane) thekson se kemi vërejtur se nxënësit kur dalin në nivelin e dytë (klasa 6) janë të humbur për shkak të moszotërimit të shumë përmbajtjeve mësimore, shtimit të numrit të lëndëve mësimore, mësimdhënësve dhe qasjeve të ndryshme të mësimdhënësve në punën me nxënës.

Ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në punën e mësimdhënësve. Lidhur me ndikimin e mbingarkesës kurrikulare në punën e mësimdhënësve, drejtorët e shkollave dhe KC të përfshirë në studim referojnë çështje të shumta, të cilat bazën e kanë më shumë në faktorët që ndikojnë në

mbingarkesën e mësimdhënësve sesa ndikimin e drejtpërdrejtë që ka mbingarkesa kurrikulare në efikasitetin dhe efektivitetin e mësimdhënësve në punën e tyre.

Sipas drejtorëve të shkollave dhe KC, ngarkesa në punën e mësimdhënësve në masë të madhe lidhet me ngarkesën që kanë mësimdhënësit në raport me kohën që duhet të shpenzojnë për përgatitjen e planeve mësimore dhe për përgatitjen e instrumenteve të vlerësimit, në shtjellimin e përmbajtjeve mësimore me pakë kohë mësimore në dispozicion sipas planit mësimor zyrtar, në arritjen e shumë rezultateve që përcaktohen me kurrikulë: RNSh, RNF, RNL.

Aspekte të tjera që lidhen me mbingarkesën e mësimdhënësve theksohen të jenë puna me tekste shkollore, angazhimi për gjetjen e burimeve e materialeve mësimore që nuk janë në tekstet në përdorim, aspektet administrative dhe të raportimit që duhet të kryhen për çdo periudhë të mësimin dhe në fund të vitit shkollor, si për prindër, ashtu edhe për nevojat e raportimeve nga shkollat.

Si drejtorët e shkollave, ashtu edhe KC kanë raportuar se te disa mësimdhënës vërejnë lodhje nga ngarkesa e tepërt, sidomos nga administrata e tepërt dhe çështjet formale që shpesh kërkohen për mësimdhënës. Sipas tyre, lodhja e mësimdhënësve po reflektohet në punën dhe komunikimin me nxënës, në kohën që e ndajnë për udhëzime dhe sqarime për nxënës jashtë orës mësimore. Gjithashtu, sipas tyre, ngarkesa e mësimdhënësve reflektohet me mosefektivitet në mësim, që tregon për një fokusim më të madh në aspektet formale e procedurale sesa në aspektet përmbajtjesore që lidhen me zbatimin cilësor të kurrikulës dhe me punën efektive me nxënës.

Pikëpamjet e drejtorëve të shkollave dhe KC për tri nënkategoritë e përshkruara më sipër lidhur me ndikimin e mbingarkesës kurrikulare në arritjet/rezultatet e nxënësve, mirëqenien e nxënësve dhe në punën e mësimdhënësve, pasqyrohen në tabelën në vijim, ku për secilën nënkategori janë renditur tema specifike, sipas shpeshtësisë së informacionit të identifikuar nga të dhënat e mbledhura me intervistat e realizuara.

Tabela 28. Pikëpamjet e drejtorëve të shkollave dhe KC për ndikimin e mbingarkesës kurrikulare

Nënkategoria	Tema specifike nga nënkategoritë
Ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në arritjet/rezultatet e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> - Mungon progresi në mësim, kjo pasqyrohet në rezultatet e testit të arritshmërisë dhe në rezultatet në PISA; - Kalimi në klasën e 6-të pa i zotëruar rezultatet e nivelit fillor, nxënës të humbur; - Ngarkesa reflektohet në suksesin e nxënësve mesatarë dhe ata nënmesatarë; - Vetëm nxënësit e mirë arrijnë të zotërojnë programet, mësimet, si duhet; - Sukses më të ulëta në lëndët e shkencave natyrore dhe në matematikë, suksese më të larta në lëndët e shkathtësive; - Detyrat e shtëpisë kryhen vetëm sa për t'i bërë, udhëzimet për to janë të pamjaftueshme, jo shumë efektive në rezultate; - Për shkak të temave të shumta, nxënësit nuk mund t'i përcjellin mësimet në të gjitha lëndët mësimore; - Suksesi jo i kënaqshëm të një numër të madh të nxënësve tregon mbingarkesën e tyre; - Shumë njësi mësimore në tekste nuk përputhen me programin dhe kjo po ndikon në rezultate të nxënësve; - Te disa nxënës ka humbur komplet dëshira për mësim, që nga mbyllja në pandemi e deri më tani.
Ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit disi janë të humbur, të pakoncentruar në mësim; - Lodhje nga detyrat e shtëpisë; - Pasivitet të disa nxënës; - Stresi i nxënësve dhe si pasojë "bullizimi";

Ndikimi i
mbingarkesës
kurrikulare në punën
e mësimeve

- Lodhje, stres, ngacmime për shkak të numrit të madh të nxënësve në klasa;
- Nxënësit me aftësi të kufizuar janë shumë të sfiduar;
- Pasivë dhe të paimentuar për mësim;
- Ngarkesa fizike me peshën e çantës;
- Ngarkesa të disa nxënësve ka ndikuar në humbje të interesimit për mësim;
- Lodhja nga puna me shumë tekste.
- Ngarkesë në përgatitjen e planeve, sidomos planeve javore;
- Ka një lodhje të mësimeve nga administrata e tepërt, e cila shpesh reflektohet te nxënësit;
- Mësimeve janë të mbingarkuar me raportime të shpeshta;
- Fokusimi më shumë në administratë;
- Ndryshimet e shpeshta në programet mësimore po sjellin probleme, mbingarkesë të mësimeve;
- Të ngarkuar me tema të zgjeruara dhe më pak kohë mësimore në dispozicion;
- Jo efektivë;
- Mësuesit fillorë të ngarkuar me përgatitjen e shumë planeve, shumë instrumenteve të vlerësimit;
- Të ngarkuar nga mungesa e disa teksteve shkollore dhe me tekste të papërshtatshme me kurrikulën;
- Të ngarkuar edhe nga mungesa e kompetencës digjitale;
- Lodhje në punën e tyre.

4.3.4.4. **Perspektiva e drejtorëve të shkollave dhe KC për strategjitë që duhen ndërmarrë për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare**

Disa nga strategjitë e sugjeruara. Sa u përket strategjive të veprimit për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare nga niveli qendror deri të shkolla, drejtorët e shkollave dhe KC të përfshirë në studim ndajnë mendime, ide të ndryshme dhe disa prej tyre janë si në vijim:

- ndërhyrja në kurrikulat lëndore, ku ka mbingarkesë me tema mësimore, rezultate të të nxënit, apo aspekte të tjera që janë ngritur si shqetësime të argumentuara nga mësimmshënësit;
- harmonizimi dhe përshtatja e teksteve shkollore me kurrikulat lëndore përkatëse, përshtatjen e tyre me moshën e nxënësve;
- krijimi i kushteve dhe pajisja me mjete të konkretizimit dhe të TIK-ut për zbatimin e kurrikulës në mënyrë efektive;
- mbikëqyrja e vazhdueshme e shkollave e mësimmshënësve dhe përkrahja e tyre;
- fuqizimi i bashkëpunimit institucional, ngritja e përgjegjësisë dhe llogaridhënies etj.

Rreth gjysma e drejtorëve të shkollave dhe KC të përfshirë në studim, si strategji të veprimit për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare, sugjerojnë edhe zvogëlimin e numrit të lëndëve mësimore, duke vërë theksin më shumë në arsimin fillor, me argumentin se në këtë nivel të arsimit ka shumë lëndë mësimore.

Kështu i përshkruan një drejtor shkolle (d/1- shkollë urbane) strategjitë e veprimit për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare:

MAShTI duhet të punojë më shumë me shkollat, të shkarkojë kurrikulat nga përmbajtja e tepërt, të punojë në përshtatjen e plotë të teksteve me kurrikulat lëndore. DKA të punojë në sigurimin e kushteve për shkollat dhe për mësim efektiv. Shkolla të angazhohet në fuqizimin e mekanizmave profesional të shkollës, mësimmshënësit të ndërrojnë qasjen në mësimmshënënie, duke u përshtatur me

kurrikulën, ndërsa prindërit të jenë më bashkëpunues me shkollën dhe mësimdhënësit.

Nga një drejtor shkolle tjetër (d/7 – shkollë rurale), për të zbutur mbingarkesën kurrikulare, sugjeron që të bëhet digjitalizimi i komplet materialeve shkollore, si p.sh. amza, ditarët, planifikimet dhe vlerësimi; thjeshtim të RNL, zvogëlim të një numri të temave mësimore, te një numër i konsiderueshëm i lëndëve mësimore. Drejtori tjetër (d/4 – shkollë urbane) sugjeron se duhet kthyer autonomia shkollore dhe institucionet shkollore duhet të ngarkohen me më shumë kompetenca dhe përgjegjësi dhe të mbikëqyren në mënyrë të vazhdueshme. Kurse kolegu tjetër i tyre (d/10 – shkollë urbane) sugjeron mbikëqyrje të shtuar të mësimdhënësve dhe shkollave, me qëllim të evitimit të anës formale, ku mësimdhënësit punojnë diçka tjetër në klasë dhe diçka tjetër shënojnë në librin e klasës.

Në anën tjetër KC (KC/2 – shkollë urbane) kështu i përshkruan disa nga veprimet që duhet të ndërmerren për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare:

Ka ardhur koha për rishikim të pjesshëm të kurrikulës, duke marrë në konsideratë shqetësimet e mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve - zvogëlim i numrit të lëndëve mësimore dhe i temave mësimore, hartimi i teksteve shkollore konform kërkesave të kurrikulës dhe nevojave e moshës së nxënësve.

Ndërsa KC (KC/4 – shkollë rurale) sugjeron që të bëhet përmirësimi i infrastrukturës, libra për mësues të nxjerra nga MASHTI, jo nga shtëpitë botuese, tekstet në harmoni me kurrikulën, tekste për fusha kurrikulare, me qëllim zvogëlimin e çantës së nxënësve.

Sugjerimet për mësimdhënës nga drejtorët e shkollave dhe KC të përfshirë në studim prekin disa aspekte përmbajtjesore që lidhen me zbatimin e kurrikulës, mundësitë e zbutjes së mbingarkesës kurrikulare, si: referimin në parimet dhe kërkesat e kurrikulës, fokusimin në analizën e RNL dhe në përzgjedhjen e përmbajtjeve/njësisve mësimore e materialeve mësimore, ndryshime ndaj qasjes në mësimdhënie, komunikimit me nxënës dhe qëndrimit me afër tyre, organizimin e mësimit plotësues dhe shtues.

Kështu i përshkruan një drejtor shkolle (d/4 – shkollë urbane) strategjitë e veprimit për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare nga ana e mësimit: *Duhet përshatur, ndryshuar qasjen e mësimit dhe vlerësimin, duhet evituar atë që është e tepërt dhe duhet thjeshtuar mësimit për nxënësit, në mënyrë që ato të kuptohen mirë nga nxënësit. Ndërsa, KC/2 nga një shkollë urbane sugjeron që mësimit gjatë punës së tyre me nxënësit vazhdimisht duhet t'u referohen parimeve të kurrikulës, mësimit të orientohet më shumë te zhvillimi shkathtësive të buta, mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve të bazuara në situata nga jeta dhe e ardhmja.*

Nevojat për mbështetje të mësimit. Sa u përket nevojave për mbështetje profesionale të mësimit, për zhvillim të kompetencës së mësimit për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare, drejtorët e shkollave dhe KC të përfshirë në studim sugjerojnë disa nga veprimet në vijim:

- trajnime cilësore nga trajnerë kompetentë që e njohin në thelb filozofinë e kurrikulës dhe anën praktike të zbatimit të saj;
- trajnime specifike në lëndë mësimore/fusha kurrikulare, për tema mësimore më të veçanta, për të cilat mësimit po sfidohen në praktikën e tyre;
- adresë të qartë dhe të përhershme ku mësimit mund të marrin informata kthyesë për kërkesat dhe shqetësimet e tyre që lidhen me kurrikulën;
- udhëzime dhe udhëzues shtesë për mësimit;
- monitorime, inspektime dhe më shumë këshillim për mësimit;

Kështu i përshkruan një drejtor shkolle (d/5- shkollë urbane) strategjitë e veprimit për mbështetje profesionale të mësimit për zhvillim të kompetencës së mësimit për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare: *Trajnime të vazhdueshme nga trajnerë me kompetencë, rrjete profesionale për mësimit, digjitalizim i teksteve shkollore, përkrahje me librin e mësimit për tekstet që përdoren.* Ndërsa drejtori tjetër i shkollës (d/7- shkollë rurale) sugjeron më shumë përkrahje profesionale për

mësimdhënës, zhvillim të rrjeteve profesionale të mësimdhënësve, adresë në MASHTI ku mësimdhënësit duhet të marrin udhëzime shtesë nga zyrtarët përgjegjës për kurrikulat përkatëse. Veprime të njëjta sugjerohen edhe nga KC të përfshirë në studim.

Ka edhe ide dhe komente shtesë që shkojnë përtej sugjerimeve të drejtpërdrejta për strategji e veprime për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare, ku theksohet rritja e pagave të mësimdhënësve, paga të bazuara në merita, pensionimi i mësimdhënësve me probleme shëndetësore etj.

4.3.5. Mbingarkesa kurrikulare nga perspektiva e njohësve dhe koordinatorëve për zhvillimin e kurrikulës

Duke shikuar idenë e rolit të njohësve, hartuesve dhe të koordinatorëve në zhvillimin e kurrikulave bërthamë dhe të kurrikulave lëndore, është vlerësuar i domosdoshëm mendimi i tyre, pikëpamja e tyre për mbingarkesën kurrikulare në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët. Prandaj, kjo pjesë përqendrohet në gjetjet kryesore, të cilat janë organizuar në katër nëntema, të cilat ishin pjesë e strukturës së diskutimit me këtë grup të respondentëve:

- Reforma kurrikulare – disa elemente të ndërlidhura me mbingarkesën kurrikulare;
- Mbingarkesa kurrikulare – faktorët ndikues;
- Ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në rezultatet e nxënësve, mirëqenien e nxënësve dhe të mësimdhënësve;
- Strategjitë për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare.

4.3.5.1. Reforma kurrikulare – disa elemente të ndërlidhura me mbingarkesën kurrikulare

Njohësit e kurrikulave, koordinatorët dhe zhvilluesit e kurrikulave të përfshirë në këtë studim, kishin mendime të ndryshme për qasjen e zhvilluar ndaj reformës kurrikulare, pas zhvillimit të dokumentit konceptual, kornizës

kurrikulare, deri në hartimin e kurrikulave lëndore. Mendimet pozitive ishin se është bërë gjëja më e mirë e mundshme pas pilotimit në periudhën 2013/14 -2015/16, në raport me kontekstin dhe mundësitë e zbatimit të kurrikulës. Ndërsa qëndrimet negative shprehnin besimin se kishte ikje nga koncepti i reformës së kurrikulës, si rezultat i mospërgatitjeve të duhura nga sistemi për ta zbërthyer drejt dhe në mënyrë të duhur këtë koncept të kurrikulës dhe si rezultat i një udhëheqje të shpërndarë për zbatimin e reformës kurrikulare, nga niveli qendror deri në nivel të shkollës.

Mundësitë e pashfrytëzuara. Nga njohës të reformës kurrikulare theksohet se ikja nga koncepti i kurrikulës ka bërë që të mos shfrytëzohen disa mundësi gjatë zhvillimit të mëtejme të kurrikulave, të cilat do të siguronin në radhë të parë kalimin në praktikë nga qasja e bazuar në përmbajtje në qasjen e synuar në kompetenca dhe rezultate të nxënit, do të mundësonin që të minimizohej fokusi i punës së mësimdhënësve me tekstet shkollore, do të mundësonin qasjen e integruar dhe do të fuqizonin autonominë e shkollës në zhvillimin e kurrikulës të kontekstualizuar me nevojat reale të fëmijëve.

Kur bëhet fjalë për mundësitë që ofrojnë fryma dhe filozofia e kurrikulës së bazuar në kompetenca, të cilat nuk janë shfrytëzuar si dhe sa duhet në zhvillimin e KB dhe kurrikulave lëndore, si dhe në zbatimin e tyre, koordinatorët e fushave kurrikulare shprehin se nuk janë shfrytëzuar shumë mundësi, për të komunikuar, interpretuar dhe prezantuar si duhet konceptin e kurrikulës, për të riorganizuar punën e shkollës, për shfrytëzimin e burimeve të shumëllojshme, e veçanërisht përdorimin e teknologjisë informative, dhe për ndërmarrje të iniciativave në aktivitete të ndryshme me interes të reformës kurrikulare.

Gjithashtu, vlerësohet se në këtë fazë, pas pilotimit, nuk është shfrytëzuar mundësia që zhvillimi i kurrikulave lëndore të bëhet në bazë të një analize të mirëfilltë, që siguron një lidhje përmbajtjesore të çdo kurrikule me kompetencat kryesore dhe me konceptet brenda secilës fushë kurrikulare.

Nga mosshfrytëzimi i të gjitha elementeve të reformës kurrikulare, i pritshmërive që shkolla vetë të hartojë kurrikulat lëndore për secilën klasë, bazuar në kërkesat dhe orientimet e KB sipas niveleve, është shtruar presioni

dhe nevojat që kurrikulat lëndore të zhvillohen nga grupet punuese të themeluara nga MASHTI, nën udhëheqjen e Divizionit për kurrikula në MASHTI.

Në anën tjetër, pas zhvillimit të kurrikulave lëndore për të gjitha klasat, nga grupet punuese të koordinuara nga MASHTI, sipas koordinatorëve të kurrikulave, nuk duket të jetë e sigurt mundësia që mësimdhënësit të punojnë vetëm me Kurrikula Bërthamë për nivelet përkatëse të arsimit, sepse nuk ka një vendim të tillë, ashtu sikur nuk ka një vendim që pengohet, pasi që me orientimet e kurrikulës bërthamë mësimdhënësit kanë fleksibilitet në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore që sigurojnë arritjen e rezultateve të fushës kurrikulare përkatëse.

Një mundësi tjetër e humbur del të jetë largimi nga qasja në njohuri, përmbajtje mësimore, fokusi në tekste shkollore - në qasje të bazuar në kompetenca dhe rezultate të të nxënit, apo në një qasje e cila siguron që të kemi kurrikula lëndore praktike dhe të zbatueshme. Sipas respondentëve, me gjithë përpjekjet në fazën e pilotimit dhe më vonë, akoma nuk është arritur që të ndryshohet kultura e punës së shkollave në zhvillimin dhe planifikimin e zbatimit të kurrikulës me bazë në shkollë, në ndryshimin e qasjes ndaj zbatimit të kurrikulës.

Ndryshimet në kurrikulat lëndore. Sa i përket asaj se çfarë kanë ndryshuar më shumë kurrikulat lëndore kundrejt kurrikulave/programeve lëndore paraprake, çfarë është shtuar dhe çfarë është hequr, koordinatorët e fushave shprehin mendimin se kurrikulat e reja lëndore janë zhvilluar duke u bazuar konceptet kryesore dhe RNF, që dalin nga Kurrikulat Bërthamë, të cilat pastaj janë bërë pjesë e kurrikulave lëndore, janë zbërthyer në tema mësimore, për të cilat janë mbarështuar disa rezultate të të nxënit, si dhe janë dhënë udhëzime metodologjike, të cilat kanë bërë që të kemi një strukturë ndryshe të kurrikulave lëndore.

Qasja në mbarështrimin e kurrikulave lëndore del të jetë ndryshimi përmbajtjesor, përdorimi i koncepteve në formë të rrahëve koncentrikë për përcaktimin e temave mësimore, ka bërë të mundur nxjerrjen e temave për lëndë - klasë dhe mundësitë e zvogëlimit të përmbajtjeve mësimore. Mirëpo,

nuk sigurohet se kjo ka ndodhur për të gjitha kurrikulat lëndore dhe se është eliminuar përsëritja e disa temave mësimore në lëndë të ndryshme. Ka raste kur për një kurrikulë lëndore të një klase përshkruhen edhe shtimi dhe riorganizimi i përmbajtjeve mësimore nga kurrikulat paraprake, lëvizjet e temave mësimore nga klasa në klasë, ose nga niveli i arsimit të mesëm të ulët në nivelin e arsimit të mesëm të lartë dhe anasjelltas. Kjo arsyetohet me zhvillimet e reja që kanë ndodhur në fusha të caktuara.

Lidhja vertikale në mes të temave mësimore të një lënde, gjerësia dhe thellësia e të mësuarit në nivel të klasës dhe shkallëve kurrikulare, përshkruhet si një sfidë në mbarështrimin e kurrikulave lëndore. Siç përshkruhet, kjo ka qenë problematika qendrore e punës në grupet punuese, për të cilën ka mendime se nuk ka funksionuar si duhet në të gjitha lëndët mësimore. Në disa fusha/lëndë mësimore nxirret përfundimi se ka funksionuar më mirë.

Referuar koordinatoreve të fushave kurrikulare të përfshirë në këtë studim, gjatë hartimit të kurrikulave lëndore, për nevojat e grupeve punuese, janë zhvilluar harta të shtrirjes së temave mësimore për lëndë, duke pasur referencë konceptet e fushës dhe rezultatet e fushës në shkallë kurrikulare. Mirëpo, një hartë e tillë e temave mësimore nuk është vendosur në asnjë nga kurrikulat lëndore brenda një shkalle kurrikulare apo brenda një niveli të arsimit. Në mungesë të saj, për të parë mësimdhënësit shtrirjen e temave mësimore të lëndës së tyre brenda një shkalle kurrikulare ose niveli të arsimit, duhet t'i kenë afër të gjitha kurrikulat lëndore të nivelit përkatës të arsimit, apo t'u referohen koncepteve të fushës kurrikulare të përfshira në kurrikulat bërthamë.

Gatishmëria e mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës. Një element i rëndësishëm i shqyrtimit të zhvillimeve të reformës kurrikulare është zbatimi i saj në shkollë, proces i cili ndikohet nga shumë faktorë, përfshirë edhe gatishmërinë e mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës.

Njohësit e kurrikulave, koordinorët dhe zhvilluesit e kurrikulave aktuale, të përfshirë në këtë studim, kishin mendime, pikëpamje të përbashkëta, se në parim mësimdhënësit kanë shprehur gatishmëri për zbatimin e kurrikulës

së re. Mirëpo, njëzëri shprehen se sistemi nuk ka bërë përgatitje të duhura organizative dhe të ndërtimit të mekanizmave mbështetës për zbatimin e kurrikulës, nuk janë mbështetur dhe udhëzuar mjaftueshëm mësimdhënësit për të bërë ndërrimin e qasjes në punën e tyre. Kjo theksohet edhe në studimet e fundit që trajtojnë zbatimin e kurrikulës në Kosovë (Potera & Shala (2018), Boshtrakaj, et al. (2018). Mehmeti, et al. (2019), etj.).

Rrjedhimisht, sipas respondentëve nga ky grup, gatishmëria fillestare e mësimdhënësve nuk është shprehur me zbatim të suksesshëm të kurrikulës në nivel shkolle, zbatimi i së cilës përshkruhet të jetë me dallime të vogla nga niveli në nivel të arsimit parauniversitar. Sipas tyre, mund të thuhet se gatishmëria fillestare e një numri të madh të mësimdhënësve është kthyer në formalitet, jo në kreativitet, më shumë në plotësimin e aspekteve administrative që lidhen me kurrikulën.

Gjithashtu, theksohet se gatishmëria e mësimdhënësve deri diku është shprehur me rritje të bashkëpunimit të mësimdhënësve dhe shkollave, por më shumë për çështje formale, në diskutime të shumta, të cilat janë bërë në mesin e mësimdhënësve, për të cilat theksohet se nuk kanë qenë mirë të raportuara dhe të dokumentuara, për t'i shfrytëzuar gjatë hartimit të kurrikulave lëndore, pas fazës së pilotimit, por edhe tani në ofrimin e informatave kthyesë në shumë kërkesa dhe pyetje të shtruara nga mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave.

Si përfundim, për këtë pjesë mund të thuhet se ky grup i respondentëve kanë argumente të shumta për mundësitë e pashfrytëzuara në zhvillimet rreth reformës kurrikulare, ndryshimet bazë në kurrikulat lëndore dhe gatishmërinë e mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës. Detajet e temave specifike për këto aspekte, të cilat janë shqyrtuar më sipër, të përmbledhura sipas kodimit dhe shpeshëtisë së informacionit të identifikuar nga të dhënat e mbledhura, pasqyrohen në tabelën në vijim.

Tabela 29. Mundësitë e pashfrytëzuara në zhvillimet rreth reformës kurrikulare

Nënkategoria	Tema specifike
Mundësitë e pashfrytëzuara	<ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi në mënyrë të qartë i konceptit të kurrikulës; - Organizimi i procesit edukativo-arsimor në klasat 6-9, mësimdhënia sipas fushave kurrikulare; - Fillimi i përgatitjes universitare të mësimdhënësve për fusha kurrikulare, për arsimin e mesëm të ulët; - Zvogëlimi i numrit të lëndëve mësimore; - Kalimi nga qasja e bazuar në përmbajtje dhe tekste shkollore, në qasjen me kompetenca dhe rezultate të të nxënit; - Përcaktimi i rezultateve të të nxënit në nivel minimal, që mund t'i arrijnë të gjithë nxënësit e një klase apo shkalle kurrikulare të caktuar; - Përcaktimi i kritereve të vlerësimit për vlerësimin e kompetencave dhe rezultatet në nivel të fushave kurrikulare; - Konsolidimi i mekanizmave për mbështetjen e zbatimit të kurrikulës, - Ndërtimi i strukturave organizative në shkollë për mbështetje të mësimdhënësve në zbatimin e kurrikulës; - Ndryshimi i qasjes në mësimdhënie, mësimdhënësit janë duke vazhduar me avazin e të kaluarës...
Ndryshimet bazë në kurrikulat lëndore	<ul style="list-style-type: none"> - Qasja në mbarështimin e kurrikulave lëndore; - Përdorimi i koncepteve në formë të rrathëve koncentrikë për zberthimin e temave mësimore; - Përcaktimi i hartës së temave mësimore për kurrikula lëndore sipas klasave, vetëm për grupet punuese për hartimin e kurrikulave lëndore;

	<ul style="list-style-type: none"> - Fusha shkencat e natyrës tani mësohet nga klasa parafillore me qasje të integruar në nivelin e parë; - Shtimi dhe riorganizimi i disa përmbajtjeve mësimore nga kurrikulat paraprake - lëvizje nga klasa në klasë, ose nga niveli në nivel; - Struktura e organizimit të kurrikulave lëndore.
Gatishmëria e mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës	<ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënësit në fazën e parë kanë shprehur më shumë gatishmëri për zbatimin e kurrikulës së re, mirëpo nuk janë mbështetur dhe udhëzuar mjaftueshëm në këtë proces; - Gatishmëria është shprehur më shumë në aspektet formale të planifikimit për zbatimin e kurrikulës; - Për kreativitetin dhe cilësinë e zbatimit të kurrikulës ka shumë pikëpyetje; - Diskutime të shumta në mesin e mësimdhënësve, por jo mirë të organizuara dhe të dokumentuara, - Rritje e bashkëpunimit të mësimdhënësve, më shumë për çështje formale; - Mësimdhënësit kanë ende mungesë/zbrazëtira të informatave të duhura për zbatimin e kurrikulës së re.

4.3.5.2. Perceptimet për mbingarkesën kurrikulare dhe faktorët ndikues

Mbingarkesën kurrikulare, aspektet e përshkrimit të saj dhe faktorët ndikues, njohësit e kurrikulës, koordinatorët dhe zhvilluesit e kurrikulës të përfshitë në këtë studim, i shohin nga një perspektivë e përafërt, por me disa dallime të vogla, të cilat më shumë theksohen në stilin e përshkrimit dhe të renditjes së elementeve të konsideruara mbingarkesë kurrikulare. Ndonëse ekzistojnë elemente të dallimit në varësi të rolit, ku hetohen rezerva ndaj punës së tyre të bërë në procesin e zhvillimit të kurrikulave.

Përshkrimi i mbingarkesës kurrikulare. Në mesin e këtij grupi të respondentëve ka qasje të ndryshme në përshkrimin e asaj se çka konsiderojnë mbingarkesë kurrikulare dhe sa kjo problematikë është marrë për bazë gjatë mbarështrimit të kurrikulave në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët. Dominon përshkrimi që aspektet përmbajtjesore të kurrikulës dhe thellësia e kërkesave të tyre, pa marrë për bazë moshën e nxënësve, përbën thelbin e mbingarkesës kurrikulare në një klasë apo në një shkallë kurrikulare. Kështu përshkruhen disa elemente të mbingarkesës kurrikulare:

Mbingarkesa konsiderohet se çfarë ka tepër (nuk duhen të jenë) në dokumentet e kurrikulës, që përcaktojnë se çfarë duhet të dinë dhe çfarë duhet të jenë në gjendje të bëjnë si duhet nxënësit, e që nuk merr për bazë mundësitë dhe moshën e nxënësve (Nj/K/1);

Mund të quhet ngarkesë kurrikulare kur i gjithë procesi bazohet në të mësuarit teorik, ky mësim shpesh është i papërbalueshëm nga ana e nxënësve (Nj/K/3);

Çdo gjë që është përcaktuar si e domosdoshme, qoftë numri i orëve mësimore, i përmbajtjeve mësimore për t'i arritur kompetencat minimale, rezultatet minimale të nxënësve, nuk duhet konsideruar si mbingarkesë. Çdo gjë që ka dalë prej këtij konteksti konsiderohet të jetë mbingarkesë. Në rastin e kurrikulave aktuale, problemi qëndron se nuk janë përcaktuar si duhet pritjet minimale dhe kjo ka bërë që të ketë mbingarkesë të nxënësve me kurrikulat lëndore, të kemi shmangie nga fryma e kurrikulare (Nj/K/2).

Organizimin e kurrikulës në shtatë fusha kurrikulare dhe referimin në kompetencat kryesore respondentët nga ky grup i studimit e shohin si pikënisje për evitimin e mbingarkesës kurrikulare, por që nuk është shfrytëzuar si duhet. Në përshkrimet e tyre preken edhe elemente të mbingarkesës kurrikulare që lidhen me procesin mësimor që nuk u përshtatet nxënësve, duke përfshirë mjedisin e për zbatimin e kurrikulës, burimet dhe materialët mësimore, qasja e mësimdhënësve, puna me tekste shkollore, detyrat e shtëpisë. Të gjitha këto tregojnë se ky grup i respondentëve të studimit mbingarkesën kurrikulare e sheh përtej përmbajtjeve mësimore dhe

rezultateve të të nxënit, edhe shumë aspekte të tjera të ndërlidhura me procesin edukativo- arsimor në klasë dhe përgjithësisht në shkollë.

Sa i përket specifikimit të **faktorëve të mbingarkesës kurrikulare**, ky grup i respondentëve, në aspektin praktik, mbingarkesën kurrikulare e lidhin më së shumti me faktorin mësimdhënës dhe mësimdhënien, përkatësisht qasjen ndaj mësimdhënies, elementet e praktikës së mësimdhënies gjatë punës me nxënës, elementet e punës së mësimdhënësve të bazuar kryesisht në tekstet shkollore. Në aspektin e përgjithshëm, numri i lëndëve mësimore, i përmbajtjeve mësimore dhe rezultateve të të nxënit, shihen si faktorët kryesorë të mbingarkesës kurrikulare.

Nga njohës të kurrikulës ekziston qëndrimi se numri i madh i rezultateve të të nxënit, pritshmëritë e larta në kurrikulat bërthamë dhe përcaktimi i numrit të madh të lëndëve mësimore janë faktorët kryesorë të mbingarkesës kurrikulare, të cilët pastaj përcillen në nivele tjera të zhvillimit të kurrikulave.

Mbingarkesën e shoh te numri i rezultateve dhe pritshmëritë e larta në kurrikulat bërthamë, do të duhej të kishte një standard të nivelit të përgjithësimin, të thellësia e rezultateve të të nxënit. Konsideroj se deri te kjo ka ardhur sepse nuk janë marrë për bazë përshkrimet e veçorive dhe karakteristikave të shkollës kurrikulare përkatëse gjatë mbarështrimit të rezultateve të të nxënit për kompetenca dhe për fusha kurrikulare. Pastaj ngarkesa ka zbritur edhe te kurrikulat lëndore. Shtoj kësjaj edhe numrin e madh të lëndëve mësimore në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët (Nj/K/I).

Nga koordinatorët e fushave kurrikulare, numri i rezultateve të të nxënit në kurrikula lëndore nuk shihet njëjtë si faktor i mbingarkesës kurrikulare. Mirëpo, në raport me rezultatet e të nxënit në kurrikulat lëndore, shihet si ngarkesë numri i kërkesave të larta brenda një rezultati të të nxënit, atëherë kur nuk ka udhëzime orientuese, kur orët mësimore javore janë minimale 1-2 dhe kur nga kërkesat e rezultateve të të nxënit priten shumë njësi mësimore.

Tekstet shkollore dhe puna e mësimdhënësve kryesisht me tekste shkollore, pa mbështetje në dokumentet kurrikulare, shihet si një faktor i mbingarkesës

kurrikulare. Tekstet shkollore përshkruhen të jenë të mbingarkuara në dy nivelet e arsimit (fillor dhe të mesëm të ulët), për shkak se kërkohet memorizim i fakteve, numrave, emrave, formulave, proceseve etj. Theksohet se në tekste shkollore ka përmbajtje të panevojshme teorike, ato do të duhej të thjeshtësohen dhe të konkretizohen me shembuj praktikë, që do të ishin në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore dhe zbatimit më të saktë të tyre, të kenë ilustrime, figura, tabela, grafikë më tërheqës dhe përmbajtjesorë, apo edhe shembuj të ndryshëm të ilustruar me situata jetësore.

Faktorë të tjerë të mbingarkesës shihen qasja në mësimdhënie, ku mbizotëron mësimi i orientuar vetëm në përmbajtje, memorizimi i përmbajtjeve, sasia e përmbajtjeve mësimore që shpjegohen në disa lëndë, në raport me numrin e orëve mësimore javore dhe vjetore, qasja ndaj detyrave të shtëpisë dhe numrit të tyre në disa lëndë mësimore brenda një dite, ngarkesa e nxënësve me prezantime të ndryshme që nuk kanë qëllime të ndërlidhura me rezultatet e të nxënësve etj. Edhe infrastruktura shkollore, përfshirë numrin e madh të nxënësve brenda në klasë/shkollë shihet si një faktor i mbingarkesës kurrikulare.

Sa i përket diskutimit se ku janë të përqendruar mësimdhënësit gjatë punës me nxënës, ekziston një konsensus nga ky grup i respondentëve se mësimdhënësit janë të përqendruar më shumë te njohuritë (më tepër te memorizimi) se te zhvillimi i kompetencave, sepse kjo është praktikë “tradicionale”, që përdoret një kohë të gjatë në shkollat tona, edhe pse ka edhe mësimdhënës që zhvillojnë kompetencat e përcaktuara tani me kurrikulën e re.

Për sa u përket klasave ku ka më shumë mbingarkesë kurrikulare, ka një pajtueshmëri se në arsimin fillor ka një ngarkesë më të madhe me numër të lëndëve, por edhe me kërkesa të larta për pritshmëritë e nxënësve. Në nivelin e arsimit të mesëm të ulët, ikja nga mësimdhënia e integruar në fusha kurrikulare shihet si mbingarkesë, e cila reflektohet në të gjitha klasat e këtij niveli.

Çështjet ndërkurrikulare. Një tjetër aspekt i mbingarkesës kurrikulare, i diskutuar me këtë grup të respondentëve. Kjo për faktin se çështjet

ndërkurrikulare, të përfshira në kurrikula lëndore, shihen si një element i mbingarkesës kurrikulare, jo vetëm në kurrikulat tona, por edhe në vendet që kanë një orientim më të theksuar në përfshirjen e tyre në kurrikula.

Në mesin e respondentëve të këtij grupi, ka mendime që përveçse kanë ndikuar në mbingarkesë të kurrikulave lëndore, ato janë edhe gabim të konceptuara, pasi që kompetencat kryesore janë konsideruar, përveç tjerash, si çështje ndërkurrikulare që sigurojnë ndërveprim ndërmjet fushave kurrikulare dhe lëndëve mësimore.

Mënyra se si janë integruar çështjet ndërkurrikulare në kurrikulat lëndore është gabim, janë kontradiktore me frymën e kurrikulës së bazuar në kompetenca, sepse kompetencat kryesore janë konsideruar si çështje ndërkurrikulare, që sigurojnë sa më shumë ndërveprim ndërmjet lëndëve mësimore, jo vetëm për disa çështje ndërkurrikulare (Nj/K/1);

Po temat, çështjet ndërkurrikulare e ngarkojnë programin mësimor (në këtë mënyrë si praktikohen në shkollat tona), sepse shpesh paraqiten si tema të veçanta, e jo të integruara në procesin mësimor brenda fushave përkatëse lëndore, këtu mendoj unë se edhe parimi bazë i kurrikulës së bazuar në kompetenca është degraduar (Nj/K/3).

Ka edhe një mendim ndryshe për temat, çështjet ndërkurrikulare, ku ato shihen si një mundësi më e madhe për integrim të fushave kurrikulare, edhe pse kjo do të duhej të bëhej përmes koncepteve të fushës kurrikulare dhe rezultateve të të nxënimit për fusha kurrikulare.

Unë nuk i shoh si ngarkesë, sepse trajtimi i çështjeve ndërkurrikulare synon përvetësimin e disa njohurive specifike, kultivimin e disa aftësive, vlerave e qëndrimeve të caktuara te nxënësit. Temat ndërkurrikulare integrojnë fushat kurrikulare, ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të bëjnë lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj. Vetëm duhet pasur kujdes në realizimin e këtyre temave dhe lidhjen e tyre me fushën përkatëse (Nj/K/2).

Përqendrimi i mësimdhënësve në punën me nxënësit. Kurrikula e bazuar në kompetenca kërkon ndryshimin e qasjeve në mësimdhënie, nga fokusi në

përmbajtjet – njohuritë, në fokusin në procesin e të nxënës dhe zhvillimin e kompetencave. Ky ndryshim i pritur vazhdon të jetë një prej sfidave kryesore në zbatimin e kurrikulës në Kosovë.

Për sa u përket informacioneve që kanë ky grup i respondentëve të këtij studimi, lidhur me atë se ku mësimdhënësit janë më shumë të përqendruar gjatë procesit mësimor, gjatë punës me nxënës - te njohuritë apo te proceset e të mësuarit dhe zhvillimi i kompetencave, referuar informacioneve që ata kanë përmes formave të ndryshme të kontakteve me nxënës, mësimdhënësit, prindër, formave formale dhe joformale, shprehin konstatim të përbashkët se pjesa më e madhe e mësimdhënësve vazhdojnë të kenë një fokus më të madh në zhvillimin e përmbajtjeve mësimore, shpjegimin e njësisve mësimore, kryesisht sipas teksteve shkollore. Ka mendime se kësaj i ka kontribuar qasja në përgatitjen e mësimdhënësve, por edhe qasja se si sistemi ynë arsimor e ka mbështetur zbatimin e kurrikulës.

Njohësit dhe zhvilluesit e kurrikulave e shohin si problem kryesor qasjen në mësimdhënie, që ndikon në mbingarkesën kurrikulare, dhe me këtë në mbingarkesën e nxënësve në mësim. Ata shprehin bindjen se kjo mund të ndryshojë nëse ka një ndërveprim në mbështetjen e mësimdhënësve nga të gjitha hallkat e sistemit të arsimit. Në radhë të parë, sipas tyre, mësimdhënësve u nevojitet përgatitje para shërbimit dhe trajnime të detajuara gjatë shërbimit, të përqendruara mbi qasjet e avancuara të mësimdhënies, të bazuara në parimet e kurrikulës, ku përqendrimi kryesor duhet të jetë në qasjen e bazuar në kompetenca dhe në qasjen e integruar të mësimdhënies.

Perceptimi im (gjatë bisedave joformale me mësimdhënësit) është se mësimdhënësit gjatë procesit të mësimdhënies i kanë dy faza, të cilat janë të shkëputura nga njëra - tjetra, një në hartimin e planeve mësimore që iu kërkohet sipas formularëve zyrtarë të planifikimit, dhe faza tjetër procesi i realizimit të tij në klasë me nxënës, ku ky proces përgjithësisht është i bazuar vetëm në tekstet shkollore (Nj/K/1).

Shqyrtimet më sipër për këto aspekte të trajtuara pasqyrohen të përmbledhura në tabelën në vijim, e cila është e organizuar sipas

nënkategorive të trajtuara më sipër dhe në tema specifike për secilën nënkategori, të cilat janë të renditura sipas shpeshtësisë së informacionit të identifikuar nga të dhënat e mbledhura me këtë grup të respondentëve.

Tabela 30. Përshkrimi i mbingarkesës kurrikulare dhe faktorët ndikues nga perspektiva e njohësve dhe koordinatorëve për zhvillimin e kurrikulës

Nënkategoria	Tema specifike
Përshkrimi i mbingarkesës kurrikulare	<p><i>Mbingarkesë kurrikulare është:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Çdo gjë që ka dalë prej pritjeve minimale për nxënës konsiderohet të jetë mbingarkesë; - Aspekti përmbajtjesor i kurrikulës dhe thellësia e kërkesave të saj, pa marrë për bazë moshën e nxënësve; - Çfarë ka tepër dhe nuk duhen të jenë në dokumentet e kurrikulës; - Të mësuarit vetëm teorik; - Procesi mësimor i bazuar në të mësuarit teorik, jo në motivimin dhe progresin e nxënësve për zhvillimin e kompetencave; - Çdo gjë që lidhet me procesin mësimor që nuk u përshtatet nxënësve, përtej vetëm përmbajtjeve mësimore dhe rezultateve të të nxënësve.
Faktorët e mbingarkesës kurrikulare	<ul style="list-style-type: none"> - Qasja ndaj reformës kurrikulare; - Numri i lëndëve mësimore; - Pritshmëritë e larta në kurrikulat bërthamë; - Numri i RNL është i madh, për t'i realizuar këto rezultate në thellësi duhet më shumë hapësirë, kohë mësimi dhe përgatitje; - Numri i kërkesave të larta brenda një rezultati të të nxënësve në kurrikulat lëndore; - Përmbajtjet mësimore jo në raport me kohën mësimore për zhvillimin e tyre;

	<ul style="list-style-type: none"> - Tekstet shkollore - puna vetëm me tekste shkollore pa mbështetje në dokumentet kurrikulare; - Mësimdhënia - qasja në mësimdhënie ku mbizotëron mësimi i orientuar vetëm në përmbajtje; - Detyrat e shtëpisë - qasja ndaj detyrave të shtëpisë dhe numrit të tyre; - Infrastruktura shkollore, përfshirë numrin e madh të nxënësve brenda në klasë/shkollë.
Çështjet ndërkurrikulare	<ul style="list-style-type: none"> - Një mundësi më e madhe për integrim të fushave kurrikulare - Temat ndërkurrikulare integrojnë fushat kurrikulare, ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të bëjnë lidhjen e arsimit me jetën dhe interesat e saj; - Janë kontradiktore me frymën e kurrikulës së bazuar në kompetenca; - E ngarkojnë programin mësimor; - Shpesh paraqiten si tema të veçanta e jo të integruara në procesin mësimor brenda fushave përkatëse lëndore.
Përqendrimi i mësimdhënësve në punën me nxënës	<ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënësit vazhdojnë të kenë një fokus më të madh në zhvillimin e përmbajtjeve mësimore, në shpjegimin e njësisive mësimore; - Procesi mësimor në klasë përgjithësisht është i bazuar vetëm në tekstet shkollore; - Nuk kemi lëvizur fare, dominon fokusi në përmbajtje, sepse indirekt fokusi i Ministrisë së Arsimit vazhdon të jetë në përmbajtje; - Më tepër te memorizimi - praktikë “tradicionale” që përdoret një kohë të gjatë në shkollat tona; - Vazhdon përqendrimi në përmbajtje, mësimin e njohurive, është praktikë shkollore në tërë sistemin arsimor të Kosovës, përfshirë edhe arsimin e lartë;

- Mësimdhënësit nuk përkushtohen sa duhet që të reformohen.

4.3.5.3. **Ndikimi i mbingarkesës kurrikulare nga perspektiva e njohësve dhe koordinatorëve për zhvillimin e kurrikulës**

Njohësit e kurrikulës, koordinatorët dhe zhvilluesit e kurrikulës të përfshinë në këtë studim, kanë perceptime të ndryshme sa i përket ndikimit të mbingarkesës kurrikulare, si në rezultatet e nxënësve, ashtu edhe në mirëqenien e nxënësve dhe të mësimdhënësve. Të përbashkëtat dhe dallimet për këto aspekte nga ky grup i respondentëve pasqyrohen në pjesën në vijim.

Kur bëhet fjalë për ndikimin e mbingarkesës kurrikulare në arritjet e nxënësve, disa nga respondentët e këtij grupi kanë vështirësi ta theksojnë qartazi se ka ndikim të theksuar në rezultate, nga fakti se, bazuar në raportet statistikore të shkollave për suksesin e nxënësve, ato raportohen të njëjta apo të përafërta nga vitet paraprake. Në anën tjetër, arritjet e nxënësve në vlerësimet e jashtme janë jo të kënaqshme, veçanërisht në studimin PISA.

Ka diskutim se nga kurrikulat e reja nuk pritët të ketë ndikim negativ në arritjet e nxënësve, pasi që rezultatet e të nxënësve kanë një lidhje hierarkie të mirë të shpërndarjes nga klasa në klasë, kundrejt rezultateve të pritura në kurrikulat paraprake. Sipas këtij diskutimi, ndikim negativ mund të bëhet vetëm nga qasja në mësimdhënie.

Në një diskutim tjetër, qartazi thuhet se mbingarkesa kurrikulare ka ndikim negativ në arritjet e nxënësve. Argumenti mbështet në shkallën e arritshmërisë së nxënësve në testin e klasës së 9-të, specifikohen rezultatet e këtij viti shkollor (2021/2022). Në mënyrë të veçantë specifikohen arritjet e nxënësve kosovarë në studimin PISA 2015 dhe 2018, pavarësisht se nxënësit e përfshirë në dy këto studime nuk kanë punuar me kurrikulat e reja. Dihet se studimi PISA nuk i vlerëson kurrikulat e sistemeve arsimore, por i vlerëson aftësitë e nxënësve, përkatësisht vlerëson kapacitetin e nxënësve për të zbatuar njohuritë dhe shkathhtësitë, për të analizuar, gjykuar dhe komunikuar në mënyrë të efektshme gjatë identifikimit, interpretimit dhe

zgjidhjes së problemeve në situata të ndryshme, aspekte këto që promovohen dhe mbështeten me kurrikula.

Thjesht, rezultatet në PISA kanë nxjerrë realitetin, i cili ekziston, dhe këtij realiteti është duke i kontribuar kjo qasje ndaj reformës në arsim, ndaj reformës kurrikulare. Ne e kemi prodhuar këtë gjendje, krejt setapi i dokumenteve kurrikulare dhe punës që kemi bërë është reflektuar në rezultatet e studimit PISA, rrjedhimisht kjo tregon se ato nuk janë të përshtatshme për nxënës dhe nxënësit nuk janë mbështetur në mënyrën e duhur për të treguar rezultate të mira në PISA. Rezultatet në PISA janë pasqyrë e pastër e punës sonë (Nj/K/1);

Unë shoh një ndërlidhje të rezultateve të nxënësve kosovarë në studimin PISA me kurrikulat në arsimin bazë. Kjo ndërlidhje është më shumë në raport me qasjen e metodologjisë së mësimdhënies/mësimnxënies, nga mënyra se si mësimdhënësit ofrojnë mësimdhënien dhe si nxënësit mësojnë (Nj/K/4).

Ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në arritjet e nxënësve shihet edhe në raport me shmangien pa arsye të kërkesave të kurrikulës, ose kur ato keqinterpretohen dhe për pasojë domosdo se nuk japin rezultate të kënaqshme dhe mundësi të përmbushjes së pritshmërive.

Në anën tjetër, kur bëhet fjalë për ndikimin e mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e nxënësve, njohësit e kurrikulës, koordinatorët dhe zhvilluesit e kurrikulës, të përfshirë në këtë studim, kanë deklaruar se në rrethanat se si organizohen mësimi dhe mësimdhënia në shkollat tona është e pamundur që të mos kenë ndikim në mirëqenien e nxënësve. Disa prej tyre këtë e lidhin me stresin e shkaktuar nxënësve, ngarkesën me mësim teorik, por edhe me injorancën që një grup i nxënësve e kanë ndaj të mësuarit, pastaj me humbjen e interesimit të nxënësve për mësim, që sipas tyre, në një mënyrë, u reflektua edhe në protestën e nxënësve “s’po shkohet në shkollë”, reflektohet me numër të madh të mungesave të nxënësve etj.

Konsideroj se mbingarkesa e nxënësve në mësim, me qasjen ndaj zbatimit të kurrikulës, është duke u manifestuar në dy ekstreme: stres, ngarkesë e lartë, dhe tjetra injorancë totale, kur mësimdhënësi nuk

arrin vetë që nxënësve t'ua shpjegojë pse është e rëndësishme një përmbajtje e caktuar për t'u mësuar, edhe fëmija e sheh që vetëm po u dashka me e bërë atë si numër, si temë etj. Tani kemi dy grupe të nxënësve, ata të cilët shqetësohen, stresohen dhe mundohen të gjejnë mënyra për të mësuar sa më shumë dhe grupi tjetër i nxënësve të cilët nuk lodhën fare, nuk stresohen dhe nuk e shohin të arsyeshme të bashkëpunojnë rreth mësimeve, sepse nuk e shohin interesin ndaj mësimit (Nj/K/1).

Kjo qasje ndaj kurrikulës nuk konsideroj se do të ketë sukses në mirëqenien e pritur për nxënës, përkundrazi kjo do të ndikojë në mbingarkesën psikike dhe emocionale në aspektin kohor dhe do të ndikojë edhe në demotivimin e tyre, sepse më shumë do të mësohen gjërat sa për një vlerësim me “notë” se për të nxënë “dije” dhe do të humbet edhe qëllimi i arsimimit/edukimit karshi ndryshimeve dhe nevojave në shoqëri (Nj/K/4).

Të tjerët e përshkruajnë lodhjen e nxënësve, sidomos në arsimin fillor, nga mësimit në numër të madh të lëndëve mësimore, ngarkesën dhe stresin me detyra të shtëpisë, kohën e lirë që ua marrin etj. Nga ky grup i respondentëve, detyrat e shtëpisë, përkatësisht mënyra se si punohet në shkollat tona me detyra të shtëpisë, ngarkesa që u bëhet nxënësve, shihen me ndikim dhe dëmtojnë në masë të konsiderueshme mirëqenien e nxënësve.

Detyrat e shtëpisë janë një aspekt i ngarkesës së nxënësve, të cilat ndikojnë shumë në lodhjen dhe stresin e nxënësve, sidomos kur hasin vështirësi në kryerjen e tyre. Duhet thënë se detyrat e shtëpisë, përveçqë ndikojnë në mirëqenien e nxënësve, ato janë formalitet.

Pavarësisht dallimeve, nuk kishte asnjë pjesëmarrës nga ky grup i respondentëve që nuk i ka përmendur se paku 2-3 elemente të ndikimit të mbingarkesës kurrikulare në arritjet dhe në mirëqenien e nxënësve.

Një aspekt tjetër i diskutuar është ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në punën e mësimeve. Lidhur me këtë aspekt, njohësit e kurrikulës, koordinatorët dhe zhvilluesit e kurrikulës, të përfshirë në këtë studim, kanë

deklaruar se ka elemente të mbingarkesës së mësimdhënësve në punën e tyre.

Sipas tyre, mbingarkesa lidhet me rrethanat se si mësimdhënësit janë sfiduar me fillimin e zbatimit të kurrikulës, nga mungesa e mbështetjes së duhur nga mekanizmat institucional, mos njohja e disa elementeve që lidhen me zbatimin në praktikë të kurrikulës së bazuar në kompetenca, nga mos përcjellja me tekste të reja shkollore për kurrikulat e reja të vendosura për zbatim, por edhe nga mos ndryshimi i organizimit të punës në shkolla, etj.

Kjo e fundit, sipas tyre ka bërë që të vazhdohet me një qasje tradicionale të punës në shkolla, qasje e cila ka pamundësuar zbatimin efektiv të kurrikulës dhe ka ngarkuar mësimdhënësit, ku një pjesë e tyre kanë mbetur kushtimisht as me të vjetrën dhe as me të renë.

Ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në punën e mësimdhënësve, në disa raste më shumë e lidhin me procesin administrativ në shkolla se sa me procesin mësimor.

Po mësimdhënësit janë të mbingarkuar sipas kërkesave të kurrikulës, ose më mirë të themi sipas interpretimit të kërkesave të saj, që më shumë ka të bëjë me proces administrativ sesa me reflektim mbi procesin mësimor (Nj/K/3);

Mënyra se si po punohet në shkolla, po del të jetë element i mbingarkesës për mësimdhënësit (Nj/K/2).

Mbingarkesa e mësimdhënësve në raport me kërkesat e kurrikulës së re, sipas këtij grupi të respondentëve, është reflektuar në pasigurinë dhe mosbesimin në punën e tyre, humbje të motivimit për punë, lodhje dhe frikë nga ndryshimet e shpeshta, vendosje e fokusit të punës së tyre në elementet administrative rreth kurrikulës, të kërkuara nga shkolla, në debate të shumta lidhur me zbatimin e kurrikulës, por edhe në rezistencë në raste të caktuara ndaj zbatimit të kurrikulës.

Pavarësisht ndikimeve në punën e mësimdhënësve, në mesin e respondentëve të studimit nga ky grup, ka mendime se te një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve kurrikula e re ka filluar të këtë edhe ndikim pozitiv, në mobilizimin e tyre që të jenë më kreativë në mësimdhënie,

që gjatë punës me nxënës të zbatojnë qasje të mësimdhënies që mundësojnë zhvillimin e kompetencave të nxënësve, të përcaktuara tani me kurrikulën e re.

Aspektet që kanë ndikuar më shumë në mbingarkesën e nxënësve dhe mësimdhënësve, të cilat i referojnë njohësit e kurrikulës, koordinatorët dhe zhvilluesit e kurrikulës, pasqyrohen të përmbledhura në tabelën në vijim, në nënkategori dhe tema specifike.

Tabela 31. Ndikimet e mbingarkesës kurrikulare nga perspektiva e njohësve dhe koordinatorëve për zhvillimin e kurrikulës

Nënkategoria	Tema specifike
Ndikimi në arritjet e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> - Në përgjithësi, arritjet e nxënësve janë jo aq të kënaqshme; - PISA nuk i vlerëson kurrikulat, por i vlerëson aftësitë e nxënësve, të cilat në rastin tonë pasqyrohen tejet të ulëta; Rezultatet në PISA janë pasqyrë e pastër e punës sonë; - Nëse marrim për bazë studimin PISA, nuk duhet të vlerësojmë as ne kurrikulat si qëllim më vete, por rezultatet që dalin nga kurrikulat; - Rezultatet e Testit të Arritshmërisë në klasën e 9-të janë larg nga raportet e shkollave për suksesin e nxënësve nga vlerësimet e brendshme; - Mënyra e të mësuarit në shkollat tona ka ndikim në rezultate të nxënësve, kjo pasqyrohet edhe në rezultatet PISA dhe në vlerësimet e tjera ndërkombëtare; - Kur kërkesat e kurrikulave për çfarëdo arsye shmangen, ose keqinterpretohen, domosdo se nuk japin rezultate të kënaqshme.
Ndikimi në mirëqenien e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> - Lodhje nga mësimet në shumë lëndë; - Shqetësime, stres e ngarkesë; - Injorancë totale;

	<ul style="list-style-type: none"> - Humbje e interesimit për mësim; - Lodhje me detyra të shtëpisë; - Pasiguri në detyra të shtëpisë; - Mbingarkesë psikike dhe emocionale; - Mungesë kohe për aktivitete jashtëmësimore.
Aspektet që kanë ndikuar më shumë në mbingarkesën e mësimdhënësve	<ul style="list-style-type: none"> - Mospërgatitja e duhur për zbatimin e reformës kurrikulare; - Mungesa e mbështetjes sistematike për mësimdhënës; - Mospërcjellja e zhvillimit të kurrikulave lëndore me tekste të reja shkollore dhe materiale mësimore; - Mosndryshimi i organizimit të punës në shkolla; - Kërkesa të shumta administrative për mësimdhënës, pa staf mbështetës në shkolla; - Ngarkesa me numër të madh të nxënësve në shkollat urbane.
Ndikimi në punën e mësimdhënësve	<ul style="list-style-type: none"> - Pasiguri dhe mosbesim në punën e tyre; - Puna vetëm me tekste shkollore; - Debate të shumta lidhur me zbatimin e kurrikulës; - Humbje të motivimit për punë; - Lodhje dhe frikë nga ndryshimet e shpeshta; - Rezistencë në raste të caktuara ndaj zbatimit të kurrikulës; - Fokusi i punës në elementet administrative të kërkuara nga shkolla rreth kurrikulës; - Ka mësimdhënës që kanë ndryshuar në qasje, që i zhvillojnë kompetencat e përcaktuara tani me kurrikulën e re.

4.3.5.4. **Strategjitë për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare**

Në përgjigje të kërkesës, sa i përket strategjive të veprimit për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare nga niveli qendror deri te shkolla, njohësit e kurrikulës, koordinatorët dhe zhvilluesit e kurrikulës, kanë dhënë ide të ndryshme, të cilat në radhë të parë lidhen me reflektimet e nevojshme nga të gjithë mekanizmat e lidhur me reformën kurrikulare, për atë se çfarë është filluar të bëhet, çfarë është bërë në raport me zbatimin e kurrikulës, çfarë është të kuptuarit e përbashkët, dhe për vendosje institucionale se çfarë të ndërmerret në vijimësi të reformës kurrikulare, që duhet të adresojë edhe problematikën e mbingarkesës kurrikulare.

Procesi i zbatimit të reformës kurrikulare, sipas këtij grupi të respondentëve të studimit, është shoqëruar me një sërë sfidash e problemesh. Sipas tyre, një pjesë e madhe lidhen me qasjen që ka ndjekur MASHTI në raport me reformën kurrikulare, prandaj një numër i konsiderueshëm i sugjerimeve i dedikohen MASHTI-t, i cili, sipas tyre, duhet të prijë me veprime konkrete në rrugën që duhet ndjekur në trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare. Sugjerohet të fillohet me baziken, të kuptuarit e reformës kurrikulare, monitorimin e zbatimit të kurrikulës, koordinimin e veprimeve nga mekanizmat e MASHTI-t që kanë rol në procesin e mbështetjes dhe zbatimit të reformës kurrikulare.

Pastaj, idetë shkojnë për ndryshime përmbajtjesore sa i përket udhëheqjes së zbatimit të kurrikulës nga niveli qendror deri në nivel shkolle, organizimit të punës në shkolla, orarit mësimor, evitimit të burokracisë në procesin e reformës kurrikulare etj.

Pjesa e radhës e ideve për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare lidhet me gjetjen e një qasjeje pragmatike në rishikimin e kurrikulave bërthamë, por edhe të kurrikulave lëndore, për të cilat ka bazë se janë të mbingarkuara për nxënës dhe nuk e lehtësojnë punën e mësimdhënësve në zbatimin e kurrikulave bërthamë.

E para, rishikimi i kurrikulave bërthamë, sepse aty është problemi kryesor. Kurrikulat lëndore nuk shoh se janë problem i madh, sepse ato nuk do të duhej të ishin obligative për mësimdhënës, ata duhet të

kenë autonomi dhe fleksibilitet ne heqjen apo shtimin e temave dhe rezultateve të nxënës, varësisht nga specifikat dhe konteksti ku punojnë. Ato janë orientuese, ndihmesë për mësuesin në përzgjedhjen e disa temave, por jo domosdo të gjitha. E rëndësishme është se mbi bazën e asaj që mësuesin përzgjedhin duhet të sigurohen në arritjen e rezultateve të kompetencave dhe fushave për shkollë kurrikulare. Nuk duhet hequr dorë nga qasja e integruar. Kjo duhet të bëhet me riveditim të numrit të lëndëve mësimore në KB, vazhdimi i qasjes së integruar me fusha kurrikulare, deri në kuadrin e ri mund të punojnë 2-3 mësuesin, mirëpo fëmijët duhet ta kenë një lëndë mësimore (Nj/K/1).

Koordinatorët e kurrikulave nuk mendojnë se duhet filluar me ndryshime në dokumentet kurrikulare pa një vlerësim gjithëpërfshirës të asaj se çfarë është zbatuar dhe çfarë nuk është zbatuar, ku janë problemet kryesore dhe çfarë mund të ndryshohet. Një pjesë e rëndësishme e ideve të tyre lidhet me nevojën për rishikimin e programeve për përgatitjen e mësuesinve para shërbimit, edhe programet për zhvillim profesional të mësuesinve në shërbim.

Rishikimi i programeve për përgatitjen e mësuesinve para shërbimit, edhe programet në shërbim, duhet me qenë në frymën e kurrikulave bërthamë të rishikuara. Me mësuesin duhet punuar në atë mënyrë që ata vetë të kuptojnë kompetencat e kurrikulës, si t'i reflektojnë ato në punën e tyre, sepse ndryshe ata nuk mund të punojnë dhe përkrahin nxënësit në zhvillimin e kompetencave. Gjashtë kompetencat duhet me qenë në radhë të parë maksimalisht të zotëruara nga mësuesin, pasi që mësuesin vetëm në këtë mënyrë, përmes shembullit të vet, mund t'i transmetojnë më lehtë të nxënësit (Nj/K/3).

Idetë për DKA-të, për nivelin komunal, shkojnë për ndryshimin e qasjes së autoriteteve komunale ndaj punës me shkollat e komunës, mbështetjes së shkollave në organizimin e punës, përfshirë mbështetjen profesionale për mësuesin, riorganizimin e aktiveve profesionale të mësuesinve në

nivel komune, riorganizimin e punës së shërbimeve pedagogjike – psikologjike në shkolla etj.

Për arritjen e këtyre veprimeve sugjerohet një ristrukturim i DKA-ve dhe kompletim i tyre me kapacitete njerëzore që sigurojnë mbështetjen sistematike të shkollave, përmes së cilës drejtpërdrejt do të ndihmonin në evitimin e disa aspekteve të mbingarkesës kurrikulare, që ndikohen nga organizimi i punës së shkollës dhe niveli i përgatitjes së mësimit në punuar në frymën e kurrikulës.

Kur bëhet fjalë për veprimet që duhet të ndërmerren nga shkollat për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare, ky grup i respondentëve shpesh i referohet rolit udhëheqës të shkollës në zhvillimin e përgatitjeve të duhura për çdo vit për zbatimin efektiv të kurrikulës, përgatitjeve teknike, organizative, profesionale, që shkolla të arrij të siguroj për nxënës një mjedis mundësues për zhvillimin e kompetencave, përkrahje individuale për secilin nxënës. Sipas tyre, secila shkollë duhet të përgatitet për të vendosur një agjendë të qartë për zhvillim të vazhdueshëm të praktikave të saj, në të mirë të përkrahjes së nxënësve drejt përmbushjes së pritshmërive, arritjes së rezultateve të të nxënësve të përcaktuara me kurrikulë.

Secili mësimit duhet të ketë një rol shtesë në shkollë, përtej mësimit në lëndën që e ligjëron. Angazhimi të bëhet në atë fushë apo tematikë që mësimit kanë zhvillim më të mirë, janë më të përgatitur në një specifikë të përkrahjes së nxënësve, prindërve, udhëheqjes së shkollës. Dikush duhet të jetë mentor për kolegë. Në këtë mënyrë bëhet maksimizimi i punës së tyre, eliminimi i mbingarkesës së disa mësimit me shumë detyra dhe angazhime, me mungesë motivimi etj (Nj/K/1).

Shkolla duhet të ndryshojë, të ketë qasje konkrete në zhvillimin e procesit mësimit, të jetë më kërkuese para përgjegjësve të sistemit arsimor. Të raportojë saktë për përparësitë dhe vështirësitë në procesin mësimit dhe të marrë përgjegjësi për shumë probleme që lidhen me këtë temë të studimit, që direkt varen nga shkolla (Nj/K/3).

Gjithashtu, për shkollat sugjerohet që të raportojnë në mënyrë objektive për përparësitë dhe vështirësitë në procesin mësimor, të jenë transparente dhe të dëshmojnë saktë për arritjet dhe pengesat e zbatimit gjatë procesit mësimor dhe mësimdhënësit të maksimalizojnë punën me nxënës, në mënyrë që të sigurohet përkrahja e të gjithë nxënësve në procesin e të nxënës.

Si përfundim, mund të thuhet se edhe ky grup i respondentëve kanë dhënë ide të ndryshme dhe kreative, që mund të shërbejnë si pikënisje dhe orientim në punën e institucioneve arsimore nga niveli qendror deri te shkolla, për të ndërmarrë veprime të menjëhershme dhe afatgjata për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare. Detajet e veprimeve të sugjeruara, të përshkrua më sipër, pasqyrohen në tabelën në vijim.

Tabela 32. Veprimet e nevojshme për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare nga perspektiva e njohësve dhe koordinatorëve për zhvillimin e kurrikulës

Nënkategoria	Tema specifike nga nënkategoritë
Veprimet që duhet të ndërmerren nga MASHTI	<ul style="list-style-type: none"> - Rishikimi i kurrikulave bërthamë; - Ridefinimi i numrit të lëndëve mësimore në KB; - Vazhdimi i qasjes së integruar me fusha kurrikulare; - Rishikimi i programeve për përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit; - Koordinimi i MASHT-it me Fakultetet e Edukimit për përgatitjen e mësimdhënësve; - Rishikimi dhe zhvillimi i programeve për trajnimin e mësimdhënësve në shërbim, në frymën e kurrikulës; - Rishikimi edhe përshkrimi i detyrave të mësimdhënësve, në përputhje me kornizën e zhvillimit të mësimdhënësve; - Nevojiten norma/standarde dhe udhëzime për organizimin e brendshëm; - Përcjellja dhe shpërndarja e informatave në mënyrë të saktë dhe me kohë të gjitha palët e involvuara; - Evitimi i burokracisë në procesin e reformës kurrikulare;

	<ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të kurrikulës; - Adresë të qartë për përgjigje të kërkesave dhe nevojave të shkollave për çështjet që lidhen me kurrikulën.
Veprimet që duhet të ndërmerren nga DKA	<ul style="list-style-type: none"> - Ristrukturimi i DKA-ve dhe i punës në DKA; - Realizimi me përgjegjësi i detyrave që DKA-ja i ka në kompetencë; - Të punojnë më shumë me përmbajtjen që ndikon në gjithë procesin arsimor, e të mos fokusohen vetëm te forma; - Përkrahje në organizimin e punës së shkollave, në trajnimin e mësimitdhënësve; - Mbikëqyrje e punës së shkollave, të mbikëqyrin në mënyrë të vazhdueshme performancën e personelit edukativ; - Të kërkojnë llogaridhënie nga shkollat/ mësimitdhënësit; - Koordinimi i punës me drejtorët e shkollave për zbatimin e kurrikulës; - Të përkrahin shkollat me mjete dhe pajisje didaktike dhe të tjera ndihmëse; - Të sigurojnë bashkëpunimin e nevojshëm ndërmjet mësimitdhënësve dhe planifikim e përbashkët të përvojave të të nxënësve.
Veprimet që duhet të ndërmerren nga shkolla	<ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqje e proceseve në shkollë në bazë të parimeve të kurrikulës; - Një rol shumë me kreativ në udhëheqjen e shkollës, me mundësi për organizim ndryshe të orarit mësimor, organizimit të klasës, gjithnjë në interes të nxënësve dhe evitimit të mbingarkesës së tyre; - Sigurimi i një mjedisi mundësues për zhvillimin e kompetencave, përkrahje individuale për nxënës; - Punë dhe angazhime shtesë me prindër, për punën e tyre me fëmijë;

- Të raportojë në mënyrë objektive për përparësitë dhe vështirësitë në procesin mësimor;
- Të jenë transparentë dhe të dëshmojnë saktë për arritjet dhe pengesat e zbatimit gjatë procesit mësimor;
- Të identifikojnë nevojat për angazhim të njerëzve kompetentë të jashtëm në shkollë.
- Secili mësimdhënës duhet të ketë një rol shtesë në shkollë, përtej mësimin në lëndën që e ligjëron;
- Maksimizimi i punës së mësimdhënësit për shkollën;
- Shkolla duhet të funksionojë si organizatë e të nxënit.

KAPITULLI V

Diskutimi i rezultateve

Diskutimi i rezultateve, gjetjeve kryesore të studimit, ndërlidhet me qëllimin dhe pyetjet kërkimore të studimit, si dhe me shqyrtimin e literaturës për problematikën e mbingarkesës kurrikulare. Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte të eksplorojë dhe të trajtojë problematikën e mbingarkesës kurrikulare në arsimin e obligueshëm në Kosovë, të hetojë nëse përmbajtjet e kurrikulave në raport me pritshmëritë dhe kohën mësimore - planin mësimor, paraqesin ndonjë aspekt të mbingarkesës për nxënës dhe për mësimdhënës dhe të përcaktojë një përmasë të përafërt të aspekteve të mbingarkesës kurrikulare në raport me kërkesat zyrtare që lidhen me zbatimin e kurrikulës.

Gjithashtu, qëllimi i studimit ishte të pasqyrojë aspekte të mbingarkesës kurrikulare, të raportuara nga pikëpamjet e subjekteve nga komuniteti i shkollës (nxënës, prindër, mësimdhënës dhe drejtues të shkollave) dhe subjekte të tjera të lidhura me zhvillimin e kurrikulës (hartues dhe koordinator për zhvillimin e kurrikulave), në përpjekje për të dhënë përgjigje në pyetjen që diskutohet shumë në komunitetin arsimor: *A është mbingarkesa “reale” apo “e perceptuar”?*

5.1. Mbingarkesa kurrikulare në setin e dokumenteve kurrikulare në zbatimin, në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët në Kosovë

Në përgjigje të pyetjes kërkimore: *Sa janë të dukshme aspektet e mbingarkesës kurrikulare në setin e dokumenteve kurrikulare në zbatimin, në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët në Kosovë?*, të dhënat e detajuara janë paraqitur në kapitullin 4, në të cilin evidentohen gjetjet kryesore nga analiza e dokumenteve kurrikulare që rregullojnë çështjet e lidhura me kurrikulën në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët dhe zbatimin e tyre në shkollat e Kosovës.

Të dhënat e kërkimit tregojnë se ka një dallim të theksuar ndërmjet zgjerimit të kurrikulës, përmbajtjeve mësimore dhe rezultateve të të nxënës me kohën mësimore të obligueshme në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët. Dallimi

është më shumë i theksuar në kurrikulat e arsimit fillor kundrejt arsimit të mesëm të ulët, në kurrikulat lëndore, në lëndët mësimore që kanë kohë mësimore të obligueshme 1-2 orë mësimore.

Zgjerimi i kurrikulës, shtimi i përmbajtje mësimore dhe rezultateve të nxëniet në raport me kohën mësimore të obligueshme, kanë raport joproporcional dhe rrjedhimisht kanë ndikim në mbingarkesën e nxënësve në mësim, por edhe të mësimdhënësve në punën e tyre.

Megjithatë, qasja në mbarështimin e kurrikulave lëndore përmes përdorimit të koncepteve në formë të rrrathëve koncentrikë për përcaktimin e temave mësimore, referimi në rezultatet e fushave kurrikulare për shkallë, si dhe zbatimi i qasjes së bazuar në kompetenca, lejon mundësi që gjatë zbatimit të kurrikulës të këtë mundësi për zvogëlim të përmbajtjeve mësimore dhe mbulueshmëri të disa rezultateve të lëndës në të njëjtën kohë mësimore.

Për të gjetur raportin midis zgjerimit të kurrikulës, përmbajtjeve mësimore dhe rezultateve të nxëniet me kohën mësimore të obligueshme, në përgjigje të nënpyetjes së pyetjes së parë kërkimore: *A ka mbingarkesë nga zgjerimi i kurrikulave, shtimi i përmbajtjeve mësimore, pritshmërive për nxënës dhe cili është raporti i mbingarkesës me kohën mësimore të obligueshme?*, përdorëm analizën tematike të dokumenteve kurrikulare, sipas hierarkisë së dokumenteve kurrikulare: Dokumentin e Kornizës Kurrikulare (KKAP), Kurrikulat bërthamë, Planin mësimor dhe Kurrikulat lëndore për klasat 1,3,5,6,8 dhe 9.

Dokumenti i KKAP është dokument konceptual i kurrikulës dhe përgjithësisht i organizimit të sistemit të arsimit parauniversitar. Si i tillë, dokumenti nuk përbën një bazë të mbingarkesës kurrikulare me përmbajtje apo tema mësimore. Mirëpo, dokumenti ka orientuar që mësimi i të gjitha fushave kurrikulare, gjithsej shtatë (7) fusha kurrikulare, të bëhet nga klasa përgatitore (klasa 0) deri në klasën e dymbëdhjetë (12). Kjo ka bërë që në zbrërthimin e mëtejme të kurrikulës, nga klasa e parë e arsimit fillor, të fillohet me minimum 10 lëndë mësimore. Kjo përben një zgjerim të kurrikulës, sidomos për arsimin fillor, i cili reflektohet si dimension i mbingarkesës kurrikulare në këtë nivel të arsimit.

Kurrikulat Bërthamë janë hierarkia e dytë e dokumenteve kurrikulare, të cilat zbërthejnë konceptin e kornizës kurrikulare dhe përcaktojnë pritshmëritë e orientimet e kurrikulës për shkallë kurrikulare dhe për organizimin e procesit mësimor që në fokus ka zbatimin e kurrikulës. Edhe dokumentet e kurrikulave bërthamë, me funksionin që kanë, në parim nuk do të duhej të përbënin një bazë të mbingarkesës kurrikulare me zgjerim të kurrikulës dhe me shtim të përmbajtjeve mësimore që duhet të zhvillohen me nxënës, pasi që kurrikula është e bazuar në kompetenca dhe është e organizuar në fusha kurrikulare, që ofrojnë mundësi fleksibiliteti në raport me aspektet e përmbajtjes së kurrikulës.

Mirëpo, në dokumentet e kurrikulave bërthamë ka disa elemente të zgjerimit të kurrikulës, duke filluar nga orientimet për planin mësimor në KB/1, i cili, ashtu si KKAP, për arsimin fillor përcakton që të mësohen se paku 10 lëndë mësimore, duke filluar nga klasa e parë e shkollës fillore, ndërsa për arsimin e mesëm të ulët sipas KB/2 përcakton deri në 15 lëndë mësimore. Kështu, lista e lëndëve thjesht është bërë më e gjatë dhe asgjë nuk është hequr për të akomoduar lëndët e reja (Alexandër dhe Flutter, 2009).

Aspektet tjera, të cilat konsiderohen mbingarkesë kurrikulare në kurrikulat bërthamë, që lidhen me zgjerimin e kurrikulës dhe shtimin e përmbajtjeve mësimore, janë numri i disa RNL dhe pritshmëritë e larta në kurrikulat bërthamë, numri i kërkesave brenda një rezultati të të nxënës për fusha kurrikulare dhe thellësia e tyre, pa një standard të nivelit të përgjithësim, pavarësisht kohës mësimore të përcaktuar për një fushë kurrikulare.

Në raport me numrin e rezultateve të të nxënës për fusha kurrikulare, gjetjet e analizës tregojnë se dallimet janë të dukshme në disa fusha kurrikulare, si p.sh. fusha kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi ka mbi 38 % të kohës mësimore për shkallën kurrikulare 1, rezultate të të nxënës për këtë fushë kurrikulare janë përcaktuar të jenë 24, ndërsa një fushë tjetër kurrikulare, siç është për shembull fusha kurrikulare Shkencat e natyrës, ka 14 rezultate të të nxënës, me rreth 5% të kohës mësimore në shkallën e njëjtë kurrikulare.

Gjetjet e analizës tregojnë se elemente të zgjerimit të kurrikulës dhe të shtimit të përmbajtjeve mësimore ka edhe nga mënyra se si janë vendosur në kurrikula bërthamë konceptet për: (i) Qëndrimet, vlerat dhe besimet; (ii)

Aftësitë dhe shkathtësitë; dhe (iii) Konceptet specifike dhe njohuritë që lidhen me fushën kurrikulare. Në shumicën e fushave kurrikulare ato janë të përbashkëta, gjë që le të kuptohen se të gjitha këto elemente bazike të kurrikulës zhvillohen në të dyja shkallët kurrikulare të një niveli të arsimit, arsimit fillor apo arsimit të mesëm të ulët.

Kjo qasje i referohet tendencës për të përfshirë artikuj të përmbajtjes së re në kurrikulë, në përgjigje të kërkesave të reja shoqërore, pa marrë parasysh, në mënyrë të përshtatshme, se cilat përmbajtje duhet të hiqen (OECD, 2020) brenda një shkalle kurrikulare apo brenda një klase.

Gjetjet nga analiza e bërë kurrikulave lëndore, në kuadër të këtij studimi, kurrikulave për klasat 1, 3, 5, 6, 8 dhe 9, tregojnë për tendencë të zgjerimit të përmbajtjeve mësimore, nga numri i temave mësimore, numri i rezultateve të të nxënit dhe në shumë raste nga numri i kërkesave brenda një rezultati të lëndës (RNL) dhe thellësia e përmbajtjeve që duhet të zërthehen në njësi mësimore nga mësimdhënësit, por edhe hartuesit e teksteve shkollore.

Elementet e shtimit të përmbajtjeve mësimore, përmes temave mësimore dhe veçanërisht RNL-ve, shihen në rastet kur për një lëndë mësimore numri i RNL-ve të vendosura në kurrikula lëndore është i barabartë me numrin e rezultateve të fushës kurrikulare përkatëse, që janë vendosur në kurrikulën e klasës së njëjtë, siç është për shembull rasti i kurrikulës lëndore Shkathtësitë për jetë – klasa e 5-të.

Ose në rastet kur numri i RNL-ve ndryshon dukshëm nga klasa në klasë, brenda një niveli të arsimit dhe nga e njëjta lëndë mësimore, siç është për shembull numri i RNL-ve në lëndën mësimore Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, klasa e pestë, ku për 50% është më i vogël numri i RNL se në klasën e parë. Raste të tilla reflektohen në të dy nivelet e arsimit.

Elementet e mbingarkesës me përmbajtje, mbingarkesë e cila vjen nga numri i temave mësimore dhe numri i rezultateve të të nxënit (RNL) në arsimin fillor, të vendosura në të gjitha kurrikulat lëndore për klasë, në raport me kohën mësimore për klasë (orët mësimore për një javë mësimi), pasqyrohen në figurën në vijim.




Figura 6. Dallimet në numrin e temave vjetore dhe numrin e RNL-ve në klasat 1,3 dhe 5

Siç shihet, dallimi ekziston ndërmjet klasave 3 dhe 5, edhe pse nxënësit e klasës së 5-të janë më të rritur, kanë 37 orë mësimi më shumë se klasa e 3-të. Për këtë klasë janë përcaktuar 7 tema mësimore më pak dhe 28 RNL më pak për të gjitha lëndët mësimore të këtyre klasave. Dallimet specifike për lëndë mësimore janë pasqyruar në kapitullin 4 të këtij studimi.

Gjetjet nga analiza e Kurrikulës Bërthamë dhe kurrikulave lëndore në arsimin fillor tregojnë se përmbajtjet, numri i kërkesave dhe thellësia e RNL-ve në lëndën Njeriu dhe natyra kanë mbingarkesë me përmbajtje, si në raport me kohën mësimore 1-2 orë mësimi në javë, ashtu edhe në raport me moshën e fëmijëve, me koncepte dhe përmbajtje të rezultateve të të nxënit që shkojnë përtej veçorive të zhvillimit të fëmijëve brenda shkallës kurrikulare përkatëse ose nivelit të arsimit përkatës.

Kështu, për shembull, në kuadër të njohurive, të kuptuarit dhe shkathtësive, është përcaktuar që nga nxënësit deri në fund të klasës së pestë (5) të zhvillohet: *Strukturimi i mendimit shkencor për konceptet, modelet, teoritë dhe ligjet për ndërtimin e lëndës, proceseve dhe dukurive në natyrë (proceset dhe dukuritë fizike, kimike, biologjike, gjeografike në Tokë dhe Gjithësi)* (MASHt (KB/1), 2016).

Rezultati i njëjtë përshkruhet edhe në Kurrikulën Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9), me një plotësim edhe për zhvillimin e shkathtësive të kërkimit shkencor për ndërtimin e materies, proceseve dhe dukurive (MASHT (KB/2), 2016).

Mungesa e qartësisë në lidhje me qëllimet e lëndës dhe pritshmëritë, përveç ngarkesës që mund të shkaktojë për nxënës, mund të shkaktojë në radhë të parë konfuzion të mësimeve në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet komponentëve tradicionalë dhe atyre të ndryshuar në kurrikulën e re (Voogt, Nieveen dhe Klopping, 2017).

Edhe në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9) dalin në sipërfaqe elementet e mbingarkesës nga numri i temave mësimore dhe numri i rezultateve të nxënësve (RNL), të vendosura në të gjitha kurrikulat lëndore për klasë, në klasat 6, 8 dhe 9, në raport me kohën mësimore për klasë (orët mësimore për një javë mësimi). Ato të përmbledhura pasqyrohen në figurën në vijim.




Figura 7. Dallimet në numrin e temave vjetore dhe numrin e RNL-vë në klasat 6, 8 dhe 9

Dallimi ekziston më shumë ndërmjet klasës së 6-të me klasën e 8-të. Sipas të dhënave, klasa 8-të ka vetëm 37 orë mësimi më shumë se klasa e 6-të, mirëpo ka 34 tema mësimore më shumë dhe ka 220 RNL më shumë. Pavarësisht faktit se elementi i thellësisë së përmbajtjes së RNL tregon më

së miri shtimin e përmbajtjeve, kundrejt treguesve kuantitativë, edhe kjo mënyrë e shpërndarjes së temave dhe RNL tregon se ndërtimi i progresit në të nxënë nuk është koherent nëpër klasa.

Gjetjet nga analiza për mbingarkesën kurrikulare, në raport me kohën mësimore të obligueshme, tregojnë se nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë, nga klasa 1- 9, sipas planit mësimor në fuqi, i kanë të garantuara gjithsej 8524 orë mësimi. Ky numër i orëve të mësimi përbën një ngarkesë me orë mësimi prej rreth 900 më shumë se mesatarja e orëve të mësimi në vendet e OECD-së, në të cilat numri total i mesatares së vendeve të OECD-së shkon në 7639 orë mësimi për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët.

Gjetjet tregojnë se vendet e OECD-së si minuta të orës mësimore kanë më shumë kohë, me mesatare 45-50 minuta, kundrejt Kosovës, me mesatare 40-45 minuta, mirëpo ngarkesa reflektohet me shpërndarje të mësimëve në shumë orë mësimi për lëndë mësimore, e cila shpie në mësimdhënie sipërfaqësore (Peffer, et al. 2005).

Çështjet ndërkurrikulare në kurrikulat lëndore. Për të gjetur raportin midis zgjerimit të kurrikulës, përmbajtjeve mësimore dhe rezultateve të të nxënës me kohën mësimore të obligueshme, në përgjigje të nënpyetjes së dytë kërkimore: *A ka mbingarkesë kurrikulare të shkaktuar nga mënyra e përfshirjes së çështjeve ndërkurrikulare në kuadër të kurrikulave?*, përdorëm analizën e kurrikulave lëndore për klasat 1,3,5,6,8 dhe 9, pjesën e udhëzimeve për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare.

Gjetjet tregojnë se udhëzimet për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare në kurrikulat lëndore janë vendosur në renditje pas udhëzimeve metodologjike, në radhë të parë konsiderohen se janë pjesë e metodologjisë, me një veçim specifik, i cili sipas mënyrës së vendosjes shkon përtej udhëzimeve metodologjike. Ka tri forma të vendosjes së udhëzimeve për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare në kurrikula lëndore të një klase të njëjtë: (i) forma e përshkrimit të përgjithshëm; (ii) vetëm specifikimi i temave/çështjeve ndërkurrikulare, si titull, i cili shkon nga 5 deri në 8 tema ndërkurrikulare vetëm në një kurrikulë lëndore; dhe (iii) përshkrimi i udhëzimeve specifike për temat/çështjet në kuadër të kurrikulave lëndore përkatëse.

Në arsimin fillor, nga gjithsej 9 kurrikula lëndore, çështjet ndërkurrikulare të përfshira në numër më të madh në kurrikulat lëndore janë: Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm (në 8 lëndë), Globalizimi dhe ndërvarësia (në 8 lëndë), Edukimi për media (në 7 lëndë), Edukimi për paqe (në 5 lëndë), Edukimi për qytetari demokratike (në 4 lëndë), Edukimi për mjedisin (në 4 lëndë), etj. Figura në vijim pasqyron përfshirjen e çështjet ndërkurrikulare në numrin e kurrikulave lëndore të klasës së pestë .




Figura 8. Integrimi i çështjeve ndërkurrikulare në numër të kurrikulave lëndore /kl. 5/

Në raport me arsimin e mesëm të ulët, ka një dallim të vogël renditja e çështjeve ndërkurrikulare nga përfshirja e tyre në kurrikulat lëndore. Çështjet ndërkurrikulare të përfshira në numrin e kurrikulave lëndore të klasës së nëntë, nga gjithsej 14 kurrikula lëndore, kanë këtë përfshirje: Edukimi për media (në 13 lëndë), Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm (në 10 lëndë), Edukimi për paqe (në 7 lëndë), Globalizimi dhe ndërvarësia (në 7 lëndë), Edukimi për qytetari demokratike (në 6 lëndë), Edukimi për mjedisin (në 4 lëndë), etj. Figura në vijim pasqyron çështjeve ndërkurrikulare të integruara sipas numrit të kurrikulave lëndore /kl. 9/.




Figura 9. Integrimi i çështjeve ndërkurrikulare në numër të kurrikulave lëndore /kl. 9/

Mënyra se si janë integruar çështjet ndërkurrikulare në kurrikulat lëndore, në pjesën më të madhe të rasteve, është kontradiktore me frymën e kurrikulës së bazuar në kompetenca, sepse kompetencat kryesore janë konsideruar se sigurojnë ndërveprim ndërmjet lëndëve mësimore, duke mbuluar edhe çështjet ndërkurrikulare.

Gjithashtu, ato nuk i orientojnë mjaftueshëm edhe mësimdhënësit dhe shkollat në planifikimin dhe realizimin e proceseve edukativo-arsimore për të mundësuar zhvillimin e kompetencave me përfshirje edhe të çështjeve ndërkurrikulare.

Temat ndërkurrikulare duhet të përdoren për të promovuar zhvillimin holistik të nxënësve përtej mëimit tradicional (OECD, 2020), prandaj ato duhet të vendosen në kontekstin e lëndës me udhëzime specifike për të siguruar ndërveprim me temat e lëndës, pa krijuar mbingarkesë për nxënës, por edhe për mësimdhënësit, dhe jo domosdo duhet të trajtohen 5-8 tema/çështje ndërkurrikulare brenda secilës lëndë mësimore.

Marrëdhënia midis rezultateve të nxënësve në arsimin e detyrueshëm dhe kohës së mësimi. Për të gjetur raportin midis zgjerimit të kurrikulës, përmbajtjeve mësimore dhe rezultateve të të nxënësve me kohën mësimore të obligueshme, në përgjigje të nënpyetjes së pyetjes së tretë kërkimore: *Çfarë është marrëdhënia midis rezultateve të nxënësve në arsimin e detyrueshëm dhe kohës së mësimi?*, përdorëm treguesit e rezultateve të studimit PISA 2015 dhe 2018, si dhe rezultatet e Testit të Arritshmërisë 2022, për klasën e 9-të.

Raporti i vitit 2015, i Programit të OECD-së për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (OECD, 2016), thekson se koha e shpenzuar për të mësuar gjatë një dite, si në shkollë, ashtu edhe jashtë kohës së mësimi në shkollë, gjegjësisht mësimi në shtëpi, nuk lidhet me performancën akademike të nxënësve. Pavarësisht se në këtë analizë specifike të OECD-së nuk përfshihet Kosova, edhe pse ishte për herë të parë pjesë e studimit PISA 2015, analizat e bëra në kuadër të treguesve të tjerë statistikorë, të raportuara nga PISA, por edhe nga MASHTI për rastin e Kosovës, theksojnë se koha e shpenzuar e nxënësve kosovarë për të mësuar gjatë një dite, si në shkollë, ashtu edhe në shtëpi, nuk lidhet me performancën akademike të tyre.

Kosova, me një mesatare të orëve të mësimi në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët (klasat 1-9), prej 947 orë mësimi për një vit, ka arritur minimale në PISA 2015, vetëm 347 pikë në Lexim, Matematikë dhe Shkencë, apo 150 pikë më pak se mesatarja e vendeve të OECD-së, e cila ishte 497 pikë, me dallime të vogla në PISA 2018, me vetëm 353 pikë në Lexim, Matematikë dhe Shkencë. Përqindja e nxënësve kosovarë që nuk e kanë arritur nivelin minimal të aftësive në PISA 2018 është tejte e lartë (Shkenca 76.6%, Lexim 78.7%, Matematikë 76.6%).

Edhe rezultatet e Testit të Arritshmërisë, klasa e 9-të, të publikuara nga MASHTI (2022), theksojnë afërsisht të njëjtën gjë, se koha e obligueshme për të mësuar në shkollë nuk lidhet me performancën akademike të nxënësve. Arritshmëria mesatare është 50.75%. Dallimet ndërmjet mesatares së arritshmërisë dhe kohës mësimore të detyrueshme për lëndë mësimore, që ishin pjesë e Testit të Arritshmërisë 2022, pasqyrohen në figurën në vijim.




Figura 10. Marrëdhënia midis rezultateve të Testit të Arritshmërisë (2022) dhe kohës së obligueshme të mësimin (klasat 6-9)

Siç shihet, rezultatet e Gjuhës shqipe janë më të ulëta për rreth 16% se rezultatet në Gjuhën angleze, edhe pse koha mësimore e gjuhës shqipe përben 16 % të kurrikulës në klasat 6-9, kundrejt gjuhës angleze, e cila përben 6.7% të kohës mësimore të detyrueshme në këto klasa. Dallime reflektohen edhe në lëndët e tjera mësimore, p.sh. në Matematikë, e cila ka 13.4% të kurrikulës në klasat 6-9 me rezultate në Testin e Arritshmërisë të përafërta me lëndën e Fizikës, e cila ka 6.7% të kohës mësimore të detyrueshme në këto klasa.

Koha e shpenzuar për të mësuar gjatë një dite, si në shkollë, ashtu edhe në shtëpi, nuk lidhet me performancën akademike të nxënësve edhe në vlerësimin e organizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës për ndikimin e pandemisë COVID në humbjet mësimore. Sipas këtij studimi, rreth 51 % e nxënësve të klasës së shtatë nuk i kanë arritur në nivelin minimal rezultatet e të nxënësve në lëndën e Gjuhës shqipe, ndërsa 36 % e nxënësve nga kjo klasë nuk i kanë arritur në nivelin minimal të pritjeve rezultatet e të nxënësve në lëndën e Matematikës (Mehmeti, et al., 2021).

5.2. Perceptimet e përgjithshme për mbingarkesën kurrikulare

Mbingarkesa kurrikulare matet, gjithashtu, bazuar në reagimet e përdoruesve, zbatuesve të saj, si mësimdhënësve, nxënësve, drejtuesve të shkollave, por edhe aktorëve të tjerë që lidhen me kurrikulën, prandaj është jashtëzakonisht e rëndësishme të bëhet dallimi midis mbingarkesës reale dhe asaj të perceptuar (OECD, 2020).

Në përgjigje të pyetjes kërkimore *Si perceptohet mbingarkesa kurrikulare nga përfaqësuesit e komunitetit të shkollës dhe aktorët e lidhur me zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës?* të dhënat e detajuara janë paraqitur në kapitullin 4, në të cilin evidentohen gjetjet kryesore nga përpunimi dhe interpretimi i të dhënave të siguruara me intervista gjysmë të strukturuar dhe pyetësorë të realizuar me respondentë nga komuniteti i shkollës, si dhe me njohës e koordinatorë të zhvillimit të reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar.

Nga të gjitha grupet e respondentëve të përfshirë në studim: mësimdhënësit, nxënësit, drejtuesit e shkollave, prindërit dhe njohësit/koordinatorët e zhvillimit të kurrikulave, gjetjet në diskutimet hyrëse, tregojnë për informacione, perceptime të përgjithshme, por të ndërlidhura me mbingarkesën kurrikulare. Pastaj, më në detaje, në diskutimet vijuese veçohen çështjet e mbingarkesës kurrikulare, faktorëve dhe ndikimeve të saja.

Kështu, mësimdhënësit fillimisht kur flasin për ndryshimet kurrikulare u referohen aspekteve të përgjithshme të ndryshimeve, si kompetencat, parimet, fushat e kurrikulës, dhe nuk thellohen shumë në aspektet përmbajtjesore që lidhen me kurrikulën e tyre.

Mësimdhënësit, me diskutimet e tyre, prekin edhe elemente të rëndësishme që lidhen me anët pozitive të kurrikulës së re, ndryshimet në kurrikulat e tyre që i kanë të njohura, strukturën dhe koherencën e kurrikulave lëndore, si dhe japin një listë të gjerë të vështirësive që lidhen me zbatimin e kurrikulës, duke filluar nga ato përmbajtjesore, organizative, teknike dhe administrative.

Mësimdhënësit, si shumicë, kur diskutojnë për ndryshimet në kurrikula, pothuajse çdo gjë e lidhin me ndryshimet në tekstet shkollë, të cilat

referohen se janë burimi kryesor i nxënësve, por edhe i punës së tyre me nxënës.

Edhe drejtuesit e shkollave dhe koordinatorët e cilësisë në shkolla, kur flasin për ndryshimet kurrikulare, u referohen aspekteve të përgjithshme të ndryshimeve në kurrikula dhe thellohen në elementet e zbatimit të kurrikulës, duke vënë theksin në rolin e tyre në koordinimin e aktiviteteve për zbatimin e kurrikulës në nivel shkolle, i cili ka pak elemente të fokusit në rolin e udhëheqjes në zbatimin e kurrikulës.

Pastaj, drejtuesit e shkollave dhe koordinatorët e cilësisë në shkolla, flasin për sigurimin e dëshmimeve për zbatimin e kurrikulës së re, të cilat mbliidhen në forma të ndryshme, mirëpo përdorimi i tyre për qëllime të përmirësimit të punës në shkollë është minimalisht i pranishëm në temat specifike të identifikuara nga diskutimet me këtë grup të respondentëve. Kjo tregon se udhëheqja e shkollës nuk ka një orientim të mirëpërcaktuar për zbatimin e reformës së kurrikulës së re (Buleshkaj & Koren, 2022).

Drejtuesit e shkollave dhe koordinatorët e cilësisë në shkolla shprehen me një pozitivitet në rritje për gatishmërinë e mësimit të nxënësve për zbatimin e kurrikulës, e cila përshkruhet se ka qenë me luhataje në faza të ndryshme të zbatimit të kurrikulës. Informacionet për ankesat, vështirësitë, sfidat dhe shqetësimet e mësimit të nxënësve dhe prindërve, lidhur me kurrikulën re, zënë vend më të gjerë në diskutimet e tyre.

Drejtuesit e shkollave dhe koordinatorët e cilësisë në shkolla pak japin sqarime se si këto informacione përdoren për t'i adresuar problemet e ngritura, të cilat kryesisht priten të gjejnë zgjidhje nga jashtë, nga DKA-të dhe nga MASHTI. Edhe pse në disa raste nuk mungojnë përpjekjet për t'i adresuar disa nga problemet që lidhen me kurrikulën, sidomos nga drejtorët e shkollave dhe KSC, të cilët janë trajnerë të kurrikulës apo kanë qenë të përfshirë në zhvillimin e kurrikulave dhe teksteve shkollore.

Nxënësit përshkruajnë angazhimin e tyre në mësim, i cili në masë të madhe varet nga mënyrat e shpjegimit prej mësimit të nxënësve të tyre, nga qasja e komunikimit të mësimit rreth mësimeve, nga interesimi i vetë nxënësve për mësim dhe nga faktorë të tjerë të shumtë.

Rreth angazhimit të nxënësve në mësim, gjetjet tregojnë se, në raport me kohën e ndarë për mësim në shtëpi dhe për detyra të shtëpisë, ka dallime të shumta, kohë e cila varet nga obligimet që marrin nga mësimdhënësit dhe mënyra e të mësuarit të tyre.

Nga të gjeturat me nxënës, rezulton se më tepër se gjysma e tyre angazhohen vetëm për detyra të shtëpisë, mesatarisht gjatë një dite deri në 2 orë, rreth 1/3 e tyre nga 1 orë, kurse të tjerët deri në 3 orë vetëm në kryerjen e detyrave të shtëpisë.

Prindërit, me përshkrimet e tyre, tregojnë se në shkolla nuk ka sistem të organizuar mirë për informimin e prindërve lidhur me ndryshimet në kurrikula dhe për këshillimin e tyre se si të punojnë me fëmijët për t'i mbështetur ata në proceset e të nxënës që lidhen me kurrikulën shkollore. Prindërit për zhvillimet në kurrikula kanë informacione të pakta, të siguruara nga mësimdhënësit kujdestarë klase, por edhe nga fëmijët e tyre. Ata flasin për probleme dhe shqetësime të shumta që lidhen me kurrikulën e re, për të cilat kryesisht u referohen informacioneve të dëgjua, por edhe të diskutuara me mësimdhënësit dhe me nxënës - fëmijët e tyre.

Për dallim prej respondentëve nga shkollat, njohësit dhe koordinatorët e kurrikulës fillimisht kur flasin për zhvillimet rreth kurrikulave u referohen rrethanave mbi të cilat janë zhvilluar ndryshimet në kurrikula, mundësitë e pashfrytëzuara nga koncepti i kurrikulës me qasje të bazuar në kompetenca, për të zvogëluar numrin e lëndëve mësimore, por edhe zgjerimin e kurrikulës.

Njohësit dhe koordinatorët e kurrikulës, konfirmojnë disa nga ndryshimet e bëra në kurrikulat lëndore, të cilat tregojnë për përdorimin e koncepteve në formë të rrethëve koncentrikë për zberthimin e temave mësimore në kuadër të kurrikulave lëndore, si një risi, por edhe për shtimin apo riorganizimin e disa përmbajtjeve mësimore nga kurrikulat paraprake - lëvizje nga klasa në klasë, ose nga niveli në nivel të arsimit.

Gjithashtu, njohësit dhe koordinatorët e kurrikulës, tregojnë se ka një pozitivitet në rritje për gatishmërinë e mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës, e cila përshkruhet se ka qenë e sfiduar dhe akoma ka disa luhajtje

për të siguruar një mobilizim më të madh drejt zbatimit të elementeve kryesore të kurrikulës që lidhen me rolin e mësimeve.

5.3. Faktorët që kanë nxitur perceptimin për mbingarkesën kurrikulare

Gjetjet kryesore tregojnë për perceptime të ndryshme për faktorët që kanë nxitur perceptimin për mbingarkesën kurrikulare. Ato vijnë nga natyra e ballafaqimit me kurrikulën, nga njohja e kurrikulës, por edhe nga njohja e sfidave dhe problemeve reale që lidhen me zbatimin e kurrikulës.

Nuancat e dallimeve janë në numrin e faktorëve nxitës, në renditjen e faktorëve, gjahën e formulimit, nivelin e arsimit fillor apo të mesëm të ulët me të cilin lidhen më shumë respondentët, në varësi të kontekstit specifik të ballafaqimit me situata ku është parë apo përjetuar mbingarkesa kurrikulare.

Në raport me arsimin fillor, perceptimi për mbingarkesën kurrikulare është i nxitur më shumë nga numri i lëndëve mësimore që zhvillohen nga klasa e parë deri në klasën e pestë. Këtë e thonë qartazi mësuesit klasorë, drejtuesit e shkollave, koordinatorët e cilësisë, prindërit, por edhe njohësit dhe koordinatorët e kurrikulës.

Mësuesit klasorë dhe njohësit e kurrikulës si faktorë të mbingarkesës kurrikulare veçojnë edhe përmbajtjet mësimore për t'i trajtuar në kohën mësimore të planifikuar për klasat e arsimit fillor, numrin e rezultateve të të nxënësve, kërkesat dhe pritshmëritë e larta të rezultateve të të nxënësve. Në mënyrë të veçantë, specifikohet ngarkesa kurrikulare me përmbajtje mësimore dhe vështirësi të kërkesave të rezultateve të të nxënësve në lëndën Njeriu dhe natyra, pothuajse në të gjitha klasat e arsimit fillor.

Faktorë të tjerë, të cilët e kanë nxitur më shumë perceptimin për mbingarkesën kurrikulare, nga mësimeve dhe në mënyrë të veçantë nga nxënësit dhe prindërit, janë tekstet shkollore dhe detyrat e shtëpisë, gjegjësisht përmbajtja dhe vëllimi i teksteve shkollore me të dhëna të tepërta, por edhe nga shpeshësia dhe përmbajtja e detyrave të shtëpisë, të cilat marrin shumë kohë dhe janë të përditshme për nxënës.

Mbingarkesën e nxënësve me tekste shkollore e përshkruajnë me çanta të ngarkuara për nxënës, me numër të madh të teksteve shkollore. Këto tregojnë se përdorimi i tepërt i teksteve shkollore, materialeve mësimore dhe detyrave të shtëpisë, është faktor nxitës në perceptimin për mbingarkesën kurrikulare (OECD, 2020).

Nisur nga fakti se detyrat e shtëpisë dalin si faktor i mbingarkesës së nxënësve në mësim dhe ndikojnë në mirëqenien e nxënësve, ato nuk duhet dhënë në mënyrën si bëhen sot, jo për çdo ditë, jo pa kurrfarë qëllimi, jo pa udhëzime. Ato janë një mundësi e mirë e pashfrytëzuar. Detyrat e shtëpisë do të duhej të ishin në formë të projekteve, në javë, në muaj, individuale, në çifte, të lidhura me rezultate të të nxënësve, të vlerësuara etj. Kohë e humbur për mësimdhënës në fillimin e orës mësimore, për t'i kontrolluar detyrat e shtëpisë, nëse i kontrollon, për fëmijët dekurajuese se pse i bëra detyrat dhe kjo shpie që detyrat e radhës të mos i bëjë.

Detyrat e shtëpisë do të duhej të kishin peshë më të madhe dhe do të duhej të planifikoheshin në mënyrë shumë më kreative, që përmes tyre fëmijëve t'u jepet mundësi, përmes stileve të ndryshme të të nxënësve, të tregojnë prirjet, mundësitë dhe rezultatet e punës (Nj/K1).

Nxënësit dhe prindërit, në masë të madhe, kanë perceptim të nxitur për mbingarkesën kurrikulare nga qasja në vlerësimin e nxënësve, duke specifikuar shpeshësinë e vlerësimeve me teste në tri periudha mësimore. Po ashtu, nxitja e perceptimit të nxënësve dhe prindërve për mbingarkesën kurrikulare vjen edhe nga mësimdhënësit dhe format e mësimdhënies, mënyrat se si mësimdhënësit i ngarkojnë nxënësit me mësim, detyra të shtëpisë, shpesh me detyra dhe projekte pa udhëzime, pa shpjegime paraprake etj.

Në anën tjetër, perceptimi i mësimdhënësve për mbingarkesën kurrikulare vjen edhe nga puna administrative, të cilën shumica e mësimdhënësve e identifikojnë me planifikimet mësimore, dokumentacionin pedagogjik, kontrollimin e vlerësimeve të nxënësve dhe raportimet. Nxitja vjen edhe nga ndryshimet e shpeshta në kurrikula, ndryshime të cilat përshkruhen si të ngutshme, pa përgatitje të duhura dhe shumë të lodhshme për një pjesë të konsiderueshme të mësimdhënësve.

Faktorë të tjerë nxitës shihen edhe numri i madh i nxënësve në shkollat urbane, kushtet dhe ambienti i punës në shkollë jo të përshtatshëm për zbatimin e kurrikulës etj. Një përmbledhje e faktorëve, të cilët sipas subjekteve të këtij studimi kanë nxitur në perceptimin e tyre për mbingarkesën kurrikulare, pasqyrohet në tabelën në vijim.

Tabela 33. Faktorët e mbingarkesës sipas perceptimit të pjesëmarrësve në studim

Subjektet pjesëmarrëse në studim	Faktorët që kanë nxitur perceptimin për mbingarkesën kurrikulare
Mësimdhënësit	<ul style="list-style-type: none"> - Tekstet shkollore; - Puna administrative; - Numri i madh i lëndëve dhe temave mësimore; - Rezultatet e të nxënësve të ngarkuara në numër dhe në përmbajtje; - Kohë e pamjaftueshme në dispozicion për shtjellim të temave; - Vlerësimi i nxënësve; - Qasja ndaj mësimdhënies dhe punës me tekste shkollore; - Angazhimi i tepërt i nxënësve me detyra të shtëpisë; - Kushtet dhe ambienti jo i përshtatshëm punës në shkollë; - Numër i madh i nxënësve nëpër klasa, në zonat urbane;
Nxënësit	<ul style="list-style-type: none"> - Shpeshtësia e vlerësimeve me teste; - Përmbajtjet mësimore, temat/njësitë mësimore; - Tekstet shkollore; - Detyra të shtëpisë; - Mësimdhënësit, qasja në mësimdhënie.
Prindërit	<ul style="list-style-type: none"> - Tekstet shkollore, ngarkesa me çanta; - Numri i lëndëve mësimore;

	<ul style="list-style-type: none"> - Përmbajtjet mësimore në tekstet shkollore; - Detyrat e shtëpisë; - Mësimdhënësit dhe format e mësimdhënies; - Shpeshtësia e vlerësimeve me teste.
Drejtorët e shkollave dhe koordinatorët e cilësisë	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i lëndëve mësimore për klasë (vihet theksi në arsimin fillor); - Tekstet shkollore, përmbajtja e teksteve dhe terminologjia e përdorur; - Numri i temave mësimore dhe rezultateve të nxënit; - Koha mësimore në raport me përmbajtjet dhe RNL-ve; - Qasja në mësimdhënie; - Vlerësimi dhe periudhat mësimore të pabarabarta; - Detyrat e shtëpisë; - Aspektet e organizimit të përmbajtjeve mësimore në kurrikula; - Puna administrative e mësimdhënësve; - Infrastruktura për mësim etj.
Njohësit dhe koordinatorët e zhvillimit të kurrikulës	<ul style="list-style-type: none"> - Qasja ndaj reformës kurrikulare, pritshmëritë e larta në kurrikulat bërthamë; - Numri i lëndëve mësimore, numri i madh i RNL, numri i kërkesave të larta brenda një rezultati të nxënit në kurrikulat lëndore; - Përmbajtjet mësimore jo në raport me kohën mësimore për zhvillimin e tyre; - Tekstet shkollore - puna vetëm me tekste shkollore, pa mbështetje në dokumentet kurrikulare; - Mësimdhënia - qasja në mësimdhënie ku mbizotëron mësimi i orientuar vetëm në përmbajtje; - Detyrat e shtëpisë - qasja ndaj detyrave të shtëpisë dhe numrit të tyre; - Infrastruktura shkollore, përfshirë numrin e madh të nxënësve brenda në klasë/shkollë.

mësimdhënësit për të ligjëruar të gjithë materien, potencialisht me një mbulim sipërfaqësor të përmbajtjes (OECD, 2020).

Sipas njohësve e koordinatorëve të kurrikulës, kur kërkesat e kurrikulave për çfarëdo arsye shmangen, ose keqinterpretohen, nuk japin rezultate të kënaqshme në mësim. Mënyra e të mësuarit në shkollat tona veçohet si një aspekt me mjaft ndikim në rezultate të nxënësve, kjo pasqyrohet edhe në rezultatet PISA dhe në vlerësimet e tjera ndërkombëtare, si TIMSS dhe PIRLS, në të cilat Kosova ka marrë pjesë.

Një kurrikulë e mbingarkuar kërkon kohë cilësore për përvetësimin e saj, për faktin se në studimet aktuale koha e shtuar e mësimit është gjetur se ofron më shumë mundësi mësimi dhe lidhet me arritje më të larta akademike, ndihmon nxënësit me performancë më të ulët që të arrijnë nxënësit me performancë më të lartë. Megjithatë, më shumë orë mësimi nuk përkthehen automatikisht në rezultate më të mira dhe mësime cilësore (Alexandër dhe Flutter, 2009).

Këtë afërsisht e thotë edhe raporti i vitit 2015 i Programit të OECD-së për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (OECD, 2016), i cili theksoi se koha e shpenzuar për të mësuar gjatë një dite, si në shkollë, ashtu edhe jashtë kohës së mësimit në shkollë, gjegjësisht mësimit në shtëpi, nuk lidhet me performancën akademike të nxënësve (OECD, 2016).

Mungesa e kohës cilësore në mësim reflektohet edhe tek rezultatet e nxënësve kosovarë në studimin PISA 2015 dhe 2018, të cilët, edhe pse kanë mesatarisht 947 orë mësimi për një vit, kanë arritje minimale, apo përqindje të lartë të nxënësve që nuk e kanë arritur nivelin minimal të aftësive në PISA 2018 (në Shkenca 76.6% e nxënësve nuk kanë arritur nivelin minimal, në Lexim 78.7% e nxënësve, ndërsa në Matematikë 76.6% e nxënësve).

Ndikimi në mirëqenien e nxënësve. Pjesëmarrësit në studim, konfirmuan ndikimin mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e nxënësve. Nga pikëpamjet e tyre, ndikimi reflektohet me stres të nxënësve, lodhje, paraqitje e mosbesimit për të arritur rezultate në mësim, pasiguri në mundësitë e nxënësit, shqetësime, humbje të ambicies së nxënësve për angazhim në mësim, humbje të interesimit për mësim, lodhje fizike, lodhje dhe pasiguri

në detyra të shtëpisë, mbingarkesë psikike dhe emocionale, zhgënjim të nxënësve, mospërfshirje të nxënësve në aktivitete jashtëmësimore etj.

Gjetjet tregojnë se mbingarkesa kurrikulare ndikon në të gjitha dimensionet e mirëqenies së nxënësve, siç përshkruhen në studimin e OECD (2017) “Mirëqenia e nxënësve në PISA 2015”, përfshirë aspektet e mirëqenies së nxënësve, nga dimensionet psikologjike, sociale, kognitive dhe dimensionet fizike të mirëqenies.

Vetë nxënësit e konfirmojnë se lodhja e tyre shpesh paraqitet si rezultat i angazhimit të tepërt ose mbingarkesës me kohë mësimore, mësimet dhe detyrat të lidhura me mësimet. Shenjat e lodhjes, siç i përshkruajnë nxënësit, janë të ndryshme, si: shpërqendrimi, zvogëlimi i aftësisë për përcjelljen normale të mësimet, shqetësimet emocionale, stresi, mungesa e disponimit etj.

Në raport me mësimet dhe detyrat e shtëpisë, nxënësit e përshkruajnë stresin dhe lodhjen nga frika për mospërbushje të detyrave dhe mësimet në shtëpi, nga mungesa e informatave dhe udhëzimeve për bërjen e detyrave të shtëpisë.

Nxënësit shprehin ndjeshmërinë e tyre edhe në raport me shqetësimet që i kanë vërejtur te prindërit e tyre lidhur me mësimet dhe rezultatet që nxënësit i kanë arritur. Sipas nxënësve, ngarkesa me detyra të shumta dhe pritjet e prindërve për suksesin e tyre në mësim, në vlerësimet me nota, janë preokupimet dhe shqetësimet më të mëdha të prindërve të tyre. Kjo tregon se sa pak është punuar me prindër në informimin e tyre për rëndësinë e zhvillimit të kompetencave tek fëmijët e tyre, përtej numrave dhe notave të vlerësimit.

Nxënësit janë të ndryshëm, ata mësojnë me stile të ndryshme, por edhe përparimin dhe ngecjen i manifestojnë me mënyra të ndryshme të sjelljeve. Këtë të fundit e thonë edhe nxënësit e përfshirë në këtë studim, kur flasin për ndryshimet dhe shqetësimet e vërejtura te bashkëmoshatarët e tyre me sukses/rezultate mesatare ose të ulëta në mësim. Sipas tyre, shpesh sjelljet manifestohen me stres, humbje kontrolli, nganjëherë edhe konflikte me

mësimdhënës dhe konflikte në mes të nxënësve, deri në bullizëm ndërmjet nxënësve.

Në raport me ndikimin në mirëqenien e nxënësve, se si perceptohet nga prindërit, vlen të theksohet se prindërit i përshkruajnë disa detaje të ndryshimeve emocionale dhe në sjellje të fëmijëve të tyre nga mbingarkesa me mësim dhe detyra gjatë mësimit në shkollë, por edhe gjatë mësimave dhe detyrave të shtëpisë. Përshkrimet e prindërve tregojnë se fëmijët shpesh rrinë pa humor, janë të lodhur, të stresuar, nervozë dhe të shqetësuar, në raste të caktuara shfaqin panik, traumë, lodhje psikike, pagjumësi nga ngarkesa e testeve të njëpasnjëshme, hezitim, humbje të durimit dhe motivimit për mësim etj.

Prindërit shprehin edhe shqetësimet e tyre për mirëqenien e fëmijëve, të cilat manifestohen me mërzitje, preokupim, angazhim në përkrahje të fëmijëve të tyre, por herë-herë edhe me presion ndaj fëmijëve për të mësuar më shumë. Duhet thënë se mbizotëron shqetësimi i prindërve më shumë ndaj rezultateve të fëmijëve të tyre nga vlerësimet me nota.

Një përmbledhje e ndikimeve të mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e nxënësve, sipas subjekteve të këtij studimi: nxënësve, prindërve, mësimdhënësve, drejtorëve të shkollave, koordinatorëve të cilësisë dhe njohësve e koordinatorëve të zhvillimit të kurrikulës, pasqyrohet në tabelën në vijim.

Tabela 34: Përmbledhje e karakteristikave të manifestimit të ndikimit të mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e nxënësve

Ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e nxënësve	
Nxënësit	<ul style="list-style-type: none"> - Lodhje dhe rraskapitje nga pesha e çantës; - Stres nga mësimet në shkollë; - Stres nga detyrat e shtëpisë; - Pa disponim dhe të stresuar nga vlerësimet e tepërta; - Me nerva gjatë kohës së ngarkesës me mësim në shkollë;

	<ul style="list-style-type: none"> - Të shqetësuar nga mosnjohja e detyrave të shtëpisë; - Dekoncentrim në mësim; - Të emocionuar, me stres dhe frikë për mosukseset në mësim; - Lodhje dhe frikë nga zgjedhjet e pasakta të detyrave të shtëpisë; - Humbje e kontrollit nga nxënësit që nuk kanë rezultate të mira; - Konflikte me nxënës dhe mësime nga nxënësit që nuk kanë rezultate të mira; - Humbje e interesimit për mësim.
Prindërit	<ul style="list-style-type: none"> - Shumë lodhje dhe stres; - Të mërzitur; - Mungesë motivimi; - Hezitim, nervozizëm, humbje e durimit; - Me panik, traumë, lodhje psikike, pagjumësi; - Ankesa në detyra të shtëpisë; - Mungesë interesimi për detyra.
Mësimdhënësit	<ul style="list-style-type: none"> - Stres te nxënësit; - Lodhje e nxënësve; - Mosinteresim për mësim; - Mbingarkesa me çanta të rënda, deformime trupore; - Padisponueshmëri, mungesë vullneti për mësim, refuzim për të mësuar; - Tërheqje nga mësimet; - Paraqitje e mosbesimit për të arritur rezultate në mësim; - Pasiguri në mundësitë e nxënësit, shqetësime;

	<ul style="list-style-type: none"> - Zhgënjim dhe për pasojë edhe humbje e dëshirës për mësim; - Jo ambicie për angazhim në mësim; - Rënie e interesimit të nxënësve për mësim; - Dyshime në kapacitete për mundësitë e arritjeve në mësim; - Probleme në angazhimit në klasë.
Drejtorët e shkollave dhe koordinatorët e cilësisë	<ul style="list-style-type: none"> - Të humbur, të pakoncentruar në mësim; - Lodhje nga detyrat e shtëpisë; - Pasivitet të disa nxënës; - Stresi i nxënësve dhe si pasojë "bullizimi"; - Lodhje, stres, ngacmime për shkak të numrit të madh të nxënësve në klasa; - Nxënësit me aftësi të kufizuar janë shumë të sfiduar; - Pasivë dhe të painteresuar për mësim; - Ngarkesa fizike me peshën e çantës; - Humbje të interesimit për mësim; - Lodhja nga puna me shumë tekste.
Njohësit dhe koordinatorët e zhvillimit të kurrikulës	<ul style="list-style-type: none"> - Lodhje nga mësimet në shumë lëndë; - Shqetësime, stres e ngarkesë; - Injorancë totale; - Humbje e interesimit për mësim; - Lodhje me detyra të shtëpisë; - Pasiguri në detyra të shtëpisë; - Mbingarkesë psikike dhe emocionale; - Mungesë kohe për aktivitete jashtëmësimore.

Të gjitha këto karakteristika të manifestimit të ndikimit të mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e nxënësve janë tregues, të cilët kërkojnë adresim

institucional, një pjesë e madhe e tyre në nivel shkolle, por edhe nga sistemi, duke pasur parasysh faktin se reforma kurrikulare është një proces, të cilin duhet menaxhuar në vazhdimësi në interes të mirëqenies së nxënësve. Vënia e mirëqenies së nxënësve në qendër të reformës së kurrikulës dhe arsimit në përgjithësi është e nevojshme për të siguruar një shoqëri gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe krijuese (OECD, 2020).

Ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në punën dhe mirëqenien e mësimitdhënësve. Ashtu si për nxënës, edhe për mësimitdhënës, nga pjesëmarrësit në studim, konfirmohet ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në punën dhe mirëqenien e mësimitdhënësve. Nga mësimitdhënësit, drejtorët e shkollave dhe koordinatorët e cilësisë mbingarkesa e kurrikulës shihet si një pengesë në punën dhe efikasitetin e mësimitdhënësve. Sipas tyre,

Sipas këtij grupi të respondentëve, në masë të madhe theksi i ngarkesës së mësimitdhënësve lidhet me aspektet administrative për kurrikulën, parapërgatitjet për kurrikulë me formate të shumta të modeleve të planifikimit mësimor, me sigurim të burimeve dhe adaptim të materialeve nga tekstet ekzistuese, për mungesë të teksteve në disa klasa në përputhje me kurrikulën, numrin e madh të nxënësve në klasa në shkollat urbane dhe, në mënyrë të veçantë, nga trysnia e kohës mësimore që kanë për zhvillimin e përmbajtjeve të përcaktuara me kurrikulat lëndore.

Në anën tjetër, gjetjet nga këto grupe të respondentëve tregojnë se është evident ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e mësimitdhënësve, i cili reflektohet me ngarkesë psikologjike, humbje e qetësisë emocionale, mbajtje në presion, humbje të kreativitetit në punë, kohë shtesë përtej orëve të mësimit për përgatitje të planeve mësimore dhe vlerësimin e nxënësve, jo efektiv nga puna e fokusuar vetëm me tekste shkollore, pasiguri dhe mosbesim në punë.

Ata, ndikimin e mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e mësimitdhënësve e shohin edhe me humbje të motivimit për punë, lodhje dhe frikë nga ndryshimet e shpeshta, lodhje dhe nervozizëm nga mbingarkesa në situata të caktuara, debate të shumta lidhur me zbatimin e kurrikulës, rezistencë në raste të caktuara ndaj zbatimit të kurrikulës, një fokusim më të madh në

punën me elementet administrative të kërkuara nga shkolla rreth kurrikulës etj.

Një bazë e ngarkesës së mësimdhënësve vjen edhe nga mosndarja formale dhe e duhur e detyrave dhe përgjegjësi të mësimdhënësve dhe balancimit të tyre me orët e mësimdhënies. Kjo ka shkaktuar mbingarkesë të një numër i mësimdhënësve, të cilët, krahas normës së plotë të mësimdhënies, kanë edhe përgjegjësi shtesë, si udhëheqës të aktiveve profesionale, kujdestarë klase dhe në role të tjera që lidhen me zhvillimin e shkollës.

Sisteme të ndryshme arsimore kanë bërë një balancim të ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi të mësimdhënësve me kohën e punës përtej mësimdhënies, duke i përcaktuar cilat prej tyre janë të detyrueshme për të gjithë mësimdhënësit dhe cilat për një pjesë të mësimdhënësve, të cilët duhet të kenë angazhime të veçanta. Balancimi i detyrave dhe përgjegjësi shtesë, në raport me kohën e mësimdhënies, ka bërë që të evitohet një pjesë e ngarkesës së mësimdhënësve¹⁶.

Është e rëndësishme të ritheksohet se mbingarkesa e kurrikulës nuk është e njëjtë me ngarkesën e tepërt të punës për mësimdhënës. Shumë faktorë të tjerë, përveç kurrikulës, kanë ndikim në ngarkesën e mësimdhënësve, të tilla si ndryshimet në strukturën administrative dhe të përgjegjësi, por edhe nga numri i madh i nxënësve në klasa (Easthope dhe Easthope, 2000). Mirëpo, mbingarkesa e kurrikulës mund të kërcënojë kompetencat e mësimdhënësve për të përballuar pritshmëritë, të ndikojë në nivelet e tyre të kënaqësisë me profesionin dhe t'i privojë ata nga ndjenja e tyre e lirisë, duke mos lënë hapësirë për kreativitet në punën e tyre (OECD, 2020).

5.5. Parashikimi i zgjidhjeve nga pjesëmarrësit në studim për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare

Nisur nga fakti se mbingarkesa kurrikulare është relative, e ndikuar nga shumë faktorë, në varësi të kontekstit të ballafaqimit me situata që reflektojnë mbingarkesën kurrikulare, edhe strategjitë duhet të jenë të

¹⁶ Më gjerësisht shih pjesën e gjetjeve të këtij studimi për kohën e punës së mësimdhënësve (4.2.6. Koha e punës së mësimdhënësve).

bazuara në nevoja reale dhe në kontekstin e zgjidhjes së problemit të lidhur me mbingarkesën.

Gjithnjë ka vend, arsye dhe nevoja për parashikuar zgjidhje të mundshme, strategji veprimi për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare, nga proceset që lidhen me zhvillimin e kurrikulës, shtrirjen e zbatimit të saj dhe, në mënyrë të veçantë, për procesin e zbatimit saj nga shkollat dhe mësimdhënësit, si zbatues të drejtpërdrejtë në punën me nxënës.

Prandaj, duke shikuar idenë e rolit të të gjitha grupeve të përfshira në këtë studim, janë diskutuar këto aspekte dhe janë gjetur ide dhe orientime të rëndësishme, të cilat presin veprime individuale dhe institucionale.

Për nivelin qendror, MASHTI-in, sugjerohet dhe kërkohet që të fillojë rishikimin e kurrikulës, në fushat/pjesët që konsiderohen bazike si mbingarkesë reale e kurrikulës, përfshirë:

- Ridefinimi i numrit të lëndëve mësimore në KB, me theks të veçantë në arsimin fillor;
- Ndërhyrja në kurrikulat lëndore ku ka mbingarkesë me tema mësimore, rezultate të të nxënit dhe në çështjet e tjera të ngritura si shqetësime të argumentuara nga mësimdhënësit dhe aktorët e tjerë;
- Vazhdimi i qasjes së integruar me fusha kurrikulare;
- Sigurimi i teksteve shkollore cilësore dhe në përputhje me kurrikulën;
- Ndryshimi në qasjen e punës me shkollat në proceset që lidhen me zbatimin e kurrikulës;
- Nxënësit dhe prindërit, në mënyrë të veçantë, nga MASHTI, kanë pritje dhe kërkojnë shkarkimin e çantës së nxënësve nga shumë libra shkollorë;
- Mbështetja e mësimdhënësve nga trajnerë kompetentë, që e njohin në thelb filozofinë e kurrikulës dhe anën përmbajtjesore e praktike të zbatimit të saj;
- Këshillim, udhëzime dhe udhëzues shtesë për mësimdhënësit;

- Evitimin e burokracisë në procesin e reformës kurrikulare, apo adresë të qartë për Përgjigje kërkesave dhe nevojave të shkollave për çështjet që lidhen me kurrikulën;
- Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të kurrikulës etj.

Disa zgjidhje të mundshme për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare, që sugjerohen për MASHTI-n, shkojnë përtej kurrikulës, por që janë faktorë ndikues në perceptimin e ngarkesës kurrikulës dhe shihen nga njohësit dhe koordinatorët për zhvillimin e kurrikulës si veprime që ndikojnë pozitivisht në trajtimin e mbingarkesës kurrikulare, si:

- Rishikimi i programeve për përgatitjen e mësimitdhënësve para shërbimit;
- Koordinimi i MASHT-it me fakultetet e edukimit për përgatitjen e mësimitdhënësve;
- Rishikimi dhe zhvillimi i programeve për trajnimin e mësimitdhënësve në shërbim, në frymën e kurrikulës;
- Rishikimi edhe përshkrimi i detyrave të mësimitdhënësve, në përputhje me kornizën e zhvillimit të mësimitdhënësve;
- Nevojiten norma/standarde dhe udhëzime për organizimin e brendshëm të shkollës.

Disa nga veprimet që duhet të ndërmerren nga DKA-të, që pritet të ndikojnë pozitivisht në adresimin e shqetësimeve nga shkollat për mbingarkesën kurrikulare, të sugjeruara nga respondentët e këtij studimi, janë:

- Krijimi i kushteve dhe pajisja me mjete të TIK-ut, për zbatimin e kurrikulës në mënyrë efektive, internet të qëndrueshëm;
- Fokusim më shumë në përmbajtjen që ndikon në gjithë procesin arsimor dhe të mos fokusohen vetëm te forma, drejt kërkesave për llogaridhënie nga shkollat/mësimitdhënësit;
- Përkrahja në organizimin e punës së shkollave dhe në trajnimin e mësimitdhënësve;

- Përkrahja e shkollave me mjete, pajisje didaktike dhe mjete të tjera ndihmëse;
- Zvogëlimi i numrit të nxënësve në klasat/ shkollat me numër të madh të nxënësve, krijimin dhe pajisjen e kabineteve me mjete dhe të qasshme për punë praktike, internet etj.
- Mbikëqyrje e vazhdueshme e punës së shkollave dhe e performancës së personelit edukativ;
- Koordinimi i punës me drejtorët e shkollave për zbatimin e kurrikulës.

Veprimet që duhet të ndërmerren nga shkolla lidhen me udhëheqjen e proceseve në shkollë dhe, në mënyrë të veçantë, me mësimdhënien, qasjen ndaj punës me nxënës, me prindër, por edhe me mësimdhënës dhe gjithë personelin tjetër në shkollës që lidhet me procesin edukativo-arsimor. Disa nga veprimet që sugjerohen për shkollat që lidhen me një ndryshim në qasje, dhe që ka pritje se ndërmarrja e tyre shpie në trajtimin dhe zvogëlimin e mbingarkesës kurrikulare, janë si në vijim:

- Një rol më kreativ në udhëheqjen e shkollës, me mundësi për organizim ndryshe të orarit mësimor, organizim të klasës, gjithnjë në interes të nxënësve, drejt përmbushjes së tyre dhe evitimit të mbingarkesës;
- Një rol më dinamik në procesin e mësimdhënies, duke përshtatur, ndryshuar qasjen e mësimdhënies dhe vlerësimit. Duhet evituar atë që është e tepërt dhe duhet thjeshtuar mësimet për nxënës, sepse nuk është detyrim që çdo përmbajtje dhe detyrë në tekstet shkollore të zhvillohen me nxënës;
- Një qasje ndryshe ndaj problemeve të identifikuara nga mekanizmat e brendshëm të shkollës, duke shkuar në drejtim të zgjedhjes së problemeve, jo vetëm të konstatimit të tyre, drejt zhvillimit të kulturës për transparencë dhe dëshmi të saktë për arritjet dhe pengesat e zbatimit të kurrikulës gjatë procesit mësimor dhe për veprimet e ndërmarrja nga shkolla;

- Një shpërndarje ndryshe e përgjegjësi brenda personalitë mësimdhënëse në shkollë, ku secili mësimdhënësi të ketë një rol shtesë në shkollë, përtej mësimdhënies.

Për ta bërë realitet ndryshimin e paradigmës kurrikulare, institucionet arsimore duhet të trajtojnë me seriozitet strategjitë e sugjeruara më sipër për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare, në mënyrë të veçantë shkollat janë të thirrura të rimendojnë për atë se çfarë të ndryshojnë në fushëveprimin dhe strukturën e organizimit të mësimdhënies, çfarë duhet të prioritetizojnë apo të heqin nga përmbajtjet mësimore, pa krijuar konflikt në aspektin formal, si të menaxhojnë procesin e ndryshimit etj. (OECD, 2020).

Konteksti i kurrikulës së arsimit parauniversitar në Kosovë mundëson fleksibilitetin dhe autonominë e shkollës, lejon mundësitë që shkolla të operojë brenda shkallëve kurrikulare, pa qenë e detyrueshme t'i përgjigjet çdo kërkesë të kurrikulave lëndore, gjithnjë në interes të nxënësve, zhvillimit dhe përparimit të tyre.

Mirëpo, tradita e punës së shkollave dhe mësimdhënësve në Kosovë këtë e sfidon në masë të madhe, edhe për shkak të pikëpamjeve se të “kesh më pak tema për t'u mbuluar më thellë një kurrikulë shpesh ngre shqetësime për uljen e standardeve të arritjeve të nxënësve” (UNESCO, 2002).

Në anën tjetër, sipas studimeve nga Coker et al., (2016), Schwartz et al., (2009) dhe Laird et al., (2008), mësimi i më pak temave mësimore në thellësi më të madhe të tyre u ndihmon nxënësve të zhvillojnë të menduar më të lartë që mund të transferohet përtej lëndëve specifike, në fusha të tjera mësimore dhe probleme të reja.

Ndër të tjera, studimet argumentojnë se një fokus në të mësuarit në thellësi mund të përmirësojë jo vetëm arritjet akademike të nxënësve, por edhe kënaqësinë e nxënësve (cituar nga OECD, 2020). Prandaj, shkollat dhe mësimdhënësit duhet të kenë qasje me kreative në proceset e planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës për të siguruar zhvillimin e kompetencave të nxënësve dhe një qasje holistike në mësimdhënie.

KAPITULLI VI

Përfundime dhe rekomandime

Gjetjet nga ky studim tregojnë sa i rëndësishëm ishte një hulumtim i tillë rasti, për kontekstin e zhvillimeve në reformën kurrikulare në arsimin parauniversitar në Kosovë, e cila është e konceptuar me bazë kompetencat kryesore.

Kurrikula me bazë kompetencat, shihet si një përpjekje për ta bërë realitet një ndryshim të paradigmës kurrikulare, ndryshim i cili u përgjigjet kërkesave të shoqërisë, ndryshimeve shoqërore, teknologjike dhe ekonomike, por edhe në përpjekje për të evituar mbingarkesën kurrikulare nga qasja e bazuar në përmbajtje.

Analiza e dokumenteve kurrikulare në zbatim, e aspekteve që lidhen me kohën mësimore të detyrueshme, si një prej faktorëve të rëndësishëm për mundësinë e zbatimit të kurrikulës, si dhe përfshirja shtresave kryesore, apo palëve të interesit, që lidhen me zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës në mostrën e hulumtimit (mësimdhënës, nxënës, prindër, drejtues të shkollës dhe koordinatorë të cilësisë, njohës dhe koordinatorë për zhvillimin e kurrikulës), ishte tejet e rëndësishme. Kjo për faktin se gjetjet i diskutuam me evidencat në dokumentet kurrikulare, sipas hierarkisë së dokumenteve, si dhe i ballafaquam pikëpamjet e mostrës së hulumtimit në përpjekje për të dhënë përgjigje në pyetjen e diskutuar në vazhdimësi nga komuniteti arsimor: *A është mbingarkesa kurrikulare realitet apo perceptim?*

6.1. Përfundime

Përmbledhja e përfundimeve u referohet qëllimit të hulumtimit dhe pyetjeve kërkimore, të cilat e udhëhoqën këtë studim. Sipas rezultateve të studimit aktual, ngjashëm si në rezultatet e studimeve të tjera për mbingarkesën në mësim, mbingarkesën kurrikulare (Bekteshi, 2009; Alexandër & Flutter, 2009; NCCA, 2010; Majoni, 2017; OECD, 2020 etj.), konfirmohen elemente të mbingarkesës kurrikulare, të cilat vijnë nga faktorë të shumtë, të lidhur me dokumentet kurrikulare dhe burimet e tyre, por edhe nga

perceptimi i atyre që janë të lidhur me zhvillimin e kurrikulave dhe zbatimin e tyre në shkollë.

Studimi i tanishëm raporton për faktorë të shumtë të mbingarkesës kurrikulare, të përafërt si në rezultatet e studimeve të tjera, që referojnë mbingarkesën kurrikulare në kontekstin e zhvillimeve të reja në reformën kurrikulare (NCCA, 2010; OECD, 2020 etj.).

Faktorët e mbingarkesës kurrikulare, që shpërfaqen nga gjetjet e këtij studimi, janë: (i) zgjerimi i kurrikulës me lëndë mësimore, tema të përmbajtjes së re në kurrikulë, në përgjigje të kërkesave të reja shoqërore; (ii) mbingarkesa e përmbajtjeve dhe pritshmërive për nxënës në raport me kohën mësimore të detyrueshme; (iii) mbingarkesa e lidhur me shkollën, nga qasja në organizimin e procesit mësimor, mësimdhënia, përdorimi i teksteve shkollore, detyrat e shtëpisë, vlerësimi i nxënësve, e cila reflektohet si mbingarkesë e perceptuar kryesisht nga komuniteti i shkollës i lidhur me rolin e tyre në zbatimin e kurrikulës.

Sipas rezultateve të studimit, ndikimi i mbingarkesës kurrikulare është evident si në suksesin dhe mirëqenien e nxënësve, ashtu edhe në efikasitetin dhe mirëqenien e mësimdhënësve. Ndikimi manifestohet në dimensionin psikologjik, social, kognitiv dhe fizik të mirëqenies (OECD, 2020).

Në raport me pyetjen e parë kërkimore: *Sa janë të dukshme aspektet e mbingarkesës kurrikulare në setin e dokumenteve kurrikulare në zbatimin, në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët në Kosovë?* Studimi nxjerr në pah evidenca të rëndësishme, që konfirmojnë elemente të ndryshme të mbingarkesës kurrikulare. Përfundimet kryesore, mbi bazën e gjetjeve të studimit për këtë pyetje, janë si në vijim:

- Zgjerimi i kurrikulës me lëndë mësimore, përmbajtje, në përgjigje të kërkesave të reja shoqërore, fillon në dokumentin e KKAP, zgjerohet me dokumentet e kurrikulave bërthamë dhe merr dimension më të madh të zgjerimit me kurrikulat lëndore, ku nga klasa e parë e arsimit fillor fillohet me 10 lëndë mësimore, për t'u zgjeruar me 15 lëndë mësimore, deri në klasën e nëntë të arsimit të mesëm të ulët.

- Pritshmëritë e larta në kurrikulat bërthamë, numri i kërkesave brenda një rezultati të të nxënit për fusha kurrikulare dhe thellësia e tyre, pa një standard të nivelit të përgjithësimit, pavarësisht kohës mësimore të përcaktuar për një fushë kurrikulare, përbën një bazë të mbingarkesës kurrikulare, e cila zgjerohet pastaj me kurrikulat lëndore, tekstet shkollore dhe nga qasja në mësimdhënie.
- Kurrikulat lëndore tregojnë për tendencë të zgjerimit të përmbajtjeve mësimore, nga numri i temave mësimore, numri i rezultateve të të nxënit dhe në shumë raste nga numri i kërkesave brenda një rezultati të lëndës (RNL) dhe thellësia e përmbajtjeve, të cilat në një numër të konsiderueshëm të lëndëve mësimore nuk kanë përputhje me kohën mësimore të detyrueshme, si një masë matëse e zbatimit të kurrikulës. Specifikohen në mënyrë të veçantë Njeriu dhe natyra dhe Matematika në arsimin fillor, si dhe Gjeografia në klasat 8 dhe 9.
- Çështjet ndërkurrikulare në kurrikulat lëndore, nga mënyra se si janë integruar në kurrikula lëndore, tregojnë se ka shpërputhje në mes të lëndëve mësimore dhe ka elemente të mbingarkesës, nëse të gjitha temat ndërkurrikulare në kuadër të një lënde mësimore merren për t'i integruar në mësimdhënie, krahas me ngarkesat e tjera me përmbajtje mësimore në kurrikulën e njëjtë.
- Koha e mësimit të detyrueshëm në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, në numër të orëve të mësimit, përbën gjithsej 8524 orë mësimi, me një mesatare prej 947 orë mësimi për një vit, më e lartë se në vendet e OECD-së me 7639 orë mësimi, me një mesatare prej 807 orë mësimi për një vit. Në raport me kohëzgjatjen e orës së mësimit në Kosovë, me mesatare 40-45 minuta për një orë mësimi dhe me një mesatare të vendeve të OECD-së 45-50 minuta për një orë mësimi, koha mësimore është e përfaqshme. Mirëpo, sfida qëndron në cilësinë e shfrytëzimit të kohës mësimore dhe në mungesën e formave alternative për mbështetjen e të nxënit të nxënësve.
- Kosova, edhe pse me një mesatare relativisht të mirë të orëve të mësimit në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët (klasat 1-9 = 947 orë mësimi për një vit) dhe me shpërndarje relativisht të lartë të kohës së

detyrueshme të mësimit për fushat kurrikulare/lëndë mësimore Gjuhë amtare, Gjuhë të huaja, Matematikë, Shkenca, me rreth 59 % në arsimin e mesëm të ulët, ka arritje tejet minimale në PISA 2015 dhe 2018. Kjo tregon se koha e shpenzuar për të mësuar nuk lidhet me performancën akademike të nxënësve (OECD, 2016).

- Marrëdhënia ndërmjet rezultateve të nxënësve në arsimin e detyrueshëm dhe kohës së mësimit nuk reflektohet mjaftueshëm edhe në Testin e Arritshmërisë (2022), me një mesatare prej 50.75% dhe me mesatare më të ulëta në lëndët mësimore me kohë mësimore të detyrueshme më të madhe. Sigurisht që rezultatet ndikohen edhe nga faktorët e tjerë, si numri i kërkesave dhe nivelet e vështirësive të tyre, të cilat kërkojnë analiza të tjera, që nuk ishin objekt i këtij studimi.

Edhe në raport me pyetjen e dytë kërkimore: *Si perceptohet mbingarkesa kurrikulare nga përfaqësuesit e komunitetit të shkollës dhe aktorët e lidhur me zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës?* Studimi nxjerr në pah çështje të rëndësishme të perceptimit për mbingarkesën kurrikulare, të parë dhe të përjetuar. Përfundimet kryesore mbi bazën e gjetjeve të studimit për këtë pyetje dhe nënpyetjet e saj janë si në vijim:

- Supozimi ynë se ka mbingarkesë kurrikulare reale dhe të perceptuar u vërtetua edhe nga mostra e hulumtimit (mësimdhënës, nxënës, prindër, drejtues të shkollës dhe koordinatorë të cilësisë, njohës dhe koordinatorë për zhvillimin e kurrikulës). Ata raportuan evidencë të mbingarkesës në lëndë të ndryshme, mbi të gjitha raportuan perceptimet e tyre të ndryshme për faktorët e mbingarkesës kurrikulare, të cilat vijnë nga natyra e ballafaqimit me kurrikulën, zbatimin e saj, por edhe nga njohja e kurrikulës. Nuancat e dallimeve janë në numrin e faktorëve nxitës, në renditjen e faktorëve, gjuhën e formulimit, rolin e tyre, si dhe në varësi të kontekstit specifik të ballafaqimit me situata, ku është parë apo përjetuar mbingarkesa kurrikulare.
- Faktorë, të cilët e kanë nxitur më shumë perceptimin për mbingarkesën kurrikulare, **nga mësimdhënësit** janë: Tekstet shkollore, puna administrative, numri i madh i lëndëve dhe temave mësimore,

rezultatet e të nxënit të ngarkuara në numër dhe në përmbajtje, dhe koha e pamjaftueshme në dispozicion për shtjellim të temave mësimore.

- Faktorë, të cilët e kanë nxitur më shumë perceptimin për mbingarkesën kurrikulare, **nga nxënësit** janë: Shpeshhtësia e vlerësimeve me teste, përmbajtjet mësimore - temat/njësitë mësimore; tekstet shkollore; detyrat e shtëpisë; mësimdhënësit dhe qasja në mësimdhënie.
- Bazuar në përgjigjet e nxënësve, me një shkallë të lartë të konfirmimit, më shumë se gjysma e mostrës së studimit me nxënës, konfirmohet se nxënësit angazhohen për mësim dhe detyra të shtëpisë mesatarisht 4-5 orë gjatë një dite, rreth 40 % rreth 1-3 orë, pjesa tjetër mbi 5 orë. Vetëm për detyra të shtëpisë, gjysma e nxënësve theksojnë se mesatarisht gjatë një dite ndajnë kohë për detyra të shtëpisë 2 -3 orë, rreth 1/3 e tyre nga 1 orë, kurse të tjerët mbi 3 orë vetëm në kryerjen e detyrave të shtëpisë.
- Faktorë, të cilët e kanë nxitur më shumë perceptimin për mbingarkesën kurrikulare, **nga prindërit** janë: Tekstet shkollore; ngarkesa me çanta; numri i lëndëve mësimore; përmbajtjet mësimore në tekstet shkollore; detyrat e shtëpisë, mësimdhënësit dhe format e mësimdhënies.
- Faktorë, të cilët e kanë nxitur më shumë perceptimin për mbingarkesën kurrikulare, **nga drejtorët dhe koordinatorët e cilësisë në shkolla** janë: Numri i lëndëve mësimore për klasë (vihet theksi në arsimin fillor); tekstet shkollore, përmbajtja e teksteve dhe terminologjia e përdorur; numri i temave mësimore dhe rezultateve të nxënit; koha mësimore në raport me përmbajtjet dhe RNL dhe qasja në mësimdhënie.
- Faktorë, të cilët e kanë nxitur më shumë perceptimin për mbingarkesën kurrikulare, **nga njohës dhe koordinatorë për zhvillimin e kurrikulës** janë: Qasja ndaj reformës kurrikulare dhe pritshmëritë e larta në kurrikulat bërthamë; numri i lëndëve mësimore, numri i madh i RNL-ve, numri i kërkesave të larta brenda një rezultati të të nxënit (RNL); përmbajtjet mësimore jo në raport me kohën mësimore për zhvillimin e tyre; tekstet shkollore - puna vetëm me tekste shkollore

pa mbështetje në dokumentet kurrikulare; dhe mësimdhënia - qasja në mësimdhënie, ku mbizotëron mësimi i orientuar vetëm në përmbajtje.

- Sipas rezultateve të studimit, konfirmohet se ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në arritjet/rezultatet e nxënësve reflektohet nga parcializimi i të nxënësve, të nxënësve sipërfaqësor, vështirësitë në të nxënësve, fokusimi në mësim mekanik, etj.
- Nuk ka dilemë se mirëqenia e nxënësve është e atakuar nga mbingarkesa kurrikulare. Kjo konfirmohet edhe nga rezultatet e studimit tonë. Bazuar në perceptimet e respondentëve të mostrës së studimit, ndikimi i mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e nxënësve, është i vërejtur nga lodhja dhe stresi, humbja e ambicies së nxënësve për angazhim në mësim dhe e interesimit për mësim, etj., Këto janë pasqyrime më të shprehura për ndikimin e mbingarkesës kurrikulare në mirëqenien e nxënësve.
- Në përgjithësi, mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave janë të informuar për elementet e mbingarkesës së nxënësve në mësim dhe për ndikimet nga mbingarkesa, mirëpo nuk konfirmojnë qasje institucionale dhe sistematike për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës së kurrikulës, më shumë kanë pritshmëri që këtë duhet ta bëjë niveli qendror, si zhvillues i politikave arsimore.
- Gjithashtu, nga rezultatet e studimit konfirmohet edhe mbingarkesa e mësimdhënësve, e cila në masë të madhe lidhet me nivelin e njohjes së kurrikulës, me aspektet administrative që lidhen me kurrikulën, parapërgatitjet për kurrikulë - me formate të shumta të modeleve të planifikimit mësimor, numrin e madh të nxënësve në klasa në shkollat urbane. Në mënyrë të veçantë, mbingarkesa e mësimdhënësve vjen nga trysnia e kohës mësimore që kanë për zhvillimin e përmbajtjeve të përcaktuara me kurrikulat lëndore, por edhe nga lidhja me traditën e mësimdhënies të bazuar kryesisht në përmbajtje dhe tekste shkollore.
- Në linjë me ngarkesën e mësimdhënësve nga mbingarkesa kurrikulare, pasqyrohet edhe ndikimi i mbingarkesës në efikasitetin e punës së mësimdhënësve dhe në mirëqenien e tyre. Sipas rezultateve të studimit, ndikimi reflektohet me ngarkesë psikologjike, mbajtje në

presion, humbje të kreativitetit në punë, pasiguri dhe mosbesim në punë, humbje të motivimit për punë, lodhje dhe frikë nga ndryshimet e shpeshta, rezistencë në raste të caktuara ndaj zbatimit të kurrikulës, si dhe një fokusim më të madh në punën me elementet administrative të kërkuara nga shkolla rreth kurrikulës, kundrejt fokusit në nxënës.

Përvojat e lidhura me zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës, mësimet nga këto përvoja, në mënyrë të veçantë nga ballafaqimet me mbingarkesën kurrikulare, nxitën respondentët e këtij studimi të shprehin mendime të ndryshme për zgjidhje e mundshme - strategjitë për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare. Ato lidhen dhe sugjerohen për nivelin qendror/MAShTI-in, nivelin lokal/DKA-të, shkollën dhe mësimdhënësit, në varësi të roleve dhe përgjegjësive.

Është shumë i shprehur diversiteti në ide për zgjidhjet e mundshme, strategjitë për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare, si në mostrën përfaqësuese nga shkollat, ashtu edhe nga njohësit dhe koordinatorët për zhvillimin e kurrikulës.

Diversiteti në ide për zgjidhjet e mundshme fillon nga idetë ku sugjerohet dhe kërkohet që të fillohet me rishikimin e kurrikulës, në ato që konsiderohen bazike, si mbingarkesë reale e kurrikulës, drejt sugjerimeve për adresim të shumë çështjeve që lidhen me arsimin parauniversitar që ndikojnë drejtpërdrejt në zbatimin e kurrikulës, përfshirë përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit, zhvillimin e mësimdhënësve, detyrat dhe përgjegjësitë e DKA-ve, shkollave dhe mësimdhënësve.

6.2. Rekomandime

Rekomandimet e studimit *Mbingarkesa kurrikulare në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë - realitet apo perceptim*, bazohen në gjetjet kryesore të studimit, idetë dhe sugjerimet e respondentëve të studimit, të cilët në një mënyrë kanë parë dhe përjetuar dimensione të ndryshme të mbingarkesës kurrikulare.

- Mbingarkesa kurrikulare, e pasqyruar në këtë studim, duke qenë reale dhe e perceptuar, në një fazë kur akoma ka dilema dhe diskutime kontradiktore rreth kurrikulës brenda komunitetit arsimor, nuk duhet neglizhuar. Sistemi duhet ta adresojë mbingarkesën kurrikulare si një problem të veçantë, nga një perspektivë më e gjerë, në kontekstin real dhe në dritën e mësimet kryesore të nxjerra nga vendet e OECD-së gjatë trajtimit të mbingarkesës kurrikulare (OECD, 2020).
- Sistemi arsimor është në një fazë të mirë pas përfundimit të shtrirjes së zbatimit të kurrikulës së re në të gjitha klasat e arsimit parauniversitar, ku mund të iniciojë dhe ndërmarrë strategji veprimi për trajtimin e mbingarkesës së kurrikulës gjatë një procesi të rishikimit të kurrikulave, duke iu përgjigjur në mënyrë të duhur argumenteve dhe mundësive për ri-përcaktim të kujdesshëm të asaj se çfarë mund të hiqet që konsiderohet mbingarkesë, asaj që mund të bartet në klasat e tjera dhe asaj që është thelbësore për t'u mësuar në kurrikulat e lëndëve përkatëse.
- Për çdo fazë të rishikimit të kurrikulave konsiderohen të rëndësishme zhvillimi dhe vendosja e standardeve për numrin e rezultateve të të nxënit, nivelin e përgjithësimin të rezultateve të të nxënit, në raport me kohën mësimore në dispozicion, gjithnjë duke ruajtur dhe marrë në konsideratë specifikat e fushave kurrikulare/lëndëve mësimore, por me idenë e preventivës ndaj mbingarkesës kurrikulare.
- Riorganizimi i mekanizmave këshillues dhe mbështetës për shkolla dhe mësimdhënës, më afër shkollës dhe mësimdhënësve, në autoritetet lokale dhe në shkolla, përtej adresimit të kërkesave administrative dhe të raportimit, janë domosdoshmëri për sigurimin e cilësisë, sigurimin e mbështetjes së qëndrueshme në procesin e zbatimit të kurrikulës. Qasja në riorganizimin e mekanizmave këshillues dhe mbështetës duhet t'u përgjigjet nevojave për organizimin e proceseve të mësimin në shkolla, përtej një rutine tradicionale, drejt hapjes së shkollës për alternativa të reja që ofrojnë mjedise dhe qasje mundësuese që nxënësit të mbështeten, të zhvillohen dhe të jenë më pak të ngarkuar, gjithnjë për të siguruar cilësi në mësim dhe mirëqenie për nxënësit.

- Nga mekanizmat institucionalë nevojitet mbështetje e shkollave, përmes zhvillimit të një seti të praktikës për shpërndarjen e detyrave dhe përgjegjësive të personalit mësimdhënës në shkolla, ku secili mësimdhënës të këtë një rol shtesë në shkollë, përtej mësimdhënies, të mbështetet dhe faktorizohet mësimdhënia. Po ashtu, të shtohet kujdesi për mirëqenien e mësimdhënësve nga zvogëlimi i ngarkesave në punë, të cilat mund/duhet të kryhen nga mënyra e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive të reja (OECD, 2021).
- Nevojitet rikonceptim i praktikës së udhëheqjes së zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle, në mënyrë që ajo të jetë e qëndrueshme dhe institucionale, të adresojë edhe problematikën e mbingarkesës kurrikulare, nga perspektiva reale dhe e perceptuar. Rekomandohet ndryshim në qasjen ndaj udhëheqjes, në zhvillimin e veprimeve praktike që kanë në fokus mirëqenien e nxënësve dhe që sigurojnë mbështetjen e duhur për nxënës në përmbushjen e pritshmërive në mësim.
- Përqendrimi i mësimdhënësve në punën me nxënës duhet të ndryshojë. Vazhdimi i mësimdhënies me një fokus në zhvillimin e përmbajtjeve mësimore, në shpjegimin e njësive mësimore dhe i bazuar vetëm në tekstet shkollore, nuk lejon ridimensionim të qasjes së mësimdhënies të bazuar në kompetenca. Ndryshimi i qasjes në mësimdhënie dhe në punën me nxënës është një ndryshim pa alternativë, ndaj të cilit mësimdhënësit duhet të reflektojnë me seriozitet për të ofruar qasje holistike në mësimdhënie.
- Krahas procesit mësimor dhe mësimdhënies në klasë, fokusi i kujdesit nga mësimdhënësit për mirëqenien e nxënësve duhet të jetë te përmbajtjet dhe te numri i detyrave të shtëpisë, te ndërrimi i qasjes pedagogjike në dhënien e detyrave të shtëpisë, duke vënë theksin në detyra më afatgjata, të bazuara në projekte dhe alternativa të kërkimit që promovojnë kompetencën Nxënës i suksesshëm. Duhet të arrihet një ekuilibër ndërmjet detyrave të shtëpisë komplekse dhe tepër të thjeshta (OECD, 2020).

- Prindërit duhet të angazhohen më shumë në jetën shkollore të fëmijëve të tyre, në përcjelljen e progresit të tyre, në krijimin e mjedisit mundësues për të mësuar në mënyrë të pavarur, në menaxhimin e orarit të mësimit në shtëpi dhe ruajtjen e ekuilibrit në mes të mësimit dhe aktiviteteve të lira, aktiviteteve relaksuese dhe kohës me bashkëmoshatarë. Në anën tjetër, shkolla duhet të intensifikojë bashkëpunimin me prindër, sepse prindërit e fuqizuar janë partneri më i mirë për një shkollë efektive (Rexhaj, 2019).
- Idetë dhe sugjerimet e dala nga respondentët e këtij studimi për zgjidhjet e mundshme, strategjitë për trajtimin dhe zbutjen e mbingarkesës kurrikulare, janë një vlerë e shtuar, një perspektivë mundësish për t'i marrë me shumë konsideratë, për vendosje apo rishikim të një politike arsimore që në thelb ka një strategji të mundshme për trajtimin dhe preventiven e mbingarkesës së kurrikulës gjatë rishikimit të kurrikulës, mirëpo edhe në menaxhimin e proceseve që kanë nxitur mbingarkesën e perceptuar, e cila në mënyra të ndryshme pengon cilësinë e procesit mësimor.

Rekomandime për hulumtime të mëtejshme. Gjetjet kryesore nga studimi hapin perspektivën për studime të mëtejshme, për eksplorimin më të plotë të problematikës së mbingarkesës kurrikulare. Në këtë drejtim mbetet të studiohet më shumë për mbingarkesën nga:

- Përmbajtja dhe aparatura didaktike e teksteve shkollore;
- Përmbajtja dhe aparatura didaktike e detyrave të shtëpisë;
- Qasja e drejtpërdrejtë e mësimdhënies, përmes vëzhgimit të një numri të konsiderueshëm të orëve të mësimit në klasa të ndryshme, në shkolla me organizime të ndryshme në procesin edukativo-arsimor.
- Përmbajtja dhe cilësia e programeve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve si dhe koherenca e tyre me nevojat e mësimdhënësve.

- Gjithashtu, është me vlerë studimi i kalimit të nxënësve nga një nivel i arsimit në një tjetër nivel të arsimit dhe ndërlidhja me efikasitetin e qasjeve në mësimdhënie.

Për vënien në jetë të të gjitha rekomandimeve të dala nga ky studim, është i domosdoshëm bashkërendimi i veprimeve institucionale, ndërmjet vendimmarrësve dhe profesionistëve (Mehmeti et al., (2021). Gjetjet nga ky studim, për mbingarkesën kurrikulare, në kontekstin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, dhe jo vetëm, paraqesin një referencë të qartë për ndërmarrjen e hapave konkretë, të planifikuar mirë, për zvogëlimin e mbingarkesës dhe të ndikimit të saj në mirëqenien e nxënësve dhe të mësimdhënësve, por edhe zbutjen e pabarazisë në shkollim, e cila vjen si një pengesë për të mësuarit, proces i cili po ashtu pengohet nga faktorë të shumtë që cenojnë suksesin dhe mirëqenien e nxënësve (OECD, 2017).

Literatura

- Alexander, R. and J. Flutter (2009). *Towards a neëw primary curriculum*. Part 1: Past and present, Cambridge Primary Review, Cambridge, <http://dx.doi.org/10.13140/RG.2.1.3460.008>.
- Bashkim, A. & Bekim, M., (2013). *Aparatura didaktike në librat e leximit të klasave 1-9*. Prishtinë, Instituti Pedagogjik i Kosovës.
- Bekteshi, S. B. (2009). *Mbingarkimi i nxënësve me mësim në shkollë*. Prishtinë: “Grafoprint”.
- Benevene, P., Simona, S., & Fiorilli, C (2020). Editorial: Well-Being of School Teachers in Their Work Environment Department of Human Sciences, Libera Università Maria SS. Assunta University, Rome, Italy. <file:///C:/Users/Fujitsu/Downloads/fpsyg-11-01239.pdf>
- Boshtrakaj, L. (autore), Rraci, E. & Bajrami, K. (2018). *Cilësia e teksteve shkollore në Kosovë*. Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN. <http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Cil%C3%ABsia-e-teksteve-shkollore-n%C3%AB-Kosov%C3%AB-Report-ALB.pdf>
- Boshtrakaj, L. (autore), Rraci, E. & Bajrami, K. (2018). *Sfidat e zbatimit të reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar në Kosovë*. Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN. <http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Sfidat-e-zbatimit-t%C3%AB-reform%C3%AB-kurrikulare-ALB.pdf>
- Buleshkaj, O. and Koren, A. (2022) ‘Educational leadership for the national curriculum implementation: the case of Kosovo’, *Int. J. Management in Education*, Vol. 16, No. 3, pp.259–275.
- Cattaneo, M., C. Oggenfuss and S. Wolter (2017). *The More, the Better? The Impact of Instructional Time on Student Performance*, *Education Economics*, Vol. 25/5, pp. 433-445, <https://doi.org/10.1080/09645292.2017.1315055>.
- Cooper, H., et al. (2006). Does Homework Improve Academic Achievement? A Synthesis of Research, 1987–2003. *Review of Educational Research* Spring 2006, Vol. 76, No. 1, pp. 1–62. <https://www.almendron.com/tribuna/wp-content/uploads/2016/02/Does-Homeëork-Improve-Academic-Achievement.pdf>
- Creswell, J. W. (2009). *Research design: Qualitative, quantitative, and mixed methods approach* (3rd ed.). Thousand Oaks, CA: Sage.
- Devetaku-Gojani, H. (2011). *Procesi i zhvillimit të Kurrikulit dhe i Planeve e Programeve mësimore në Kosovë 2001-2011*. Kërkime pedagogjike - përmbledhje punimesh, 2011, (f. 136-164). Prishtinë, Instituti Pedagogjik i Kosovës.
- Easthope, C. and Easthope, G. (2000). ‘Intensification, Extension and Complexity of Teachers’ Workload’, *British Journal of Sociology of Education*, Vol. 21/1, pp. 43-58, <http://dx.doi.org/10.1080/01425690095153>.

- Grillo, K. (2002). Fjalor Edukimi (Educational Glossary), (Psikologji-Sociology-Pedagogji). Tiranë: ISP.
- Gjokutaj, M., Hoti, I., & Kadriu, D., (2016). Fjalor temash në edukim (Shpjegues – Krahasues). Prishtinë: Dukagjini.
- Habili, B. (2018). Vlerësimi i detyrave të shtëpisë ndikimi i tyre në arritjet akademike të nxënësit. Universiteti i Tiranës.
[file:///C:/Users/Fujitsu/Downloads/Vleresimi i detyrave te shtepise ndikimi.pdf](file:///C:/Users/Fujitsu/Downloads/Vleresimi%20i%20detyrave%20te%20shtepise%20ndikimi.pdf)
- Huebener, M., S. Kuger and J. Marcus (2017). Increased Instruction Hours and the Widening Gap in Student Performance, Labour Economics, Vol. 47, pp. 15-34,
<http://dx.doi.org/10.1016/j.labeco.2017.04.007>.
- Joyce L. Epstein & Frances L. Van Voorhis (2001). More Than Minutes: Teachers' Roles in Designing Homework, Educational Psychologist, 36:3, 181-193,
https://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1207/S15326985EP3603_4
- Karameta, P. (2014). *Arsimi i gjeneratës tjetër – Konstruktivizmi, kurrikula, kompetenca*. Tiranë: Sara.
- Kuvendi i Kosovës (2006). Ligji Nr.02/L-67 për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2437>).
- Manninen, J. (2014). *Evaluation report: Qualitative stakeholder evaluation of the first year of implementation of në Kosovo curriculum*. Projekti i Binjakëzimit, i financuar nga BE dhe menaxhuar nga zyra e BE-së në Kosovë.
- Marash, J. Colin. (2009). *Koncepte themelore për ta kuptuar kurrikulumin*. Botimi i katërt në shqip. Tiranë, Qendra për Arsim Demokratik (CDE).
- Matthews, B./ Ross, L. (2010). *Metodat e hulumtimit*. Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane. Tiranë, Qendra për Arsim Demokratik (CDE).
- McCallum, F., Price, D., Graham, A. & Morrison, A. (2017). Teacher Wellbeing: A review of the literature. <https://apo.org.au/sites/default/files/resource-files/2017-10/apo-nid201816.pdf>
- Mehmeti, S. & Buleshkaj, O. (2017). Përdorimi dhe zbatimi i programeve mësimore të hartuara në bazë të kurrikulës së bazuar në kompetenca. *Kërkime Pedagogjike*, 2017 përmbledhje punimesh nr 6,. F. 10-50. Prishtinë, Instituti Pedagogjik i Kosovës.
- Mehmeti, S. et al. (2019). Kurrikula e bazuar në kompetenca - Përvojat gjatë zbatimit, sfidat dhe mundësitë. Prishtinë, Instituti Pedagogjik i Kosovës.
- Mehmeti, S. et al. (2020). Mësimi në distancë/e-mësimi në arsimin parauniversitar në Kosovë, në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID – 19. Prishtinë, Instituti Pedagogjik i Kosovës.

Mehmeti, S. et al. (2021). Ndikimi i COVID-19 në humbjet mësimore, pasojat në rritjen e pabarazive në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimit. Prishtinë, Instituti Pedagogjik i Kosovës.

Mehmeti, S., Buleshkaj , O. & Lynn, D. (2013). Mësimdhënia dhe të mësuarit – Programi për udhëheqje arsimore - Seminari dy -BEP. Prishtinë, Qendra për Arsim e Kosovës.

Ministria e Arsimit, e Sportit dhe e Rinisë. (2021). Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026. <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026.pdf>

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016). Korniza e sigurimit të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë. IPK, Prishtinë. <http://ipkmasht.rks-gov.net/kriteret-dhe-treguesit-e-cilesise-se-performances-se-shkolles>

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016). Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-kurrikulare-finale.pdf>).

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016). Kurrikula Bërthamë për Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor të Kosovës (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf>).

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016). Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës (https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-berthame-2-final_1.pdf).

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016). Udhërrëfyes për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021 (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/udherrefyes-per-zbatimin-e-kk-2016-2021-final.pdf>),

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2018, 2019, 2021). Kurrikulat lëndore/ Programet mësimore, Klasa e parë, klasa e tretë, klasa e pestë. (<https://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>).

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2018, 2019, 2020). Kurrikulat lëndore/ Programet mësimore, Klasa e gjashtë, klasa e tetë, klasa e nëntë. (<https://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>).

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.(2016). *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës* (e rishikuar). Prishtinë. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-kurrikulare-finale.pdf>

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit (2020). Raport vjetor statistikor me tregues arsimorë. <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/raporti-vjetor-statistikor-me-tregues-arsimore-2019-20.pdf>

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit (2021). Shënime statistikore 2021/2022. <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/raport-ujetor-statistikor-me-tregues-arsimore-2020-21.pdf>

Ministry of Education and Science of the Republic of Kazakhstan (2016), Organisation and Dosing of Homeöork of Kazakhstani students, http://iac.kz/sites/default/files/proekt_1_-_prezentaciya-.pdf.

Morgan, M. and D. Craith (2015), "Workload, stress and resilience of primary teachers: Report of a survey of INTO members", Irish Teachers' Journal, Vol. 3/1, pp. 9-20, <https://www.into.ie/app/uploads/2019/07/IrishTeachersJournal2015.pdf>.

National Council for Curriculum and Assessment (NCCA). (2009). Curriculum Overload in Primary Schools - An overview of national and international experiences. Irland, NCCA. https://ncca.ie/media/2052/curriculum_overload_in_primary_schools_an_overvieë_of_national_and_international_experiences.pdf

National Council for Curriculum Assessment (NCCA) (2010). Curriculum overload in Primary schools: An Overvieë of National and International Experiences , National Council for Curriculum Assessment,NCCA. https://ncca.ie/media/2052/curriculum_overload_in_primary_schools_an_overview_of_national_and_international_experiences.pdf

O'Neill, H. (Ed.) (2017). Wellbeing in Our Schools: International Perspectives. CIDREE Yearbook 2017. Dublin: National Council for Curriculum and Assessment. http://www.cidree.org/fileadmin/files/pdf/publications/CIDREE_Yearbook_2017_Wellbeing.pdf

OECD (2016). PISA 2015 Results (Volume I): Excellence and Equity in Education, <https://doi.org/10.1787/9789264266490-en>.

OECD (2017). PISA 2015 Results (Volume III): Students' Well-Being, PISA, OECD Publishing, Paris. <http://dx.doi.org/10.1787/9789264273856-en>

OECD (2020). Curriculum Overload: A Way Forward, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/3081ceca-en>.

OECD (2021). Scotland's Curriculum for Excellence: Into the Future, Implementing Education Policies, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/bf624417-en>.

Osdautaj, M., (2020). Gjendja e arsimit kosovar bazuar në testin PISA 2018. Prishtinë, Instituti Pedagogjik i Kosovës.

Peppers, J., Reid, E., Stylianidou, dr.F., Walsh, dr.P., & Young, prof. Michael (2005). *Planprogramet kombëtare në Kosovë – Vlerësim i hapave të parë*. Instituti i Edukimit, Universiteti i Londrës.

Potera, I. & Shala, L. (2018). Qëndrimi i mësimdhënësve ndaj kurrikulës së re. *Kërkime Pedagogjike - përmbledhje punimesh, 2018, f. 71-103*. Prishtinë, Instituti Pedagogjik i Kosovës.

- Potera, I., Mehmeti, S. & Zylfiu, H. (2017). Addressing students' wellbeing in the new Kosovo curriculum: Challenges and opportunities. CIDREE Yearbook 2017. Dublin: National Council for Curriculum and Assessment.
http://www.cidree.org/fileadmin/files/pdf/publications/CIDREE_Yearbook_2017_Wellbeing.pdf
- Qehaja, L., & Aliu, J. (2015). Ndikimi i cilësisë së mësimdhënësve dhe burimeve shkollore në rezultatet e nxënësve Kosovarë. Qendra për Arsim e Kosovës (KEC). Projekti “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN”, Prishtinë. http://kec-ks.org/ep-content/uploads/2018/10/PISA-2015-Results_ALB-1.pdf
- Ramaj, A. (2001). Formësimi didaktik i lëndës në tekstin mësimor. Prishtinë, Libri Shkollor.
- Rexhaj, Xh. (2019). Teori dhe strategji të mësimdhënies – Qasja konstruktiviste. Prishtinë, Kolegji AAB.
- Rivkin, S. and J. Schiman (2015). Instruction time, Classroom Quality, and Academic Achievement, The Economic Journal, Vol. 125/588, pp. F425-F448, <http://dx.doi.org/10.1111/eoj.12315>.
- Santiago, P., et al. (2016). OECD Reviews of School Resources: Estonia 2016, OECD Reviews of School Resources, OECD Publishing, Paris, <http://dx.doi.org/10.1787/9789264251731-en>.
- Schwartz, M. et al. (2009). Depth versus breadth: How content coverage in high school science courses relates to later success in college science coursework. Science Education, Vol. 93/5, pp. 798-826, <http://dx.doi.org/10.1002/sci.20328>.
- Shahini, G., (2022). Planet dhe programet mësimore në lëndën e gjuhës shqipe (niveli fillor dhe i mesëm i ulët). Prishtinë, Libri Shkollor.
- Thaçi, J. (2012). Problemet dhe te metat e teksteve shkollore - Analizë e teksteve shkollore të Kosovës të ciklit të Shkollës së Mesme të Ulët (klasat VI, VII, VIII dhe IX). Rishqyrtim i çështjeve të ngritura në studimin e vitit 2010. Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese - BIRN (Kosovë).
- UNESCO (2002). Building the capacities of curriculum specialists for education reform, UNESCO, Paris, http://www.ibe.unesco.org/fileadmin/user_upload/archive/curriculum/Asia%20Network.pdf/vienrepor.pdf
- Vogrinc, J., & Saqipi, B. (2020). Hulumtimi në shkencat e edukimit – këndvështrime konceptuale dhe metodologjike. Tiranë, Albas.
- Voogt, J., N. Nieveen and S. Klopping (2017). Curriculum Overload: A Literature Study, Unpublished OECD Reference Document, https://thehub.swa.govt.nz/assets/documents/42417_Monitoring-Evaluating-web-06042011_0.pdf.

Shtojcat

Shtojca 1: Lista e shkollave të përfshira në studim

Nr.	Emri i shkollës	Lokacioni/ Komuna
1	SHFMU "Faik Konica"	Prishtinë
2	SHFMU "Arfi Shala"	Korroticë e Poshtme, Drenas
3	SHFMU "Zekeria Rexha"	Gjakovë
4	SHFMU "Asdreni"	Pejë
5	SHFMU "Emin Duraku"	Prizren
6	SHFMU "Ilmi Bahtijari"	Bllaq, Dragash
7	SHFMU "Fan Noli"	Kamenicë
8	SHFMU "Martin Camaj"	Gurrakoc, Istog
9	SHFMU "Fazli Grajçevci"	Shipol, Mitrovicë
10	SHFMU "Tefik Çanga"	Ferizaj
11	SHFMU "Vëllezërit Frashëri"	Lipjan

Shtojca 2: Lista e zyrtarëve arsimorë dhe njohësve të kurrikulës të intervistuar

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita
1	Lindita Boshtrakaj	Njohëse e arsimit dhe reformës kurrikulare (pjesë e ekipit teknik për hartimin e Kornizës Kurrikulare)
2	Nizafete Kutllovci-Bardhi	Zv. Koordinatore, fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi
3	Mustafë Kadriu	Koordinator, fusha kurrikulare: Matematika
4	Mirlinda Dehari-Zeka	Zv. Koordinatore, fusha kurrikulare: Shkencat natyore

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Shtypi

Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë

Tirazhi: 500 copë

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

371.214(496.51)(047)

Mbingarkesa kurrikulare në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë : (realitet apo perceptim?) / ekipi hulumtues dhe autorët e raportit Selim Mehmeti ... [etj.]. - Prishtinë : Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2022. - 298 f. : ilustr. ; 24 cm.

Arsimi -- Programet mësimore

Raporte -- Kosovë

1. Mehmeti, Selim
2. Zylfiu, Haxhere
3. Mekolli, Skender
4. Aliu-Gashi, Mevlude
5. Shala, Luljeta
6. Potera, Ismet

ISBN 978-9951-591-60-7

Aleph [000105000]

ISBN 978-9951-591-60-7



9 789951 591607